UKZ ka në proces të ri/akreditimit edhe 12 programe studimi, prej të cilave në proces të ri akreditim ka gjashtë programe: Fillor dhe Parashkollor (BA), Shkencat Kompjuterike (BA), Finance dhe Kontabilitet i Aplikuar (BA), E-qeverisje (MA), Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (MA) si dhe për akreditim po ashtu ka në proces gjashtë programe të reja: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA), Mësimdhënie e Kurrikula (MA), Kontrolla e Sistemeve dhe Inteligjenca Artificiale (MSC), Menaxhim dhe Ndërmarrësi (MSC), Juridiko-Penal (MSc), Administrimi dhe e Drejta e Unionit Evropian (BSc).

Me tabelën në vijim paraqesim fakultetet, emërtimet e programeve dhe gradave përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve në këto programe:

Tabela 2: NJA dhe organizative të UKZ, numrin e programeve që ofrohen dhe gradat përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve. (UKZ)

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Bachelor i arsimit parashkollor
		Fillor	BA	Bachelor i arsimit fillor
2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
3.	Fakulteti Ekonomik	Banka financa dhe kontabilitet	BSc	Bachelor i bankave financave dhe kontabilitetit
		Menaxhment	BSc	Bachelor i menaxhmentit
		Marketing	BSc	Bachelor i makertingut
4.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat kompjuterike	BA	Bachelor i shkencave kompjuterike
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Bachelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Sh. Kompjuterike Fakulteti Juridik Fakulteti Ekonomik	E- Qeverisja	MA	Master i E- qeverisjes
7.	Universiteti i Gjilanit Universiteti i Prizrenit Universiteti i Pejës	Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike	MA	Master i Qeverisjes Lokale dhe Shoqërisë Demokratike

Në tabelën e mëposhtme jepet rrjedha e procesit të akreditimit të UKZ, si institucion dhe të programeve studimore:

Tabela 3: Procesi i akreditimit të UKZ dhe programeve studimore 2013-2021

<i>Faculty</i>	<i>Study Program</i>	<i>First</i>	<i>Riakreditation</i>
Institutional Akreditation		2014	2017
Education	Preschool education (BA)	01.10.2014 30.09.2016	- 01.10.2016- 30.09.2020
	Primary Education (BA)	01.10.2014 30.09.2016	- 01.10.2016- 30.09.2020
Economy	Banc a Finance and Countable (BA)	01.10.2014 30.09.2017	- 01.10. 2017- 30.09.2021
	Management (BA)	01.10.2014 30.09.2016	- 01.10. 2016- 30.09.2020
	Marketing (BA)	01.10.2014 30.09.2017	- 01.10. 2017- 30.09.2021
Law	General Law (BA)	01.10.2014 30.09.2016	- 01.10.2016- 30.09.2020
Computer Sciences	Computer Sciences (BA) Specialities: IE and SEW	01.10.2014 30.09.2016	- 01.10.2016- 30.09.2020
Applied Sciences	Mathematics Education (BA)	1.10.2019- 30.11.2022	
Fcs - FEc-FLaw	e- government	01.10. 2017- 30.09.2021	
UKZ-UPZ-UHZ	Local Governance and Democratic Society	01.10. 2017- 30.09.2021	


b. Udhëheqja institucionale, strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit;

Universiteti organizohet dhe qeveriset në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, në bazë të Statutit të UKZ dhe në bazë të rregulloreve përkatëse të UKZ. Universiteti përbëhet prej njësive akademike, të cilat qeverisen dhe administrohen në tri shtylla kryesore: KD, Senati dhe administrata. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues.

Organizimi i strukturave vendimmarrëse në çështjet akademike bëhet konform Statutit të Universitetit. KD merr vendime për hapjen dhe mbylljen e programeve studimore dhe njësive akademike. Për të gjitha çështjet akademike vendos Senati i Universitetit, të cilin e kryeson rektori. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga NJA të Universitetit, nga administrata dhe nga Parlamenti i Studentëve.

KF udhëheq dhe merr vendime për të gjitha çështjet akademike të Fakultetit. Dekani është menaxheri kryesor i Fakultetit dhe ai e prezanton Fakultetin në Senatin e UKZ

KF propozon programin studimor të ri i cili i dërgohet Komisionit të Studimeve për shqyrtim. Komisioni i Studimeve e shqyrton, e refuzon apo e propozon për miratim në Senatin e UKZ-së. Senati i UKZ-së e aprovon ose e refuzon propozimin e KF. Këtë mënyrë të organizimit e paraqesim në mënyrë skematike, si në vijim:



Emërimet e titujve për personelin akademik, bazuar në Statutin e UKZ-së, janë:

- Prof. dr. (profesor i rregullt)
- Prof. Asoc. dr. (profesor i asocuar)
- Prof. Ass. dr. (profesor asistent)
- Ligjërues
- Lektor
- korepetitor
- Ass. (asistent universiteti)

UKZ në vitin 2020 ka 45 staf akademik, prej të cilëve 2 janë ligjërues të lëndëve të arteve (Master of Arts), 4 janë asistentë (PhDcand.) dhe të tjerët janë doktor shkencash. Ky është një zhvillim i madh, kur të kihet parasysh fakti që në vitin 2016 UKZ ka pasur 4 profesorë me kontratë të plotë, 3 me gjysmë normë dhe disa asistentë. Gjatë këtyre viteve UKZ ka zhvilluar çdo vit akademik nga një konkurs për rekrutim të stafit të ri akademik dhe ka përkrahur asistentët që të përfundojnë me sukses studimet e doktoratës. Po ashtu, edhe 4 asistentët aktualë janë në prag të përfundimit të studimeve të doktoratës.

Edhe gjatë viti 2020/21 UKZ ka hapur konkursin për rekrutim edhe të 13 stafi të ri akademik.

Një kujdes të madh UKZ i ka kushtuar në këtë periudhë edhe avancimit të stafit akademik: gjatë vitit 2019/20 janë avancuar në tituj akademikë një numër i konsiderueshëm ti stafit akademik, e po ashtu edhe në vitin vijues 2020/21 është hapur konkursi për avancime të tjera. Të gjitha procedurat e avancimit bëhen në mënyrë transparente, duke respektuar në mënyrë strikte Rregulloren për pranimin në punë dhe avancimin e stafit akademik dhe udhëzimeve administrative të MASH, të cilat paraqesin revistat dhe platformat e indeksimit të revistave ku duhet të publikojë stafi akademik për avancim.

Stafi administrativ, përfshirë edhe sekretarin e përgjithshëm, i cili është menaxheri kryesor i administratës, ka 32 zyrtarë, të ndarë nëpër njësi të veçanta. Edhe në këtë pikë UKZ ka shënuar rezultat të prekshëm: në vitin 2016 UKZ ka pasur 16 zyrtarë administrativ dhe nga viti 2018 e këndej janë rekrutuar edhe 16 zyrtarë të tjerë, duke e bërë administratën e UKZ shumë më efikase. Po ashtu, UKZ ka një plan të rritjes edhe më tej të numrit të zyrtarëve, duke marrë me prioritet: Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Zyrën për Cilësi dhe Zhvillim Akademik, Bibliotekën Universitare etj. Po ashtu, UKZ ka planifikuar gjatë vitit 2021 edhe themelimin e Zyrës për Projekte, Zyrës për hulumtime Shkencore.

Kampusi i UKZ është në rrugën “Zija Shemsiu”, në qendër të Gjilanit. Ai përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të bashkuara në rikonstruktim. Kampusi është në kufi me Kampusin e Shkollave të Mesme të qytetit, duke e shndërruar gjithë zonën në zonë shkollore, dhe universitare. Kampusi nuk i plotëson të gjitha nevojat në zhvillimin dinamik të UKZ, prandaj Komuna e Gjilanit dhe Qeveria e Kosovës janë duke gjetur një zgjidhje për një kampus të ri të universitetit, e po ashtu edhe brenda kampusit të tashëm në vitin 2020 janë shtuar hapësira të reja mësimore dhe bibliotekare.

c. Studentët, prejardhja e tyre socio-ekonomike dhe informatat përkatëse kontekstuale rreth fushës në të cilën vepron institucioni;

UKZ është i hapur dhe nxitë të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet formale për t’u regjistruar në studime universitare, në programet të cilat akreditohen. Studimet zhvillohen në gjuhën shqipe. Procesi mësimor në UKZ zhvillohet prej orës 8:30 deri në orën 18:00, ndërsa për studimet master vazhdon deri në ora 20:00.

Në konkurset e rregullta për pranimin e studentëve të rinj, ftohen kandidatët të cilët kanë të kryer shkollën e mesme, pa ndonjë kufizim gjinie apo përkatësie tjetër. Në bazë të Statutit të UKZ, realizohen dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj, në qershor dhe shtator. Numri më i madh i studentëve është nga rajoni i Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Vitisë, Ferizajit, Kaçanikut, Hanit të Elezit, Partesh, Kllokot, Ranillug, por edhe një numër i konsiderueshëm është nga rajonet e tjera të Kosovës, sidomos në programet master, si dhe nga Serbia (komunat: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje) dhe nga Maqedonia Veriore (Kumanovë).

Pritet që për vitin akademik 2020/21 të ketë një interesim të shtuar nga studentët e rajonit të Kumanovës pasi që rruga Kumanovë-Gjilan është lëshuar për qarkullim me hapjen e pikëkalimit kufitar në [Stançiq mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut](#).

UKZ rezervon kuota të veçanta për pranimin e studentëve nga komunitetet e vogëla (serbë, turq, romë) apo nga komunat jashtë Kosovës (Serbi dhe Maqedoni e Veriut), si dhe lehtësira për pranimin e personave me nevoja të vecanta.

Që nga themelimi e deri më tash në UKZ janë regjistruar gjithsej 8174 studentë.

Tabela 4: Numri i studentëve të regjistruar në vitet 2013-2020

Viti akademik Fakulteti	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21	Totali
FEEd	401	210	277	221	202	196	167	199	1873
FJ	454	372	296	272	257	226	203	178	2258
FEk	608	608	497	386	245	244	234	235	3057
FShK		96	91	115	96	73	63	76	610
FShA							22	33	55
FShK, FEk, FJ: E-qever.					60	44	37	46	187
Juridik: QLSHD					50	28	22	34	134
Gjithsej	1463	1286	1161	994	910	811	748	801	8174

Prej 4904 studentëve të regjistruar deri në vitin 2016/17 kanë diplomuar gjithsej 1303 studentë, prej të cilëve 958 janë femra dhe 345 meshkuj, me një përqindje prej 26.6%.

Nga shifrat e mësipërme shihet një rënie e lehtë latente e studentëve të regjistruar dhe kjo shpjegohet:

- Me proceset globale dhe rajonale të migrimeve, ku Kosova nuk bënë përjashtim;
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë regjistruar një numër i madh i studentëve, të cilët kanë kaluar nga Universiteti I Prishtinës në UKZ.
- Sepse në dy vitet e para 2013-2014 janë pranuar një numër më i madh i studentëve (sipas vendimit të MASHT për vendet e rezervuara për komunitetet)
- Politikat e UKZ për zvogëlimin e kuotave të studentëve të pranuar në disa fakultete, si në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik;

Konkurrenca për një vend të studentit në UKZ është e madhe: në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin e Edukimit, në programet master, në Fakultetin e Shkencave Aplikative konkurrenca shkon 3-4:1, pra ka tre deri në katër kandidat për një vend të studentit. Në disa programe të tjera studimore, si në Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik konkurrenca është më e vogël.

Një interesim të veçantë UKZ i ka kushtuar edhe marrëdhënies numerike profesor-student. Kështu që tashmë kemi një marrëdhënie relativisht të mirë, të afërt me mesataren europiane: 1 staf akademik me 21 studentë (1:21). Shih këtë marrëdhënie në vitin 2020 tek standardi 8.

Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të UKZ-së ka dy karakteristika kryesore:

- Studentët e UKZ janë pothuajse të gjithë nxënës të cilat kanë kryer shkollimin e mesëm të lartë (12-vjeçar) dhe provimin e maturës (për të dy këto kualifikime merret numër i caktuar i pikëve të cilave u shtohen pikët e fituara në provimin pranues që e organizojnë fakultetet përkatëse);
- Nuk hetohet ndonjë dallim drastik i gjendjes ekonomike të studentëve, duke pasur parasysh që pagesa për regjistrimin e semestrave është i pranueshëm për studentët;
- Për studentët me gjendje të vështirë ekonomike, komunat nga të cilat vijnë ata, ndajnë rregullisht bursa për studentë. Bursa për studentët e shkëlqyeshëm ndan edhe Universiteti, sikurse edhe MASH-i. Po ashtu edhe organizmat e tjerë, ndajnë bursa për kategori të studentëve të shkëlqyeshëm, për studentët me vështirësi ekonomike dhe të tjera;
- Numri më i madh i studentëve të cilët jetojnë jashtë Gjilanit, për t'i ndjekur ligjëratat dhe aktivitetet e tjera mësimore, udhëtojnë. Duke iu falënderuar pozitës së Gjilanit që është afër vendbanimeve të shumicës së studentëve dhe zhvillimit të hovshëm të kompanive të transportit publik, nuk hetohet ndonjë ngecje në këtë drejtim.

Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve. Përfaqësimi i studentëve bëhet në të gjitha nivelet e menaxhimit të Universitetit dhe në të gjitha komisionet e përhershme.

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

UKZ ka një stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare afatgjatë, pasi si universitet publik financohet prej buxhetit të Republikës së Kosovës. Granti qeveritar është fond i lejuar nga buxheti i Kosovës, i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore.

Qëllimi i UKZ është edhe ta nxis Qeverinë e Kosovës që ta themelojë një fond suplementar për financimin e universiteteve publike në mënyrë jo-lineare: një fond në të cilin universitetet konkurrojnë dhe [fitojnë grante në bazë të performancës së tyre hulumtuese, programore e të tjera](#).

d. Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula

Mësimdhënia dhe mësim-nxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Ky proces është i orientuar kah studenti: studenti është qendra dhe i gjithë procesi funksionon në interes të ngritjes së tij intelektuale, hulumtuese dhe sociale.

Disa prej përparësive të UKZ janë:

- syllabuset e lëndëve rishikohen dhe miratohen në KF në fillim të semestrit;
- ligjëratat dhe ushtrimet organizohen me qasje dhe metoda fleksibile për studentin;

- përveç librave obligativë dhe atyre të sugjeruar, studentëve u vihen në dispozicion edhe materiale të nevojshme konkretizimi;
- organizohen vlerësime periodike dhe të vazhdueshme-gjatë tërë semestrit;
- përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning (SMU, Moodle, Google Meet, TEdu);
- konsultimet e rregullta me mësimdhënësit etj.
- në të gjitha programet studimore kujdes i kushtohet punës praktike; në disa programe në Fakultetin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Aplikative, në Fakultetin Juridik, praktika është pjesë obligative e programit studimor.
- Mësim-nxënia plotësohet edhe me aktivitete të lira akademike, të cilat zhvillohen përmes klubeve të ndryshme, si Klubi i Oratorëve, Klubi i IT, Klubi i Matematikanëve, të cilat mbajnë gara në fushat e tyre.

Vlerësimi i studentëve shprehet me notë të barasvlershme me Sistemin e Bolonjës.

1.4.Përmbyllje

UKZ po krijon shpresa të mëdha për shoqërinë e re kosovare, për të rinjtë, familjarët, për institucionet dhe për bizneset.

Duke qenë universitet i ri, UKZ ka mundësi të mëdha: ai nuk lëngon nga procesi i reformimit të një universiteti klasik, po gjithçka që krijohet bëhet sipas një modeli më të mirë të synuar nga universitetet bashkëkohore.

Si universitet i ri, UKZ e ka të qartë se ekziston për studentët dhe për shoqërinë. Qasja jonë në procesin e arsimit është orientuar kah studenti dhe kah mendimi kritik. Sistemi i memorizimit të të dhënave nuk është i mjaftueshëm për studentin bashkëkohor, nëse ai nuk mësohet me mendimit kritik, me multidisiplinaritetin, me botën virtuale dhe me tregun global të punës.

Ky është modeli i studentit të cilin synojmë ta krijojmë dhe besojmë ia arrijmë.

Standard 1. Misioni publik dhe objektivat institucionale

1.1. Institucioni ka një deklaratë misioni të definuar që përfshin tre shtylla kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet

Përputhshmëria e UKZ-së

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm UKZ) është themeluar në vitin 2013, me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Duke qenë universitet i ri, ai ka pasur mundësinë që të marrë përvojat bashkëkohore të universiteteve dhe të orientohet kah një universitet modern. Ai nuk e ka pasur problemin e reformimit, ashtu si e kanë shumë universitete të vjetra, sepse gjithçka që është krijuar është bërë mbi njohuritë, mbi arritjet dhe mbi përvojën moderne të arsimit të lartë në Kosovë dhe në Bashkimin Europian.

Misioni i UKZ është përshtatur me tre shtyllat kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet.

Misioni i UKZ është:

Tempull i dijes i cili kultivon nxënien dhe zhvillimin e dijeve, nxit mendimin kritik dhe shpirtin e ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik, përgatit të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të

qenë pjesë e një shoqërie virtuale dhe globale, pjesë e një tregu të hapur të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Ky mision është i mbështetur në disa shtylla: mësimi dhe dija; nxitja e mendimit kritik, shpirti i ndërmarrësisë, hulumtimit, zhvillimi teknologjik, ndihma në komunitet, shoqëria virtuale, globalizmi dhe tregjet e hapura të punës. Ky mision e shprehë shumë qartë orientimin e një universiteti të ri e bashkëkohor, i gatshëm të ballafaqohet me botën virtuale e globale, njëkohësisht duke patur kujdes e duke i zhvilluar vlerat themelore të shoqërisë njerëzore.

Për UKZ janë të rëndësishme sidomos disa nga këto shtylla të misionit, të cilat janë të elaboruara në objektiva specifike në

- “nxitja e mendimit kritik” është pikë themelore e procesit mësimor, pasi hapësira arsimore në Kosovë dhe në Ballkan ende nuk është reformuar tërësisht nga modeli i vjetër i mësimit memorizues. Për këtë arsye UKZ ka orientuar metodat e mësimdhënies me interaktivitet, duke e fokusuar studentin si aktorin kryesor në klasë dhe në aktivitetet e tjera akademike. Studenti është subjekti i procesit të ligjëratave dhe subjekti i detyrave të pavarura, të cilat i zhvillon në mbikëqyrje të mësimdhënësit. Metodrat e reja të mësimdhënies mbështeten kryesisht te interaktiviteti, te puna në grupe, te puna hulumtuese e studentit, te puna praktike e tij etj. Po ashtu, menaxhmenti nxitë formimin e klubeve të studentëve, në të cilat ata zhvillojnë aktivitete akademike pa ndikim të menaxhmentit dhe të vetë Parlamentit Studentor, si është rasti me Klubin e Oratorëve, të cilët zhvillojnë debate oratorike për tema të ndryshëm. Ne besojmë se duke e nxitë mendimin kritik në nxësim shpirtin ndërmarrës të studentit.
- “shpirti ndërmarrës” është ai student i cili zhvillon ide dhe projekte inovative dhe hapë rrugë të reja për të tjerët. Kështu, psh. Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike prijnë në këto aktivitete, përmes aplikimit të teknologjisë informative në procese të tjera biznesore. Virtualizimi i shërbimeve në stacionin e autobusëve në Gjilan është padyshim një prej shembujve të mirë të shpirtit ndërmarrës.
- “shoqëria virtuale” është një proces teknologjiko-social që po ndodhë kudo në botë. Periudha pas-Covid 19 do të dëshmojë se sa shumë ka ndryshuar bota në aspektin e teknologjisë virtuale. Shumë aktivitete të deritashme do të modifikohen dhe do të organizohen onlajn (konferenca, takime, ligjëratat etj.). në anën tjetër, brenda disa vjetëve shumë profile të vendeve të punës do të zhduken, duke u zëvendësuar me teknologji informative. UKZ është orientuar kah ky proces: ne po e realizojmë me sukses digjitalizimin e shërbimeve universitare dhe të shërbimeve studentore (platforma SMU), digjitalizimin e një pjese të procesit mësimor (edhe pas kalimit të pandemisë, një pjesë e procesit mund të vazhdojë onlajn, sipas interesit të studentëve), po ashtu po FSHK orientohet kah mekatronika etj. Studenti i diplomuar i UKZ është në gjendje të ambientohet me shumicën e vendeve të punës ku aplikohet TI.
- “globalizmi” dhe “tregjet e hapura të punës” janë dy koncepte komplementare për të cilat studenti i UKZ përgatitet që nga fillimi. Sa do proceset globaliste rrezikojnë shoqëritë dhe kulturat e vogla, ai proces ofron një mundësi të pakufishme për sukses dhe prosperitet, sepse eliminon të gjitha barrierat hapësinore, nacionale, kulturore, shtetërore etj. Kjo sjell vetvetiu “tregun e hapur” dhe studenti i UKZ edukohet të konkurrojë në cilindo treg të punës. Përdorimi i librave jo më të vjetër se 10 vjet në procesin mësimor e ka këtë kuptim. Edhe mësimi i gjuhës angleze e gjermane, apo objektivi për ta mësuar studentët e edukimit edhe gjuhën e shenjave po ashtu e ka këtë qëllim.

Po ashtu, misioni i UKZ është koherent edhe me parimet e aplikuara në:

1. Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë ([European Higher Education Area EHEA](#))
2. [Hapësirën Evropiane të Kërkimeve Shkencore](#).
3. [Udhëzimet e Komisionit Evropian për Arsimin e Lartë](#).
4. [Deklaratën e Bolonjës](#).
5. Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE) (Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, AESC);
6. [Konventën e Lisbonës](#).

Kjo arrihet përmes qasjeve të aplikuara nga universiteti të cilat fokusohen në trajtimin e studentëve si aktër të rëndësishëm për vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit si dhe në përfshirjen e tyre në strukturat vendimmarrëse të universitetit.

Universiteti jonë angazhohet në aplikimin e metodologjive të avancuara të mësimdhënies të cilat synojnë të rrisin interaktivitetin me studentë, theksojnë individualitetin e studentëve dhe marrin parasysh kërkesat dhe nevojat e studentëve gjatë procesit mësimor.

Në përputhje me parimet e zonës evropiane të arsimit të lartë ne përpiqemi të ofrojmë një ambient mbështetës të mësim nxënies, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, promovojmë dhe nxisim mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik në universitetet evropiane si dhe mbështesim punën kërkimore të stafit akademik.

Kohëve të fundit përpjekjet e universitetit tonë janë fokusuar edhe në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me tregun e punës me qëllim që programet tona të jenë në përputhje me kërkesat e tregut dhe të diplomuarit tanë të dëshmojnë kompetencë në përmbushjen e detyrave të tyre me rastin e punësimit.

Në përmbushjen e misionit të vet publik dhe vizionit të udhëheqësve të stafit akademik, UKZ mbështetet dhe promovon vlerat e veta themelore:

- Barazia në kushtet për fitimin dhe gjenerimin e dijes, e cila reflektohet në mos-diskriminimin e askujt;
 - Kreativiteti, i reflektuar në hapjen tonë ndaj ideve të reja dhe format e shprehjes, kureshtje intelektuale, gatishmëri për t'u ballafaquar me rreziqe dhe frymën sipërmarrëse;
 - Integriteti, i reflektuar në aderimin tonë me standardet më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale, si dhe në angazhimin tonë për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në çdo gjë që e funksionalizojmë;
 - Qëndrueshmëria, e reflektuar në angazhimin tonë të përbashkët për të udhëhequr me shembull në ruajtjen dhe mbrojtjen e interesit publik dhe në qasjen tonë ndaj planifikimit përgjegjës financiar;
 - Ekselencia: Kërkojmë përsosmëri. E kuptojmë rëndësinë e të menduarit kritik, disiplinën, përgjegjësinë dhe presim standardet shumë të larta për veten dhe të studentëve tanë;
- Lidhja: Jemi një ekip i integruar. Funksionojmë rreth parimit të besimit, bashkëpunimit dhe lidhjes në disiplinën tona të ndryshme dhe në të gjithë botën.

1.2. Misioni i institucionit është përcaktuar dhe nëse është rasti është rishikuar, bazuar në një proces konsultimi që përfshin palët e interesit të jashtme dhe të brendshme

Përputhshmëria e UKZ-së

Misionin e vet UKZ e ka hartuar në Strategjinë Zhvillimore 2017-2022. ([Shih doc. Strategjia Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2017-2022](#)).

Grupi që ka hartuar Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit të UKZ 2017-2022 ka qenë heterogjen, duke përfshirë strukturat e ndryshme brenda universitetit (menaxhmenti i UKZ-së, stafi akademik, stafi administrativ, studentët) ashtu edhe hisedarë (stakeholders) të jashtëm, si Drejtoritë e Arsimit në Komuna, përfaqësuesit e Bizneseve, përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit. ([Shih Vendimin 02/260 të dt.21.02.2017](#) [Vendimi për Grupin Punues 2017 për Strategjinë](#)).

Misioni është hartuar në një proces të hapur dhe në një proces konsultues me hisedarët e brendshëm dhe të jashtëm.

Misioni publik i UKZ është rishikuar edhe në vitin 2020, , kur është rishikuar PSt i UKZ, në mbështetje nga projekti HERAS Plus. ([Vendimi i KD nr.02/1971 të dt. 27.11.2020 për rishikimin e Strategjisë](#); vendimi për themelimin e Grupit Punues ([Vendimi nr.02/1970 të dt. 27.11.2020](#)). Në proces të rishikimit kanë marrë pjesë të gjithë hisedarët e arsimit të lartë: menaxhmenti i Universitetit, stafi akademik, stafi administrativ, studentët, BKI dhe punëdhënës të tjerë, Alumni, përfaqësues të arsimit në komuna, kryetarë komunash, përfaqësues të gjykatave, përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të komuniteteve si: personat me nevojë të veçanta, komuniteti i grave etj.

Misioni i rishikuar në vitin 2020 paraqet më drejt dhe më mirë qëllimet dhe prirjet e UKZ për një periudhë të mesme. Si u pa më lartë, aty theksohen disa nga konceptet kyçe për UKZ, gjë që nuk ka qenë ashtu me misionin e mëhershëm. Në misionin e mëhershëm UKZ është mbështetur te mësim-nxënja, roli në komunitet dhe konkurrenca e lirë, pra nuk është theksuar mjaftueshëm shtylla e hulumtimit shkencor, nuk është përmendur mendimi kritik, shpirti ndërmarrës dhe shoqëria virtuale e globalizmi. Me formulimin e ri të misionit ne besojmë se e shprehim më qartë, më kuptueshëm dhe më përmbajtësisht aspiratën tonë për arsimin universitar.

1.3. Misioni njihet nga anëtarët e komunitetit akademik të institucionit

Përputhshmëria e UKZ-së

Me vetë faktin se në hartimin e Strategjisë Zhvillimore dhe Planit të Veprimit të UKZ 2017-2022 dhe të Statutit të UKZ dhe rishikimit të Planit Strategjik 2020-2025 kanë marrë pjesë një grup i gjerë nga stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët e UKZ në rishikimin e misionit publik, ata e kanë të njohur mirë këtë mision. Shtyllat e misionit ata i prezantojnë në pritjen e studentëve në çdo fillim viti akademik. Ata veprojnë gjatë procesit të mësimdhënies dhe hulumtimit duke pasur parasysh misionin publik, për të përgatitur të rinj me dije shkencore bashkëkohore, të aftë për hulumtime dhe për të shërbyer në komunitet, në një shoqëri moderne dhe virtuale, me tregje globale të punës.

[Misioni publik i UKZ](#) është vendosur në ueb faqen e UKZ në një vend të dallueshëm dhe të qasshëm sapo të hapet faqja.

Po ashtu, në objektet e UKZ është vendosur misioni publik i shkruar në letër me format të madh, vendosur në mur, në mënyrë që kushdo që hyn apo del në objekt e vëren atë.

Misioni i UKZ vendoset edhe në të gjitha [broshurat informative](#) të UKZ.

Po ashtu, në programet studimore të UKZ gjithnjë përfshihet edhe misioni, në mënyrë që të gjitha palët, të brendshme e të jashtme, ta kenë të njohur dhe ta kuptojnë.

Vështirësi paraqet të kuptuarit e misionit nga disa hisedarë të jashtëm: disa biznese dhe ndonjë institucion tjetër publiko-privat ende nuk e kuptojnë thellësisht lidhjen midis studimit akademik dhe tregut të punës, duhet të elaborohet: aktivitete në industri, konferenca, këto aktivitete i bëjnë komunitetin akademik me misionin si dhe shfrytëzimin e dijeve universitare për nevojat e komunitetit e të biznesit. Për këtë arsye, UKZ mban takime me BKI dhe me hisedarë të tjerë, si drejtorët e arsimit nëpër komuna, kryetarë komunash, biznesmenë etj. dhe diskuton për misionin e UKZ, sidomos për impaktin e mësimit akademik në shoqëri dhe në ekonomi. Po ashtu, në të gjitha aktivitetet akademike që zhvillojnë strukturat e UKZ, si psh. Ceremonia e Diplomimit, Dita e Themelimit të UKZ etj. Ne i ftojmë hisedarët e jashtëm të marrin pjesë, gjë që edhe vijnë, dhe ata njihen për së afërmi me punën dhe misionin e UKZ.

1.4. Misioni institucional ofron një udhëzues efektiv për planifikimin strategjik, vendimmarrjen dhe funksionimin e institucionit

Përputhshmëria e UKZ-së

PSt i UKZ e ka zbërthyer misionin publik të UKZ në objektiva strategjike, të cilat shërbejnë si objektiva dhe qëllime strategjike për gjithë stafin e Universitetit. Kapitulli II i Planit Strategjik 2017-2022, i cili i orienton objektivat strategjike të UKZ, niset nga misioni publik i UKZ. (Shih: Strategjia Zhvillimore 2017-2022). Secila prej objektivave shërben si udhëzues për stafin e Universitetit dhe studentët në fushën e caktuar.

Secila njësi akademike dhe secila strukturë universitare ka një plan veprimi që mbështetet në Planin Strategjik dhe në objektivat strategjike. Këto plane veprimi azhurnohen në çdo vit. KD ka miratuar Rregulloren e KMZPSt në UKZ, Nr.02/2065, dt.03.12.2020, për realizimin e këtyre planeve të veprimit dhe përputhshmërinë e tyre me objektivat strategjike të Planit Strategjik. KMZPSt, i formuar nga rektori, raporton në KD dhe te Rektori për masën e zbatueshmërisë së PSt, KD dhe Rektori marrin vendime përkatëse për zbatimin sa më të mirë të PSt.

Në përputhje me misionin publik të UKZ janë edhe qëllimet e theksuara në Statutin e UKZ, neni 6 Misioni, ku theksohet misioni publik i UKZ, i cili shërben si pikë orientuese për arritjen e objektivave të UKZ (Shih Statutin e UKZ, neni 6).

1.5. Objektivat institucionale afatmesme dhe afatgjata janë në përputhje dhe mbështesin misionin

Përputhshmëria e UKZ-së

PSt i UKZ është hartuar mbi shtyllat kryesore të misionit institucional. Objektivat strategjike të Planit Strategjik e zbërthejnë misionin në këto objektiva (Shih: [Planin Strategjik 2017-2022](#)).

Nxitja e mendimit kritik dhe studenti në qendër të gjithë procesit mbështeten nga disa objektiva specifike:

- **Qendra Multidisciplinare të udhëhequr nga studentët.** UKZ të themelojë Qendrën Multidisciplinare, e cila ndërlidh kryerjen e punëve të ndryshme dhe shërbimeve për komunitetin.
- **Rritja e konkurrencës ndërmjet studentëve.** Nxitja e garave të ndryshme studentore dhe shpërblimi i më të mirëve, si në gjuhë dhe letërsi, matematikë, oratori, degë sportive, në arte etj. UKZ të ndihmojë financiarisht themelimin e klubeve për këto gara, në modelin e Klubit të Oratorëve, tashmë të themeluar dhe të nxisë shpirtin e konkurrencës të studentët.
- **Fryma akademike të studentët.** Nxitja e krijimit të frymës akademike dhe e kreativitetit në jetën e përditshme studentore.

Orientimi drejt tregut të hapur të punës dhe proceseve globaliste mbështetet nga disa objektiva specifike:

- **Programet studimore të jenë në përputhje me tregun e punës.** Të gjitha programet e reja që do të dërgohen për t'u akredituar në AKA, do të kenë studimin e fizibilitetit dhe asnjë program i ri nuk do të propozohet po që se nuk do të përputhet me nevojat e tregut të punës.
- **Krijimi i programeve në gjuhë të huaja.** Krijimi i programeve studimore në gjuhë të huaj për të shtuar mobilitetin e studentëve dhe të stafit akademik.
- **Të pasurohet dhe të digjitalizohet Biblioteka Universitare.** Përveç avancimit të mëtejshëm të digjitalizimit të universitetit, një rëndësi të madhe paraqet digjitalizimi i Bibliotekës Universitare, jo vetëm i shërbimeve, por edhe i fondit bibliotekar.

Në këtë pikë UKZ dallohet më shumë se çdo universitet tjetër publik në Kosovë: përveç numrit të madh të projekteve të Erasmus+ në të cilat kemi qenë apo jemi aktualisht partnerë dhe grantmbajtës, UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete ndërkombëtare, me të cilat zhvillon aktivitete akademike (si psh. Me Universitetin e Zug-ut në Zvicër me të cilët zhvillojmë mobilitet studimor të studentëve për çdo vit), ka edhe MoU me shumë universitete ndërkombëtare etj.

Rritja e hulumtimit shkencor dhe roli i UKZ në shoqëri mbështetet nga disa objektiva

- **Hulumtimi të ndërlidhet me zhvillimin e shoqërisë.** Studentët tanë të pajisen me njohuri të transferueshme dhe pas diplomimit të jenë konkurrentë në tregun vendor, rajonal dhe evropian të punës, duke përfshirë sektorin privat dhe publik.
- **Ofrimi i ekspertizave dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet dhe shoqërinë.** UKZ do të krijojë ekupe të ekspertëve të fushave të ndryshme, duke ofruar ekspertizë dhe shërbime të ndryshme për institucionet publike dhe private, duke ofruar shërbime për shoqërinë, për OJQ-të e ndryshme, etj.
- **Të formohet një Komision Qendror që do të mbikëqyrë punën kërkimore shkencore.** Komisioni do të përkrahë punën kërkimore-shkencore.
- **Të caktohen koordinatorët nëpër fakultete për punën kërkimore shkencore.** Dekanët e Fakulteteve kanë caktuar koordinatorët për punë kërkimore-shkencore.
- **Mbështetja, Financimi dhe shpërblimi për punën kërkimore shkencore.** Me Rregulloren për veprimtari shkencore çdo aktivitet hulumtues-shkencor i stafit të UKZ ndihmohet financiarisht, hulumtuesit më të mirë shpallen publikisht dhe marrin shpërblim financiar, stafi që publikon në revista me impakt të madh faktorin marrin shpërblime të veçanta etj.

1.6. Analiza SWOT për misionin dhe objektivat institucionale:

Tabela 5: Analiza SWOT për misionin dhe objektivat institucionale

Pikat e forta	Dobësitë
Të qenit universitet i ri: përvoja bashkëkohore dhe orientimi drejt një shoqërie moderne; UKZ është themeluar në një qendër si Gjilani, rreth të cilit gravitojnë një numër i konsiderueshëm i qyteteve të Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë Veriore;	Vështirësi në të kuptuarit e misionit nga disa hisedarë të jashtëm; Hapësirat e mjaftueshme pjesërisht, , ndikojnë në realizimin e vështirë të hulumtimeve;

Në UKZ studiojnë studentë nga të gjitha anët e Kosovës dhe jashtë Kosovës; Programet studimore të orientuara kah tregu i punës; Kultivimi i frymës akademike brenda universitetit; Programet studimore në trend me botën virtuale (shkencat kompjuterike, matematika arsimore, E-qeverisja, edukimi, qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike etj.); Bashkëpunimi me komunitetin, biznesin dhe industrinë; Imazhi pozitiv i Universitetit në komunitet; Orientimi i UKZ kah shoqëria moderne, multikulturore dhe kah tregu global i punës; Bashkëpunimi ndërkombëtar në projekte të Erasmusit dhe në projekte të tjera. Kerkund ne tekst nuk u elaboru deri tash	Në çështje të funksionimit të institucionit pamundësia e të vepruarit në mënyrë të shpejtë dhe fleksibile për shkak të procedurave të tejzgjatura burokratike.
Mundësitë	Rreziqet
Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes projekteve të Erasmusit dhe të fondeve të tjera publike e bëjnë më të realizueshëm misionin Stafi akademik i moshës së re me kompetenca për teknologjinë informative dhe prirjet virtuale të shoqërisë bashkëkohore; Thellimi i bashkëpunimit me bizneset dhe industrinë në të akceptuar të misionit të Universitetit Adaptimi i arritjeve të fundit teknologjike-shkencore në punën kërkimore dhe mësimore në UKZ; Rritja e mundësive të UKZ për lidhjen e mësimin akademik me praktikën dhe e interesimit të studentëve për mësimin praktik	Reformat e shpeshta nga MASH pa përfunduar reforma paraprake dhe Ndryshimet e shpeshta të Ligjit për Arsimin e Lartë; Politizimi i politikave arsimore nga struktura dhe nivele të ndryshme qeverisëse (si psh. ndërhyrjet politike në KSHC dhe përjashtimi i tij nga EQAR dhe ENQA); Moskuptimi i duhur nga ana e studentëve dhe e komunitetit për rëndësinë e vlerësimit korrekt të njohurive të studentëve nga profesori.

Standard 2. Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrata

2.1. Institucioni ka një plan strategjik për një periudhë minimale prej tre vjetësh

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ e ka miratuar Planin Strategjik në vitin 2017, për një periudhë prej pesë vitesh. Dokumenti është quajtur “Strategjia Zhvillimore e UKZ 2017-2022”. [Dokumenti është miratuar](#) më datë 02.05.2017.

Që nga viti 2018 çdo vit hartohet PV me të cilin janë detajuar objektivat strategjike dhe objektivat specifike të PS. Po ashtu secili fakultet harton në baza vjetore planin e tij të veprimit. (Shih Planet e Veprimeve të Njësive Akademike : [Fakulteti i Edukimit](#), [Fakulteti Ekonomik](#); [Fakulteti Juridik](#); [Fakulteti i Shkencave Kompjuterike](#).)

PS është rishikuar në vitin 2020. Duke parë dinamikën e madhe të zhvillimit të UKZ-së, menaxhmenti i universitetit ka hapur gjatë vitit 2020 procesin e diskutimit dhe të rishikimit të Strategjisë Zhvillimore 2017-2022.

Kjo dinamikë e shtuar nënkupton rritjen e numrit të programeve studimore, krijimin e nivelit të dytë të studimeve Master si dhe fillimin e bashkëpunimit për krijimin e programeve të doktoraturës, krijimin e Fakultetit të ri, rritjen e numrit të stafit akademik, rritjen e hulumtimeve shkencore, rritjen e numrit të stafit administrativ, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, rritjes së numrit të projekteve ndërkombëtare, rritjes së anëtarësimeve ndërkombëtare, etj. shumica e objektivave specifike të parapara në PSt 2017-2022 janë realizuar ose janë në proces të realizimit në vitin 2020, prandaj u shtrua nevoja imediate për procesin e rishikimit, i cili nënkupton një ndryshim të vogël në përcaktimin e objektivave specifike në të cilat do të punohet deri në procesin e hartimit të Planit të ri Strategjik në vitin 2022.

Me datën 26.11.2020 KD ka marrë vendim për fillimin e procesit të rishikimit të strategjisë, i cili proces nuk do ta ndryshojë tërësisht, por do ta modifikojë Planin Strategjik me dinamikën e zhvillimit në UKZ. Në të njëjtën mbledhje KD ka themeluar Grupin Punues prej 35 anëtarëve, në të cilin janë përfaqësuar të gjithë aktorët kryesorë të UKZ-së, si dhe përfaqësuesit e hisedarëve të jashtëm të arsimit universitar. Pas marrëveshjes me projektin HERAS Plus, KD ka vendosur që ekspertët e HERAS Plus ta ndihmojnë UKZ në këtë proces të rishikimit.

Përveç PS të UKZ, strukturat e ndryshme në UKZ kanë hartuar edhe strategjitë sektoriale:

- ZBN ka hartuar “Strategjinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte”.
- **Senati i UKZ-së ka miratuar Strategjinë për Hulumtime Shkencore. Strategjia përkufizon se çfarë nënkuptohet me veprimtari kërkimore shkencore në UKZ. Strategjia ka listuar objektivat në hulumtimin shkencor. Ajo parasheh formimin e Qendrës hulumtuese që do të koordinojë aktivitetin hulumtues kërkimor.**
- Pas miratimit të ndryshimeve në PS në vitin 2020, UKZ ka miratuar dokumentin “TP në UKZ”, në të cilin ka listuar të gjithë TP për realizimin e PS në të gjitha nivelet.

2.2. Plani strategjik hartohet në konsultim të ngushtë me komunitetin akademik në institucion, si dhe aktorët e jashtëm dhe sektori privat

Përputhshmëria e UKZ-së

Planifikimi strategjik në UKZ fillon nga lart-poshtë. KD merr vendimin për fillimin e planifikimit dhe formon një grup të gjerë punues, në të cilin përfshinë të gjithë hisedarët e arsimit të lartë: menaxhmentin e lartë të universitetit, stafin akademik, administratën, studentët, hisedarët e jashtëm, studentët alumni, grupet e ndryshme të interesit etj. Ky grup organizon takime të veta ku bën planin për metodologjinë e punës: planifikon dhe organizon takime të veçanta me grupe të ndryshme të interesuara për arsimin e lartë, si me stafin akademik, me fakultetet, me administratën, me studentët, me bizneset, me punëdhënës të tjerë, me OJQ të ndërlidhura me arsimin e lartë etj.

Pas dëgjimeve në grupe të veçanta, GP harton një draft të PS dhe e vendos në diskutim publik: vendoset në ueb faqen e Universitetit por edhe u dërgohet në adresa të gjithë hisedarëve të mundshëm të arsimit të lartë. Pas dëgjimit publik GP në një punëtori diskuton inkuorporimin e propozimeve a të komenteve të hisedarëve në PS.

Pas inkuorporimit edhe të propozimeve nga dëgjimi publik, GP ia dërgon draftin KD, i cili e diskuton në një mbledhje të veçantë dhe e miraton.

Pas miratimit PS publikohet në ueb faqe dhe shtypet edhe në kopje fizike, u shpërndahet hisedarëve të arsimit të lartë, ndërsa brenda Universitetit bëhet e qasshme për të gjithë.

Kështu, për shembull, ka ndodhur edhe me procesin e rishikimit të PS në vitin 2020.

PSt i UKZ 2017-2022 është rishikuar në vitin 2020 dhe rishikohet në vijimësi dhe merret parasysh për çdo program të ri studimor që hartohet. Vendimin për fillimin e procesit të rishikimit dhe për formimin e Grupit Punues e ka marrë KD. [Grupi Punues ka një përbërje të gjerë](#), ku përfshihen të gjithë hisedarët e arsimit të lartë: anëtarët e KD, rektori, të gjithë prorektorët, të gjithë dekanët e fakulteteve, përfaqësues të studentëve, zyrtarë të administratës, studentë alumni, bizneset dhe përfaqësues të BKI, përfaqësues të Komunave, përfaqësues të Drejtorive të Arsimit në Komuna, Kryetarja e komisionit për arsim në Kuvendin e Kosovës, përfaqësues të gjykatave themelore, hisedarët e tjerë si: OJQ-të për të drejtat e grave, OJQ-të për personat me nevoja të veçanta etj.

Për rishikimin fillestar të PS të UKZ janë mbajtur pesë punëtori. Më 10-11. 12. 2020 është mbajtur dy punëtori të Grupit të ngushtë, në të cilat GP ka sugjeruar ndryshimet që duhet bërë në Planin Strategjik, duke propozuar të ndryshohet edhe emri i dokumentit nga “Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2017-2022” në **“PSt UKZ-së 2017 – 2022 (rishikuar në vitin 2020)”**.

Më datën 14 dhe 15 dhjetor 2020 është organizuar punëtorja e tretë me hisedarët e brendshëm të Universitetit, ku janë ftuar të gjitha strukturat udhëheqëse dhe përfaqësuesit e të gjitha strukturave të UKZ. Aty janë diskutuar gjerësisht të gjitha ndryshimet e mundshme dhe, sidomos, janë diskutuar dhe vendosur objektiva shtesë specifike.

Më datën 17 dhjetor është organizuar punëtorja e katërt me hisedarët e jashtëm. Në punëtori janë ftuar anëtarë të BKI të UKZ, biznesmenë dhe sipërmarrës të tjerë, kryetarë komunash, drejtorë të arsimit të komunave, përfaqësues të gjykatave, përfaqësues të OJQ si ata për persona me aftësi të kufizuara, të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të grave etj. Në këtë punëtori hisedarët e jashtëm kanë dhënë propozime interesante, disa prej të cilave janë inkorporuar në këtë Plan Strategjik.

Mbas kësaj punëtorie, GP e ka redaktuar tekstin e rishikuar të Planit Strategjik dhe e ka vënë në diskutim publik, më datë 19.12.2020. PS i UKZ është vendosur në ueb faqen e Universitetit, u është dërguar përmes emailit të gjitha anëtarëve të Grupit të Gjerë Punues, u është dërguar edhe hisedarëve të jashtëm, duke përfshirë MASH, QK, KPA, AKA, OJQ, që mbikëqyrin procesin e arsimit të lartë, kryetarëve të komunave në Kosovën Lindore, drejtorëve të arsimit nëpër komuna etj.

Hisedarët e jashtëm kanë komentuar draft-PS duke dhënë propozime, sugjerime dhe komente të tjera. Përfaqësuesja e fëmijëve me nevoja të veçanta ka propozuar që në FEd të futet një lëndë për mësimin e gjuhës së shenjave, si lëndë obligative, në mënyrë që edukatorët e ardhshëm dhe mësuesit të kuptojnë këtë gjuhë dhe ta përdorin me fëmijët me nevoja të veçanta nëpër klasat e tyre. Një zyrtarë e lartë e administratës publike ka propozuar që të zvogëlohen edhe më shumë orët e ligjëratave dhe të rriten orët e studimeve vet orientuese, punës praktike etj. Disa hisedarë, zyrtarë të arsimit nëpër komuna, kanë kërkuar që të krijohen programe studimore për profile në mungesë, si: programe studimore të gjuhës shqipe, të gjuhës angleze, të gjuhës gjermane, të doganave dhe shpëditionit etj.

Shumica e këtyre propozimeve të hisedarëve të jashtëm janë inkorporuar në PS.

Mbas procesit të diskutimit publik, mbas inkorporimit të disa propozimeve nga diskutimi publik në Planin Strategjik, KD i UKZ, në mbledhjen e dt. 29.12.2020 miratoi Planin Strategjik të UKZ 2017-2022 (rishikuar më 2020).

2.3 Planifikimi strategjik është i integruar me proceset buxhetore vjetore dhe afatgjata që sigurojnë rregullime të rregullta

Përputhshmëria e UKZ-së

Objektivat strategjike të Planit Strategjik janë llogaritur edhe në kosto financiare. Kjo është në përputhje me politikat dhe proceset vjetore dhe afatgjata të planifikimit buxhetor të UKZ dhe të Qeverisë së Kosovës. UKZ ka një siguri dhe qëndrueshmëri financiare, pasi financohet nga fondet publike, nëpërmes Qeverisë dhe KK.

Tabela 6 Buxheti tre vjecar i UKZ i projektuar. (Qeveria e Kosovës)

Kategoritë e Buxhetit	Viti 2021 - aprovuar	Viti 2022 - vlerësuar	Viti 2023 - vlerësuar
Pagat dhe Meditjet	1,297,643.00 €	1,297,643.00 €	1,347,423.00 €
Mallrat dhe Shërbimet	400,000.00 €	347,998.00 €	347,998.00 €
Shpenzimet komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet	100,000.00 €	100,000.00 €	100,000.00 €
Shpenzimet Kapitale	700,000.00 €	1,200,000.00 €	1,200,000.00 €
TOTAL:	2,547,643.00 €	2,995,641.00 €	3,045,421.00 €

UKZ i kushton rëndësi planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit duke e orientuar në realizimin e objektivave strategjike. Në vijim po japim tabelën me të dhënat e shpenzimit të buxhetit për vitin 2019 sipas disa fushave strategjike:

Nr.	Kategoria	Shuma	Perqindja
1	Burimet njerezore	1,246,356.52	71.05%
2	Infrastruktura- (projektet kapitale, shërbimet teknike, paisjet tjera, mirëmbajtja e kampusit, paisje të TI-së)	180,843.76	10.31%
3	Puna kerkimore shkencore UKZ dhe Erasmus+	143,440.00	8.18%
4	Projektet Nderkombetare	64,825.39	3.70%
5	Bashkepunimi nderkombetar	40,208.78	2.29%
6	Studentet	78,479.80	4.47%
	Totali	1,754,154.25	100.00%

Tabela 7 Orientimi i buxhetit drejt objektivave strategjike. (UKZ)

UKZ është aktive në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare për hulumtime, sidomos në ato të Erasmus+, dhe një pjesë të mjeteve financiare i merr nga ato fonde. Po ashtu, një pjesë të të hyrave UKZ i realizon nëpërmes të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos në kuadër të Programit Erasmus+, si grant-mbajtës apo si partner dhe nga të hyrat vetanake.

Tabela 8 Projektet Erasmus+ dhe Buxheti

<i>Akronimi</i>	<i>Emri</i>	<i>Koordinator</i>	<i>Buxheti</i>	<i>Afati i kontratës</i>
QUADIC	Quality development of international cooperation and project management (Ngritja e kapaciteteve në bashkëpunim ndërkombëtar dhe menaxhim të projekteve)	UKZ	991,381.00 €	36 M
STAND		IBCM		36 M
SIAHDP C		HC		36 M
STEAM Edu		Universiteti i Mostarit		36 M
e-VIVA	Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Eastern Balkan Universities - Ngritja dhe validimi i kompetencave në shërbim	Universiteti Evropian i Tiranës	56,075.00 €	36 M
SMAHPC	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center -Krijimi i Qendrës Multidisciplinare për studentë	Kolegji Heimerer	73,115.00 €	36 M
Research Cult	Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo Ngritja e kulturës së hulumtimit në IAL në Kosovë	Kolegji IBCM	53,440.00 €	36 M
ENEMLOS	Legal clinics in service of vulnerable groups: enhancing the employability of law students through practical education Ngritja dhe funksionalizimi i Klinikave Ligjore Në universitetet partnere përmes edukimit në praktikë	Universiteti i Podgoricës	90,586.00 €	36 M
QATEK	Towards a quality-oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo Ngritja e cilësisë së mësimi tek stafi dhe studentët në fakultetet e edukimit	Universiteti i Prishtinës	95,865.00 €	36 M
Rebus	Integrating And Validating Practical entrepreneurship skills in engineering and ICT studies - REBUS	Universiteti i Sarajevës	78,498.00	36 M
GreenTechWB		Universiteti i Vigos		36 M
EUFORIA		Universiteti i Stafordshir		36 M
Totali			1,438,960.00	36 M

2.4. Plani strategjik merr llogari të plotë dhe realiste të aspekteve të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e institucionit

Përputhshmëria e UKZ-së

PSt ka parasysh të gjithë aspektet e mjedisit të brendshëm të UKZ në zhvillimin e tij, si:

- potencialin akademik: UKZ hap çdo vjet së paku një konkurs për pranimin e stafit të ri akademik, me c'rast rekrutohen rreth 10 staf i ri akademik; nga viti 2019 ka filluar edhe procesi i avancimit të stafit akademik, me c'rast çdo vit hapet konkurs për avancim, dhe si

rezultat tah UKZ ka disa profesorë me titullin akademik Profesor i asocuar; kështu, UKZ i përmbush tash rreth 60% te kërkesave për staf akademik (pjesën prej 40% e ploteson me angazhimin e stafit të jashtëm;

- potencialin administrativ: UKZ është duke e rritur stafin administrativ, pasi nga viti 2019 për cdo vit shpallë konkurs për staf administrativ dhe ka pranuar në punë 16 zyrtarë të ri. Në total tash ka 32 zyrtarë, me të cilët plotëson rreth 80% të nevojave të veta. Po ashtu, në vitet 2019-2020 ka krijuar edhe nivelin e menaxherëve të mesëm dhe tash UKZ ka edhe udhëheqës zyrash, drejtor zyrash, zyrtarë të lartë etj.
- cilësia e ofruar në programet studimore dhe në zhvillimin e tyre praktik: [Rregullorja për Procedurat e Sigurimit të Cilësisë në UKZ është miratuar në vitin 2016](#), e rishikuar në vitin 2020. Ndërsa matja e cilësisë ka filluar në vitin 2018, me hartimin e Planeve të Veprimt për secilin fakultet dhe për administratën. në vitin 2018 është themeluar Zyra për Cilësi dhe Zhvillim Akademik dhe është caktuar drejtori i zyrës. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Zyra për Cilësi ka organizuar vlerësimin e studentëve për stafin akademik dhe për administratën. Në vitin 2020 është themeluar KMCV, i cili bashkë me Zyrën për Cilësi organizon vlerësime të shumanshme të cilësisë (vlerësimi i procesit nga menaxhmenti, nga stafi akademik, nga studentët, nga alumni, nga punëdhënësit, nga kolegët etj.). ka nje procedurë të qartë se si përmbillet cikli i vlerësimit të cilësisë dhe hapat që duhet ndërmarrë. Me këto zhvillime UKZ ka përmbushur rreth 80% të treguesve të performancës për cilësi.
- praktika e studentëve: ka zhvillime të rëndësishme në qasjen e UKZ për praktikën e studentëve. Praktika e studentëve është bërë pjesë obligatore e kurrikulës. Praktika e studentëve të FEd zgjatë në vitin e katërt deri në 15 javë, edhe në FJ ne vitin e katërt studentët kanë praktikë 15 javë, studentët e FShK kanë një lëndë “Projekt” i cili është punë praktike jashtë UKZ, njësoj edhe studentët e FShA kanë lëndën “Projekt”, ndërsa studentët e FEK obligohen që një pjesë të kohës të bëjnë praktika në biznese të ndryshme. Studentët e UKZ janë treguar të suksesshëm në këto praktika. Në vitin 2020, Drejtorët e Komunave për Arsim kanë kërkuar nga UKZ nënshkrimin e një marrëveshje me të cilën studentët tanë do të zëvendësojnë mësuesit dhe edukatorët që përkohësisht nuk mund ta zhvillojnë procesin mësimor si pasojë e Covid 19, ndonjë arsyeje tjetër etj. Me praktikën e studentëve UKZ ka realizuar të gjithë TP të paraparë.
- projektet ndërkombëtare: UKZ është liderë në projektet ndërkombëtare në Kosovë. Për pesë vitet e kaluar ne kemi qenë dhe jemi partnerë në 19 projekte të Erasmus+ dhe në disa projekte të tjera ndërkombëtare (Zug, LECU, Shpresa etj.). vetëm në vitin 2020 ne jemi pjesë e 9 projekteve të Erasmus+ ndërsa në njërin UKZ është Grantmbajtës (QUADIC). Me këtë sukses UKZ ka kaluar TP të paraparë.
- Bursat studentore: UKZ ndanë cdo vit bursa për studentët e shkëlqyeshëm. Konkurrenca është e hapur dhe transparente. Kriteret për bursë i cakton Senati ndërsa lartësinë e bursës e cakton çdo vit KD. Studentët e UKZ marrin pjesë edhe në bursat vjetore që i ndanë Komuna e Gjilanit (UKZ bashkëpunon me Komunën në këtë çështje) dhe në bursat që i ndanë MASHT. Deri në vitin 2019 UKZ nuk ka qenë e kënaqur me shumën që ia jep Qeveria për bursat studentore, por nga viti 2019 ka një përmirësim të dukshëm të kësaj shume.
- statusin arsimor, social e kulturor të studentëve: UKZ merr parasysh statusin e studentëve të vet. Për shembull, për studentët e rajonit të Preshevës e Bujanocit (Serbi) dhe ata të Kumanovës (Maqedoni e Veriut) standardi i pranimit në studime është i përshtatur për hapësirën arsimore të tyre në shkollimin e mesëm).

- hapësirat fizike (objekti) jo sa duhet të mjaftueshme: objekti i UKZ i plotëson pjesërisht kushtet për arsimin e lartë. Për këtë arsye në vitin 2020 UKZ ka bërë disa kontrata për renovimin e objektit, si renovimi 100% i Bibliotekës universitare, renovimi numrit më të madh të sallave të mësimi, renovimi dhe krijimi i zyrave për staf të ri akademik, është rinovuar 100% salla e Konferencave, është krijuar një amfiteatër i ri i vogël etj. Po ashtu, gjatë viti 2020 sallat janë pajisë me teknologji digjitale të re (smart table, projektorë etj.), salla e konferencave është pajisë me zërim etj. Nga planifikimi në PS ka mbetur pa u realizuar vetëm ngritja e një objekti të ri në Kampusin e UKZ, realizimi i së cilës nuk varet tërësisht nga UKZ, por edhe nga Komuna e Gjilanit dhe nga Qeveria e Kosovës.

PSt ka parasysh të gjithë aspektet e mjedisit të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e tij, si:

- buxhetin: UKZ kufizohet në pranimin e një numri të kufizuar të stafit akademik, apo në përkrahjen e kufizuar të veprimtarisë hulumtuese etj. për shkak të kufizimeve buxhetore. Prandaj UKZ nxitë Ministrinë e Arsimit që të ndryshojë mënyrën e financimit të universiteteve publike, duke ndarë buxhetin në dy pjesë:
 1. pjesa buxhetore për paga dhe investime kapitale (e njëjtë për të gjitha universitetet, varësisht nga numri i stafit akademik etj.)
 2. Pjesa buxhetore për performancë, e cila shpërndahet nëpërmes projekteve konkurruese publike (të cilën e fiton universiteti varësisht nga performanca).
- tregun vendor, rajonal dhe global të punës: (çdo program studimor e ka në hyrje një studim të fizibilitetit për tregun e punës; merren parasysh kërkesat e tregut të punës për llojin dhe nivelin e fuqisë punëtore etj.);
- dinamikën e zhvillimit të teknologjisë virtuale: çdo njësi akademike synon ta virtualizojë deri në një masë të caktuar procesin mësimor e hulumtues;
- kuptimi i misionit të UKZ në komunitet: UKZ organizon ngjarje të ndryshme ku e kyçë komunitetin, ose merr pjesë në aktivitetet e komunitetit, në mënyrë që sa më mirë të kuptohet roli dhe misioni i UKZ në komunitet.
- kuptimi i UKZ si universitet i të gjithëve dhe për të gjitha: UKZ nxitë të kuptuarit e UKZ si universitet i të gjithëve dhe për të gjitha. UKZ nuk është universitet “lokal” i Gjilanit e as vetëm për studentët e Kosovës Lindore. Tashmë në UKZ studiojnë edhe studentë të pjesëve të tjera të Kosovës, studentë nga Serbia dhe nga Maqedonia Veriore.
- “Profilizimi i universiteteve”: Një problem në këtë pikë paraqet politika e “profilizimit të universiteteve”, e cila është përmendur në pikën 7.6.3 të [Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021](#), por nuk është elaboruar. Kjo ka krijuar hapësirë për keqkuptim të “profilizimit” si detyrim që universitetet të kufizohen vetëm te disa profile programore dhe të mos lejohen të bëjnë konkurrencë njëri me tjetrin në programe të njëjta studimore. UKZ e sheh procesin e profilizimit si proces akademik dhe vetërregullues e jo si një proces politik, centralist dhe mekanik, ashtu si është artikuluar në vitet e fundit në qarqe politik-bërëse, duke përfshirë edhe MASH, në disa raste. Për këtë arsye në PSt objektivi 7 e trajton këtë çështje.
- politikat dhe shkallën e zhvillimit arsimor dhe ekonomik të Kosovës: UKZ nxitë bashkëpunimin e mësimi akademik me tregun e punës dhe biznesin. Cdo program studimor i ri në UKZ duhet të bazohet mbi një qasje ndaj tregut të punës. Themelimi i Fakultetit të Shkencave Aplikative është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

2.5. Zbatimi i planit strategjik monitorohet mbi objektivat afatshkurtra dhe afatmesme dhe rezultatet vlerësohen

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka miratuar Rregullore e KMZPSt në UKZ, [Nr.02/2065, dt.03.12.2020](#). Në bazë të kësaj Rregulloreje rektori ka formuar Komisionin për mbikëqyrje (KMZPSt), në të cilin përfshihen disa struktura të UKZ: KD, Zyra e Rektorit, Dekanët dhe studentët.

Në vitin 2018 raportet e zbatimit të PSt i ka bërë Zyra e Rektorit dhe Zyra e Dekanit për fakultetin e tij (Shih si model [Planin e Veprimit të Fakultetit të Edukimit](#),

Mirëpo ky model i kontrollit ka funksionuar vetëm për disa faza të vlerësimit, prandaj, duke mbështetur edhe rekomandimin e Ekipit të Ekspertëve nga akreditimi 2017, rektori ka formuar KMZPSt, i cili bën raporte periodikisht dhe në kontinuitet për masën e zbatimit të PSt.

KMZPSt mbikëqyr zbatimin e Planit Strategjik dhe bën raporte vjetore për KD dhe Rektorin, dhe sugjeron marrjen e masave të duhura. Kështu për shembull, KMZPSt ka përgatitur Raportin për Zbatimin e Planit Strategjik në fund të vitit 2020, të cilin duhet ta miratojë KD në fillim të vitit 2021.

2.6. Institucioni ka një sistem vendimmarrës dhe rregullore të brendshme të punës në përputhje me dispozitat aktuale ligjore

Përputhshmëria e UKZ-së

Menaxhmenti i UKZ është një strukturë shumë efikase, e përkushtuar për zgjidhjen e të gjitha çështjeve. Ajo takohet, në formate të ndryshme rregullisht dhe diskuton për të gjitha problemet, idetë apo veprimet që duhet të ndërmerren. Në anën tjetër, ajo kontrollon dhe vlerëson punë që bëhen. Udhëheqja e administratës po ashtu është efikase dhe e përshtatur me kushtet e punës, e gatshme që të kryejë të gjitha detyrat, edhe kur ato janë përtej përshkrimit të vendit të tyre të punës, ose përtej kohës së paraparë.

UKZ ka miratuar të gjitha rregulloret që rregullojnë vendim-marrjen dhe ka funksionalizuar organizimin e jetës institucionale. Këto rregullore janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, me Ligjin e Punës, me Ligjin për Shërbimin Civil, Ligji për Administratën Shtetërore, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e UKZ etj. Dhe janë të publikuara në ueb faqen e Universitetit.¹

Këto përgjegjësi të vendimmarrjes, llogaridhënies dhe kontrollit janë të rregulluara me statutin e UKZ-së dhe me rregullore të veçanta:


¹ Rregulloret e UKZ-së që rregullojnë vendimmarrjen, llogaridhënien dhe kontrollin:

1. Rregullore mbi punën e Këshillit Drejtues të UKZ, 02/1034, dt. 23.09.2015 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2016/01/Rregullore-mbi-pun%C3%ABn-e-K%C3%ABshillit-Drejtues-t%C3%AB-Universitetit-Kadri-Zeka-Gjilan.pdf>).
2. Rregullore mbi punën e Senatit të UKZ, Nr. 01/640, dt. 17.06.2015 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/07/rregullore-mbi-punen-e-senatit.pdf>).
3. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UKZ, 02/1531, dt. 13.10.2020 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/Rregullore-per-organizimin-e-brendshem-dhe-sistematizimin-e-vendeve-te-punes-2020.pdf>).
4. Rregullore për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të UKZ-së, Nr. 01/268-1, dt.23.02.2017 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2019/12/Rregullore-p%C3%ABr-themelimin-dhe-parimet-e-funksionimit-t%C3%AB-Bordit-K%C3%ABshill%C3%ABdh%C3%ABn%C3%ABs-t%C3%AB-Universitetit-Kadri-Zeka-n%C3%AB-Gjilan.pdf>).
5. Rregullorja për punën e Këshillit Botues në UKZ, Nr. 02/864, dt. 03.08.2020 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/Rregullore-p%C3%ABr-punen-e-K%C3%ABshillit-Botues-1.pdf>).

1. **Këshilli i Drejtues (KD)** i Universitetit është organi kryesor qeverisës i Universitetit. KD është përgjegjës për të gjitha çështjet e politikave strategjike dhe për politikën financiare dhe e zgjedh rektorin e Universitetit. KD zhvillon një plan strategjik i cili rishikohet çdo vit. Monitoron shfrytëzimin e efektshëm të burimeve. Miraton planet vjetore buxhetore dhe raportet periodike të shfrytëzimit të buxhetit. KD miraton dhe publikon Raportin Vjetor të Punës në UKZ.
Ai është trupi më i lartë llogari-marrës në UKZ. KD përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve: 4 prej tyre zgjidhen në çdo tre vjet në procesin e rregullt zgjedhor në Universitet, ndërsa tre prej tyre i emëron ministri i MASH, me vendim të veçantë. KD kryesohet, kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi, të zgjedhur nga KD, nga anëtarët e emëruar nga MASH.
2. **Rektori** është autoriteti kryesor menaxhues dhe akademik i Universitetit. Rektori i raporton KD. Rektorin e zgjedh KD për një mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhje dhe për një mandat tjetër, përmes një konkursi publik. Rektori është autoriteti që e përfaqëson Universitetin jashtë tij.
3. **Senati** është organi më i lartë akademik i Universitetit. Është organ vendim-marrës për të gjitha çështjet akademike.
Të gjitha organet qeverisëse të Universitetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash, nëse nuk përcaktohet ndryshe në Statut.
4. **Këshilli i Fakultetit dhe Dekani.** Organizimi i studimeve është në përgjegjësinë e fakulteteve. Fakulteti ka KF, i cili është organi më i lartë i tij për çështje akademike, ndërsa fakultetin e drejton dekani, i cili është autoriteti kryesor ekzekutiv i Fakultetit.
5. **Sekretari i Përgjithshëm.** Administrata e Universitetit udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit dhe për të gjitha çështjet administrative vendim-marrja i takon Sekretarit gjeneral.
6. **Parlamenti Studentor.** Për të gjitha çështjet e aktivitetit të studentëve, vendim-marrja i takon Parlamentit Studentor

Organogrami i më poshtëm tregon për vendimmarrjen, llogaridhënien dhe kontrollin brenda sistemit administrativ të UKZ-së.

Tabela 9 : Organogrami i organizimit dhe udhëheqjes së UKZ (UKZ)



2.7. Kriteret dhe proceset zgjedhore të vendimmarrësve dhe të pozitave të tjera të zgjedhura janë të qarta, transparente dhe të botuara në rregulloret institucionale

Përputhshmëria e UKZ-së

Të gjitha zgjedhjet, nga pranimi dhe avancimi i stafit akademik, pranimi dhe avancimi i stafit administrativ, zgjedhjet e menaxhmentit të Universitetit dhe ato të fakulteteve dhe të studentëve janë të rregulluara me statutin e UKZ dhe me rregullore të veçanta. Statuti dhe rregulloret janë të publikuara në ueb faqen e Universitetit.

Zgjedhjet e rregullta mbahen në katër vjet. KD shpallë zgjedhjet dhe cakton kufijtë për procesin zgjedhor dhe satën e përfundimit të tyre. KD themelon Komisionin Zgjedhor (në të cilin bëjnë pjesë edhe të dërguar të MASH), i cili udhëheq me procesin zgjedhor.

Sipas Statuti dhe këtyre rregulloreve proceset zgjedhore organizohen kështu:

1. **Këshilli Drejtues** i UKZ përbëhet nga shtatë (7) anëtarë me të drejtë vote. MASH emëron tre anëtarë me të drejtë vote, kurse Universiteti zgjedh katër anëtarë. Universiteti i zgjedh anëtarët e vet në proces të hapur e demokratik, ka të drejtë të konkurrojë secili staf akademik. Senati voton për zgjedhjen e tyre dhe ata zgjidhen me shumicë votash. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i KD zgjidhen me vota të KD nga radhët e personave që i ka emëruar Ministri i MASH.
2. **Rektori** zgjidhet sipas një konkursi të hapur publik, të botuar në media. Senati formon një komision për vlerësimin e përmbushjes së kushteve statutore të

konkurrentëve dhe ia bën një raport KD për kandidatët që i plotësojnë ato kushte. KD i fton kandidatët të prezantojnë para anëtarëve të KD programin e tyre udhëheqës me Universitetin. Anëtarët e KD u bëjnë pyetje kandidatëve dhe ata përgjigjen. Pas dëgjimit të prezantimeve, KD voton me votim të fshehtë për zgjedhjen e rektorit. Rektori i zgjedhur e merr vendimin për zgjedhjen dhe kontratën e punës, të dyja të nënshkruara nga kryesuesi i KD.

3. **Senati i Universitetit** themelohet mbas një procesi të zgjedhjes së anëtarëve të Senatit nëpër fakultete, në administratë dhe në Parlamentin Studentor. Secili fakultet zgjedh një senator, ndërsa dekani i fakultetit e përfaqëson fakultetin në Senat sipas detyrës. Administrata zgjedh një senator. PS zgjedh një senator, ndërsa kryetari i Parlamentit Studentor është anëtar Senati sipas detyrës zyrtare. Sekretari i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.
4. **Sekretari i Përgjithshëm** zgjidhet sipas një konkursi të hapur publik, të botuar në media. Rektori formon një komision i cili i propozon rektorit tre nga kandidatët më të suksesshëm, pas një procesi të intervistimit të kandidatëve. Rektori i propozon njërin prej kandidatëve KD dhe KD voton për kandidatin. Kontratën e punës së Sekretarit të përgjithshëm e nënshkruan rektori, ndërsa zgjedhjen e tij kryesuesi i KD.
5. **Këshilli i Fakultetit** themelohet nga stafi akademik brenda fakultetit. Çdo fakultet ka KF, anëtarët e të cilit janë: Dekani; Prodekani (ët); Deri në tridhjetë (30) anëtarë të zgjedhur nga radha e profesorëve të fakultetit; Deri në 5 anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve të fakultetit; sekretari i fakultetit; Një anëtar nga personeli jo akademik i fakultetit i zgjedhur nga personeli jo akademik i fakultetit; Një përfaqësues nga radha e studentëve, të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit.
6. **Dekani** është zgjidhet nga një proces i konkurrimit brenda fakultetit, pas shpalljes së zgjedhjeve për dekanë. Kandidatët votohen së pari në KF, pasi të kenë prezantuar programet e tyre të udhëheqjes së fakultetit. Kandidati që merr vota më së shumti dërgohet për votim në Senat. Senati e voton me shumicë votash. Vendimin për zgjedhjen e dekanit e nënshkruan rektori.
7. **Parlamenti Studentor** është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve. PS ka nëntë (9) anëtarë. Anëtarët propozohen nga organizatat studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore në fillim të fushatës zgjedhore. Anëtarët e Parlamentit të studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin. Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve e përgatitur nga këshilli i studentëve i njësisë akademike. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit

2.8. Përgjegjësitë e organeve vendimmarrëse përcaktohen në mënyrë të tillë që rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për politikën e përgjithshme dhe llogaridhënien, administratën e lartë për menaxhimin dhe strukturat akademike të vendimmarrjes, dallohen qartë dhe ndiqen në praktikë

Përputhshmëria e UKZ-së

Përgjegjësitë e organeve vendimmarrëse të Universitetit janë të përcaktuara qartë me Statutin e UKZ dhe me rregullore të tjera veçanta. Në Statutin e UKZ ndahen qartë përgjegjësitë e planifikimit dhe ato të ekzekutimit dhe llogaridhënies, vendimmarrja financiare, vendimmarrja akademike dhe vendimmarrja administrative:

Në Statutin e UKZ-së janë përkufizuar qartë dhe dallueshëm përgjegjësitë e secilit organ vendim-marrës, ato planifikuese, ekzekutive dhe kontrolluese:

- organi më i lartë drejtues është KD. Ai është përgjegjës për planifikim, për politikat strategjike, për monitorimin e shfrytëzimit të burimeve dhe për monitorimin e punës vjetore në zbatimin e PS. KD I përgjigjet kolektivisht Ministrit të Arsimit e të Shkencës.
- Rektorin është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive, ai është organi më i lartë ekzekutiv. Ai nënshkruan kontratat e punës dhe mbikëqyrë në baza ditore realizimin e PS dhe Planit të Veprimit, TP, etj. Ai kryeson Senatin.
- Senati është organi më i lartë për të gjitha çështjet akademike të Universitetit.
- Sekretari i Përgjithshëm është autoriteti kryesor i administratës së Universitetit.
- Dekani është autoriteti kryesor menaxherial i fakultetit. Ai kryeson KF dhe përfaqëson fakultetin në Senat.
- KF merr vendime me shumicë votash për çështjet akademik në fakultet ose i propozon Senatit çështje të ndryshme akademike për vendim-marrje.
- PS organizon jetën studentore dhe realizon të drejtat e studentëve të menaxhmenti i Universitetit.

Edhe në praktikën e punës së Universitetit, në të gjitha strukturat dhe nivelet, këto praktika ndiqen dhe nuk sfidohen.

Në rast të sfidimit të këtyre rregullave dhe procedurave, në rregullore janë të parapara mënyrat për zgjidhjen e problemeve.² Për shembull: nëse ka paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë, Komisioni Statutar ka autoritetin të vendos interpretimin e drejt të rregullave statutare dhe të gjitha organet detyrohen ta përfillin interpretimin e tij. Në raste të tjera, kur çështja ka të bëjë me etikën, KE merr vendime konform KdE. Në raste të tjera, kur ka të bëjë me çështje organizative ditore, rektori, dekani apo sekretari mund të formojnë komisioni ad hoc për vlerësimin e problemit, të cilat i sugjerojnë menaxhmentit ndërmarrjen e veprimeve.

² Dokumentet e UKZ që rregullojnë masat për sfidimin e rregullave dhe të procedurave:

- Statuti i UKZ (https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/06/Statuti_i_P%C3%ABrkoresh%C3%ABm_i_Universitetit_Publik_t%C3%AB_Gjilanit_110471-1.pdf);
- Kodi i Etikës (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2018/03/Rregullore-p%C3%ABr-Kodin-e-Etik%C3%ABs-n%C3%AB-UKZ.pdf>);
- Rregullorja për masat dhe procedurat disiplinore për stafin akademik dhe studentet Nr. 03/353, dt. 15.04.2014 (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2015/03/Rregullore-p%C3%ABr-Masat-dhe-Procedur%C3%ABn-Disiplinore-p%C3%ABr-Personelin-Akademik-dhe-Student%C3%ABt.pdf>),

2.9. Përfaqësuesit e studentëve janë anëtarë të të gjitha organeve vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative. Mekanizmi për zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve shpjegohet qartë në rregulloret e brendshme. Ekziston një procedurë zgjedhore demokratike, transparente dhe jo diskriminuese, e cila nuk kufizon të drejtën e studentëve për të përfaqësuar dhe për t'u përfaqësuar. Institucioni nuk është i përfshirë në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve

Përputhshmëria e UKZ-së

Studentët përfaqësohen në të gjitha organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe këshilluese. Studentet organizohen në Parlamentin Studentor i cili është organ përfaqësues i të gjithë studentëve. Në nivel të fakultetit studentët organizohen në Këshill të Studentëve të Njesisë Akademike, i cili është organ i përfaqësimit të studentëve të asaj njësie akademike.

Pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e KD e rregullon [Rregullore mbi punën e Këshillit Drejtues në UKZ, 02/1034, dt. 23.09.2015.](#)

Në Senatin e Universitetit ata përfaqësohen me dy anëtarë të përhershëm, të zgjedhur prej Parlamentit Studentor të UKZ. Kjo rregullohet me [Rregullore mbi punën e Senatit të UKZ, Nr. 01/640, dt. 17.06.2015.](#)

Studentët përfaqësohen edhe në të gjitha grupet punuese për politika afatgjata si dhe në të gjitha grupet punuese për hartimin dhe vlerësimin e programeve studimore.

Studentët përfaqësohen edhe në Këshillat e Fakulteteve, me anëtarë të përhershëm (Rregullore mbi zgjedhjet në UKZ dhe punën e këshillave të fakultetit, [Nr. 02/335, dt. 25.04.2016.](#)

Studentët përfaqësohen edhe në trupat e tjera ekzekutive apo këshillëdhënëse të Universitetit, si: Komisioni i Studimeve (Shih Statuti, Neni 95 pika 1.4) Komisioni i Etikës etj. (Shih [Rregullorja e Etikës](#), Neni 31 pika 1).

Organizatat studentore mbajnë zgjedhje të rregullta një herë në dy vite dhe procedurat e zgjedhjeve janë demokratike e transparente dhe të pandikuara nga stafi akademik apo menaxherial. Këto procedura zgjedhore rregullohen me [Rregullore për zgjedhjet studentore, Nr. 02/1188, dt. 28.09.2017.](#)

2.10. Institucioni i arsimit të lartë ka një administratë që është efektive në drejtim të organizimit, niveleve të personelit dhe kualifikimeve, dhe funksionon në mënyrë rigorozë

Përputhshmëria e UKZ-së

Në bazë të Statutit të UKZ dhe [Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës nr. 02/1531 te datës 13.10.2020](#), administrata qendrore e Universitetit është përgjegjëse për çështjet profesionale, administrative dhe teknike në lidhje me arsimin, kërkimet shkencore, administrimin e personelit, planin zhvillimor të Universitetit, aspektet financiare, mirëmbajtjen dhe dokumentimin e pronës, qarkullimin e mallrave, menaxhimin e sistemit të informimit, bazën qendrore të të dhënave fizike dhe elektronike dhe aspektet tjera të përgjithshme të administrimit të Universitetit. Të gjitha këto përgjegjësi ajo i kryen në mënyrë efektive.

Përgjegjësitë e administratës udhëhiqen nga Sekretari i përgjithshëm, i cili është zyrtari më i lartë administrativ i Universitetit.

Sekretari i Universitetit zgjidhet nga KD sipas propozimit të Rektorit të bazuar në Raportin e Komisionit profesional dhe të Konkursit publik. Administrata ka tri nivelet e menaxherëve: menaxherët e lartë, të mesëm dhe të ulët.

Administrata e Universitetit është e organizuar në nivel qendror-Administrata Qendrore, dhe në nivel të administratës së njësive akademike-Administrata e fakulteteve.

Në kuadër të Administratës Qendrore janë formuar zyrat e veçanta:

1. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi
2. Zyra për Buxhet e Financa
3. Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte
4. Zyra për IT
5. Zyra për Marrëdhënie me Publikun
6. Zyra për Çështje Akademike
7. Zyra për Prokurim
8. Zyra për Shërbime Studentore
9. Zyra për Burime Njerëzore
10. Zyra e Auditimit të Brendshëm
11. Zyra për Logjistike

[Organogrami i Administratës së UKZ-së gjendet në web.](#)

Stafi administrativ i Universitetit është i kualifikuar për vendet e punës. Kjo rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi, marrëdhënia e punës së nëpunësve të shërbime publike rregullohet me Ligjin e Punës, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në pjesën e pestë (PJESA E V-të NËPUNËSI I SHËRBIMIT PUBLIK), të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrat Publik.

Stafi administrativ i UKZ i pranuar në punë kalon nëpër procedurat e konkursit publik (të brendshëm dhe të jashtëm), i cili kërkon nga kandidatët plotësimin e kushteve të parapara me ligjet në fuqi.

Organizimi, funksionimi, nivelet, kualifikimet dhe efikasiteti i administratës rregullohen me rregulloret e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të Ligjit për Shërbimin Civil, me Statutin e UKZ dhe me [Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UKZ, Nr. 02/1531, 13.10.2020.](#)

Sipas [Ligjit për Shërbyesit Civil 03/L-149](#), menaxherët administrativë vlerësojnë një herë në vit performancën e zyrtarëve administrativë.

[Studentët bëjnë vlerësimin e stafit administrativ](#), të cilin e organizon ZZhAC.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	
<i>Te shkruhen zyrat</i>	<i>Personeli i zyrës</i>
Zyra e Rektorit	1 Asistente 1 Vozitës
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Sekretari i Përgjithshëm 1 Zyrtar Ligjor 1 Zyrtar Çertifikues 1 Asistent
Zyra e Personelit	Menaxheri 1 zyrtar për Arkiv
Zyra për Teknologji Informative	Udhëheqësi 1 Zyrtar për rrjet
Zyra për Buxhet dhe Financa	Drejtori 3 zyrtarë
Zyra e Prokurimit	1 Zyrtar
Zyra për Çështje Akademike	1 Zyrtar për Çështje Akademike 1 Zyrtar për Mësim
Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi	Drejtori

Zyra e Shërbimit të Studentëve	Udhëheqësi 6 Zyrtar për Shërbime Studentore 1 Zyrtar për Diploma
Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar	1 Zyrtar i Lartë i B.N 1 Zyrtar për B.N.
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	Udhëheqësi
Zyra për Logjistikë	1 Zyrtar i Depos
Zyra Administrative e Njësive Akdemike	1 Sekretar i Njësive Akademike
Biblioteka Universitare	1 zyrtar

2.11. Përgjegjësitë e stafit administrativ janë të përcaktuara qartë në përshkrimet e pozicionit dhe përputhen me kualifikimet e individit

Përputhshmëria e UKZ-së

Përgjegjësitë dhe përshkrimi i pozitave të administratës rregullohen me:

- Me Statutin e UKZ-së. Statuti rregullon vetëm kornizën e detyrave dhe të përgjegjësive të zyrtarëve kryesorë.
- [Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UKZ, Nr. 02/1531, 13.10.2020](#). Kjo rregullore rregullon në detaje pozitat për secilën kategori të vendeve të punës. Ajo parasheh edhe koeficientin e pagesës për secilën pozitë.
- Me konkursin publik dhe me përshkrimin e secilit vend të punës, i cili shpallet për secilën pozitë. Cdo konkurs publik për rekrutimin e zyrtarëve të administratës propozohet nga UKZ dhe miratohet në Ministrinë e Administratës Publike, sipas Rregullores për Sistematizimin dhe Organizimin e vendeve të Punës në UKZ. Në konkurs përshkruhen detyrat dhe përgjegjësit për secilin zyrtar që rekrutohet.
- Të drejtat dhe obligimet e zyrtarëve të Universitetit përkufizohen edhe me Rregulloret e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të Ligjit për Shërbimin Civil.

2.12. Analiza SWOT për Standardin 2

Tabela 10 Analiza SWOT për Standardin 2

Pikat e forta	Dobësitë
1. UKZ ka miratuar dokumentin strategjik që nga viti 2017 për një periudhë pesë vjeçare 2017-2022; 2. Në të gjitha proceset e hartimit të Strategjisë Zhvillimore kanë marrë pjesë hisedarët e arsimit të lartë në një përfshirje të gjerë; 3. Hartimi i Planit të Veprimit 2018 dhe 2019, 2020 si dhe miratimi i akteve normative për mbikëqyrjen e zbatimit të PSt (e rishikuar në vitin 2020); 4. Mbikëqyrja e zbatimit të PSt; 5. Gatishmëria e menaxhmentit në zgjidhjen e kërkesave të stafit e të studentëve; 6. Administrata e kualifikuar për pozitat e tyre; 7. UKZ ka hartuar një numër të madh rregullore të cilat rregullojnë procesin vendimmarrës, menaxhues dhe llogaridhënës; 8. Pjesëmarrja e studentëve në të gjitha proceset planifikuese dhe vendimmarrëse dhe në të gjitha strukturat menaxheriale të UKZ; 9. Digjitalizimi i shërbimeve të universitetit	1. Në çështje të administrimit të universitetit pamundësia e të vepruarit në mënyrë të shpejtë dhe fleksibile për shkak të procedurave burokratike; 2. Mungesa e një udhëzuesi për trajnimin e përhershëm të stafit administrativ; 3. Varësia financiare dhe administrative nga MASH-i; 4. Fondet publike pjesërisht të mjaftueshme;
Mundësitë	Rreziqet

1. Digjitalizimi i të gjitha shërbimeve universitare; 2. Trajnimi i stafit akademik dhe atij administrativ përmes projekteve ndërkombëtare (EUFORIA, REBUS, QUADIC, SMAHPC, eVIVA, QATEK, ENEMLOS, RESEARCHCULT, LECU, GIZ, IKAP); 3. Rritja e të hyrave përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nga të hyrat e Institutit Pedagogjik; 4. Rritja e bashkëpunimit me tregun e punës, ndërlidhja më e mirë mesim akademik-tregu i punës; 5. Rritja e mundësive të UKZ për mësimin praktik të studentëve (Shih: Planin Strategjik);	1. Reformat e shpeshta nga MASH pa përfunduar reforma paraprake dhe Ndryshimet e shpeshta me Udhëzime Administrative; 2. Politizimi i politikave arsimore nga struktura dhe nivele të ndryshme qeverisëse (si psh: ndërhyrjet politike në KSHC dhe përjashtimi i tij nga EQUAR dhe ENQA); 3. Rreziku i të kuptuarit të UKZ nga komuniteti si “universitet lokal”, përkundër faktit se universiteti është universal; 4. Të keqkuptuarit e procesit të “profilizimit të universiteteve”, duke i detyruar universitetet e reja të fokusohen vetëm në disa fusha të ngushta studimore; 5. Të kuptuarit e pamjaftueshëm nga ana e studentëve dhe komunitetit për rëndësinë e vlerësimit të studentit nga ana e profesorit
--	--

Standard 3. Planifikimi financiar dhe menaxhimi

3.1. Institucioni mund të demonstrojë se ka burime të mjaftueshme financiare në periudhën afatshkurtër (njëvjeçare) dhe afatmesme (një minimum prej tre viteve të njëpasnjëshme) për të arritur misionin e tij si dhe objektivat e përcaktuara në planin strategjik

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ, ka burime të mjaftueshme financiare të përcaktuara në [Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2021-2023](#), [Ligjin mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës](#) për vitin fiskal aktual dhe parashikimet për dy vitet vijuese si dhe burimet nga donacionet për aktivitete specifike. Buxhetin e Universitetit të Gjilanit e karakterizon sistemimi i kërkesave të administratës qendrore dhe njësive akademike të harmonizuar me kufijtë final buxhetor të përcaktuar nga grantet qeveritare dhe Ministria e Financave. Kërkesat harmonizohen me NJA duke konsideruar që aktivitetet të ndërlidhen me implementimin e përgjegjësive që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Metodologjia e përpilimit të buxhetit bazohet në qasjen poshtë-lart (bottom-up) ku fillimisht pranohen kërkesat financiare nga të gjitha njësitë e UKZ dhe më pas harmonizohen në nivelin qendror të UKZ konform objektivave dhe dërgohen për aprovim në KD.

Kufijtë final buxhetor përcaktohen bazuar në konsultimet gjithë përfshirëse, gjithnjë duke u bazuar në Planin Strategjik të Universitetit. Aktivitetet e planifikuara të bazuara në objektivat inkorporohen në dokumentin “Korniza Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2021/2023”, e cila justifikon edhe qëndrueshmërinë për periudhën afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme. Burimet financiare për periudhën një vjeçare për Universitetin e Gjilanit janë inkorporuar në Ligjin mbi Ndarjen e Buxhetit për vitin 2020.

Kufijtë e përcaktuar sipas KASH 2021/2023 dhe Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2020 justifikojnë masën e mjaftuar financiare për periudhën afatshkurtër (njëvjeçare) dhe afatmesme buxhetore (periudhën tre vjeçare 2021-2023) për të realizuar misionin, objektivat dhe aktivitetet që ndërlidhen me dokumentet strategjike të aprovuara nga organet vendimmarrëse të universitetit.

Buxheti i UKZ, planifikohet bazuar në Ligjin e [Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësisë](#), Ligjit vjetor të buxhetit, ku viti aktual aprovohet ndërsa projektohen në bazë të vlerësimeve dhe nevojave financiare për dy vitet, gjithnjë duke u bazuar në [Planin strategjik të UKZ-së](#) dhe kufijve buxhetor të Ministrisë së Financave. Buxheti për vitet 2021-2023, do të përmbajë shpenzimet operative duke përfshirë pagat dhe medijtjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet si dhe investimet kapitale për ndërtimin e Kampusit Universitar.

Tabela 11 Projektionet buxhetore për periudhën 2021-2023

Buxheti 2021	Buxheti-Projektion 2022	Buxheti-Projektion 2023	Totali 4 (3+2+1)
2,547,642.99€	2,995,640.99€	3,045,421.00€	8,588,704.98€

Detajet e buxhetit dhe projektionet janë bashkëngjitur në shtojcën.3.1 e buxhetit (Numrat e shtojcave kanë kete kuptim: nr i pare tregon numrin e standardit kurse i dyti numrin rendor te dokumentit). Mjete e përfshira financiare dhe të buxhetuara nga QK për UKZ kanë për qëllim zhvillimin e këtyre objektivave:

- Krijimin dhe ruajtjen e një disipline financiare për institucionin dhe të gjitha njesitë përbërëse të tij; përfshirë njesitë akademike, menaxhmentin dhe administratën. Synimi kryesor i menaxhimit financiar të UKZ-së konsiston në kontrollin efektiv të të gjitha zërave buxhetor dhe harmonizimin e tyre me afatet e caktuara kohore.
- Alokimet e burimeve financiare dhe humane në përputhje me prioritetet e UKZ-së, planin strategjik dhe operaiv të saj si dhe krijimi i një shpërndarje efikase financiare për t'i përcaktuar prioritetet në buxhet si dhe për t'i klasifikuar burimet sipas objektivave dhe nevojave institucionale;
- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve, qofshin ato menaxheriale, teknike apo operative, ngritjen e cilësisë së llogaridhënjes dhe kontrollit, që me kosto sa më të ulët të kemi shpërndarje sa më të mirë të të gjitha shërbimeve tona.

UKZ ka qenë pjesë e 3 projekteve Erasmus+ dhe Erasmus Mundus dhe tani është pjesë aktive e 9 projekteve në Erasmus + për ngritje të kapaciteteve, 1 si grant mbajtës/koordinator dhe 8 të tjerë si partnerë.

Tabela 12 Buxheti me të hyrat nga projektet periudha 2014-2023

QUADIC	991,381.00	SMAHPC	73,115.00
QATEK	95,865.00	ENEMLOS	90,586.00
E-VIVA	56,075.00	RESEARCHCULT	53,440.00
STEAMedu		SIAHDPC	
STAND		REBUS	
REBUS		GreentechWB	
EUFORIA			

3.2 Institucioni ka një buxhet real vjetor dhe njw buxhet trevjeçar, si dhe politika financiare që adresojnë qëndrueshmërinë e saj financiare

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ, si Institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë ka një buxhet real vjetor për vitin 2020 dhe një buxhet të planifikuar për periudhën 3 vjeçare, e që pasqyrohet sipas kategorive ekonomike në tabelën në vijim:

Tabela 13 Projektionet e buxhetit sipas kategorive ekonomike 2021-2023

Kategoria ekonomike	Buxheti 2021	Buxheti-Proj. 2022	Buxheti-Proj. 2023	Totali 4 (3+2+1)
Planifikimi i shpenzimeve 2021 – 2023				
Paga dhe mëditje	1,297,642.99€	1,297.642.99€	1,347,423.00€	3,942,708.98€
Mallra dhe shërbime	400,000.00€	347,998.00€	347,998.00€	1,095,996.00€
Shpenzime komunale	50,000.00€	50,000.00€	50,000.00€	150,000.00€
Subvencione dhe transfer	100,000.00€	100,000.00€	100,000.00€	300.000.00€
Pasuritë Jofinanciare	700,000.00€	1,200,000.00€	1,200,000.00€	3,100,000.00€
Totali	2,547,642.99€	2,995,640.99€	3,045,421.00€	8,588,704.98€

Detajet e buxhetit dhe projektionet janë bashkëngjitur në shtojcën.3.1

Masa buxhetore të strukturuar nëpër kategori ekonomike paraqet realizimin e politikës financiare për funksionimin e mirëfilltë të universitetit. Sqarim:

- Si rregull buxheti i UKZ-së shpenzohet në bazë të kornizave të planifikimit buxhetor në sajë të dëgjimeve buxhetore paraprake dhe në këtë aspekt nuk kemi luhatje apo shmangie planifikim-shpenzim.
- E njëjta vlenë edhe në rastet e shpenzimeve të donacioneve ose buxheteve nga projekte të ndryshme.

UKZ realizon edhe të hyra vetanake por ato fillimisht shkojnë në MASH dhe kthehen si grant. Granti është i fikësuar pavarësisht nivelit të të hyrave që realizon UKZ, siç prezantohet në tabelën 4.

Tabela 14 Projektioni i të hyrave vetanake të UKZ

Përshkrimi	Të hyrat 2021	Të hyrat 2022	Të hyrat 2023	Totali 4 (3+2+1)
Të ardhurat për vitet 2020-2022				
Totali vjetor i të hyrave	124,187.00€	124,187.00€	124,187.00€	372,561.00€

3.3. Mbikëqyrja dhe menaxhimi i funksioneve të buxhetimit dhe të kontabilitetit të institucionit kryhen nga një zyrë e specializuar përgjegjëse te një administrator i lartë

Përputhshmëria e UKZ-së

Buxhetimi në UKZ është pjesë e Ligjit për ndarje buxhetore i cili miratohet nga KK me të cilin autorizohen organizatat buxhetore për shpenzimin ose bartjen e fondeve publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime të caktuara, gjatë vitit fiskal. Në këtë kuadër UKZ i nënshtrohet edhe kornizës ligjore dhe akteve nënligjore për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e buxhetit.

Në kuadër të UKZ-së funksionon Administrata Qëndrore e cila udhëhiqet nga ZKA- zyrtari kryesor administrativ (Sekretari i Pwrgjithswm) i cila kryen dhe koordinon të gjitha aktivitetet financiare në kuadër të institucionit dhe në bashkëveprim me MASH-in. UKZ kaZyrën për Buxhet dhe Financa, që udhëhiqet nga ZKF- zyrtari kryesor financiar (Drejtori i Zyrës) e cila kryen dhe koordinon të gjitha aktivitetet financiare në kuadër të institucionit dhe në bashkëveprim me MASH-in.

Zyra për buxhet dhe financa bën harmonizimin e kërkesave (prioriteteve) të bazuar në kufijtë buxhetor të përcaktuar nga MF dhe MASH, në bashkëveprim me rektorin bënë propozim

buxhetin për aprovim nga ana e KD, harton planin e rrjedhës së parasë, mbikëqyrë ekzekutimin e buxhetit dhe përgatit raporte periodike dhe vjetore për KD ([shih Shtojcën nr 3.3 Raporti periodik i KD](#)), propozon rishikimin e buxhetit dhe harmonizim e tij në bazë të kërkesave të menaxhmentit, njësive akademike dhe administratës, siguron që shpenzimet e planifikuara buxhetore janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore.

Zyra për Buxhet dhe Financa është e autorizuar dhe përgjegjëse për:

- (i) përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore të UKZ;
- (ii) të sigurojë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit; Free Balance
- (iii) të sigurojë që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim përmes sistemit të thesarit;
- (iv) mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të raportimit buxhetor dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese në rast nevojë.

Përgatitja dhe përmbajtja e Propozim-Buxhetit Vjetor të UKZ-së konsiston në këto faza:

Tabela 15 Përgatitja dhe përmbajtja e Propozim-Buxhetit Vjetor të UKZ-së

Data	Aktiviteti
Procesi i buxhetit	
15 prill	MF-ja përgatitë KASH-in për tri vitet e ardhshme
30 prill	Afati i fundit i MF-së për t'i dërguar qarkoret buxhetore organizatave buxhetore dhe për t'i dorëzuar KASH-in Kuvendit të Kosovës (Neni 19 i LMFP)
15 qershor	Afati i fundit i organizatave buxhetore për t'i dërguar propozimet e tyre për buxhetin, të bazuara në udhëzimet e Ministrisë, shpenzimet dhe tavanet buxhetore
15 qershor – 31 tetor	MF-ja i merr në konsideratë propozimet për buxhet nga OB dhe organizon dëgjimet buxhetore me OB, procesi përfundon gjatë muajve korrik – gusht, pastaj MF-ja i'a dërgon çdo organizate ndarjen e buxhetit të propozuar dhe së bashku me KASH-in i dërgon në Qeveri për miratim
31 tetor	Qeveria miraton propozim – buxhetin dhe ia dërgon atë Kuvendit: - MF-ja dorëzon në Kuvend projekt ligjin për buxhetin (Neni 22, LMFP); - Para leximit të parë në seancë plenare, Komisioni për Buxhet e shqyrton në parim projekt ligjin; - Projektligji dërgohet në seancë plenare për leximin e parë; - Komisionet kryesore i paraqesin raportet e tyre rreth projektligjit brenda 10 ditësh; - Komisioni për Buxhet dhe Financa dorëzon një raport rreth projektligjit të paktën 5 ditë para leximit të dytë;
31 dhjetor	Afati i fundit për miratim të buxhetit të Kosovës nga Kuvendi

Për shpenzimin e buxhetit UKZ ka të miratuara edhe rregulloret përkatëse.

- [Rregullorja për të ardhurat personale të stafit akademik](#)
- Rregullorja për shpenzimet e telefonisë

3.4. Ekziston një monitorim i saktë i shpenzimeve dhe angazhimeve ndaj buxheteve me raporte të përgatitura së paku një herë në vit

Përputhshmëria e UKZ-së

Procesi i mbikëqyrjes financiare realizohet sipas planit të rrjedhës së parasë të hartuar nga Zyra për Buxhet dhe Financa e në bashkëveprim me menaxhmentin dhe bartësit e njësive akademike.

Planifikimi dhe realizimi i mjeteve financiare i nënshtrohet edhe procesit të kontrolleve periodike dhe vjetore nga auditorët e brendshëm (funksionojnë në kuadër të MASH) dhe auditorit të jashtëm (Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës-ZKA).

Plani përcakton dinamikën e realizimit të shpenzimeve, alokimit të fondeve dhe burimit të tyre. Të gjitha aktivitetet e realizimit financiar regjistrohen në Sistemin e Integruar të Menaxhimit Financiar të Kontrollit (SIMFK), me ç'rast pasqyrohen të gjitha shpenzimet dhe alokimi i burimeve financiare. Burimet e alokuara realizohen sipas aktiviteteve dhe dinamikës së planifikuar të përcaktuar në planin e realizimit të definuar në buxhet.

Kërkesat me karakter specifik adresohen tek KD për aprovim, që nënkupton se i tërë procesi është nën mbikëqyrje.

Rektori, sipas përgjegjësisë që dalin nga Statuti i Përkohshëm i UKZ-së, është i obliguar që përmes Zyrës për buxhet dhe financa të harton raporte periodike tremujore dhe vjetore të shpenzimeve dhe burimeve duke specifikuar dhe komentuar se në çmasë janë realizuar objektivat dhe aktivitetet të pasqyruara në planin të punës për administratë dhe njësi akademike. I tërë ky proces është i harmonizuar me të dhënat të cilat janë të inkuorpuara nga Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Financave të Kosovës-SIMFK i cili është i mbikëqyrtur nga Departamenti i Thesari në MF.

KD, përmes raporteve të pasqyruara nga rektori, mbikëqyrë realizimin dhe përputhshmërinë e shpenzimeve. Raportet periodike dhe vjetore aprovohen nga K.D dhe në raste të jashtëzakonshme obligon rektorin me vendim të posaçëm për realizim të kërkesave specifike të cilat nuk janë planifikuar për realizim.

Ngritja e nivelit të mbikëqyrjes tek personeli përgjegjës në fushën e financave është reflektuar në menaxhim të mirë duke krijuar një administratë efektive, transparente dhe llogaridhënëse.

Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, çdo organizatë buxhetore duhet t'i dorëzojë Ministrit një raport vjetor për vitin e kaluar fiskal. Ky raport duhet të përfshijë raportimin mbi veprimtarinë e organizatës buxhetore, duke përfshirë një Deklaratë të Rezultateve në të cilën identifikohen arritjet (rezultatet) kundrejt planit të veprimit.

Gjithashtu, UKZ në baza të rregullta 3 mujore raporton për shpenzimet financiare në KD – si organi më i lartë qeverisës i universitetit duke paraqitur shkallën e realizimit të buxhetit dhe sfidat për vitin raportues.

Raportet financiare në UKZ kanë për qëllim këto objektiva:

- Si është shpenzuar buxheti sipas kategorive ekonomike dhe a po arrihen objektivat e përcaktuara me planifikim buxhetor?
- A është i mjaftueshëm buxheti për kryerjen e aktiviteteve në Universitet brenda vitit fiskal?
- Çfarë ka raportuar Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese gjatë planit të veprimit?

I tërë procesi i llogaridhënies financiare dhe i mbikëqyrjes realizohet përmes zyrtarëve të përcaktuar në Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike sic janë:

1. Zyrtari Kryesor Administrativ – (ZKA) është zyrtari më i lartë i administratës. Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Zyrtari Kryesor Financiar – (ZKF) Drejtori i ZBF ose Prorektori për BF – Çdo ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës përkatëse buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike.
3. Zyrtari Certifikues – Çdo organizatë buxhetore ose njesi autonome duhet të ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Certifikues është përgjegjës që të sigurojë që shpenzimi i parave publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF (kontrollit dhe menaxhimit financiar). Zyrtari Certifikues duhet që të identifikojë dhe menjëherë t'i raportojë me shkrim Zyrtarit Kryesor Administrativ, ZKF dhe cilitdo zyrtar tjetër të rangut të lartë në organizatën buxhetore, agjencinë autonome publike mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të ligjit të financave publike.
4. Auditori i brendshëm – i cili funksionon në kuadër të MASH dhe një herë në vit bënë kontrollin dhe auditimin e aspekteve financiare në UKZ.

Auditimi nga Auditori i Përgjithshëm - do të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit të Kosovës një [raport](#) mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike për vitin e kaluar fiskal.

3.5. Sistemet e kontabilitetit përputhen me standardet e pranuar profesionale të kontabilitetit dhe për aq sa është e mundur atribuojnë koston totale për aktivitete të veçanta

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ e përdorë sistemin e kontabilitetit i cili aplikohet në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, i njohur si Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK), si dhe:

- Free balance – Sistem i thesarit / Ministria e Financave; Sistemi qeveritar “Free balance” përmban të gjitha aktivitetet duke përfshirë, buxhetin, alokimin, zotimin, shpenzimin dhe certifikim
- BDMS-ja – Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit; BDMS – Budget Development Management System ose Sistemi i Menaxhimit të zhvillimit të Buxhetit, përfshin planifikimin financiar të OB-së
- PIP – Programi i Investimeve Publike; PIP – përfshin planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve të investimeve publike kapitale
- OB – Organizata Buxhetore, Sistemi i brendshëm i universitetit përfshinë të gjitha aktivitetet në detaje në nivel të UKZ-së që janë gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme për palëet e ndërlidhura lidhur me veprimtarinë financiare të UKZ-së.

Sistemi i kontabilitetit në UKZ, përputhet plotësisht me standardet e pranuar profesionale të kontabilitetit bazuar në ligjet, Udhëzimet administrative dhe rregulloret të hartuara nga [Ministria e Financave për fushën e financave dhe kontabilitetit](#).

Analiza SWOT për planifikimin dhe menaxhimin financiar

Tabela 16 Analiza SWOT për planifikimin dhe menaxhimin financiar

A. Pikat e forta	B. Pikat e dobëta
- Buxheti i garantuar – grant qeveritar - Stabilitet financiar	- Statuti i përkohshëm i UKZ i cili pamundëson të jemi organizatë e pavarur buxhetore nga MASH

- Struktura e konsoliduar për menaxhimin e financave - Sistem adekuat i kontrollit të brendshëm - Gjithpërfshirje në përgatitjen e buxhetit - Burime të vazhdueshme shtese nga projektet	- Menaxhimi i centralizuar i buxhetit në nivel të UKZ-së - Menaxhimi i të hyrave vetanake realizohet nga Ministria e Financave
C. Mundësitë	D. Rreziqet
- Organizatë e pavarur buxhetore - Rritje e efikasitetit si rezultat i pavarësisht buxhetor nga MASH - Gjenerimi i të hyrave vetanake përmes projekteve të bazuara në ekspertizën profesionale të njësive akademike	- Rritja e rekrutime të reja në sajë të rritjes së buxhetit. - Rritja e buxheti për nevoja të dixhitalizimit në proceset akademike - Rritja e buxhetit për mbështetje të projekteve hulumtuese - Procedurat e ngarkuara të prokurimit sfide për shfrytëzimin e buxhetit për investime kapitale

Standard 4. Integriteti akademik, përgjegjësia dhe përgjegjësia publike.

4.1. Institucioni ka një kod etik dhe integritet akademik nëpërmjet të cilit mbron vlerat e lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe integritetit etik

Përputhshmëria e UKZ-së

Angazhimet e UKZ në lidhje me integritetin akademik dhe përgjegjësinë publike të mësimdhënësve dhe personelit tjetër në UKZ pasqyrojnë angazhimet të cilat janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e lartë të Kosovës, Statutin e UKZ-së, dhe Rregullores për cilësi dhe vlerësim të UKZ-së, Rregullores për KdE në UKZ si dhe Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

UKZ konform Statutit të tij dhe Ligjit për Arsimin e Lartë krijon mundësi të barabarta dhe pa diskriminim për të gjithë individët, qofshin ata staf akademik, administrativ apo studentë. Statuti i UKZ-së, në njërin anë implementon standardet më të larta të bazuara në integritet, objektivitetin dhe përgjegjësi për të gjithë stafin e tij dhe studentët, dhe në anën tjetër promovon sinqeritetin dhe ndershmëri të udhëheqjes. UKZ theks të veçantë i kushton lirisë akademike, dhe është shtytës i stafit për kërkime shkencore dhe krijimtari tjera profesionale.

Në kuadër të mbrojtjes së vlerave të lirisë akademike si dhe autonomisë institucionale duke përfshirë edhe integritetin akademik por edhe atë të etikës, UKZ ka miratuar dy dokumente të rëndësishme të cilat në mënyrë eksplicite trajtojnë Integritetin Akademik:

- [Statutin e Universitetit](#);
- [Rregullorja për Kodin e Etikës](#): - i cili është i detyrueshëm për zbatim duke përfshirë personelin akademik, punëtorët e administratës si dhe studentët.
- Rregulloret e cdo niveli të studimeve e trajtojnë integritetin akademik edhe të studentit në procesin mësimor.

Sipas nenit 9 të Statutit të UKZ-së, Universiteti gëzon autonominë dhe lirinë e mësimdhënies akademike, të kërkimeve shkencore si dhe të krijimtarisë artistike brenda veprimtarisë së tij. Mjediset e universitetit gëzojnë të drejtën e paprekshmërisë nga organet e rendit publik, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta; ndërsa sipas nenit 165 dhe 166 të Statutit të UKZ-së, personeli akademik ka lirinë e shprehjes, lirinë të pyesin dhe testojnë njohuritë e marra dhe të shprehin idetë e reja, mendimet kundërshtuese apo jopopullore pa e vënë veten në rrezik

me humbjen e punës apo çfarëdo privilegji që mund të kenë me Universitetin. Po ashtu personeli akademik ka lirinë për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe krijuese, që ka të bëjë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale për dobi të universitetit. Po ashtu, personeli akademik i UKZ-së duhet të respektojë frymën e humanizmit, autonominë e Universitetit, lirinë e kreativitetit shkencor dhe artistik, aktet universitare dhe vendimet e bazuara në to, KdE dhe reputacionin e universitetit dhe ta përmirësoj atë.

Në anën tjetër Rregullorja për KdE në UKZ në nenin 1, ka vendosur rregullat e sjelljes së personelit akademik, administrative dhe të studentëve sipas rregullave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të universitetit dhe me lirinë akademike. Nenet 4-6 të KdE trajtojnë të drejtat dhe liritë akademike e personale të personelit të universitetit në përputhje me frymën e etikës akademike, profesionale dhe morale të universitetit dhe lirisë akademike.

KdE gjithashtu informon të gjitha palët e interesuara mbi politikat dhe procedurat e etikës dhe rregullat e sjelljes, mbi shkeljet e mundshme të etikës dhe rregullat e pajtueshmërisë së UKZ.

Sipas Nenit 3 të Rregullores për KdE, plagjiatura nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimit të idesë, rezultateve, punimeve të shkruara a të ndonjë forme tjetër në tërësi apo pjesërisht, pa e treguar burimin e shfrytëzuar dhe pa pasur asnjë meritë për të njëjtën.

Sipas nenit 16 përcakton kuptimin e situatave kur rezultatet fabrikohen apo falsifikohen, duke u përvetësuar edhe mobjektivat, qëllimet, metodat proceset etj., dhe trajtimi i tyre sipas neni 17 dhe Nenit 18 përcakton se kuptimin e të konsidhruarit autorësi: Nga të punësuarit në UKZ, kërkohet që të vendosin si autorë vetëm ata persona që kanë marr pjesë në procesin kërkimor dhe të cilët kanë dhënë kontribut intelektual në hartimin e veprës shkencore dhe profesionale. Aurore i një veprë shkencore dhe profesionale nuk mund të jenë personat, të cilët vetëm e kanë financuar kërkimin, e kanë siguruar literaturën, janë vetëm drejtues të institucionit ku është kryer kërkimi shkencor, kolegët, miqtë, anëtarët e familjes etj.

Sipas Nenit 14 të rregullores për KdE, përcaktohen praktikatat e ndaluara në procesin mësimor: studentëve nuk u lejohet përshkrimi apo kopjimi i çfarëdo forme të procesit mësimor (detyrat në provime, seminare etj.), gjat testimeve të njohurive u ndalohejt përdorimi i telefonave dhe mjeteve tjera teknologjike- përveq rasteve specifike ku ato kërkohen në fushat e caktuara mësimore.

Ndërsa Nenet 29 – 38 përcaktojnë procedurat e punës së KE, dhe organet kompetente për zbatimin e KdE:

Organet për zbatimin e KdE janë:

- KE I cili zgjidhet nga Senati i UKZ-së,
- Komisioni i disiplinor, i zgjedhur nga Këshilli i NJA,
- Komisioni i Disiplinor ad-hoc, i caktuar nga Rektori ose Dekani i NJA.

Procedurat për vërtetësinë e shkeljes së ndonjë parimi të KdE fillohen me dorëzimin e fletëparaqitjes për shkelje të KdE, në formë të shkruar te organet për zbatimin e KdE. Fletëparaqitjen për shkeljen e KdE mund ta dorëzojnë të gjithë të punësuarit, e cila duhet të jetë e arsyetuar me të gjitha dëshmitë dhe të dhënat për shkelje, dhe e nënshkruar. Organet për zbatimin e KdE, nuk do të marrin në shqyrtim fletëparaqitjet anonime.

4.2. Kodi i etikës kërkon që të gjithë aktorët e brendshëm të veprojnë në përputhje me standardet e larta të sjelljes etike dhe shmangien e plagjiaturës në kërkime, mësimdhënie, vlerësim të performancës dhe në kryerjen e detyrave administrative dhe të shmangin konfliktet e interesit

Përputhshmëria e UKZ-së

Të gjithë të punësuarit në UKZ, si stafi akadmeik, ashtu edhe studentët janë të obliguar që në kuadër të autoirizimeve të tyre të kujdesen për aplikimin dhe avancimin e standardeve etike në UKZ për zbatim të KdE. Ky proces realizohet në mënyrë permanente në procesin mësimor, përgatitjen e ligjëratave dhe materialit tjetër mësimor nga stafi akadmeik të cilët evidentojnë burimet (literaturën) e shfrytëzuara, pnë rastin e publikimeve të punimeve shkencore, dhe punën tjetër akademike shkencore si dhe gjat vlerësimit të njohurive të studnetëve.

Përveq kësaj, janë siguruar edhe aplikacione të TI për të përdoren për aplikimin e standardeve të etikës kundër plagjiaturës. Përmes aplikacionit SMU, të cilin e përdor UKZ, e ka opsionin e antiplagjiatures. Rektori me nje vendim obligon qe te gjitha temat e diplomës në UKZ të verifikohen për antiplagjiaturë në këtë aplikacion.

Për të bërë të mundur mbrojtjen e vlerave dhe parimeve etike (neni 14 i rregullores për KdE):

- Ndalohet që studentët të përshkruajnë/kopjojnë gjat provimeve dheose/testimeve, punimeve të diplomave të nivelit bachellor, master dhe doktoraturë, etj.
- Dhënja/marrja e ndihmës e cila ka ndikim në korrektësinë e vlerësimit të punës dhe dijes.
- Mbështetja e çfardo ndihme që ka të bëjë me kopjimin.
- Përdorimi i telefonave apo mjeteve të tjera teknologjike – kur kjo konsiderohet e dëmshme për vlerësim korrekt të njohurive.

Për këtë qëllim, UKZ ka hapur procedurat e prokurimit për blerjen e softuerit anti-plagjiaturë (Projekti ResearchCult). Përmes kësaj do të bëhet e mundur mbrojtja dhe kontrolli më i mirë i punës shkencore të stafit akademik si dhe tezave të diplomës së studentëve ashtu që të sigurohet cilësia e këtyre punimeve.

Në veçanti KdE, në nënin 21 qartazi parasheh rastet kur ka konflikt interesi. Një konflikt i ineteresit ndodhë kur interesi privat i një anëtari të UKZ-së, me përjashtim të studentëve, është në kundërshtim real ose potencial me inetreresat jo vetëm ekonomike por edhe akademike të UKZ-së. Konflikti i interesit ka të bëjë edhe me raportet e punës në institucione arsimore apo universitare tjera dhe që konsiderohen si konkurrent potencial. Sipas këtij neni, anëtari i Univesitetit në rast të konfliktit të interesit informon organin kompetent dhe përmbahet nga zgjidhjet dhe vendimet.

Më tutje, sipas nenit 22 të Rregullores për KdE, definoen kuptimet edhe për nepotizëm, favorizim dhe keqpërdorimet tjera. UKZ nuk lejon asnjë formë të nepotizmit dhe të favorizimit . Kërkohet nga të gjithë të punësuarit në UKZ, që të përmbahen nga praktikatat e tilla. Me Nepotizëm konsiderohet kur një mësimdhënës apo stafg administrativ duke përdorë financimet e palës së tretë përdorë reputacionin ose aftësit`në e tij bindëse për të ofruar favore, për të përshtatur shpalljet dhe kontratat e punës, për të ndikuar në rezultatet e konkurrencës apo procedurat e përzgjedhjes. Po ashtu këtu përfshihen edhe pranimi i fëmijëve, pjestëratët e familjes dhe të afërmeve (në formën e bashkëjetesës).

4.3. Kodi zbatohet përmes proceseve dhe mekanizmave të qarta, dhe zbatohet për të gjithë stafin dhe njësitë strukturore të institucionit

Përputhshmëria e UKZ-së

KdE,pothuajse në të gjitha nenet në mënyrë implicite por veqanarisht në nenet 4-23 në mënyrë eksplicite kërkon që të gjithë aktorët e brendshëm të Universitetit të udhëhiqen nga parimet e etikës akademike dhe jetës publike të tilla si:

- Ndershmëria, morali, respekti, përgjegjshmëria, përgjegjësia, korrektesia, drejtësia,virtyti, transparenca, tolerance etj
- Integriteti dhe dinjiteti
- Efikasitet dhe konkurrenca
- Profesionalizëm dhe respektim të ligjeve dhe rregulloreve
- Mirësjellje, vullnet i mirë, solidaritet dhe bashkëpunim;
- Morali, ndalimi I diskriminimit, ngacmimit si dhe objektiviteti i lartë;
- Përsosmëria akademike dhe liria akademike;
- Respektimi i hierarkisë akademike dhe institucionale;
- Respekt të ndërsjellë dhe dinjitet njerëzor;
- Kundër nepotizmit, favorizimeve apo keqpërdorimeve të pozicionit

Në veçanti KdE, në nënin 21 dhe 22 qartazi parasheh rastet kur ka konflikt interesi: nepotizmi, favorizimi, pranimi i fëmijëve dhe anëtarët e familjes së afërme, favorizimi i mësimdhënësve ndaj studentëve rastet abuzive me frymën e rregulloreve të Universitetit). Sipas këtij neni, anëtari i Univesitetit në rast të konfliktit të interesit informon organin kompetent dhe përmbahet nga zgjidhjet dhe vendimet.

Në KdE janë parashikuar në mënyrë të qartë detyrimet e personelit si dhe studentëve në aspektin e sjelljes akademike, mësimdhënies kërkimeve hulumtuese si dhe raportet në mes stafit dhe palëve të treta. Në mënyrë specifike KdE paraqet politikat e anti-diskriminimit, rastet e konfliktit të angazhimit të stafit, konflikt interesi, pronës intelektuale, plagjiaturës akademike dhe sjelljeve të studentëve. Për të gjitha këto raste KdE parashikon masa disiplinore si dhe organin disiplinor në të gjitha nenet e saj 29-38, në bazë të fletëparaqitjes për shkelje të KdE, Kryetari i KE thërret anëtarët tjerë jo më larg se 30 ditë nga pranimi i fletëparaqitjes:

- Nëse KE e vërteton se mosekzistimin e shkeljes të KdE, me një vendim të saj e refuzon fletëparaqitjen si të pabazuar.
- Nëse KE vërteton se se është bërë shkelje e ndonjë parimi të KdE, ai me një vendim i propozon Senatit të UKZ-së masën përkatëse e cila është: vërejtje me shkrim, ose vërejtje publike.
- Në rast se këto shkelje persëriten, atëherë KE i propozon autoritetit drejtues ndëshkime të tjera më të rrepta, deri në marrjen e thirrjes akademike dhe largim nga puna.
- Vendimet ne KE merren me shumicë te votave të anëtarëve.

4.4. Institucioni ka krijuar një strukturë të caktuar (siç është Komiteti i Etikës) përgjegjës për analizën dhe zgjidhjen e çdo shkeljeje të mundshme në kodin e etikës

Përputhshmëria e UKZ-së

Organet të cilat kanë kompetencë për zbatimin e KdE janë:

- KE, i cili zgjedhet nga Senati,

KE e përbëjnë 4 anëtarë të stafit akademik me mandat katër vjeçar dhe përfaqësuesi i PS.

Kryetari i KE zgjidhet nga anëtarët e Këshillit dhe ka mandat 4 vjeçar.

KE vërteton mos/ekzistimin e shkeljeve pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve të poranuara me shkrim, deshimi dhe të nëshkruara.

KE i propozon Senatit masat disiplinore për secilin rast.

- Komisioni Disiplinor, i cili zgjedhet nga Këshilli i NJA

Komisioni disiplinor përbëhet nga tre anëtarë: kryetari një nga stafi akademik dhe një nga organizatat e studentëve. Studenti ka mundat njëvjeçar.

Komisionet disiplinore shqyrtojnë rastet e shkeljeve eventuale dhe i propozojnë Këshillit të NJA vendimet në harmoni me Rregulloret e NJA dhe Rregullores për KE.

- Komisioni ad-hoc i cili zgjedhet nga Rektori, përkatësisht Dekani i njësisë akademike

Komisioni ad-hoc është organ i cili themelohet me vendim të Rektorit dhe është kompetent për zbatimin e procedurave në rastet kur KdE është shkelur nga të punësuarit jashtë procesit mësimor në Rektoratin e UKZ-së, gjegjësisht në njësinë akademike të UKZ-së.

Procedurat për vërtetësinë e shkeljes së ndonjë parimi të Etikës, sipas nenit 34, bëhen përmes paraqitjes së ankesës nga të punësuarit në formë të shkruar, por me të dhëna të sakta dhe jo anonime, të njëri nga organet sipas nenit 31, të KdE.

Në nenet 35-39 të KdE janë paraqitur në mënyrë të detajuar proceset të cilat sipas KdE ndërmerren nga strukturat e caktuara që janë përgjegjëse për zgjidhjen e çdo shkelje të mundshme në KdE.

4.5. Ekzistojnë dëshmi se institucioni po zbaton kodin e etikës dhe proceset dhe mekanizmat e lidhur me të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin, administrimin, mësimdhënien dhe hulumtimin. Rezultatet e aplikimit të saj bëhen publike

Përputhshmëria e UKZ-së

Sipas Nenit 35, KE shqyrton rastet kur denoncimet, ankesat ose raportimet kanë identifikuar individin që bën ankesën, dhe konform kësaj vendosë masa disiplinore në lidhje me shkeljet e parashikuara në nenet e të KdE, deri të largimi nga puna. Në rast se shkeljet nga mësimdhënësit apo bashkëpunëtorët e Universitetit bien ndesh me Ligjin e Punës dhe Statutin e Universitetit, atëherë Këshilli propozon masa konform rregulloreve të Universitetit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë. Në rast se këto shkelje bëhen të përsëritura, atëherë KE mund të propozoj masa tjera më të rrepta si marrja e titullit akademik, deri në përtjashtim nga puna..

Nenet 36-38 të KdE kanë paraparë Procedurat e Komisionit Disiplinor, si dhe afatet. Sipas nenit 37, komisioni ad-hoc fillon procedurën për vërtetësinë e shkeljeve të parimeve të Etikës, dhe atë në një afat brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës. Komisioni ad-hoc ose kthen ankesën si të pabazuar, ose në rast se vërteton se janë shkelur parimet KdE, atëherë i propozon Rektorit/Dekanit/Drejtorit masat:

Vërejtje me shkrim apo Vërejtje Publike.

Në rast se komisioni vërteton se janë shkelur parimet e KdE të cilat janë në kundërshtim me Ligjin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Statutin e Universitetit, atëherë komisioni u propozon organeve përkatëse fillimin e procedurave disiplinore sipas akteve ligjore të lartëpërmendura.

Gjatë vitit 2019 ka pasur një rast (fletëparaqitja Nr. 05/311 dt. 18 mars 2019), ku është trajtuar fakti se një staf akademik ka pasur dy kontrata pune me orar të plotë (njëra në Universitetin Shtetëror të Tetovës në Maqedoninë e Veriut) duke insistuar të fitojë thirrjen akademike në kundërshtim me Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik në UKZ. (shih Ankesa – Fletëparaqitja e rastit të prof. B.A).

4.6. Të gjitha rregulloret e brendshme, procedurat, raportet e vetëvlerësimit dhe vendimet e organeve qeverisëse bëhen publike

Përputhshmëria e UKZ-së

Të gjitha rregulloret e brendshme dhe dokumentet tjera strategjike janë të publikuara në ueb faqe të [Universiteti Publik “Kadri Zeka”](#):

- [Vendimet e Këshillit Drejtues](#); [Vendimet e Rektorit](#); [Vendimet e Senatit të UKZ-së](#)

Vendimet e Njësive akademike:

- [Fakulteti i Edukimit](#); [Fakulteti Juridik](#); [Fakulteti Ekonomik](#); [Fakulteti i Shkencave Kompjuterike](#); [Fakulteti i Shkencave të Aplikuara](#)

Poashtu, vendimet e Senatit dhe të KD janë të publikuara në linkun: [Dokumente të rëndësishme](#). Një sërë dokumentesh të tjera të cilat konsiderohen të nevojshme, shpërndahen te stafi edhe në kopje fizike.

UKZ si institucion publik i arsimit të lartë njeh rëndësinë dhe detyrimin e të qenit i hapur dhe i përgjegjshëm ndaj anëtarëve të komunitetit akademik, por edhe ndaj palëve të treta dhe palëve të interesit. Për këtë qëllim, universiteti synon të jetë sa më transparent që të jetë e mundur duke publikuar të gjitha rezultatet e aktiviteteve të tij si vendimet, rregulloret, njoftimet, thirrjet e ndryshme si dhe aktivitetet ditore ose të rëndësishme të organizuara nga universiteti dhe njësitë e tjera akademike.

4.7. Institucioni publikon informacione të qarta, të sakta, objektive, relevante, të arritshme dhe të detajuara në lidhje me stafin akademik, veprimtaritë kërkimore dhe akademike, programet që ofron, numrin e studentëve të regjistruar, rezultatet e pritshme të mësimit të programeve të saj, kualifikimet që ata i japin , procedurat e mësimdhënies, të mësimit dhe të vlerësimit të përdorura, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e mësimit për studentët, informatat e diplomimit të punësimit, mundësitë e bursave, si dhe pagesat për shkollim dhe taksat administrative

Përputhshmëria e UKZ-së

Disa nga rregulloret e brendshme, procedurat, raportet e vetëvlerësimit e trajtojnë Integritetin akademik në mënyrë eksplicite. Dy dokumente të rëndësishme, siç është Statuti i përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit, dhe Rregullorja për KdE në UKZ zbërthejnë në hollësi kuptimin e shkeljeve të KdE, procedurat për shqyrtimin e rasteve të tilla dhe organet të cilat marrin vendimet adekuate me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të integritetit akademik në UKZ.

Publikimi i të gjitha dokumenteve të mësipërme bëhet kryesisht në gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe të gjitha dokumentet/rregulloret janë të përkthyer edhe në anglisht dhe kështu të kontribuojnë në ndërkombëtarizimin e universitetit.

Menaxhmenti i universitetit në vazhdimësi merr masa për të plotësuar dhe azhurnuar informacionin në faqen e internetit duke siguruar që të gjitha programet e studimit në kuadër të secilit fakultet të publikohen me të gjitha informacionet:

- [Fakulteti i Edukimit](#); [Fakulteti Juridik](#); [Fakulteti Ekonomik](#); [Fakulteti i Shkencave Kompjuterike](#) dhe [Fakulteti i Shkencave të Aplikuara](#)

Prandaj, në ueb faqen e secilit fakultet publikohen të dhënat e detajuara për me stafin akademik, veprimtaritë kërkimore dhe akademike, programet që ofron, numrin e studentëve të regjistruar, rezultatet e pritshme të mësimit të programeve të saj, kualifikimet që ata i japin ,

procedurat e mësimdhënies, të mësimi dhe të vlerësimit të përdorura, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e mësimi për studentët (lidhja me platformat e-learning, SMU, T-Edu, etj), informatat e punësimit të diplomuarve, konkurset për bursa të Universitetit, bursat e MASH të Kosovës, etj., si dhe pagesat për shkollim dhe taksat administrative psh:

- [Për stafin akademik FSHK](#); [Për stafin akademik FEK](#); [Për Stafin Akademik në FJU](#); [Për stafin Akademik në FED](#); [Për Stafin Akademik në FSHA](#)

Të gjitha informacionet e tjera në lidhje me Fakultetin, siç janë Diplomimet, Revistat Shkencore, Projektet apo Dokumentet tjera me rëndësi janë të azhurnuara në webfaqe të Universitetit, e cila është e hapur për krijimin e hapësirave dhe linqeve shtesë për të gjitha informacionet tjera me rëndësi në të ardhmen, [për shembull](#).

Universiteti publikon edhe broshura në kopje fizike, të cilat azhurnohen kohë pas kohe, dhe të cilat përmbajnë informata të derajuara për procesin mësimor, për stafin akademik, për studentët, për programet e studimit, për veprimtarinë hulumtuese e shkencore etj.

[Doracaku për studentë](#); [Doracaku për Stafin Akademik](#):

Analiza SWOT për Standardin 4.

Tabela 17 Analiza SWOT për Standardin 4.

A. Pikat e forta	B. Pikat e dobëta
Universiteti transparent, i hapur dhe i përgjegjshëm ndaj komunitetit akademik dhe aktorëve të jashtëm; Trajtim i barabartë dhe jo-diskriminues i të gjithë komunitetit akademik brenda universitetit; Janë krijuar mekanizma të qarta për të siguruar që parimet etike të universitetit të respektohen vazhdimisht; Trajtimi efektiv dhe në kohë i të gjitha ankesave dhe çështjeve që lidhen me çështje etike.	Mungesa e deritashme e softuerit funksional anti-plagjiaturë; Mungesa e dixhitalizimit të plotë të procedurave dhe proceseve universitare në drejtim të publikimit të të dhënave për stafin akademik dhe rreziqet e mundësive të studentëve. Rezistenca e “heshtur” e stafit akademik dhe studentëve për të mos raportuar rastet e shkeljeve të KdE;
C. Mundësitë	Rreziqet
Rritja e efikasitetit dhe cilësisë si rezultat i rrespektimit në mënyrë strikte të rregullave në funksion të parandalimit të parregullsisë; Rritje e transparencës dhe mundësive konkurruese brenda Universitetit; - Rritje në përsosmërinë dhe lirinë akademike - Publikimi i të dhënave të personelit akademik në faqen e internetit; - Publikimi i rregulloreve dhe vendimeve të UKZ në faqen e internetit;	Përdorimi i aplikacioneve për dëshmim të origjinalitetit dhe joorigjinalitetit në projektet hulumtuese e shkencore; - Mosgatishmëria për raportim të rasteve nga studentët ose stafi akademik.

Standard 5. Menaxhimi i cilësisë

5.1. Ofruesi i arsimit ka miratuar zyrtarisht një politikë të sigurimit të cilësisë që përshkruan sistemin e sigurimit institucional të cilësisë, proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimin, grumbullimin e të dhënave, afatet kohore, ciklin e cilësisë, përgjegjësitë e të gjithë individëve dhe njësitë të përfshira në këto procese. Politika është një dokument publik

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka në fokus realizimin e studimeve sa më cilësore: siguri i burimeve adekuate njerëzore, përcaktimi i kompetencave (caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësisë), menaxhimi cilësor si dhe përcaktimi adekuat i formës së raportimit në lidhje me kontrollin e cilësisë, të

cilat gjithnjë e më tepër kontribuojnë në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, të ofruar nga UKZ.

I tërë sistemi i realizimit të cilësisë brenda UKZ-së, bazohet në kornizën e pasur normative, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë i kontribuon përmbushjes së synimeve të UKZ-së.

UKZ është fokusuar në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të dala gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm apo të jashtëm. Aktiviteti kryesor i realizuar në këtë rast është rishikimi i Rregullores për Cilësi i përfunduar në dhjetor 2020, përpilimi dhe miratimi i MVP, Formimi i Këshillit për mbikqyrje të cilësisë dhe vlerësimit, për periudhën tre vjeçare, duke u bazuar në rekomandimet e marra nga ekipi vlerësues. Duhet të bartet me lart, ndoshta në fillim të standardit 5.

Të dhënat e grumbulluara dhe gjendja faktike e konstatuar nga procesi i vlerësimit të brendshëm në raport me përmbushjen e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit është analizuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet ZZhAC, Komisionit për sigurim të cilësisë, KMCV, Menaxhmentit të lartë të UKZ-së (Prorektorit për Mësim dhe Çështje Akademike).

Në anën tjetër, përmirësimi i shërbimeve administrative dhe ofrimi i kushteve më të mira fizike për studentë që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së studimeve është pothuajse aktiviteti i integruar në menaxhimin ditor të UKZ.

UKZ, ka të miratuar politikat e sigurimit të cilësisë brenda institucionit, të cilat janë dokumente publike. Përmes këtyre masave të sigurimit të cilësisë definohe të gjitha proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimet, grumbullimet e të dhënave, afatet kohore, cikli i të siguruarit të cilësisë si dhe të gjitha përgjegjësitë e individëve dhe njësive të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë.

Përmes këtyre politikave të sigurimit të cilësisë në nivel institucioni është i përcaktuar sigurimi i cilësisë duke përfshirë strategjinë për sigurimin e cilësisë, strukturën organizative për sigurimin e cilësisë, subjektet e sigurimit të cilësisë, programet studimore, procesin arsimor, punën hulumtuese, resurset njerëzore, studentët, literaturën, hapësirën arsimore, çështjen e financimeve, menaxhimin e institucionit si dhe përfshirjen e studentëve në procesin e sigurimit dhe avancimit të cilësisë së punës.

Politika e sigurimit të cilësisë është e paraparë edhe në Planin Strategjik të UKZ-së 2017-2020, e rishikuar në vitin 2020. Kapitulli 6 tek Objektivat Strategjike flet në pikën 5 për sistemin e sigurimit të cilësisë- sigurimi dhe ngritja e cilësisë, e cila ka 11 nënobjektiva, secila e rëndësishme për politikën e sigurimit të cilësisë në UKZ.

Rregullorja për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit në UKZ është rishikuar në vitin 2020 dhe e cila është miratuar nga Senati. Kjo rregullore përcakton sistemin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, mekanizmat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, akterët e sigurimit të cilësisë dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces. I gjithë procesi ka për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të UKZ-së.

Rregullore për themelimin dhe funksionimin e KMCV, Nr.01/2124, dt.08.12.2020 , Ky është një organ këshillues, i cili në bashkëpunim me organet e tjera profesionale të UKZ, planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga UKZ. KMCV të UKZ ka hartuar MVP.

UKZ ka nxjerrur edhe MVP. Qëllimi i MVP është të krijojë një mekanizëm për të ndihmuar stafin e UKZ-së që të zhvillohet gjatë procesit të ndërtimit të karrierës së tyre, që të kontribuojë në cilësinë e punës në UKZ, si dhe të harmonizojë punën e tyre me objektivat strategjike.

Sa i përket aplikimit të instrumenteve në fushën e sigurimit të cilësisë, në mbledhjen e të dhënave janë të aplikuara forma të ndryshme, sikurse pyetësorë, anketat, intervista si dhe realizohen edhe monitorime gjatë mbajtjes së mësimit (Metodologjisë, përdorimit të teknologjisë, format e vlerësimit, çështjeve të transparencës).

UKZ nëpërmjet vlerësimeve të shumfishta e bënë vlerësimin e cilësisë. Për këtë arsye UKZ ka hartuar edhe pyetësorët për të gjitha vlerësimet, ku vlerësohen stafi akademik, administrativ, shërbimet si dhe kushtet mësimore-infrastruktura:

UKZ dy vitet e fundit , për të realizuar hulumtimin ka përdorur një llojllojshmëri të pyetësorëve si në vijim:

1. Pyetësori për studentë lidhur me shërbimet administrative në UKZ
2. Pyetësori për studentët lidhur me mësimin online në UKZ
3. Pyetësori për staf akademik lidhur me mësimin online të UKZ
4. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e Profesorëve të UKZ
5. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e asistentëve të UKZ
6. Pyetësori për personelin akademik lidhur me vlerësimin e aspekteve të punës së tyre me studentë në UKZ
7. Pyetësori për personelin administrativ të UKZ lidhur me aspektet e tyre të punës, posaçërisht sugjerimet e tyre për përmirësime eventuale.
8. Pyetësori për vetëvlerësim të stafit akademik
9. Pyetësori për alumni
10. Pyetësori për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi

UKZ mbetet e përkushtuar që të gjitha mekanizmat, përfshirë instrumentet, mënyrat e realizimit të vlerësimit, metodologjinë dhe të tjera të i azhurnoj vazhdimisht në mënyrë që të plotësohen zbrazëtira që mund të ndikojnë në rritjen e cilësisë.

Skema në vijim pasqyron në mënyrë të plotë sistemin e sigurimit të cilësisë në UKZ.

Tabela 18 Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UKZ



5.2. Janë siguruar burime adekuate njerëzore, financiare dhe materiale për udhëheqjen dhe menaxhimin e proceseve të sigurimit të cilësisë

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka themeluar edhe *Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi*, e cila ka filluar punën në korrik të vitit 2018 dhe e cila zyrë ka Drejtorin e saj. Universiteti ka miratuar edhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, e cila parasheh edhe shtimin e personelit të kësaj zyre edhe me së paku 2 zyrtarë të tjerë. Kjo zyrë koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe me procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përfshijnë këto procese dhe poashtu koordinon punën e zyrës me Senatin, Këshillat e Fakulteteve, komisioneve dhe grupeve të tjera punuese.

Detyrat kryesore të Zyrës janë:

- Koordinimi i punës në mbështetje të njësive akademike për procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përfshijnë këto procese
- Koordinimi i punëve të Zyrës me senatin e UKZsë, KD, NJA, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura etj.

Në kuadër të përgjegjësisë dhe detyrave të Zyrës, ZZHAC realizon Planin njëvjeçar të punës ku planifikon aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me:

1. **Përmbylljen e obligimeve të ZZHAC në raport me AKA**

- Deklarimi i Stafit Akademik në AKA, si dhe verifikimin i dokumentacionit të kërkuar bazuar në UA 15/2018, Neni 11, paragrafi 2
- Përgatitja e aplikacioneve për proces të Ri/Akreditimit për Programe studimore (për çdo 31 tetor)
- ZZHAC koordinon të gjitha punët që kanë të bëjnë me kërkesat e AKA ndaj IAL-ve

2. Realizimin e Vlerësimeve të brendshme

- Në bashkëpunim me KMCV, harton pyetësorët
- Vlerësimet realizohen në kopje fizike si dhe elektronike
- Rezultatet përpunohen në ZZHAC në bashkëpunim me koordinatorët e cilësisë nga NJA dhe studentët
- Pas përpunimit të rezultateve hartohen raportet dhe u dorëzohet menaxhmentit të lartë, njësisë akademike si dhe raportet me të dhënat të përgjithshme behen publike në veb faqen e universitetit

3. Takimet e rregullta mujore me Komisionin për Sigurim të Cilësisë (Tani KMCV)

- Mbikqyrje e realizimit të Planit të Veprimit për Cilësi
- Diskutim i rezultateve të hulumtimit
- Shyrtim i cilësisë së rezultateve
- Rishikim i pyetësorëve

Bazuar në Rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit është themeluar **KMCV** në përbërje prej dhjetë anëtarëve.

Gjithashtu, në bashkëpunim me *Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, UKZ* ka caktuar edhe Koordinatorët për Cilësi, në secilën njësi akademike nga një, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguruarit të cilësisë brenda njësisë akademike përkatëse. UKZ ka gjithsejt 5 koordinatore për cilësi.

Koordinatori i Cilësisë, anëtar i stafit akademik, është urë lidhëse në mes njësisë akademike dhe ZZHAC. Ai i raporton menaxhmentit dhe KF.

Koordinatori i Cilësisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësisë akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshillëdhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit;
- Është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore);
- Këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatorin kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në ëeb-faqe.

Të gjitha proceset e lidhura me sigurimin e cilësisë mbështeten nga menaxhmenti i institucionit në aspektin financiar dhe material me qëllim të realizimit të objektivave strategjike të vendosura me Planin Strategjik.

Objektivat strategjike të UKZ në Planin Strategjik të rishikuar në vitin 2020 janë si në vijim:

- Rregullorja për sigurim të cilësisë dhe vlerësimit në UKZ është përmirësuar edhe duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve.
- UKZ ka themeluar Zyrën për cilësi që do të përbëhet nga stafi administrativ. Zyra për cilësi do të jetë e pavarur nga strukturat udhëheqëse të universitetit dhe roli kryesor i saj do të jetë monitorimi i cilësisë, i paanshëm dhe në përputhje me politikat zhvillimore të universitetit. Zyra në vitin 2021 do të zgjerohet edhe me minimum me 1 personel të ri.
- Janë caktuar koordinatorët për cilësi dhe zhvillim akademik në secilën njësi akademike.
- Është themeluar KMCV.
- UKZ ka hartuar udhëzuesin (manualin) me të cilën do të udhëzojë si të matet cilësia në mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtime shkecore me parametra real duke hartuar edhe formular për këtë proces të matjes së cilësisë.
- UKZ ka planifikuar të hartojë një raport të detajuar në lidhje me indikatorët e rangimit të universiteteve. Pastaj, do të bëjë një vlerësim të thuktë se ku qëndron në raport me parametrat e vlerësimit dhe si rrjedhojë, do të përpilojë strategjinë zhvillimore të saj që të dalim më të suksesshëm në rangimet vendore dhe ndërkombëtare.
- Është hartuar Udhëzuesi për ECTS dhe është vendosur në ueb faqen e UKZ.
- Të sigurohet qasja e UKZ-së në biblioteka elektronike ndërkombëtare
- Të sigurohet literatura bashkëkohore për studentët. Në Syllabuset e kurseve, librat bazikë nuk duhet të jenë më të vjetër se 10 vjetë, përveç në raste të arsyeshme.
- UKZ të punojë jo vetëm të përmbushë të gjitha standardet e përcaktuara nga AKA, por edhe t'i tejkalojë ato, si është rasti edhe tash me fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Po ashtu, të gjitha rezultatet e vlerësimeve të brendshme dhe raportet e hartuara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik të institucionit.

Në ngritjen e kapaciteteve për sigurim të cilësisë në UKZ, me rezultatet e tij kontribuon projekti QATEK (Erasmus+). Projekti, në mënyrë indirekte adreson zhvillimin e kurrikulës, përmes rishikimit të programeve dhe lëndëve me qëllim që të rriten njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e studenteve, rrjedhimisht edhe cilësia e studimeve.

Dy konceptet e rëndësishme në këtë projekt janë:

- mekanizmi i brendshëm i sigurimit të cilësisë (përfshirë por pa u kufizuar në rishikimin e programit, monitorimin e organizuar, mbledhjen e vlerësimeve nga studentët mbi cilësinë e mësimdhënies dhe burimeve të të nxënës, rishikimin e cilësisë së shërbimeve të studentëve, rishikimin e menaxherëve praktikë përfshirë politikat e stafit, rishikimi i veprimtarisë kërkimore, etj., dhe
- zhvillimi i profesional i mësimdhënies. Projekti e bën lidhjen në një mënyrë që mekanizmi i propozuar i sigurimit të cilësisë duhet të kontribuojë në arritjen e profesionalizmit të dëshiruar në sistemin shkollor.

Gjithashtu, UKZ është pjesë e Projektit OPTIMA (Programi i US Embassy), i cili ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të performances së mësimdhënësve akademik për sistemin Universitar të arsimit të lartë publik në Kosovë.

5.3. Gabimet dhe dobësitë njihen nga përgjegjësit dhe përdoren si bazë për planifikim për përmirësim

Përputhshmëria e UKZ-së

Bazuar në Rregulloret dhe dokumentet të cilat përcaktojnë sigurimin e cilësisë në UKZ, krijohet hapësirë për të identifikuar gabimet dhe dobësitë si dhe të merren masa për përmirësimin e tyre.

UV dhe përdorimi i rezultateve të tyre, parasheh masat pasuese duke marrë parasysh që jo vetëm vlerësimi por edhe përdorimi adekuat i rezultateve të vlerësimit do të qojë në përmirësim të cilësisë. Duke u bazuar në rezultate, masat përcjellëse i referohen ose mësimdhënësit të vetëm ose fakultetit në rast nevojë.

Shembull: në rast të përsëritjes së performancës së dobët të mësimdhënësve, kur ata bëjnë pjesë në grupin e atyre me rezultate më të ulëta se mesatarja dy herë në dy vjet, prorektori për Çështje Mësimore i fton ata në një intervistë vlerësimi dhe propozohen masa përmirësuese, respektivisht trajnime plotësuese për përmirësimin e mësimdhënies. Nëse mësimdhënësi nuk e përmbush këtë marrëveshje, ose nëse performanca e tij/saj nuk përmirsohet, prorektori për Çështje Mësimore iniciacion takimin e tij/saj me Rektorin.

Masat e mundshme pas takimit me Rektorin janë:

- Vërejtje me shkrim nga dekani i njësisë akademike përkatëse.
- në rast të mospërfilljes së vërejtjes, paraqitja e masës pranë Komisionit të Etikës;
- varesisht nga lloji vërejtjes, do të iniciohet ndalesa e mediteve nga paga si dhe masa të tjera konform Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik dhe KdE.

Në kuadër të kësaj, në rast të angazhimit të stafit akademik me orë shtesë (honorar), si dhe të stafit të jashtëm, gjithmonë merren për bazë rezultatet e vlerësimit të dalë nga Raporti i vlerësimit nga ZZHAC lidhur me performancën e stafit. Kandidatëve me përvojë në mësimdhënie të mëparshme në UKZ, iu kërkohet të paraqesin rezultatet e vlerësimit të performancës nga IAL gjatë procesit të aplikimit për zgjedhje apo rizgjedhje në UKZ. Gjithashtu edhe mësimdhënësve/asistentë që aplikojnë rishtas për angazhim në UKZ t'u merret për bazë vlerësimi paraprak.

Rezultatet e vlerësimit të profesorëve janë pjesë e të gjitha procedurave të promovimit (promovimi në një titull më të lartë akademik, promovimi në një pozitë menaxheriale etj.).

Në këtë kuadër të ciklit të përmirësimeve, Komisioni i Studimeve, si një organ këshillëdhënës i Senatit të UKZ, bënë korrigjimin e gabimeve eventuale në procesin e matjes së cilësisë, duke ndikuar direkt nëpërmjet marrjes së masave për ndryshimet eventuale që kërkohen. Senati miraton korrigjimet e nevojshme në të gjitha çështjet akademike.

Menaxhmenti i lartë pas vlerësimit të rezultateve merr hapat drejt përmirësimeve. Ja disa hapa konkretë që janë ndërmarrë në përmirësimin e performancës, bazuar në rezultatet e vlerësimeve të mëhershme të cilësisë:

- Është vendosur aparati për evidentim të hyrje-daljeve të stafit akademik dhe administrativ;
- Këshillat e Fakulteteve, evidentojnë dhe përmirësojnë programet e studimeve, bazuar në nevojë, duke gjetë mbështetje në rregulloren për studimet bachelor, master dhe duke u bazuar në udhëzuesin administrativ të AKA-së (15/18);

- Në programet studimore është inkorporuar praktika profesionale si pjesë e programeve të studimit.
- Këshillat e Fakulteteve miratojnë ndryshimet e syllabusëve të lëndëve;
- Është rritur numri i punonjësve të administratës, që ka bërë që të përmirësohen shërbimet studentore;

NJA kanë ndërmarrë hapa në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e suksesit të studentëve dhe kanë hartuar [udhëzuesin me numër Nr. 105](#).

- Janë zhvilluar hulumtime për matjen e cilësisë së mësimin në klasë nga mësimdhënësit, është bërë matja e cilësisë së mësimin online gjatë periudhë së pandemisë, gjithashtu është zhvilluar edhe hulumtimi në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e shërbimit të studentëve e UKZ-së;
- Një herë brenda akademik realizohet hulumtime me studentët Alumni;

5.4. Funksionet e sigurimit të cilësisë në të gjithë institucionin janë integruar plotësisht në strategjitë normale të zhvillimit dhe planifikimit në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë mbulon të gjithë gamën e aktiviteteve institucionale

Përputhshmëria e UKZ-së

Viteve të fundit janë bërë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të kapacitetve në sigurim të Cilësisë. Menaxhimi i Cilësisë është rregulluar, përveç në dokumentacionin themelor të UKZ, si: Statuti i UKZ-së, PSt i UKZ-së, Rregullorja për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësim, Rregulloret për studimet bachelor dhe master, Standardet e sigurimit të cilësisë etj.

Standardet e cilësisë janë të mirënjohura për secilin staf akademik, administrativ dhe për studentët dhe realizimi i tyre monitorohet në baza të rregullta-në mënyrë rutine. Sigurimi i cilësisë nuk është vetëm një masë e kohë pas kohshme po një proces normal që rrjedh gjatë tërë viti akademik dhe mbikëqyrjet gjithnjë.

Për realizimin e synimeve të strategjisë, UKZ-ja harton çdo vit Planin e Veprimit të UKZ-së dhe Planin e Veprimit për Cilësi, duke përditësuar të gjitha aktivitetet, që shkojnë në dobi të realizimit të objektivave të parapara në strategji.

Me qëllim të realizimit të misionit UKZ-ja, për çdo vit akademik planifikon të gjitha aktivitetet me rëndësi për sigurimin e cilësisë, propozimin e *Planit të Veprimit për Cilësi* të vitit akademik e përgatitë Zyra për Cilësi në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ, të cilin para fillimit të vitit akademik e miraton Senati i UKZ-së. PV për cilësi është bazuar dhe në harmoni me dokumentet tjera strategjike të UKZ-së.

Cikli i sigurimit të cilësisë është një cikël i cili në vete përfshinë aktivitete në funksion të sigurimit të cilësisë së programeve studimore, proceseve mësimore, cilësinë e punës kërkimore shkencore, cilësinë e ligjërimeve, kriterëve të zgjedhjes dhe avancimit të kuadrit akademik, cilësinë e teksteve mësimore, pjesëmarrjes në projekte dhe të tjera.

Secili program studimor e ka [rregulloren e vet të studimeve](#), me të cilën janë të përcaktuara gjithashtu edhe rregullimi dhe matja e cilësisë së programit, të cilat janë në web faqe të UKZ-së.

Planet vjetore dhe semestrale të punës së Zyrës për Sigurim të Cilësisë janë në përputhje të plotë me rregullativën në fuqi. Ato zbërthehen në plane më të detajuara të punës nga niveli institucional, në nivel të njësive akademike si dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga [Këshilli për Mbikëqyrjen e cilësisë dhe për vlerësim](#).

PV për Sigurimin e Cilësisë, implementohet në NJA në bashkëpunim me ZZHAC-në dhe koordinatorët për sigurim të cilësisë në NJA.

Ndër të tjera, plani i tillë përfshinë edhe aktivitetet si në vijim: standardizimin e syllabuseve, miratimin e tyre një herë në vit në Këshillat e Fakulteteve, kontrollimin e vendosjes së syllabusëve në platformat online nga ana e stafit akademik (SMU, Moodle, Platforma UKZ, Mahara, eëbsite), monitorimin e implementimit të syllabusëve, publikimit të materialeve elektronike, rishikimin e raportit semestral pas përfundimit të semestrit, vlerësimet e brendshme për përmbushjen e rekomandimeve nga raporti i ekspertëve të jashtëm për akreditim.

5.5. Vlerësimet e rregullta bëhen në fund të çdo semestri dhe raportohen raporte që ofrojnë një pasqyrë të performancës për institucionin në tërësi dhe për njësitë organizative dhe funksionet kryesore brenda saj

Përputhshmëria e UKZ-së

Nga viti 2017, pas riakreditimit të dytë institucional, ka pasur avancim në fushëveprimin e sigurimit të cilësisë: përpos vlerësimeve të rregullta semestrale nga studentët për stafin akademik dhe administrativ, tani realizohen vlerësime të rregullta cilësinë e studimeve edhe nga palë të tjera: stafi akademik bën vetëvlerësim, menaxherët vlerësojnë stafin akademik e punëdhënësi vlerëson cilësinë e Universitetit. Vlerësimet e studentëve bëhen në fund të çdo semestri, ndërsa vlerësimet e tjera bëhen një herë në vit.

Për të realizuar një nivel sa më adekuat të cilësisë, në mënyrë periodike bëhet vlerësimi i stafit akademik si dhe i lëndëve, i cili bazohet në UV. UV dhe përdorimi i rezultateve të tyre në UKZ, specifikon rregullat e përcaktuara nga misioni, politikat dhe strategjitë e UKZ, që burojnë në mënyrë të veçantë nga Statuti i UKZ-së . Ky dokument është plotësisht në përputhje me [Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë](#) (ESG,2015) dhe [Rregulloren për sigurimin e Cilësisë dhe vlerësimin në UKZ](#)

Vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve realizohet në dy faza. Faza e parë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të semestrit dimëror si dhe faza e dytë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të semestrit veror. ZZHAC, publikon rezultatet e hulumtimit në këtë mënyrë: Secilit mësimdhënës të vlerësuar i dërgohen rezultatet e tij në mënyrë elektronike, studentët marrin informacion rreth vlerësimit përmes raporteve të shprehura gojarisht nga dekani dhe mësimdhënësit, Dekanët dhe Prodekanët marrin të gjitha rezultatet për fakultetin e tyre, kurse Rektori dhe Prorektorët marrin të gjitha rezultatet për Universitetin. [Raporti përmbledhës 1](#) dhe [2](#) publikohet në eëb faqen e Universitetit.

UKZ kryen vlerësimin e lëndëve në mënyrë të standardizuar dhe transparente. Këto udhëzime qartë rregullojnë mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të fituara gjatë vlerësimit të stafit akademik si dhe lëndëve . Ato zbatohen për të gjithë stafin akademik (duke përfshirë ligjëruesit dhe asistentët mësimdhënës) pavarësisht nga thirrja e shkencore apo pozita e tyre. Në veçanti, rezultatet e vlerësimit i ndihmojnë mësimdhënësit dhe njësisë akademike të vetëpërmisohen në mënyrë të vazhdueshme. Në rastet kur personeli akademik nuk ka aftësi ose vullnet për t'u përmirësuar, universiteti do të vendosë masa/sanksione, p.sh. caktimin e detyrave/aktiviteteve tjera.

Mekanizëm tjetër për vlerësimin e cilësisë nëpër NJA të UKZ-së, aplikohet edhe vlerësimi nga Menaxhmenti i Fakultetit për stafin akademik.

Një mekanizëm tjetër është vlerësimi i hisedarëve të jashtëm (punëdhënësit) për cilësinë e mësimin akademik. Ky mekanizëm ka filluar të aplikohet nga viti 2020. Universiteti ka

bashkëpunim me biznese, në të cilët edhe dërgon studentë për punë praktike, por gjithashtu studentët e diplomuar të UKZ mund të punësohen. Hisedarët e jashtëm bëjnë vlerësime për studentët dhe alumni të UKZ në bazë të pyetësorit të krijuar nga UKZ, e ku këto pyetësorë masin mendimin kritik, bashkepunimin në grupe, aftësinë e punës në presion, mangësitë e studenteve tane pas diplomimit, etj.

Një mekanizëm efikas është edhe vlerësimi i studentëve Alumni për programet studimore. UKZ angazhon në çdo proces të rishikimit të programeve studimore apo të dokumenteve strategjike edhe një numër të studentëve Alumni të cilët japin kontributin e tyre. Për çështje specifike të programeve studimore me ta zhvillohen [anketa dhe mbahen debate konsultative](#).

Një mekanizëm bazik për sigurimin e cilësisë vjen edhe nga raportet e Komisioneve Recensuese. Këto komisione emërohen nga Senati dhe gjithmonë janë për një titull akademik më të lartë se kandidati në konkurrim. Kjo ndodhë sa herë pranohet një staf i ri akademik ose sa herë një staf avancohet. Këto raporte janë me detaje për punën shkencore të kandidatit dhe publikohen në ueb faqen e UKZ.


Bazuar në Rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin në UKZ-së, ZZHAC në bashkëpunim me KMCV realizon [vlerësime lidhur me shërbimet e administratës](#) të cilat u ofrohen studentëve gjatë studimeve në UKZ.

Për shkak të rrethanave të krijuara përgjatë pandemisë Covid 19, gjatë semestrit dimëror 2019/2020 është realizuar një vlerësim për vlerësimin e mësimin online nga stafi akademik dhe studentët. Pas pezullimit të përkohshëm të mësimin në klasë, edhe UKZ ka aplikuar e-mësimin si mënyrë për ruajtjen e vazhdimësisë së mësimin, duke përdorur platforma të ndryshme online. Lidhur me këtë, janë analizuar të dhënat dhe është publikuar [raporti](#) me rezultatet e gjetura.

Mësimdhënësit e njësisë akademike, në peridhura mujore dorëzojnë raportin për mbajtjen e procesit mësimorë. Dekanët në baza semestrale hartojnë raport përmbledhës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të njëjtin e dorëzojnë tek Prorektori për Mësim dhe Çështje Akademike. Zyra e personelit, gjithashtu harton raportin e vijueshmërisë të stafit akademik dhe administrativ në baza mujore. Ai raport i dorëzohet menaxhmentit të UKZ-së për vlerësim.

UKZ-ja posedon edhe raportet e mbajtjes së mësimi online, të cilat burojnë nga SMU, Google Meet, Moodle, UKZ Platforma. Këto platforma gjenerojnë raportet në baza mujore; [Raportet](#) vlerësohen nga Dekanët dhe Rektori.

Tabela 19 Procesi i Vlerësimit të Cilësisë (UKZ)



UKZ çdo vit zhvillon vlerësimin e stafit administrativ lidhur me performancën e tyre. Kjo bëhet nga sekretari i përgjithshëm i UKZ-së, ndërsa raporti deponohet në arkivën e UKZ-së dhe MAPL-së. Gjithashtu vlerësimin e administratës e bëjnë edhe studentët e UKZ-së të cilët vlerësojnë shërbimet e administratës së UKZ si dhe sjelljen e personelit administrativ gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve, e ku ZZHAC bënë [raportin](#) përmbljedhës.

UKZ, ka hartuar edhe raportin e hulumtimit përmes fokus grupit me biznese në lidhje me programet e studimit, praktikën e studentëve, rritjen e aftësive dhe shkathtësive praktike të studentëve, punësueshmërinë dhe proceset tjera.

Dekani i fakultetit përgatitë raportin vlerësues, i cili do të bëhet pjesë e dosjes personale për çdo mesimdhënës. (Grumbullimi i raporteve nga vlerësimet e mëhershme, të menaxhmentit dhe studentëve). UKZ-ja për çdo vit kalendarik, dorëzon raportin institucional të performancës në Ministrinë e Arsimit;

5.6 Vlerësimet marrin parasysh inputet, proceset dhe rezultatet, por i kushtojnë vëmendje të veçantë cilësisë së rezultateve. Vlerësimet kanë të bëjnë me performancën në lidhje me aktivitetet e vazhdueshme rutinore si dhe me objektivat strategjike. Ato gjithashtu sigurojnë përmbyshjen e standardeve të kërkuara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës

Përputhshmëria e UKZ-së

Vlerësimet në UKZ kanë të bëjnë me performancën e aktiviteteve të përditshme si dhe objektiveve strategjike të përcaktuara me rregullativën për sigurim të cilësisë. Nga rezultatet e marra, mekanizmat që punojnë në sigurim të cilësisë marrin parasysh inputet, sygjërimet, pastaj kjo reflektohet në përmirësime të vazhdueshme të performancës.

Për të pasur pasqyrë sa më të përafërt me realitetin, UKZ përdorë një sërë instrumentesh vlerësuese, grumbullon të dhëna, harton raporte dhe i referohet cilësisë së rezultateve.

Lidhur me këtë, pas përpunimit të të dhënave, ZZHAC në bashkëpunim me komisionin për sigurim të cilësisë, analizon të dhënat, nxjerr rekomandimet dhe harton raportin e gjetjeve.

Në kuadër të kësaj, akterët përgjegjës për sigurim dhe vlerësim të cilësisë ndërmarrin hapa për rishikimin e instrumenteve vlerësuese, duke u bazuar në rezultatet dhe inputet e raporteve.

Tre shembuj:

1. Gjatë vlerësimit të stafit akademik nga ana e studentëve, në semestrin dimëror të vitit akademik 2018/2019, është hartuar një pyetësor i përbashkët për të gjithë mësimdhënësit (profesorë dhe asistentë). Duke marrë parasysh se angazhimi i profesorit dhe asistentit dallon, në semestrin verorë hulumtimi është realizuar me dy lloje të ndryshme të pyetësorëve (një për profesorë dhe një tjetër për asistentë).
2. Nga analizimi i raporteve të vlerësimit për vitin akademik 2017/2018 nga ana e studentëve, Komisioni për Sigurim të Cilësisë dhe ZZHAC, kanë konstatuar se duhet shtuar instrumente të tjera të vlerësimit për të pasur një pasqyrë më gjithëpërfshirëse për performancën e mësimdhënësve. Kështu që, në vitin pasues ka filluar të praktikohen edhe instrumente tjera matëse, duke përfshirë vlerësimin nga menaxhmenti, dekanët nëpër njësi akademike dhe stafi. (Shih standardin 5.5)
3. Gjatë rishikimit të programeve të studimit lidhur me procesin e riakreditimit janë marrë parasysh inputet e palëve të interesit si: BKI, Komunitetit të Bizneseve, OJQ-ve, Gjykatave, DKA-ve dhe studentëve Alumni;

Të gjitha inputet e palëve të përfshira në proces, janë marrë parasysh dhe mund të themi se kanë ndikuar direkt në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së performancës brenda UKZ-së, në përmbushjen e standardeve të kërkuara.

5.7. Të gjitha njësitë akademike dhe administrative brenda institucionit (duke përfshirë edhe organin drejtues dhe menaxhmentin e lartë) marrin pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë dhe kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të tij

Përputhshmëria e UKZ-së

Të gjithë palët brenda Universitetit mbajnë përgjegjësi në arritjen e objektivave strategjike në Planin Strategjik të UKZ-së, vecanërisht për sigurimin e cilësisë.

Deri sa cikli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë është përcaktuar me Statutin e Universitetit, në paragrafët e neneve 187-201, kjo nënkupton që të gjitha NJA, Administrata, studentët, menaxhmenti i lartë i UKZ deri te KD, janë të kyçur në procesin e sigurimit të cilësisë.

Senati harton rregullore për cilësi dhe merr vendime të tjera për cilësi rregullisht dhe sipas nevojës. Këshillat e Fakulteteve po ashtu marrin vendime për sigurimin e cilësisë. Të gjitha këto rregullore dhe vendime votohen nga shumica e anëtarëve të Senatit dhe të KF. Rregulloret e vendimet për sigurimin e cilësisë publikohen në ueb faqen e UKZ dhe shpërndahen në forma të ndryshme (broshura, doracakë etj.) për t'i kuptuar të gjitha palët e Universitetit.

Në anën tjetër, Zyra për Zvillim Akademik dhe Cilësi, bashkë me KMCV, në bashkëpunim me Menaxhmentin e lartë dhe me dekanët e UKZ-së, hartojnë plane veprimi dhe ndërmarrin veprime për kontrollin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të cilësisë në Universitet. Në të gjitha këto veprime përfshihen: prorektorët, dekanët, prodekanët, zyrtarët administrativ dhe studentët.

PV për Cilësi përmban veprimet, masat, afatin kohor, bartësit, mbikëqyrësit si dhe evidencën për realizim: plotësisht, pjesërisht, në proces të realizimit, nuk është realizuar si dhe vërejtje dhe miratohet nga Senati. Ai duhet të jetë në përputhje me Planin e Veprimit Vjetor të UKZ, i cili miratohet në KD.

Mbikqyrjen e tërë procesit për sigurimin e cilësisë e bënë KMCV.

Ne ngritjen e cilësisë faktor kyç ka edhe përdorimi i mjeteve të ndryshme të teknologjisë si me poshtë:

- Përdorimi i Platformës SMU: është platformë e cila mundëson menagjimin virtual të Notave të studenteve, Aplikimin për provime, Mesimin Online, statistikën e ndryshme, temat e diplomës, aplikimin për pranim në UKZ, komunikimin profesor-student, shpërndarjen e literaturës etj
- Përdorimi i mjeteve teknologjike virtuale, si Moodle, Online Video Lecturing Software (gjate pandemise) si Google Meet etj. Platforma moodle është një platformë që përdoret nga shumë universitete botërore me shumë sukses. Ne UKZ ka vite që platforma Moodle është duke u përdorur në të gjitha Fakultetet.
- Platforma e punuar nga UKZ (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike) që ka dhënë një ndihmë të madhe në ngritjen e cilësisë së mbarëvajtjes së mësimit dhe Student satisfaction duke aplikuar metoda të reja të kontrolluesve të profesorëve dhe studenteve. Në këtë Platformë që quhet [EDU](#) mund të monitorohet mesazhi Live, të shikohet a është duke mbajtur mësimin, të lejohen zëvendësimet e orëve të humbura, të monitorohet vijueshmëria e Studenteve, të uploadohet materiali i lendeve duke përfshirë Syllabuset etj dhe shumë funksione të tjera bëhen në mënyrë automatike. Gjithashtu edhe Orari i ligjëratave gjenerohet automatikisht për semestër varësisht nga kërkesat e mësimdhënësve. Gjenerimi i raporteve për stafin bëhet çdo javë dhe çdo muaj. Ky softuer ka ngritur cilësinë e mbarëvajtjes së mësimit.
- Zbatimi i cilësisë në UKZ është sanksionuar në statutin e Universitetit me në detaje në seksionin e cilësisë “Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi” Neni 187.

5.8. Zyra e menaxhimit të cilësisë është themeluar brenda administratës qendrore të institucionit dhe personeli i mjaftueshëm, burimet dhe mbështetja administrative duhet të sigurohen për funksionimin efektiv të zyrës

Përputhshmëria e UKZ-së

Brenda administratës qendrore të UKZ-së është themeluar ZZhAC, në vitin 2018. Në kuadër të kësaj zyreje është emëruar drejtori. Gjithashtu është paraparë që për vitin 2021 zyra të zgjerohet edhe me një zyrarë.

ZZhAC, koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e matjes së cilësisë në UKZ si dhe procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve (shih më lartë) duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përshijnë këto procese dhe po ashtu, koordinon punën e Zyrës me senatin e UKZ-së, Këshillat e Fakulteteve, Institutet, si dhe me komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe në cilësi.

ZZhAC përpilon planin e punës së Zyrës dhe e mbikëqyr realizimin e tij nën udhëheqjen e prorektorit për mësim dhe kërkime shkencore.

Në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, secila nga NJA ka caktuar nga një Koordinator për Cilësi, (gjithsejt pesë koordinatorë deri më tani), i cili ka detyrë dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguruarit të cilësisë brenda njësisë akademike nga e cila është zgjedhur. Koordinator i Cilësisë, është një nga anëtarët e stafit të rregullt akademik.

Si i tillë, Koordinatori është urë lidhëse në mes njësisë akademike dhe Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi të Universitetit.

ZZHAC në kuadër të punës së saj ditopre ndihmohet direkt nga koordinatorët e cilësisë. Koordinatorët, në përpjekje të sigurimit të cilësisë i raporton menaxhmentit të fakultetit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi: udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësisë akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së; në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafit akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshilldhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit; Koordinatori për cilësi është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë; në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore); Koordinatori këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatori kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në ëeb-faqe.

5.9. Një komitet i besueshëm është themeluar me anëtarët e zgjedhur nga të gjitha llojet e anëtarëve të bashkësisë akademike, duke përfshirë studentët

Përputhshmëria e UKZ-së

Anëtarët e KMCV vijnë nga stafi akademik i secilës njësi akademike dhe zgjedhën me votë të fshehtë nga KF. Pjesë e këtij komisioni janë edhe përfaqësuesit e studentëve, të deleguar nga PS, si dhe përfaqësuesi i zyrës për cilësi. Për sigurimin e cilësisë në UKZ-, kanë përgjegjësi të gjitha subjektet e mëposhtme: ligjëruesit, punëtorët shkencorë, bashkëpunëtorët, Këshilli Mësimor Shkencor, Komisionet e Universitetit, studentët, stafi jo akademik si dhe shërbimet administrative.

KMCV përgatitë plane për implementim ndërkohë që më pas i njëjti i raporton Këshillave të Fakultetit, Dekanit, Rektorit dhe Senatit të UKZ-së për rezultatet e treguara si dhe propozimin për ndërmarrjen e ndonjë mase konkrete.

KMVC në përbërjen e tij ka dhjetë (10) anëtarë. Përbërja e anëtarëve të KMCV është:

- Prorektori për Mësim, Kërkime Shkencore dhe Çështje të Studentëve (i përhershëm) Kryesues
- Pesë përfaqësues nga NJA të Universitetit (staf akademik), të cilët propozohen nga Këshilli i NJA
- Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (i përhershëm) pa të drejtë vote
- Zyrtari për Çështje Akademike (i përhershëm) pa të drejtë vote
- Përfaqësuesi i studentëve
- Anëtarët jo të përhershëm votohen nga Senati i Universitetit për një mandat tre (3) vjeçar, përveç përfaqësuesve të studentëve që zgjat një (1) vit
- Së paku një e treta e anëtarëve të komisionit vazhdojnë në përbërjen e komisionit pas mandatit 3 vjeçar, për të siguruar vazhdimësinë e punës.
- Në rast kur votimi është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare
- KMCV harton dhe aprovon Rregulloren e punës së këtij komisioni i cili është dokument publik i Universitetit. Këshilli për punën e vet i raporton Senatit.

5.10. Rolet dhe përgjegjësitë e zyrës dhe komitetit të menaxhimit të cilësisë dhe marrëdhëniet e tyre me njësitë e tjera administrative dhe të planifikimit janë të përcaktuara qartë. Nëse funksionet e sigurimit të cilësisë menaxhohen nga më shumë se një njësi organizative, aktivitetet e tyre përcaktohen qartë dhe koordinohen në mënyrë efektive nën mbikëqyrjen e një përfaqësuesi të menaxhimit institucional

Përputhshmëria e UKZ-së

KMCV është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me organe tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit, i cili planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga universiteti.

Detyrat e KMCV-së janë:

- I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmisimin e vazhdueshëm
- Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë
- Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregullativën në fuqi dhe dokumentin strategjik të UKZ-së.
- I dorëzon Rektorit dhe Senatit raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë
- I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Komisioneve të njësive akademike, për përmisim të nivelit të cilësisë
- Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë bënnda universitetit
- Analizon të dhënat e mbledhura në fushat e vlerësimit të përcaktuara
- Harton dhe i propozon Senatit aprovimin e raportit të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim Institucional
- Shqyrton dhe i propozon Senatit aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve Studimore.
- Harton raporte të përmisimit në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve të pranuar nga Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi.
- Analizon dhe aprovon raporte periodike/vjetore dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë së njësive akademike të Universitetit, të cilat raporte i dëron tek Menxhmenti i Lartë

Në anën tjetër Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi, koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përshijnë këto procese dhe po ashtu, koordinon punën e Zyrës me senatin e UKZ-së, KD, NJA, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura etj. Nën udhëheqjen e prorektorit për mësim dhe kërkime shkencore, e përpilon planin e punës së Zyrës dhe e mbikëqyr realizimin e tij; Punon duke u këshilluar me menaxhmentin e UKZ-së, përkatësisht me prorektorin për mësim dhe kërkime shkencore, si dhe me akteret e tjerë relevantë për ta përkrahur promovimin dhe zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Procesi i Bolonjës në UKZ. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (ZZHAC), punën e saj e bazon në dokumentacionin e nevojshëm i cili përmban rregulloret e miratuara nga senati i UKZ-së që nga themelimi i Universitetit e këtej. Përgjegjësitë dhe punët janë të ndara nga njëra tjetra, por koordinimi është shumë i suksesshëm.

5.11. Format e përbashkëta dhe instrumentet e anketimit përdoren për aktivitete të ngjashme në të gjithë institucionin (veprimtari akademike, shërbime studentore, administrim etj.) Dhe përgjigjet përdoren në analizën e rezultateve duke përfshirë trendet gjatë kohës. Të dhënat e anketimit grumbullohen nga studentët, stafi, të diplomuarit dhe punëdhënësit; rezultatet e këtyre sondazheve bëhen publike

Përputhshmëria e UKZ-së

Për hartimin e raporteve të vlerësimit punojnë kryesisht ZZHAC në konsultim me KMCV dhe në bashkëpunim me menaxhmentin/Dekanin e Fakultetit.

Deri tani janë përdorur forma të përbashkëta dhe instrumente të njëjta për të njëjtën fushë, por të ndryshme për fusha të tjera. Kështu, është përdorur i njëjti pyetësor për vlerësimin e gjithë stafit akademik nga studentët por një pyetësor tjetër unik për vlerësimin e stafit akademik nga menaxherët, një pyetësor tjetër unik për vlerësimin e stafit administrativ, një pyetësor unik për vlerësimin e të gjithë asistentëve etj. pra, UKZ ka bërë standardizimin e pyetësorëve për fushat me interes për vlerësim.

UKZ ka ndërtuar standard në vlerësim, i cili është gjithëpërfshirës dhe përmbajtësor.

Rezultatet e vlerësimit analizohen nga ZZHAC dhe nga Kshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësim. Të dhënat e të gjitha anketimeve grumbullohen, përpunohen me softëver adekuat dhe publikohen në uebfaqe. Krahësimet bëhen për të shikuar trendin e zhvillimit, në mënyrë që të ndërmarë masat për përmisim të mëtejshëm. Raportet e rezymuara bëhen publikë edhe në uebfaqen e UKZ dhe raportohen edhe në Senatin e Universitetit, ndërsa raportet me detaje për secilin staf i raportohen Dekanit të Fakultetit dhe vetë stafit konkret. Të gjitha këto vlerësime (anketa, pyetësorë etj.) ruhen në Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, ndërsa raportet e kësaj Zyre arkivohen dhe ruhen në Arkivin e UKZ, sipas Ligji Nr. 04/L-088 Për Arkivat Shtetërore.

Të gjitha imputet e palëve të përfshira në proces, janë marrë parasysh dhe mund të themi se kanë ndikuar direkt në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së performancës brenda UKZ-së, në përmbushjen e standardeve të kërkuara.

5.12. Të dhënat statistikore mbahen në një bazë të dhënash qendrore të qasshme dhe sigurohen në mënyrë rutinore për departamentet dhe njësitë për përdorimin e tyre në përgatitjen e raporteve mbi treguesit dhe detyrat e tjera në monitorimin e cilësisë

Përputhshmëria e UKZ-së

ZZHAC, ka krijuar një bazë me të dhëna të grumbulluara nga vlerësimet përgjatë viteve. Këto të dhëna janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit. ZZHAC-ja, posedon të dhënat si në vijim:

- **Materialet e dorës së parë** (Pyetësorë: Kopje fizike dhe elektronike)
- **Rezultatet e hulumtimeve** (Rezultatet e përgjithshme për institucionin, njësitë akademike dhe personelin akademik dhe administrativ)

UKZ-ja posedon këto lloje të raporteve:

1. Raportet nga hulumtimet në formë fizike
2. Raportet nga SMU
3. Raportet nga Moodle
4. Raportet nga UKZ platforma
5. Raportet nga Google Meet
6. Raportet nga aparati i vijueshmërisë

Të gjitha këto të dhëna janë në funksion të menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në UKZ.

Rrjedhimisht, në fund të çdo semestri, por edhe në fund të çdo viti akademik, në kuadër të *Fakulteteve*, do të publikohet në ëeb faqe të UKZ-së, *Raporti përmbledhës për vlerësimin e stafit akademik dhe të lëndëve*, ku në mënyrë të detajuar do të pasqyrohen të arriturat dhe mangësitë për semestrin ose vitin akademik të përfunduar. Paraqitja në formën e tillë gjithsesi se i kontribuon ngritjes së cilësisë së jetës akademike brenda *Fakulteteve të UKZ-së*, motivon edhe më shumë stafin akademik si dhe në anën tjetër i kontribuon evidentimit të mangësive eventuale, gjithnjë me synim të eliminimit të tyre.

5.13 Ekzistojnë dëshmi të qarta se të dhënat e sigurimit të cilësisë përdoren për të udhëhequr përmirësimin dhe si një bazë për përmirësim

Përputhshmëria e UKZ-së

Të dhënat e sigurimit të cilësisë përdoren nga Këshili i Fakultetit dhe menaxhmenti i UKZ-se në procesin e avancimit dhe të angazhimit të stafit akademik dhe administrative të UKZ-s.


ZZhAC pas çdo Semestri dhe në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ-së përdor rezultatet e vlerësimit, të cilat i dorëzohen Dekanit të secilës njësi akademike dhe i cili pastaj bënë dorëzimin në mënyrë individuale, në formë elektronike tek Stafi akademik.

Ky vlerësim ju shërben stafit akademik dhe stafit të lartë drejtues të UKZ për të reflektuar dhe për të vlerësuar se në çfarë gjendje është UKZ sa i përket cilësisë së procesit të mësimi.

Bazuar në raportet e vlerësimit të performancës në UKZ, janë ndërmarrë masa të cilat ndikojnë në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Në vijim përmendim disa hapa të ndërmarrë:

- Është vendosur aparati për regjistrimin e vijueshmërisë së stafit administrativ;
- Është vendosur aparati për regjistrimin e vijueshmërisë së stafit akademik;
- Është rishikuar rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik, në kuadër të së cilës janë vendosur kritere të qarta që burojnë nga masat për sigurim të cilësisë;
- Është rishikuar rregullorja për angazhimin e stafit akademik, në kuadër të së cilës janë vendosur kritere të qarta që burojnë nga masat për sigurim të cilësisë;
- Është hartuar rregullorja për themelimin dhe funksionimin e KMCV;
- Janë shtuar instrumentet e vlerësimit;
- Është vendosë një kontroll më i madh i revistave shkencore ku stafi akademik publikon punimet shkencore;
- Është marrë qndrim që në syllabus, përveç në raste të vecanta, të mos ketë literaturë më të vjetër se 10 vjet;
- Është vendosur që konsultimet profesor-student duhet të jenë obligative gjatë tërë viti akademi dhe jo vetëm pas provimeve, prandaj secili staf akademik duhet 2 orë në javë të kushtojë vetëm konsultimeve me student;
- Meqenëse disa nga sallat e mësimi përdoren nga më shumë se një fakultet, është vendosur që në hapësirat e korridoreve të objekteve të vendosen televizorë të mëdhenj të cilët do të transmetojnë vijimisht oraret e mësimi e të ushtrimeve apo të aktivitetëve të tjera.
- Praktika është bërë pjesë e kurrikulës në disa fakultete: në programet studimore të Fakultetit të Edukimit, në Juridik, në Shkencat Kompjuterike, në Matematikën Arsimore etj.

Tabela 20 Procesi i analizës dhe përdorimi i rezultateve të cilësisë. (UKZ)



5.14. Marrëveshjet e sigurimit të cilësisë vetëvlerësohen, raportohen dhe përmirësohen rregullisht

Përputhshmëria e UKZ-së

Masat për sigurimit të cilësisë vetëvlerësohen nga ZZHAC-ja, KMCV, Koordinatorët e NJA, KF, komisioni i studimeve, Senati dhe KD i UKZ-së .

Vlerësim të vecantë për efikasitetin dhe efektet e masave bënë KMCV.

Të gjitha këto organe në baza të rregullta rishikojnë strategjinë e UKZ-së dhe Planin e Veprimit të kësaj strategjie për të shikuar se çfarë duhet të ndryshohet apo rregullohet më tutje. Kjo strategji është rishikuar në vitin 2020.

Poashtu strategjia për cilësi dhe PV për cilësi si dhe rregullorja për sigurim të cilësisë si dhe [Manuali](#) janë rishikuar nga këto organe dhe si rrjedhojë këto dokumente janë bërë gati për vitin 2020, duke u miratuar nga Senati dhe KD.

Poashtu të gjithë pyetësorët janë rishikuar dhe janë ndryshuar për të përfshirë elementet e nevojshme për matjen e performancës së stafit. Pyetësoret e vitit 2020 janë ndryshuar me ato 2019 sepse stafi edhe studentet kanë kërkuar të kenë pyetje me detajizuese sesa përgjithesuese. Për këtë arsye ZZHAC ka marrë parasysh të gjitha vërejtjet nga stafi akademik, stafi administrativ e sidomos studentët që të ndryshojnë disa elemente/pyetje të pyetësorëve. ZZHAC ka ngritur këtë çështje në nivel menaxhmenti dhe së bashku me KMCV dhe koordinatoret për cilësi kanë punuar në hartimin e pyetësorëve të rinj, duke u bazuar në vërejtjet e cekura. UKZ gjithashtu ka realizuar në vitin 2020 edhe pyetësorin për mësimin online, i cili ka dalluar nga pyetësorët e kaluar, për shkak të rrethanave të reja të krijuara – COVID 19. Rezultatet e këtij pyetësori janë përmbledhur në një [raport](#) nga ZZHAC dhe janë publikuar në web të UKZ.

Të gjitha mekanizmat e përmendur në këtë standard, rregullisht evidentojnë mangësitë dhe rekomandojnë dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme për përmisim të masave dhe veprimeve.

Analiza SWOT për Standardin 5:

Tabela 21 Analiza SWOT për Standardin 5

Pikat e forta	Dobësitë
- Krijimi i politikave për sigurimin e cilësisë në PSt; - Hartimi dhe rishikimi i Rregulloreve dhe dokumenteve tjera që menaxhojnë sigurimin e cilësisë brenda Universitetit - KMCV dhe funksionimi i tij - Emërimi i Kordinatorëve të Cilësisë për secilën Njësi Akademike - Realizimi, përpunimi si dhe publikimi i rezultateve të vlerësimeve që realizohen brenda universitetit. - Publikimi i raporteve të përgjithshme për vlerësimin e performancës; - Studentët si palë e rëndësishme dhe shumë aktive në çdo aktivitet që ka të bëjë me sigurim të cilësisë (hartim të pyetësorëve, hulumtime, përpunim të të dhënave si dhe shqyrtimin dhe analizën e gjetjeve) - Mbështetje e menaxhmentit të UKZ për ZZHAC, KMCV dhe Koordinatorët e Cilësisë - Realizimi i vlerësimit nga ana e studentëve realizohet online përmes platformës SMU - Të qenët në rrjedhë të teknologjisë bashkëkohore të TI në procesin mësimor	- Mungesa e stafit të mjaftueshëm administrativ në ZZHAC. - Numër i vogël i stafit të trajnuar për metodologji të mësimdhënies; - Mosnjohja e gjuhëve të huaja; - Mungesa e literaturës së re; - Mungesa e literaturës origjinale
Mundësitë	Rreziqet
- Zgjerimi i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi me zyrtarë për cilësi - Zgjerimi i rrjetit me partnerë ndërkombëtarë e vendorë lidhur me sigurimin e cilësisë, duke marrë modele të ndryshme nga praktikat e vendeve të zhvilluara (Projekti Erasmus+ Qatek) - Universiteti jonë pjesë e projektit për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës lidhur me performancën e Stafit Akademik (Projekti Optima) - Realizimi i vlerësimeve brenda UKZ në formë elektronike. - Trajnimi i stafit akademik për metodologji të mësimdhënies - Mbështetja e stafit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe publikime shkencore - Realizimi i mësimin online - Themelimi i qendrës për trajnimin e mësimdhënësve në UKZ. - Krijimi i programeve të mësimin në distancë (online).	- Vështirësitë e komunitetit në të kuptuarit e rëndësisë së vlerësimit të bazuar në TP; - Plagjiatura; - Revistat fiktive; - Konkurrenca vendore dhe ndërkombëtare;

Standard 6. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

6.1. Institucioni ka hartuar dhe miratuar politika dhe procedura të zbatueshme për të gjitha programet akademike; institucioni vëzhgon masën në të cilën zbatohen efektivisht këto politika dhe procedura

Përputhshmëria e UKZ-së

Në bazë të misionit të UKZ, mësimdhënia dhe mësimnxënia është veprimtari kryesore e universitetit i cili zhvillohet nëpërmjet njësive akademike- fakulteteve. Mësimdhënia dhe mësimnxënia zhvillohet në kuadër të programeve studimore të cilat funksionojnë brenda fakulteteve. UKZ është themeluar me 3 Fakultete në vitin 2013, dhe tani ushtron veprimtarinë e tij në kuadër të 5 Fakulteteve: FEd, Juridik, Ekonomik, shkencave Kompjuterike dhe Fakultetin e Shkencave Aplikative. Që në vitin e parë të themelimit UKZ i është nënshtruar procesit të akreditimit dhe riakreditimit nga AKA. Organizimi i procesit mësimor në kuadër të programeve studimore, bazohet në Statutin e UKZ-së, [Rregulloret të studimeve bachelor/master](#), [rregulloret për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit](#), [udhëzuesit për ECTS-së](#) dhe [treguesit e performancës në UKZ](#).

Se procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është i nivelit të mirë në UKZ, dëshmon edhe e dhëna se studentët e UKZ të cilët kanë përfunduar studimet bachelor në UKZ dhe kanë konkurruar në programe master në universitete të tjera si në Kosovë ashtu edhe në Zvicër, Austri, Gjermani, Slloveni, janë renditur ndër të parët në listat e pranimit. Një numër i tyre tani kan kryer me sukses studimet master dhe kan vazhduar në studime të doktoratës dhe/ose janë të punësuar.

Në vazhdim po prezantojmë përmbushjen e secilit prej standardeve për mësimdhënien dhe mësim nxënien si vijon:

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në programet studimore të UKZ bazohen:

Në statutin e UKZ (duke fillu nga neni 5 etj); UKZ, si institucion i arsimit të lartë, zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Studimet në UKZ kanë këto qëllime:

- Të veprojë si qendër udhëheqëse për avancimin e diturisë, ideve dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
- Të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- Të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
- Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase, dhe të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Mësimdhënia dhe mësimnxënia në UKZ t'u përshtatet standardeve evropiane, me qëllim të integritit plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë (konform Deklaratës së Bolonjës, Konventës së Lisbonës mbi Njohjen dhe në zonën evropiane të kërkimeve shkencore), si dhe
- Të ndër marrë hapat adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtyre qëllimeve

Në rregulloret për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit (neni 3 e të tjerë) përcaktohet sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në:

- Vlerësimin në nivel institucional.
- Vlerësimin në nivel të programeve studimore.

- Hartimin dhe miratimin e programeve të reja studimore.
- Vlerësimin e procesit mësimor, kërkimit shkencor, artistik, i administratës, stafit akademik dhe gjitha fushave të tjera të veprimtarisë së Universitetit.
- Rishikimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.
- Vlerësimi i jashtëm të sigurimit të cilësisë.
- Mobiliteti, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimi.
- Teksteve mësimore, literatura, biblioteka dhe infrastrukturës mësimore.
- Mbështetja financiare.
- Fusha të tjera sipas nevojës apo kërkesave të ndryshme nga MASHT, AKA, etj.

Rregulloret për studime bachelor (secili prej fakulteteve e ka rregulloren e studimeve bachelor) dhe të gjitha programet master kanë rregulloret e tyre të studimeve.

- Të dhënat për programin e studimit (titulli, lloji i studimit, thirrja akademike, titulli akademik, objektivat e dhe rezultatet e nxënies së programit, etj)
- Kushtet për regjistrim në programin e studimeve, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues, dokumente e nevojshme për regjistrim etj.
- Kushtet e regjistrimit në vitin vijues, vërtetimi i semestrit, etj.
- Ndërrimi i drejtimit të studimeve, kalimi nga fakulteti tjetër
- Organizimi i provimeve, paraqitja e provimeve, format e mbajtjes së provimeve vlerësuese, notimi, etj.,
- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe organizimi i studentëve,
- Përfundimi i studimeve dhe mbrojtja e provimit të diplomës
- Evidentimi i dokumentacionit në administratë.

Të dhëna më të detajuara përshkruhen edhe në dokumentet tjera si Rregulloret për punimin e diplomës, në rregulloren për pranimin e studentëve të rinjë në UKZ;

Në rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik, përshkruhen kushtet, procedurat për zgjedhjen e stafit akademik për mësimdhënie në UKZ..

Organizimi i procesit mësimor në UKZ është në funksion të politikave të qeverisë për arsimin e lartë në Kosovë (shih [ligjin për arsimin e lartë në Kosovë](#)). Po ashtu procesi mësimor në UKZ udhëhiqet në bazë të dokumenteve si në vijim: Standardeve të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian (AESC).

Masa e zbatimit të këtyre politikave vëzhgohet dhe pasqyrohet në raportet e zyrës së ZZHAC, që realizohet në fund të çdo semestri për secilën lëndë dhe për secilin program. Këto raporte analizohen dhe vlerësohen nga Këshillat e Fakulteteve, të cilat marrin masat e nevojshme për përmirësimet e dobësive të identifikuara.

Vëzhgimi dhe zbatimi efektiv i këtyre politikave të mësimdhënies dhe mësimnxënies bëhet në nivel të njësisë akademike (Fakultetit) dhe në nivel të Universitetit. KF propozon programe, ndryshime në programe, metoda të mësimdhënies dhe çështje të tjera akademike për senatin e UKZ-së; mbikëqyrë procesin mësimor dhe përcakton masat e duhura për sigurimin e cilësisë së procesit mësimor, si dhe harton raportin vjetor për rektorin (neni 76 të statutit të UKZ); Senati në nivel të Universitetit është organi më i lartë.

Senati i UKZ është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e politikave dhe procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies (shih nenin 48). Senati është përgjegjës për politikat dhe procedurat e vlerësimit të punës akademike të studentëve dhe mësimdhënësve, për validitetin dhe rishikimin e syllabusëve dhe programeve studimore, procedurat për dhënien e kualifikimeve etj.

6.2. Ekziston një sistem efektiv për të siguruar që të gjitha programet të përmbushin standardet e larta të mësimnxënies dhe të mësimdhënies nëpërmjet aprovimeve fillestare, ndryshimeve të rregullta dhe monitorimit të performancës

Përputhshmëria e UKZ-së

Gjatë hartimit dhe përgaditjes së programeve studimore e sidomos gjatë realizimit të procesit mësimor të këtyre programeve, rol të rëndësishëm luan stimulimi dhe motivimi i studentëve në procesin mësimor, duke ofruar një varg të aktiviteteve: Ofrimi i syllabusëve të lëndëve në fillim të semestrit, ligjëratat dhe ushtrimet me metoda fleksibile dhe me material të nevojshëm, organizimi i vlerësimeve periodike dhe të vazhdueshme, përdorimi i TI-së dhe aplikacionit e-learning, konsultimet e rregullta me mësimdhënësit janë parakushte etj.

Nga këndvështrimi institucional, hartimi i një programi nënkupton planifikimin e një kurrikule dhe përbërësve të saj në kredi, duke treguar rezultatet e të nxënit dhe ngarkesën e lidhur me punën, aktivitetet e mësimi dhe procedurat/ kriteret e vlerësimit. Kuadri institucional i kredisë duhet të kujdeset për nevojat e programeve të ndryshme dhe të mbështesë qasjet ndër-dhe multi-disiplinore. Përdorimi i ECTS në UKZ kërkon një kornizë institucionale kredie të bazuar në rregullore institucionale dhe një kuptim të thellë të sistemit nga secili anëtar i stafit akademik. Vendimet e bazuara në ekip gjatë hartimit të programit e rrisin koherencën e programit studimor.

Hapat e mëposhtëm janë identifikuar si të dobishëm në hartimin e programeve.

Kur zhvillohet një program i ri, vendimi i parë zakonisht ka të bëjë me nivelin e kualifikimit që duhet të jepet, i cili përcaktohet në bazë të legjislacionit përkatës kombëtar dhe kornizave ekzistuese të kualifikimeve [Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve](#) (KKK) dhe me Kornizën për Kualifikimet e Evropiane të Arsimit të Lartë.

Do të jetë e qartë se jo të gjitha rezultatet e mësimi janë në të njëjtin nivel - kështu që zbatimi i plotë i një sistemi krediti kërkon përshkrues të nivelit. Në UKZ zbatohet Korniza për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (QF-EHEA) e cila përdorë rezultatet e të nxënit për të përshkruar kualifikimet (p.sh. Bachelor, Master, Doktoratë) dhe janë në pajtueshmëri me KKK për sa i përket Arsimit të Lartë (ciklet QF-EHEA 1, 2 dhe 3 korrespondojnë me nivelet Ba, Ma dhe Dr) dhe mbulojnë kualifikimet në nivelet ISCED 6, 7, 8. Në QF-EHEA, tre cikle kryesore, si dhe një cikël i shkurtër, identifikohen dhe përshkruhen aplikimet e njohurive dhe të nxënurit, aftësive të komunikimit dhe të nxënit për të mësuar. Cikli i shkurtër, i parë dhe i dytë karakterizohen gjithashtu nga vargjet e kredive:

- Kualifikimet e ciklit të parë zakonisht përfshijnë 180 ose 240 ECTS kredi.
- Kualifikimet e ciklit të dytë zakonisht përfshijnë 90 ose 120 kredi ECTS, me minimumin prej 60 ECTS kredi në nivelin e ciklit të dytë.
- Përdorimi i ECTS në ciklin e tretë ndryshon.

Tetë nivelet mbulojnë tërë hapësirën e kualifikimeve nga ato që janë arritur në përfundim të arsimit të detyrueshëm deri tek ato që janë fituar në nivelet më të larta të edukimit profesional apo akademik si dhe trajnimit.

Në matjen e performancës së mësimdhënësve dhe procesit mësimor, indikatorët kryesor janë: vlerësimi i studentëve, rezultatet e arritura të studentëve, monitorimi i rregullt i procesit mësimor, vlerësimi nga tregu i punës së studentëve, etj.

Procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies konsiderohet si shtylla kurrizore e aktivitetit akademik të një Universiteti. Ka të bëjë me të mësuarit e studentëve për pjesën teorike dhe

praktike të disiplinave të ndryshme me qëllim të përgatitjes së tyre për tregun e punës dhe kontributin e tyre për kulturën lokale. UKZ ka ofruar gjithnjë programe akademike të një standardi ndërkombëtarë sa i përket përmbajtjes dhe metodologjisë së përdorur. Metodologjitë e mësimdhënies janë në përputhshmëri me zhvillimet e fundit në metodat e mësimdhënies dhe shfrytëzimin e teknologjisë.

Procesi mësimor si dhe vlerësimi i të arriturave të studentëve bëhet konform rregulloreve të programeve studimore. Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave, bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë (bachelor, master dhe doktoratë), Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbatohen të gjitha rekomandimet e [Deklaratës së Bolonjës](#).

Përcaktues i rëndësishëm i punës në UKZ është PSt 2017-2022, si dhe Planet e veprimit për secilin fakultet të UKZ.

6.3. Institucioni monitoron treguesit e cilësisë, identifikon dhe heton dallimet në cilësi midis programeve dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të siguruar që të gjitha programet përmbushin standardet e kërkuara të performancës

Përputhshmëria e UKZ-së

Ne konsiderojmë se TP prezantojnë mënyrën se si funksionon mësimdhënia dhe mësimnxënia në programet studimore. TP mbështesin vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe ndihmojnë në vendimmarrjen, drejtimin strategjik dhe hartimin e politikave për procesin mësimor në Universitet.

Në nivel të njësisë akademike, dekani, prodekani dhe koordinatori i cilësisë monitorojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënien duke u bazuar në TP (shih Udhëzuesin për ECTS, dhe [Udhëzuesi për treguesit e performancës](#)).

Më poshtë do t'i elaborojmë TP veç e veç që lidhen me mësimdhënien dhe mësim nxënien.

- Raporti i aplikuesve me numrin e studentëve që pranohen për çdo program të studimit. Ky tregues i performancës na tregon raportin ndërmjet aplikuesve për çdo program studimi me numrin e studentëve që pranohen.
- Performanca akademike e studentëve. Ky tregues i performancës e mat performancën e studentëve përmes notës mesatare të akumuluar dhe bazuar në specifikat sipas programeve të studimit.
- Braktisja e studimeve. Ky tregues paraqet përqindjen e numrit të studentëve të cilët i braktisin studimet në Universitet (për arsye akademike apo jo-akademike) para kompletimit të programit të studimeve me numrin total të studentëve të regjistruar për semestër.
- Transferimi i studentëve nga/në UKZ. Sipas statutit të UKZ. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit, duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit, me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
- Diplomimi i studentëve. Ky tregues performancë është një matës i vlerësimit të raportit të studentëve që kanë diplomuar në vit krahasuar me totalin e numrit të studentëve që është pritur të diplomojnë nëse secili do të kishte përfunduar studimet me kohë. Treguesi i diplomimit prej 1.0 nënkupton që të gjithë studentët kanë diplomuar me kohë atë vit.
- Pas diplomimit. Përmes këtij treguesi të performancës masim numrin e studentëve që kanë kryer studimet bachelor tek ne, të cilët janë punësuar, kanë vazhduar studimet

master, nuk janë punësuar dhe nuk i kanë vazhduar studimet.

- Mësimdhënia. Ngarkesa mësimore e një profesori është numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor. Numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor në nivel universiteti. Numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor në nivel të fakulteteve.
- Raporti teori-praktikë. Përmes këtij treguesi të performancës në e paraqesim lidhshmërinë dhe raportin në mes të teorisë dhe praktikës të lëndëve mësimore sipas fakulteteve
- Numri i programeve të reja në tre vitet e fundit. Ky tregues performance e tregon numrin e programeve të reja në kuadër të Universitetit tonë për tri vitet e fundit

Për këtë qëllim programet studimore në kurrikulën e tyre përfshijnë lëndë obligative dhe lëndë zgjedhore (të gjitha programet studimore), module dhe praktikë profesionale (FJu), specializime (FShK), seminare (FShA), mësim praktik (FEEd) dhe projekte (FSHK).

UKZ ka një numër të konsiderueshëm të të interuarve për regjistrim. Numri i aplikuesve është më shumë se dyherë sa numri i të pranuarve, sidomos në programet e Edukimit, shkencave kompjuterike, matematikë, e-qeverisje.

Gjat tri viteve të fundit, është ngritë niveli i studimeve edhe në Master, dhe është themeluar një fakultet i ri- FShA.

Po ashtu identifikohen dhe hetohen nevojat për ngritjen e cilësisë së programit studimor. KF i inicon veprimet e nevojshme për sigurimin e përbushjes së standardeve të kërkuara të performancës, duke propozuar masat konkrete në Komsionin e studimeve të UKZ. Komsioni i Studimeve formulon propozimin konkret i cili i propozohet Senatit për miratim. Me qëllim që të gjitha programet studimore të përbushin standardet e kërkuara, Senati merr vendim për të gjitha ndryshimet e programit studimor në rastin e procesit të Riakreditimit, i cili i propozohet AKA.

6.4. Secili program studimi bazohet në korrelacion midis rezultateve të mësuarit. Një program studimi paraqitet në formën e një serie dokumentesh të cilat përfshijnë: objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit; kurrikula, me peshën e subjekteve të shprehura në kreditë dhe disiplinat ECTS të shpërndara

Përputhshmëria e UKZ-së

Gjatë hartimit të programeve studimore, marrim në konsideratë programet e ngjashme të universiteteve evropiane, sepse konsiderojmë se kontribut të madh në arsimin universitar janë duke dhënë hulumtuesit nga vendet e Evropës. Prandaj edhe programet tona të studimit, synojnë të arrijnë dhe të përcjellin rrjedhat dhe rezultatet bashkëkohore shkencore në nivel evropian.

Rezultatet e të nxëniet të programit bazohen në profilin e programit dhe përshkruajnë atë që një student e di, kupton dhe është në gjendje të bëjë pas përfundimit të programit.

Formulimi i rezultateve të të nxëniet të programit:

Duhet pasur kujdes të konsiderueshëm në formulimin e rezultateve të të nxëniet. Lista e mëposhtme ofron një grup udhëzimesh i cili ka dëshmuar të jetë i dobishëm. Rezultatet e të nxëniet (të nxëniet) duhet të pasqyrojnë në mënyrë të duhur kontekstin, nivelin, qëllimin dhe përmbajtjen e programit:

- Deklaratat e rezultateve të të nxëniet duhet të jenë të përmbledhura dhe jo shumë të hollësishme.
- Rezultatet e të nxëniet duhet të jenë në përputhje reciproke.

- Rezultatet e të nxënit duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të verifikueshme për sa i përket asaj që studenti ka arritur në të vërtetë në fund të programit.
- Rezultatet e të nxënit duhet të jenë të arritshme brenda ngarkesës së specifikuar të punës.
- Rezultatet e të nxënit duhet të lidhen me aktivitete të përshtatshme mësimore, metodat e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit.
- Nuk ka rregulla për numrin ideal të rezultateve të të nxënit në nivelin e programit. Përvoja jonë është midis 10 dhe 12 rezultate janë të mjaftueshme.
- Një mënyrë e pranuar gjerësisht për të formuluar rezultatet e të nxënit bazohet në tre elemente thelbësore.
- Përdorimi i një folje aktive për të shprehur atë që studentët pritet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë (p.sh. të diplomuarit mund të "përshkruajnë", "zbatojnë", "nxjerrin përfundime", "vlerësojnë", "planifikojnë").
- Specifikoni se çfarë i referohet këtij përfundimi (objekti ose aftësia p.sh. mund të shpjegojë "funksionin e përbërësve të harduerit" ose mund të paraqesë "hartimin e një dhome të ndejës me dorë").
- Specifikoni mënyrën e demonstrimit të arritjeve të rezultateve të të nxënit (p.sh. 'për të dhënë një përmbledhje të materialeve që përdoren më shpesh në kompjuterikë'; 'për të zhvilluar një model hulumtimi duke aplikuar metoda shkencore të azhurnuara', etj.).

Kjo arrihet me anë të realizimit të procesit mësimor nga lëndët obligative (të përgjithshme dhe profesionale), lëndët zgjedhore, seminarët/punimet hulumtuese, moduleve, specializimeve nga fushat e programeve studimore. Studimet bachelor organizohen në 6 semestra përkatësisht në 8 semestra (Edukim dhe Juridik). Një semestër përbëhet nga 15 javë, me ngarkesë për studentin prej 60 ECTS/semestër, pra, sistemi i kredive (ECTS) zbatohet në të gjitha programet e studimit. Për secilin kurs (lëndë mësimore) hartohet syllabusi i cili përshkruan në hollësi të dhënat për emërtimin, programin, kreditë ECTS, mësimdhënësin, qëllimet, rezultatet e pritura të nxënies, ngarkesa e studentit, metodologjia e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, literatura, plani i dizajnuar i mësimit sipas javëve, politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes (shih aneksin [1](#) dhe [2](#), [3](#), [4](#) dhe [5](#).

Diplomimi i studentëve është provimi i fundit i cili sipas kurrikulës së programit studimor përcaktohet me syllabusin e punimit të diplomës. Një nga pikat e rëndësishme është llogaritja e ECTS për secilin kurs në veçanti dhe për semestrin, përkatësisht për programin e studimit e cila bazohet në [Udhëzuesin e përdorimit të ECTS-ve](#).

6.5. Rezultatet e të mësuarit të studentëve të secilit program janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe me Kornizën për Kualifikimet e Evropiane të Arsimit të Lartë *Përputhshmëria e UKZ-së*

Profili i programit është i ndarë në komponentë arsimore të cilat mund të përbëhen nga module të vetme ose disa, lloje të tjera të njësisë së lëndës, vendosje pune dhe klinike, projekte kërkimore, punë laboratorike dhe aktivitete të tjera mësimore përkatëse. Mund të përfshijnë edhe aktivitete sociale dhe ato të komunitetit (për shembull, projekte, seminare) me kusht që ato të përshtaten me rezultatet e të nxënit të programit dhe të bartin kredi.

Rezultatet e të nxënit, me strategjitë e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit, duhet të përcaktohen për secilin komponent arsimor.

Rezultatet e të nxënit të programit dhe të përbërësve të tij edukativ shpesh janë të hartuara për të demonstruar përforsimin e tyre të ndërsjellë. Kjo do të arrihet së pari me respektimin e kornizës formale të përcaktuar nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Statuti i UKZ-së dhe aktet e tjera normative, si Rregullorja për procedurat e sigurimit të cilësisë në UKZ.

Pasi të jenë identifikuar pjesët përbërëse të programit, struktura e përgjithshme duhet të përshkruhet dhe kreditë të ndahen për secilën komponentë, në bazë të rezultateve të të nxënit dhe ngarkesës së tij të punës, duke marrë parasysh që 60 kredi korrespondojnë me një vit me kohë të plotë-ekuivalent akademik.

Vendosja e e lëndëve zgjedhore në kurrikulë do të lehtësojë lëvizshmërinë e studentëve në programe tjera. Kurset e programit studimor mund të përshkruhen si në përmbajtje dhe kohë në hartimin e programit ose mund të lejojnë fleksibilitet në kohën dhe përmbajtjen për studentin individual. Lëndët (kurset) obligative dhe/ose zgjedhore nuk preferohet të përdoren për të përsëritur atë që do të studiohej në shtëpi, por për t'i lejuar studentët të përfitojnë nga përvoja të larmishme arsimore në ambiente të tjera.

Kërkesat e progresit të studentëve në UKZ janë të qarta nëse studentët dëshirojnë të lëvizin nëpër program me sukses dhe të marrin kualifikimin e synuar. Kërkesat e përparimit përfshijnë ndër të tjera parakushte, bashkë-kërkesa dhe rekomandime. Rregullat e përparimit shprehen në lidhje me numrin e kredive ose niveleve të kredive të kërkuara në faza të ndryshme brenda një programi studimi (p.sh. një numër minimal i kredive që kërkohen të kalojnë nga një vit akademik / semestër në tjetrin). Ato gjithashtu formulohen në terma të rregullave të hollësishme mbi cilat komponentë duhet dhe/ose mund të merren në cilën fazë dhe në çfarë niveli (p.sh. kurse të detyrueshme (obligative), kurse opsionale (zgjedhore)).

Shkalla e nxënies dhe të gjithë titujtë që i lëshon UKZ janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe me Kornizën për Kualifikimet e Evropiane të Arsimit të Lartë, si dhe perfshihen në RVV. Asnjë program studimor nuk mund të akreditohet dhe asnjë diplomë e lëshuar nga UKZ nuk mund të pranohet në Ministrinë e Arsimit po nuk që në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës.

6.6. Ekzistojnë procese efektive për të siguruar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e metodave të vlerësimit për arritjen e rezultateve të synuara të mësimnxënies

Përputhshmëria e UKZ-së

Në çdo program mësimor përcaktohen rezultatet e synuara të mësimnxënies dhe metodat e arritjes së atyre rezultateve. Edhe në secilin syllabus për secilën lëndë janë përcaktuar rezultatet e synuara të mësimnxënies dhe metodat e arritjes së tyre si dhe metodat e vlerësimit të tyre. Rezultatet e synuara të mësimnxënies, programet studimore dhe sidomos syllabusët janë të njohur mirë për studentët dhe qëndrojnë të publikuar gjatë gjithë kohës në ueb faqen e Universitetit.

Programet studimore të UKZ-së janë të krahasueshme me të pakten 2 programe të universiteteve evropiane.

Metodat e vlerësimit të arritjes së rezultateve të synuara të mësimnxënies janë të përcaktuara edhe me Statutin e UKZ (neni 101, 102, 103 etj.), në rregulloret e studimeve bachelor dhe në harmoni me Procesin e Bolonjës. Studenti vlerësohet gjatë tërë semestrit dhe ai është në rrjedhë të plotë të këtij vlerësimi, duke u vlerësuar aspekti i punës në grupe, nxitje e mendimi kritik, etj.

Statuti i UKZ, Rregulloret e studimeve Bachelor dhe Master në UKZ, dhe rregulloret e njësisë akademike përcaktojnë format e vlerësimit të studentëve. Suksesi i studentit në provim përshkruhet nga notat nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) – Shih në hyrje të dokumentit. Provimet janë publike dhe publikohen në web faqen e UKZ të njësisë përkatëse akademike. Nota përfundimtare e provimit nxirret si më poshtë:

Studentët duhet të arrijnë notën minimale 6 për kalueshmëri, që do të thotë se ata duhet të arrijnë

minimum prej 5% të pikëve për lëndët përkatëse.

Tabela 22 Sistemi i notimit i barasvlerësuar me sistemin Bolonjës

<i>Nota në UKZ</i>	<i>Përshkrimi me fjalë</i>	<i>Barasvlershme me Sistemin e Bolonjës</i>
10	Shkëlqyeshëm	A,
9	Shkëlqyeshëm	B
8	Shumë mirë	C
7	Mirë	D
6	Mjaftueshëm	E
5	pamjaftueshëm	F

Studentët konsiderohet se e kanë kaluar provimin me sukses kur vlerësohen me notën 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e kanë kaluar provimin nëse janë vlerësuar me notën 5. Studentët kanë të drejtë të paraqesin një ankesë me shkrim pranë dekanit të njësisë akademike përkundrejt notës së vlerësimit të tyre. Ankesa duhet të paraqitet brenda dy ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve dhe mund të paraqitet për: provim me shkrim; provim me gojë; provim i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Pas marrjes së një ankesë në kohë, dekani i njësisë akademike krijon një komision provimi brenda një biznesi pas marrjes së ankesës dhe emëron tre anëtarë, përveç mësimdhënësit të provimit kundër të cilit është ankuar studenti. Vlerësimi i këtij Komisioni nuk mund të apelohej. Testet nga provimet e vlerësimit të studentëve mbahen për një maksimum prej 30 ditësh.

Gjatë rishikimit të planprogramit, Komiteti i Studimit në bashkëpunim me Zëvendësdekanin për Mësimdhënien rishikojnë format e vlerësimit në secilën lëndë, pajtueshmërinë e tyre me rezultatet e të nxënit dhe hartojnë një raport të cilin e ndajnë sipas nevojës me secilin anëtar të stafit. Ky proces do të plotësohet me zhvillimin e një manuali për harmonizimin e metodave të vlerësimit me rezultatet e të nxënit (aktivitetet në planin strategjik).

6.7. Personeli mësimor është i kualifikuar dhe ka përvojë të përshtatshme për përgjegjësitë e veçanta të mësimdhënies, ata përdorin strategji mësimore të përshtatshme për lloje të ndryshme të rezultateve të mësuarit dhe marrin pjesë në aktivitete për të përmirësuar efektivitetin e tyre të mësimdhënies

Përputhshmëria e UKZ-së

Bazuar në Statutin e Universitetit, procedura për përzgjedhjen e personelit dhe për emërimet e mësimdhënësve është si vijon: Pas identifikimit të nevojës për mësimdhënës nga NJA të universitetit, me miratimin e Senatit, Rektori shpall konkurs të hapur në mjetet e informimit publik, ku përshkruhet vendi i punës dhe kushtet e nevojshme që duhet të plotësojë kandidati i cili konkurron.

Në njësinë akademike, për secilin vend të punës, formohen *komisionet recensuese* (prej 3 anëtarëve-anëtarët e komisionit duhet të kenë thirrje akademike relevante), të cilat shqyrtojnë dokumentacionet e kandidatëve, dhe ua propozojnë njësisë akademike. Propozimet e Komisionit recensues shqyrtohen në KF dhe nga aty dërgohen në *Komisionin për studime* të Senatit. Komisioni për studime shqyrton aspektin akademik, rezultatet shkencore të kandidatit, si dhe aspektet e tjera, të cilat sigurojnë cilësi në punën akademike të universitetit. Pas kalimit në Komisionin për studime, procedura e përzgjedhjes bëhet nga *Senati i Universitetit* për periudhë 4-vjeçare për profesorë, profesorë të asocuar dhe profesorë asistentë. Për emërimin e ligjëruesve dhe asistentëve mësimorë, emërimi bëhet për periudhë 3-vjeçare. [Shih Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik](#)

Preokupim i vazhdueshëm i mësimdhënsve të UKZ-së është përmirësimi dhe efektiviteti në mësimdhënie. UKZ përcakton objektivat e mësimnxënies dhe mësimdhënies në lidhje me programet e tyre të studimit të cilat i nështrohen vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm (AKA). Parimet e përgjithshme të mësimnxënies, mësimdhënies dhe vlerësimit në UKZ janë:

- Parimi i përgjithshëm. Në lidhje me të nxënit, mësimdhënien dhe vlerësimin duhet të merren parasysh kur dorëzohet një program studimi, pavarësisht nga mënyra e të nxënit dhe mësimdhënies.
- Dialog i hapur dhe pjesëmarrje. Qasja me studentin në qendër kërkon një dialog të hapur dhe reagime reflektuese midis studentëve, profesorëve dhe administratorëve përkatës, përmes të cilëve mund të shprehen dhe diskutohen nevojat dhe aspiratat e tyre. Të gjithë palët e interesuara duhet të përfshihen në diskutimin konstruktiv të hartimit dhe shpërndarjes së programit.
- Transparenca dhe besueshmëria. Syllabusi I lëndës duhet të ofrojë informacion të besueshëm, të azhurnuar dhe cilësor për programet sipas niveleve, si dhe për komponentët arsimor në veçanti. Ai duhet të sigurojë një përshkrim të saktë të lëndës/programit sipas nivelit, duke përfshirë të gjitha detajet: strukturën, komponentët, rezultatet e të nxënit, ngarkesën e punës, qasjet e të nxënit / mësimdhënies, metodat e vlerësimit, kriteret e vlerësimit dhe rregullat e përparimit.
- Konsistenca. Stafi akademik përgjegjës për shpërndarjen e programit dhe përbërësit e tij duhet të sigurojë konsistencë midis rezultateve të të nxënit të përcaktuara në program, aktiviteteve të mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe procedurave të vlerësimit. Vlerësimi konstruktiv ndërmjet rezultateve të të nxënit, aktiviteteve mësimore dhe vlerësimit është një kërkesë thelbësore për programet arsimore.
- Fleksibiliteti. Një strukturë fleksibile programi është thelbësore për të lejuar zgjedhjen e studentëve dhe plotësimin e nevojave të ndryshme, p.sh. duhet ti jepet mundësi për zhvillimin e rrugëve të të nxënit personal dhe duhet të ofrohen aktivitete opsionale. Një organizim fleksibël i aktiviteteve të mësimin, mësimdhënies dhe vlerësimit, përfshirë fleksibilitetin në orar dhe më shumë mundësi për të mësuar të pavarur janë thelbësore për të akomoduar stile të ndryshme të të nxënit. Integrimi i teknologjive dixhitale (e-learning, T-Edu, etj) në arsimin e lartë kanë një ndikim të rëndësishëm në qasjet e të nxënit dhe mësimdhënies. Ndarja e kredive për rezultatet e të nxënit të cilat arrihen përmes mënyrave të reja të shpërndarjes të mundësuar nga teknologjia, bazohen në të njëjtat parime si ndarja e kredive për rezultatet e të nxënit për komponentët tradicionale arsimore.
- Vlerësimi i duhur i arritjeve. Kreditë jepen kur vlerësimi i duhur tregon se rezultatet e përcaktuara të mësimin janë arritur në nivelin përkatës. Nëse studenti nuk ka arritur rezultatet e të nxënit, nuk do të shpërblehet me kredi. Metodatat e vlerësimit përfshijnë tërë gamën e testeve/provimeve me shkrim, me gojë dhe praktikë, projekteve dhe portofolios që përdoret për të vlerësuar përparimin e studentit dhe për të konstatuar arritjet e rezultatet e të nxënit të një njësie ose moduli të lëndës, ndërsa kriteret e vlerësimit janë përshkrime të asaj që pritët të bëjë studenti, në mënyrë që të demonstrojnë se është arritur një rezultat mësimor

Që të realizohen këto parime me sukses në punë e UKZ, stafi akademik i UKZ trajnohet për vazhdimisht në procesin e mësimdhënies. Disa nga anëtarët e stafit akademik janë trajnuar në institucione ndërkombëtare, si për shembull trajnimi në kuadër të projektit REBUS, nga programi [Erasmus+, në Universitetin ESSEN të Gjermanisë](#). Edhe projektet tjera ofrojnë programme trajnimi për mësimdhënësit në tema të caktuara. UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi për trajnimin e stafit akademik edhe me [Qendrën e Përsosmërisë të Universitetit të Prishtinës](#).

Deri në fund të vitit 2022 PSt i UKZ parasheh formimin e Qendrës për Trajnimin e Mësimdhënsve.

6.8. Metodatat e mësimin dhe mjediset janë të përqendruara në studentët dhe nxisin motivimin, reflektimin dhe angazhimin e studentëve në procesin e të mësuarit

Përputhshmëria e UKZ-së

Bazuar në [Udhëzuesin për përdorimin e ECTS-ve](#), mësimi me studentët në qendër është një proces i transformimit cilësor të njohurive dhe shkathtësive për studentët dhe individë të tjerë në një mjedis të nxënies-studjuar, që synon përmirësimin, autonominë e tyre dhe zhvillimin e aftësive kritike përmes një qasje të bazuar në rezultate.

Koncepti *studenti në qendër*, mund të përmbledhet në elementët:

- mbështetja në mësimin aktiv dhe jo në mësimit pasiv;
- nxitja e mendimit kritik dhe analitik;
- rritje e përgjegjësisë nga ana e studentëve;
- rritja e autonomisë së studentëve.

Për këtë qëllim, Syllabuset për secilën lëndë dhe për secilin program studimi, publikohen në uebfaqe dhe u shpërndahen studentëve në fillim të semestrit.

Vlerësimi i studentëve bëhet gjat gjithë semestrit. Studenti motivohet për të qenë aktiv dhe ky motivim rezulton në mësim cilësor, kritik dhe analitik. Në syllabuset e lëndëve potencohet përdorimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, si: interaktiviteti, nxitja e mendimit kritik, ofrimi i kushteve për të mësuar në bibliotekë, përdorimi i TI, puna në grupe, puna në projekte, klubet e studenteve, puna kreative etj.

Ligjëratat dhe ushtrimet e studentëve janë të orientuara në punën në grupe: studentët punojnë të pavarur në grupe, diskutojnë dhe nxjerrin përfundime të përbashkëta. Studentët punojnë në grupe edhe në detyra shtëpie, në seminare, në prezantime, në projekte si edhe në tema të diplomës.

Edhe gjatë procesit të provimeve studenti është në qendër: para provimit stafi akademik i ndihmon dhe udhëzon studentët të përgatiten për provim; pas provimit studentët konsultohen me profesorin rreth rezultatit të provimit; studenti ka të drejtën e ankësës në rezultatet e provimit.

Në tërë këtë proces, përdorimi i [Moodle, e-learning](#) bënë të mundur dhe të jetë më efikas realizimi i mësimdhënies me studentin në qendër.

6.9. Cilësia e mësimdhënies dhe efektiviteti i programeve vlerësohet nëpërmjet vlerësimeve të studentëve dhe të diplomuarve dhe të punëdhënësve me prova nga këto burime të përdorura si bazë për planet për përmirësim

Përputhshmëria e UKZ-së

Për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e programeve studimore përdoren instrumentet e mëposhtëm nga Paketa e Instrumenteve të Matjes së Cilësisë përdoren:

- vlerësimi i mësimdhënësve nga studentët;
- vlerësimi i programeve nga studentët;
- Vlerësimi i programeve studimore nga alumni;
- Vlerësimi nga punëdhënësit;
- vlerësimi i aftësive dhe të studentëve të diplomuar nga tregu i punës, [vlerësimi i shërbimeve dhe administratës nga studentët](#).

Të dhënat nga këto vlerësime përpunohen dhe analizohen nga ZZHAC, e cila përgatit raport e detajuar për secilën njësi akademike dhe u dorëzohet dekanëve të secilit fakultet. Dekanët e njësive akademike, analizojnë, shqyrtojnë dhe propozojnë masat e nevojshme për aspektet të cilat janë evidentuar mangësi.

Raporti shërben si një informacion shumë i rëndësishëm për përmirësimin e programeve aktuale. Një raport për të gjitha programet i dorëzohet Rektorit. Bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet, ndryshimet dhe përmirësimet konkrete propozohen dhe planifikohen fillimisht nga Komisioni i Studimeve të Senatit të UKZ, i cili pas shqyrtimit, i paraqiten Senatit për aprovim. Rezultatet e vlerësimeve të biznesit ose punëdhënësit të ish studentëve tanë, tani punonjës të tyre, gjithashtu paraqiten në ZZHAC, njësitë akademike dhe te Rektori. Prezentimi i vlerësimit të fundit në UKZ u organizua nga shoqata [Alumni e studnetëve të ekonomikut](#). [Raporti](#) i plotë i redaktuar nga ZZHAC për të gjitha vlerësimet dhe rekomandimet publikohet në web faqen e Universitetit.

Në anën tjetër, mësimi praktik, projektet hulumtuese, dhe punimet e diplomave të cilat trajtojnë probleme të caktuara nga tregu i punës, shërbejnë si tregues të rëndësishëm gjat procesit të hartimit të programeve të reja dhe/ose gjat rishikimeve të programeve studimore. Kjo arrihet nëpërmjet studimit të fizibilitetit të propozimeve për programe studimore dhe përfshirjes të së paku një anëtari nga Alumni dhe Bizneset në komisionet për hartimin e programeve studimore.

Analiza SWOT për Standardin 6:

Tabela 23 Analiza SWOT për Standardin 6

Pikat e forta	Dobësitë
- Personeli akademik ka kualifikime në fushën përkatëse studimore - Mësimdhënia bashkëkohore - Respektimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit akademik për mbarëvajtjen e procesit mësimor - Motivi, klima e bashkëpunimit, etika, vullneti, - Cilësia dhe përvoja e stafit akademik. - Përkrahja e plotë e menaxhmentit të UKZ në implementimin e mësimdhënies studentit në qendër dhe sigurimin e kushteve të punës. - Bashkëpunimi me kolegët dhe përvoja e stafit akademik në fushën e mësimdhënies universitare në vendet e tjera të Evropës (Barcelonë, Tiranë, Vjenë, Sofje, etj.) dhe bashkëpunimi me kolegët - Rezultatet e studentëve të UKZ në studimet pasuniversitare në universitetet tjera në vend dhe në botë (UP, Ljubljana, Shkup, Split, Boston- SHBA; Gjermani etj.). - Mësimi në distancë, e-learning (moodle) cilat janë sfidat e universitetit e kalimit të mesimit nga mesimi normal në online, a ka pas sfida....	- Infrastruktura pjesërisht e mjaftueshme hapësinore për stafin e angazhuar akademik (të jashtëm). - Procedurat e vështira administrative në zhvillimin e aktiviteteve të shkëmbimit të personelit akademik ndërkombëtar, furnizimit me literaturë, revista shkencore dhe të ngjashme. - Numër i vogël i stafit të trajnuar për metodologji të mësimdhënies
Mundësitë	Rreziqet
- Intensifikimi i hulumtimeve shkencore dhe inkorporimi i tyre në rrjedhat e hulumtimeve globale. - Ofrimi i mundësive për hulumtime të reja nga fusha përkatëse të studimit në UKZ. - Rritja e bashkëpunimit të UKZ me universitetet e tjera vendore, dhe ndërkombëtare.	- Themelimi i qendrës për trajnimin e mësimdhënësve në UKZ. - Të qenët në rrjedhë të teknologjisë bashkëkohore të TI në procesin mësimor.

- Rritja e interesimit të studentëve për studime, si një nga elementet e rëndësishme të zhvillimit tekniko-teknologjik të shoqërisë bashkëkohore. - Trajnimi i stafit akademik për metodologji të mësimdhënies - Mbështetja e stafit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe publikime shkencore	- Krijimi i programeve të mësimin në distancë (online).
---	---

Standard 7. Hulumtimi

7.1. Është përgatitur një plan zhvillimor kërkimor që është në përputhje me natyrën dhe misionin e institucionit dhe nevojat e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të rajonit dhe është bërë publik

Përputhshmëria e UKZ-së

Universiteti ka Plan Strategjik 2017-2022, të cilën e ka rishikuar në vitin 2020 dhe e cila përmban një kapitull të veçantë për Objektivat Strategjike. Në kuadër të këtyre objektivave hynë edhe Objektiva numër 6, e cila përfshinë përmirësimin dhe promovimin / përkrahjen e punës kërkimore shkencore në UKZ. Kjo strategji dhe objektivat e saj përfshijnë elemente si në vijim, e të cilat direkt do të ndikojnë në rritjen e hulumtimit shkencor në UKZ.

Nënobjektiva e parë thekson se UKZ duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë punës kërkimore dhe shkencore dhe sidomos të orientuar në të mirë të komunitetit. UKZ mbështetë botimin e veprave shkencore dhe të teksteve universitare, publikimin në revistat shkencore dhe nxitë punën kërkimore-shkencore të stafit akademik, duke ofruar mbështetje, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar. Në këtë aspekt është miratuar edhe Rregullorja për veprimtarinë kërkimore – shkencore, ku me anë të kësaj Rregullore për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të UKZ-së, do të përkrahet stafi akademik në hulumtime shkencore dhe publikime shkencore. Kjo Strategji ka paraparë edhe krijimin e një Komisioni Qëndror që do të mbikqyrë punën kërkimore shkencore. Komisioni Qëndror planifikon, do të mbikqyrë, dhe do të përkrahë punën kërkimore shkencore në UKZ. UKZ me anë të kësaj Strategjie gjithashtu ka paraparë dhe janë caktuar tashmë edhe koordinatorët nëpër fakultete për punën kërkimore shkencore. Koordinatorët do të mbështesin stafin akademik në punën e tyre kërkimore shkencore, duke udhëzuar stafin akademik për punë kërkimore shkencore. Strategjia ka paraparë që UKZ duhet të bëjë mbështetje, financim dhe shpërblim për punën kërkimore shkencore dhe me këtë qëllim UKZ mbështetë stafin akademik financiarisht për punën e tyre kërkimore shkencore, e në cilin rast ka paraparë shpërblim me një pagë për profesorin me më së shumti punime në UKZ dhe shpërblimi për shkencëtarin e vitit në UKZ. Në këtë aspekt, UKZ ka paraparë në kuadër të kësaj Strategjie edhe organizimin e konferencave shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Organizimi i tryezave dhe konferencave shkencore do të jetë prioritet i UKZ-së në mënyrë që temat me interes të debatohen dhe analizohen në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët e tjerë që kanë ndikim direkt dhe indirekt në tematikat e ngritura. Poashtu UKZ ka paraprë edhe krijimin e revistave të UKZ. UKZ, rëndësi të veçantë do t'i kushtojë paraqitjes së stafit akademik në revistat shkencore ndërkombëtare që të jenë në trend me zhvillimet dhe tematikat aktuale kudo në botë. Do të bëhen përpjekjet e duhura që të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për të mbështetur këtë objektiv dhe do të kërkohet përkrahje nga MASHT, universitetet me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi, si dhe me institucionet e tjera që përkrahin zhvillimin e shkencës. Në këtë aspekt, puna edhe me projektet ndërkombëtare, siç është projekti Erasmus+ ResearcCult do mundësojë krijimin e 6 revistave ndërkombëtare, ku UKZ do jetë hisedarë e tyre. Me anë të kësaj Strategjie është paraparë edhe themelimi i KB, i cili do të mbështesë botimin e teksteve universitare, monografive dhe botimeve të tjera.

Senati i UKZ-së ka miratuar Strategjinë për Hulumtime Shkencore. Strategjia përkufizon se çfarë nënkuptohet me veprimtari kërkimore shkencore në UKZ. Strategjia ka listuar objektivat në hulumtimin shkencor. Ajo parasheh formimin e Qendrës hulumtuese që do të koordinojë aktivitetin hulumtues kërkimor. Ky dokument parasheh themelimin e revistave shkencore, publikimin e teksteve universitare, organizimin e konferencave shkencore, publikimet në revista ndërkombëtare, etj.. Strategjia parasheh se secili staf akademik të publikojë së paku një publikim shkencor brenda një viti.

UKZ përkrah projektet hulumtuese për të cilat ka kërkesa nga NJA. Për këtë arsye është miratuar edhe [Rregullorja për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore](#) e UKZ-së, e cila përkrah stafin akademik në hulumtime shkencore. Me anë të kësaj rregullore bëhet e mundur rritja e pjesëmarrjes së stafit në punë kërkimore shkencore, duke i stimuluar edhe në aspektin financiar, por gjithashtu duke e bërë të detyrueshme edhe pjesëmarrjen dhe një minimum të publikimeve në baza vjetore.

Në këtë drejtim, UKZ përkrah projektet hulumtuese për të cilat ka kërkesa nga NJA dhe nga individët. KD i UKZ ka miratuar Rregulloren për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të UKZ-së, e cila përkrah stafin akademik në hulumtime shkencore, sidomos në aspektin financiar. Në rregullore përcaktohen vlerat e pagesave financiare për çdo publikim në revistat e rëndësishme ndërkombëtare me impakt faktor.

Po ashtu rregullorja e nxitë punën kërkimore e shkencore edhe me shpalljen e “hulumtues i vitit” të personit i cili ka realizuar arritjet më të mira hulumtuese e shkencore brenda vitit.

Fakultetet e UKZ bashkëpunojnë me institucionet dhe bizneset rajonale dhe ofrojnë shërbime për nevojat e tyre. Këto shërbime profesionale deri tash janë bërë sipas marrëveshjeve dy-palëshe: Fakultet-Institucion apo biznes lokal. Kështu, për shembull, FEk ka ofruar ekspertizë financiare për Gjykatën Themelore në Gjilan për disa lëndë gjyqësore. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka krijuar softuerë për nevojat e shkollave të mesme e të atyreve fillore si dhe për Kompaninë e Transportit të Gjilanit. FEd ndihmon rregullisht shkollat fillore në plotsimin e zbrazëtive të papritura që krijohen gjatë procesit apo edhe me organizimin e tryezave debatush për çështje të ndryshme. Këtu vlen të përmendet një projekt i UKZ “Klasa 1-5: një apo më shyumë mësues?” të cilin FEd është duke e zhvilluar prej 2015, e në të cilin janë kërshirë disa komuna, disa shkolla fillore, është duke u testuar pilot projekti dhe pritet që efekti i këtij projekti të jetë i madh dhe vendimtar për organizimin e procesit mësimor në klasët 1-5 në tërë territorin e Kosovës.

Edhe në planin kulturor ka një impakt të rëndësishëm të punës kërkimore-shkencore të UKZ në komunitet. Anëtarë të stafit akademik të UKZ, fakultetet e UKZ ose vetë UKZ organizon apo merr pjesë në konferenca shkencore, tryeza diskutimi, simpoziume kulturore (psh. Takimet e Dom Nikollë Tarabulluzit), orë letrare, promovime kulturore, aktivitete teatrore dhe sportive, e të gjitha këto në bashkëpunim dhe bashkëpjesëmarrje edhe të komunitetit.

Edhe Plani Strategjik i UKZ i kushton rëndësi orientimit të mësimit akademik dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore në të mirë të komunitetit. Kjo është një fushë që në të ardhmen do të investohet më shumë në UKZ: do të bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë e UKZ me platformat për zhvillimin ekonomik të Kosovës, si me Agjencinë Statistikore të Kosovës, për të lehtësuar orientimin e aktivitetit kërkimor-shkencor në të mirë të ekonomisë vendore.

Secila njësi akademike për çdo vit organizon dhe merr pjesë në konferenca shkencore me karakter rajonal dhe ndërkombëtar për prezantimin e rezultateve të projekteve hulumtuese. Përpos kësaj, NJA të UKZ në kuadër të bashkëpunimeve me universitete nga rajoni dhe Evropa janë duke rritur numrin e aktiviteteve mësimore dhe hulumtuese. Në kuadër të programeve të

Universitetit dhe në kuadër të mësimit praktik, klinik, praktikës pedagogjike, dhe në bashkëpunim me GIZ janë bërë edhe disa hulumtime profesionale që [aftësojnë studentët se si duhet të bëhet një hulumtim](#), si duhet të udhëhiqet dhe si duhet të prezantohet.

7.2. Plani i zhvillimit të hulumtimit përfshin indikatorë dhe parametra të përcaktuar qartë për objektivat e performancës

Përputhshmëria e UKZ-së

TP së hulumtimit dhe kërkimit shkencor në UKZ janë të përmbledhur në dokumentin Udhëzues për TP, në të cilin janë paraparë qartë parametrat dhe indikatorët e performancës në UKZ.

Poashtu edhe në kuadër të Rregullores për avansime puna kërkimore shkencore merret parasysh, por gjithashtu edhe projektet lokale dhe ndërkombëtare janë një indikatorë i mirë matës për performancën e stafit.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese dhe artistike vlerësohen sipas:

- » numrit të publikimeve në tri vitet e fundit;
- » numrit të citimeve nga autorët e huaj (të dhëna nga bazat e citimeve);
- » numrit të përgjithshëm të projekteve të paraqitura në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- » numrit të përgjithshëm të projekteve të realizuara në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare)
- » pjesëmarrjes në seminare, konferenca, këshilla shkencor (vendore dhe ndërkombëtare) në tri vitet e fundit);
- » numrit të përgjithshëm të mbledhjeve të organizuara shkencore në tri vitet e fundit nga ana e UKZ.

Intenca e Universitetit është të marrë pjesë në mënyrë aktive në hulumtimet ndërkombëtare përmes projekteve të përbashkëta me Universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat bashkëpunojmë. Numri i universiteteve dhe institucioneve me të cilat bashkëpunojmë është në rritje gjithnjë.

Poashtu, Rektori I Universitetit, ka nxjerrë [vendimin për stimulimin financiar të stafit akademik](#) të cilët zhvillojnë dhe aplikojnë për project propozime. Përmes atij vendimi secili pjestarë I stafit që zhvillon project dhe aplikon te donatorët merr një stimulim financiar për punën e bërë, pa llogaritur përfitimet që më pas vijnë si rezultate i menaxhimit të projektit.

Performanca e stafit akademik në zhvillimin e projektpropozimeve dhe implementimin e tyre, është pjesë e vlerësimit të brendshëm të përferomancës së tyre. Projektet kanë rëndësi të vecanët për UKZ-së dhe konsiderohen si njëri nga prioritetet e rëndësishme në dokumentet qeverisëse dhe strategjike.

Si rezultat i angazhimit të stafit akademik dhe administrativ, UKZ-ja ka menaxhuar dhe vazhdon të implementoj disa projekte Erasmus + dhe një numër të konsiderueshëm të projekteve. UKZ është lider në një project Erasmus Plus dhe si partner është një 16 projekte të tjera. Gjithashtu UKZ-ja ka zhvilluar edhe projekte të tjera nga donator të tjerë, si Programi HERAS (WUS Austria), CODE (Banka Botërore), LECU (University of Cyrih), USAID, OSCE etj.

Tabela 24 Lista e projekteve Erasmus+ si dhe buxheti. (UKZ)

Programme or initiative	Beneficiary Organisation	Title of the Project □	Budget awarded
ERASMUS +	University “Kadri Zeka”	"Quality development of international cooperation and project management / QUADIC	991,831.00 Euro

ERASMUS +	Kolegji Heimerer	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center / SMAHPC	73,115.00 Euro
ERASMUS +	European University of Tirana	Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Eastern Balkan Universities (e-VIVA)	66,075.00 Euro
ERASMUS +	University of Montenegro	"Enhancing the Employability of Law Students through Practical Education / ENEMLOS"	90,586.00 Euro
ERASMUS +	International Business College in Mitrovica	"Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo - ResearchCult"	53,440.00 Euro
ERASMUS +	University of Prishtina "Hasan Prishtina"	"Towards a Quality oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo"	95,865.00 Euro
Erasmus Mundus Action 2	Universida de Vigo, Green-TECH Western Balkans, Erasmus Mundus	Green Tech WB: Smart & Green Technologies for Innovative and Sustainable Societies in Western Balkans	
ERASMUS +	Staffordshire University	Entrepreneurial Universities for Industrial Alliance – EUFORIA"	
ERASMUS +	University of Sarajevo	"Ready for business – integrating and validating practical entrepreneurship skills in engineering and ICT studies REBUS"	78,498.00 Euro

Secili nga projektet e lartëcekura në vete përmbanë pjesë të hulumtimit të cilat janë zhvilluar dhe zhvillohen nga stafi i UKZ-së në bashkëpunim me stafin e partnerëve. Projektet kanë impakt në rritjen e cilësisë së hulumtimit përmes transmetimit të praktikave nga vendet e rajonit dhe shteteve të Evropës.

Tabela 25 Lista e stafit të angazhuar në zhvillimin e projekteve ndërkombëtare

Programi	Projekti	Nr. i stafit akademik	Nr. i stafit administrativ	Nr. i studentëve	Total
Erasmus Mundus	Green Tech	7	2	5	12
ERASMUS +	EUFORIA	6	3	50	59
ERASMUS +	ReBus	5	3	34	42
ERASMUS +	e-VIVA	8	6	20	30
ERASMUS +	SMAHPC	9	7	13	29
ERASMUS +	QUADIC	9	8	11	28
ERASMUS +	ENEMLOS	6	2	50	58
ERASMUS +	QATEK	9	3	20	32
ERASMUS +	ResearchCult	10	3	5	18
HERAS	HERAS – Internationalization in Hel	5	2	0	7
HERAS	HERAS – Students (stateless persons)	2	1	5	8
USAID	Fullbright	2	0	0	2

GIZ	GIZ	7	2	20	29
US Embassy	NOU	2	1	10	13

7.3. Institucioni ka miratuar zyrtarisht një buxhet adekuat të kërkimit (duke përfshirë alokimet për pajisjet kërkimore) për të mundësuar arritjen e planit të hulumtimit

Përputhshmëria e UKZ-së

Rritja e aktiviteteve hulumtuese shkencore të stafit akademik është edhe një detyrim kontraktues me institucionin dhe ndërlidhet me proceset e avancimit akademik, e i cili kërkon realizim të botimeve në revista shkencore ndërkombëtare të cilat janë të indeksuara sipas platformave kredibile të përcaktuara si obligative edhe nga udhëzimi administrativ i MASHT-it, projekte kërkimore-shkenore dhe hulumtues, projekte lokale dhe ndërkombëtare, etj.

Stafi akademik i angazhuar në programet e studimit të UKZ obligohet që të angazhohet në punë kërkimore dhe të bëjë publikime në revista të njohura ndërkombëtarisht. Sipas kontratës së punës, secili pjesëtar i stafit akademik obligohet të publikojë të paktën një punim shkencor brenda vitit si dhe të angazhohet në projekte të tjera të bashkëpunimit të cilat kanë për qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies në NJA të këtij Institucioni. Hulumtimi shkencor në UKZ vërtetohet nëpërmjet botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative, produkteve artistike, transferimit teknologjik përmes qendrave të konsulencës, dhe strukturave të tjera për validim.

UKZ ka poashtu Strategjinë për hulumtim shkencor në të cilin janë të përshkruara objektivat strategjike për hulumtim. Poashtu Rregullorja për veprimtarinë kërkimore shkencore i parasheh kushtet për avansim, me të cilën stafi inkurajohet të bëjë punë kërkimore shkencore. Edhe Rregullorja për KB e inkurajon stafin akademik të botojë monografi, të botojë libra, për të cilat atyre ju mbulohen të gjitha shpenzimet por gjithashtu ju jepen edhe stimulohen financiarisht për punën e bërë.

KD i UKZ ka buxhetin vjetor dhe ndane një shume të konsiderueshme, në vlerë prej 10,000.00 € për hulumtim për çdo vit kalendarik, në kuadër të buxhetit vjetor që UKZ-së i ndahet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Gjithashtu UKZ është një prej institucioneve që në krahasim me buxhetin vjetor ka arritur që një përqindje të madhe ta sjellë nëpërmjet projekteve vendore dhe ndërkombëtare, e sidomos Erasmus+. Kjo pjesë e konsiderueshme financiare përdoret për ngritje të kapaciteteve për stafin e UKZ, për zhvillim dhe hulumtim kualitativ sipas standardeve ndërkombëtare.

Tabela 26 Buxheti për hulumtim nga projektet vendore dhe ndërkombëtare

Programi	Shuma për hulumtim
UKZ	10,000.00 €
ERASMUS +	133,440.00 €
HERAS	41,500.00 €
USAID	5,000.00 €
GIZ	10,000.00 €
MASHT	20,000.00 €

Me Rregulloren për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të UKZ janë parashikuar shumat fikse për publikimet në revistat ndërkombëtare me impakt faktor (1000 euro për punimin e publikuar në revistat të indeksuara në platformat Eeb of Science dhe Scopus, 500 euro për platformat e tjera të përcaktuara me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit e të Shkencës.

Rregullorja parasheh një përqindje të financave që merr autori-autorët e secilit projekt hulumtues që konkurron në fondet kombëtare për hulumtim, e cila përqindje nis me 2%-5%:

- Per vleren e projektit ne shumen 29.999 euro, vlere e perqindjes se projektit eshte 5%.
- Per vleren e projektit ne shume 59.999 euro, vlere e perqindjes se projektit eshte 4%.
- Per vleren e projektit ne shume 99.999 euro, vlere e perqindjes se projektit eshte 3%.
- Per vleren e projektit ne shume mbi 100.000 euro, vlere e perqindjes se projektit eshte 2%.

Me të njëjtën rregullore është parashikuar cmimi “hulumtues i vitit” i cili tërheq një shpërblim sa paga mujore e profesor doktorit.

7.4. Ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore për arritjen e objektivave të propozuara të hulumtimit

Përputhshmëria e UKZ-së

KD i UKZ ka buxhetin vjetor dhe ndane nje shume te konsiderueshme, në vlerë prej 10,000.00 € per hulumtim për cdo vit kalendarik, në kuadër të buxhetit vjetor që UKZ-së i ndahet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky buxhet është i pamjaftueshëm për mbulimin e gjithë veprimtarisë hulumtuese, prandaj UKZ përkrah financiarisht vetëm një pjesë të një hulumtimi shkencor (për shembull: pjesëmarrjen, koston e publikimit apo biletat e udhëtimit).

MASH ndan një buxhet për hulumtime shkencore në të cilin stafi akademik i UKZ konkurron dhe ka fituar disa projekte. Te elaborohen projektet....

Instituti për Trajnime dhe Hulumtime Arsimore në UKZ ka fituar projektin me titull “Ndikimi i teksteve shkollore në nxitjen e zhvillimit të mendimit kritik të nxënësve”. Ky projekt hulumtues fokusohet në grumbullimin e të dhënave të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e opinioneve të mësimdhënësve për mundësit që japin tekstet shkollore në zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Poashtu, një burim i financimit të punës kërkimore vjen prej projekteve ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe UKZ. Një prej projekteve hulumtuese ka qenë edhe projekti me studentë i fituar nga HERAS si dhe projekti për ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve.

Më miratimin e Rregullores për përvetësimin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore të UKZ kostoja buxhetore për hulumtime shkencore është rritur: përveç pagesës për publikime në revista ndërkombëtare me impakt faktor dhe shpërblimi financiar “hulumtuesi i vitit”, rregullorja parasheh një përqindje të financave që merr autori-autorët e secilit projekt hulumtues që konkurron në fondet kombëtare për hulumtim.

Te fillohet nese ka prorektor per shkence, te elaborohen detajisht detyrat e tij....

Universiteti nuk ka caktuar Prorektorin për Shkencë, edhe pse me statutin e UKZ-së është paraparë edhe funksioni i prorektorit për hulumtime dhe kërkime shkencore. Detyrat e Prorektorit për hulumtime dhe kërkime shkencore caktohen nga Rektori me rastin e zgjedhjes. Aktualisht përgjegjësisë për Hulumtim dhe kërkime shkencore i kryejnë Prorektori për Mësimdhënie dhe çështje të studentëve dhe Prorektori për bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte.

Universiteti ka krijuar Zyrën për shkencë, zhvillim akademik dhe cilësi në vitin 2018. Sipas Rregullorës për Sistematizim të Vendeve të Punës për stafin administrativ, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për shkencë, zhvillim akademik dhe cilësi janë:

- Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e akreditimit institucional dhe të akreditimit të programeve, përfshirë udhëzimin në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, si raportin e vetëvlerësimit, planin për zbatimin e rekomandimeve, raportin e progresit për zbatimin e rekomandimeve etj.;
- Kryen punë në koordinimin e Zyrës me Senatin e UKZ-së, KD, NJA, institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura;
- Punon duke u këshilluar me menaxhmentin e UKZ-së, përkatësisht me prorektorin për mësim dhe kërkime shkencore, si dhe me akterët e tjerë relevantë për ta përkrahur promovimin dhe zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Procesi i Bolonjës në UKZ;
- Nën udhëheqjen e prorektorit për mësim dhe kërkime shkencore, e përpilon planin e punës së Zyrës dhe e mbikëqyr realizimin e tij.;
- E udhëheq rjetin e koordinatorëve për zhvillim akademik të fakulteteve;
- I përcjell rjetet dhe trendet ndërkombëtare të kërkimeve shkencore dhe kujdeset që të njëjtat t'ua përcjella strukturave gjegjëse të UKZ-së;
- E përfaqëson Zyrën për shkencë, zhvillim akademik dhe cilësi në takime, në komisione dhe në organizime të tjera zyrtare brenda dhe jashtë UKZ.
- Merret me koordinimin dhe organizim e konferencave shkencore;
- Përkrahjen e zhvillimit shkencor dhe hulumtues në UKZ;
- Koordinimin dhe monitorimin e projekteve hulumtuese;
- Administrimin e dokumentacionit të hulumtimeve;
- Mirëmban bashkëpunimin me partnerë relevantë;
- Përkrah stafin në aplikimin për projekte hulumtuese dhe shkencore;

Drejtori i Zyrës për zhvillim akademik dhe cilësi, raporton tek Sekretari i Përgjithshëm në aspektin administrativ ndërsa në aspektin operacional koordinon punët me prorektorin për mësim dhe kërkime shkencore.

Aktualisht UKZ ka vetëm një zyrtarë për hulumtim, i cili është i mbështetur vazhdimisht nga 5 koordinatorë nëpër fakultete. UKZ nga viti 2021 parasheh rritjen e stafit për këtë zyre, sipas Rregullres për sistematizimin e vendeve të punës.

Universiteti ka emëruar [koordinatorët për punë kërkimore shkencore](#) në secilin fakultet, e ata janë:

Puna e tyre është të koordinojnë hulumtimin dhe punën kërkimore shkencore në mes të stafit, studentëve dhe universitetit.

UKZ ka krijuar edhe Komisionin për hulumtime shkencore konform [Rregullores për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore e UKZ-së](#).

Rektori i UKZ, me [Vendimin numër 01/1857](#) të datës 30.09.2019 ka formuar Komisionin për vlerësimin për financim nga UKZ të punimeve të stafit akademik në revista, konferenca shkencore, simpoziume dhe kongrese shkencore ndërkombëtare.

Hulumtimi shkencor në UKZ është orientuar në realizimin e objektivave strategjike dhe të atyre specifike në Planin Strategjik.

Instituti i edukimit është themeluar mbi këtë parim, duke bërë punë kërkimore dhe shkencore së bashku me studentët. Puna e institutit është zhvilluar në atë mënyrë që të arrijë që të bëhet një institucion i rëndësishëm për hulumtim mbrenda UKZ, dhe i cili poashtu në bashkëpunim me GIZ do të fillojë me procese edhe trajnuese edhe për bashkëpunëtorët e jashtëm, sikurse që janë mësuesit nëpër shkolla.

7.5. Hulumtimi vërtetohet nëpërmjet: botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative, produkteve artistike, transferimit teknologjik përmes qendrave të konsulencës, parqeve shkencore dhe strukturave të tjera për validim

Përputhshmëria e UKZ-së

Stafi akademik i UKZ publikon punime shkencore në revista ndërkombëtare me impakt faktor, të indeksuara në platformat e caktuara nga MASH (Shih Statuti i UKZ, neni 156, 157 dhe 158) dhe në revista nacionale e rajonale, merr pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare, nacionale e rajonale, publikon monografi shkencore dhe libra universitarë (Shih Statuti i UKZ, neni 156, 157 dhe 158), merr pjesë në punëtori ndërkombëtare dhe hapë ekspozita pikturë apo mban koncerte muzikore e korale në nivel nacional.

Cdo anëtar i stafit akademik është aktiv në veprimtarinë kërkimore e shkencore. Fushëveprimtaria e tyre shkencore e kërkimore është e gjerë:

- Marrin pjesë në konferenca shkencore nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare;
- Marrin pjesë në punëtori të ndryshme shkencore;
- Marrin pjesë në debate shkencore;
- Publikojnë artikuj shkencor në revista ndërkombëtare me impact factor, në revista nacionale e rajonale;
- Marrin pjesë nëpër forume të ndryshme akademike, nëpër redaksi të revistave, nëpër borde të konferencave shkencore, si recensionistë për artikuj shkencor në revista ndërkombëtare etj;
- Publikojnë monografi shkencore;
- Publikojnë tekste universitare;
- Përkthejnë tekste universitare në gjuhën shqipe për nevojat e studentëve;
- Organizojnë ekspozita të arteve figurative në UKZ dhe më gjerë;
- Organizojnë koncerte korale me Korin e Universitetit.
- Publikojnë projekte aplikative teknologjike, hulumtime të ndryshme për procesin arsimor etj.

Puna kërkimore shkencore kalon përmes një procesi të validimit, i cili përfshinë disa nivele. Me Statutin e UKZ-së stafi akademik është i obliguar që të bëjë publikime shkencore në revista kredibile ndërkombëtare, si dhe të marrë pjesë në konferenca vendore e ndërkombëtare shkencore. Veprimtaria shkencore është e bazuar në hulumtime dhe në paraqitje të rezultateve të këtyre hulumtimeve dhe përmes tyre arrihen rezultate, të cilat stafit akademik ju vlerësohen gjatë procesit të avansimit të tyre. Për çdo avansim ekzistojnë kushtet nga Statuti si dhe nga Regullorja për Emrim, reimrim dhe avansim e UKZ-së, e cila i ka të përcaktuara kushtet minimale që një staf që pretendon për tu avansuar duhet plotësuar. UKZ ka krijuar mekanizma të mbrendshëm për ta validuar punën kërkimore shkencore, e cila përbëhet nga 5 mekanizma:

1. Kosmisioni recensues, i cili ka për ta vlerësuar kandidatin për arritjet shkencore. Ky komision është në përmëje të profesorëve që janë eminentë dhe kanë thirrje më të lartë shkencore se kandidati që është në proce të avansimit.
2. Komisioni i studimeve i Fakultetit, i cili ka për detyrë që të bëjë verifikimin e raportit të Komisionit recensues, e të cilin raport e rekomandon në KF për miratim apo hedhje poshtë.
3. KF është organ kolegjal i Fakultetit, i cili poashtu vlerëson raportin e komisionit recensues si dhe Komisionit të studimeve të fakulteti dhe vendos për të rekomanduar ose jo tutje në Komisionin e studimeve të UKZ-së.
4. Komisioni i studimeve i UKZ-së është një mekanizëm në nivel të UKZ-së, i cili ka për detyrë që në mënyrë të detajuar të vlerësojë punën kërkimore shkencore të kandidatit,

si dhe të vlerësojë dhe verifikojë raportet recensuese dhe vendimet e tjera të organeve relevante. Komsioni i Studimeve verifikon validitetin e punimeve, revistave, indeksimet ëe tyre nëpër databaza ndërkombëtare si dhe pjesmarrjen në konferenca shkencore. Komsioni raportin e vet e paraqet para Senatit të UKZ.

5. Senati është organi kolegjal i UKZ i cili vendos për çështje akademike dhe validon përfundimisht punën kërkimore shkencore të personelit akademik, që është në proces të avansimit.

7.6. Çdo anëtar i stafit akademik dhe studiues ka prodhuar së paku një mesatare prej një botimi hulumtimi shkencor/aplikuar ose rezultat artistik/produkt në vit për tre vitet e fundit

Përputhshmëria e UKZ-së

Publikimeve shkencore të stafit akademik, UKZ i kushton një rëndësi tejet të veçantë, pasi që me anë të kësaj vlerëson performancën, eksperiencën dhe arritshmërinë e profesorëve në raport me fushat përkatëse të studimit dhe transmetimit të këtyre njohurive tek studentët. Nga të dhënat e marra nëpër NJA, çdo staf akademik i UKZ prodhon më së paku një aktivitet shkencor e hulumtues brenda vitit, e cila është obligim për avansim edhe në kuadër të Strategjisë për Hulumtime shkencore, i cili proces u paraqit më lartë. Kjo ndodh për shkak se UKZ stimulon punën e për hulumtime shkencore, por edhe për shkak të detyrimit statutar (shih Statuti i UKZ, neni 156, 157, 158).

Përpos aktiviteteve me karakter hulumtues-shkencor, UKZ ka realizuar një numër të madh të tryezave të diskutimit për çështje relevante për fusha të ndryshme të shkencës. Thëkso tryezat e mbajtura dhe temat e diskutuara: _tryezë debatuese fillimi i implementimit të Pilot Projektit “Klasa 1 deri në 5 qasja me mësimëdhënës lëndor”, tryezë debatuese “Klasa 1 deri 5, 1 apo më shumë mësues”, tryezë shkencore “Nga shqipëtarët ose serbët, deri te shqipëtarët dhe serbët”, etj. Në anën tjetër janë ftuar persona të cilët janë të kyçur drejtpërdrejtë në institucione të ekonomisë, drejtësisë etj., dhe të njëjtit kanë bashkëbiseduar me studentët për çështje të ndryshme relevante. Të ftuar ishin: personalitete ftuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, Akademia e Drejtësisë në Kosovë, Qendra e Dokumentimit të Kosovës, Policia e Shtetit, Qendra për Punë Sociale, etj.

7.7 Pritjet për përfshirjen e stafit mësimdhënës në veprimtaritë kërkimore/akademike/artistike janë specifikuar dhe performanca në lidhje me këto pritje është konsideruar në sistemin e shqyrtimit individual të performancës dhe në kriteret e promovimit

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ përkrah projektet hulumtuese për të cilat ka kërkesa nga NJA. Për këtë arsye është miratuar edhe Rregullorja për Veprimat Kërkimore-Shkencore të UKZ-së, e cila përkrah stafin akademik në hulumtime shkencore (XXX). Me anë të kësaj rregullore bëhet e mundur rritja e pjesmarrjes së stafit në punë kërkimore shkencore, duke i stimuluar edhe në aspektin financiar, por gjithashtu duke e bërë të detyrueshme edhe pjesëmarrjen dhe një minimum të publikimeve në baza vjetore. Kjo detyrueshmëri e stafit është e paraparë në Statutin e UKZ dhe në Rregulloren për Emrim, riemrim dhe avansim të personelit akademik të UKZ-së, por gjithashtu edhe në kontratën e punës që stafi akademik nënshkruan me UKZ.

Poashtu, Rektori i Universitetit, ka nxjerrë vendimin për stimulimin financiar të stafit akademik të cilët zhvillojnë dhe aplikojnë për projekt propozime. Përmes atij vendimi secili pjestarë I stafit që zhvillon projekt dhe aplikon te donatorët merr një stimulim financiar për punën e bërë, pa llogaritur përfitimet që më pas vijnë si rezultate të projektit. Hulumtimi shkencor është pjesë e vlerësimit të performancës së stafit akademik, dhe kjo bëhet nëpërmjet

vetëvlerësimit të stafit, pastaj kjo kalon nëpër procesin e vlerësimit të performancës edhe nga Dekani si dhe vlerësimi i performancës nga procesi i avansimit, i cili është spjeguar më lartë. Kjo është e rregulluar nga procesi i vlerësimit të stafit akademik (Shih Standardin 5) si dhe nga Statutit dhe Rregullorja për Emrimin, Riemrimin dhe avansimin e stafit akademik.

Për pranimin e stafit të ri akademik në UKZ, po ashtu dhe në cdo avansim të tyre, kushti kryesor kërkohet performanca shkencore dhe hulumtuese. Në Statutin e UKZ, më specifikisht në Rregulloren për pranimin në punë dhe avancimin e stafit akademik është theksuar për secilin titull akademik shprehimisht se çfarë kontributi shkencor kërkohet. Ky kontribut merret parasysh nga Komisionet e recensionimit, nga KF, nga Komisioni i Studimeve dhe nga Senati në rastin e pranimi apo avancimit të kandidatit në thirrje akademike. Kontributi që kërkohet për pranim/avancim konsiston në këto veprimtari hulumtuese e shkencore:

- Publikim i artikujve shkencor në revista ndërkombëtare me impact factor;
- Publikim i monografive shkencore;
- Publikim i teksteve universitare;
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare;
- Ekspozita/koncerte artistike.

UKZ i kushton një rëndësi të vecantë zhvillimit të projektpropozimeve për projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe financon secilin projektpropozim në një përqindje të caktuar me Rregulloren për Veprimtari kërkimore shkencore të UKZ.

Si rezultat I angazhimit të stafit akademik dhe administrativ, UKZ-ja ka menaxhuar dhe vazhdon të implementoj disa projekte Erasmus + dhe një numër të konsiedrueshëm të projekteve. UKZ është lider në një project Erasmus Plus dhe si partner është një 16 projekte të tjera. Gjithashtu UKZ-ja ka zhvilluar edhe projekte të tjera nga donator të tjerë, si Programi HERAS (WUS Austria), CODE (Banka Botërore), LECU (University of Cyrih), USAID, OSCE etj.

Nëpërmjet projektit “eViva” (Erasmus+) është krijuar qasja në Platformën Mahara në kuadër të projektit. Nëpërmjet projekti “ResearchCult” (Erasmus+) do të blehet softueri për antiplagiarizëm dhe do të krijohet platforma digjitale për hulumtime shkencore për konsorciumin e anëtarëve të projektit.

Do të krijohen edhe 6 revista ndërkombëtare në kuadër të konsorciumit.

Nëpërmjet projektit Erasmus + ResearchCult, do të bëhet përmirësimi i strategjisë universitare për publikimin e punës kërkimore shkencore përmes zhvillimit dhe aprovimit të standardeve të njohura ndërkombëtare për revistat shkencore, si dhe krijimin e revistave shkencore ndërinstitucionale në prioritetet kryesore të kërkimit në Kosovë; Promovimi i punës kërkimore përmes konferencës shkencore të përbashkët vjetore; Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve të kërkimit duke zhvilluar rregulloret për etikën dhe integritetin kërkimor, si dhe krijimin e këshillave të etikës kërkimore në institucionet e arsimit të lartë; Lehtësimi i qasjes së rregullt në publikimin e hulumtimit dhe krijimin e një platforme / baze të dhënash në internet për qasje të hapur për akumulimin e njohurive kërkimore; Rritja e mundësive për publikimin e hulumtimeve përmes ngritjes së kapaciteteve tek kerkuesit e rinj në e artikujve për hulumtime sipas kriterëve dhe kërkesave për botimin e punëskërkimore; Në kuadër të këtij projekti,

Universitetet në Kosovë përballen me sfida të ngjashme sa i përket veprimtarisë kërkimore. Të gjithë përballen me kapacitet të ulët për të ndërmarrin kërkime shkencore cilësore, si dhe atyre u mungojnë strukturat institucionale dhe politikat e caktuara për të mbështetur aktivitetin

kërkimor në baza të vazhdueshme. Në këtë drejtim, rezultatet e mëposhtme të pritshme do të kontribuojnë në nevojat e UKZ-së:

- Një raport vlerësimi i publikuar në përshkrimin e situatës kërkimore në Kosovë;
- Do të themelohen shtatë zyra kërkimore, një për secilin partner të universitetit, duke përfshirë edhe UKZ;
- Universitetet përkatëse do të emërojnë të paktën një koordinator kërkimi për secilën zyrë kërkimore.
- Plane strategjike të zhvilluara, një për secilin universitet.
- Themelimi i gjashtë (6) revistave shkencore, një për një përparësi kërkimore në Kosovë (a. Mjedisi, Energjia dhe Burimet Natyrore; Prodhimi Bujqësor dhe Siguria e Ushqimit; Kërkime mjekësore; Zhvillimi të një shoqërie të bazuar në dije; e Studime gjuhësore, historike dhe kulturore; dhe Informacion dhe Teknologjitë e Komunikimit.
- Krijimi i Këshillave Shkencore ndër-institucionale, një për çdo revistë shkencore.
- Krijimi dhe azhurnimi i një regjistri të vlerësuesve (recensues ndërkombëtarë, gjithashtu recensues lokalë me reputacionin shkencor ndërkombëtar të vendosur).
- Krijimi i një Komiteti Organizativ ndër-institucional për Konferencën Vjetore Shkencore; Ndërtimi i kapaciteteve në fushën e Arsimit të Lartë - Projekte strukturore Përmirësimi i Kulturës Kërkimore në Arsimin e Lartë në Kosovë - Kulturë Kërkimore
- Organizimi i të paktën një konference gjatë jetës së projektit në gjashtë sesione shkencore, me pjesëmarrjen e rreth 200 studiues, dhe të paktën 100 prezantime të zgjedhura kërkimore në të gjitha seksionet shkencore;
- Minimum 60 punime që përmbushin standardet e zgjedhura për botim në revistat shkencore.
- Politika / rregullorja mbi etikën kërkimore dhe integritetin e adaptuar në secilin universitet përfitues (tetë politikat / rregulloret).
- Të paktën tetë Këshilla të Etikës Kërkimore të themeluara dhe funksionale, një për secilin institucion përfitues (universitetet përkatëse mund të krijojnë komitete të tilla në nivele fakulteti).
- Një bazë e të dhënave në internet për qasje të hapur të zhvilluar dhe lëshuar në treg;
- Baza e të dhënave azhurnohet me njohuri kërkimore nga revistat e krijuara, si dhe kërkime të tjera punime që plotësojnë standardet e përcaktuara të kërkimit.
- Rreth 100 studiues (veçanërisht të rinj dhe të papërvojë), minimumi 10 studiues për partner përfitues do të trajnohen për përgatitjen e artikujve kërkimor duke përmbushur kriteret e ndërkombëtarisht revista të indeksuara.

UKZ gjithashtu është anëtarësuar në shumë rrjetë ndërkombëtare, me anë të cilave krijon mundësi të reja për zhvillimin e stafit të saj, sipas tabelës së mëposhtme, ku aktivitetet konkrete ka pasur nga më të ndryshmet. . Me u përmend me explicit me shume

Tabela 27 UKZ gjithashtu është anëtarësuar në shumë rrjetë ndërkombëtare

Nr.	Emri i institucionit
1.	Anëtare e Forumit të Rektorëve të Evropës Juglindore, ku UKZ ka marrë pjesë në dy takime vjetore në kuadër të kësaj konference.
2.	Anëtare Themeluese e BUA- Balkan Universities Association, ku UKZ ka marrë pjesë në të gjitha konferencat vjetore si dhe konferencat e tjera që anëtarët partnerë kanë organizuar së bashku me UKZ-në.
3.	Anëtare themeluese e Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, ka marrë pjesë në shumë mbledhje, takime, diskutime, ëorkshope dhe konferenca. UKZ në vitin 2020 është edhe udhëheqëse e kësaj konference.
4.	Anëtare e EUF- European Universities Foundation, ku UKZ ka marrë pjesë në të gjitha takimet vjetore të EUF. Poashtu janë krijuar edhe projekte të përbashkëta Erasmus+ në kuadër të këtij anëtarësimi.

5.	Anëtare e ATEE- Association of Teacher Education in Europe, ku stafi akademik i UKZ-së ka marrë pjesë në konferenca vjetore të organizuara nga ATEE.
6.	Anëtare e ENAI- European Network for Academic Integrity, ku stafi akademik ka marrë pjesë në konferenca vjetore të saj si dhe ka publikuar në revista me impakt faktor, punime që kanë dalur nga këto konferenca.
7.	Anëtare e ELFA- European Laë Faculties Association, ku UKZ ka marrë pjesë në disa konferenca online që janë realizuar si dhe ka marrë pjesë në mbledhjen vjetore.
8.	Anëtare e SDSN- Sustainable Development Solutions Network, ka marrë pjesë në disa konferenca e sidomos në vitin 2020 gjatë pandemisë.

7.8. Personeli mësimor inkurajohet të përfshijë në informacionin e tij të mësimdhënies në lidhje me hulumtimet e tyre dhe aktivitetet shkencore që janë relevante për kurset që ata mësojnë, së bashku me zhvillimet e tjera të rëndësishme kërkimore në terren

Përputhshmëria e UKZ-së

Profesorët e UKZ nxiten dhe financohen pjesërisht për të publikuar në revista me impakt faktor. Ata nxiten dhe financohen plotësisht për të publikuar monografi shkencore dhe tekste universitare.

Të arriturat e tyre shkencore stafi mundohet t'i inkorporojë në programet studimore dhe t'i bëjë pjesë të syllabusëve e të ligjëratave. Njëri prej kërkesave të KB për publikime ka të bëjë pikërisht me këtë pikë: aty kërkohet në mënyrë specifike se cilat lëndë që ligjërohen në UKZ i mbulon një tekst që synon për t'u botuar?

Poashtu hartimin e syllabuseve profesorët duhet ta bëjnë duke përdorur literaturën më të re se 10 vite, kjo një masë që i bënë ata të jenë në hap me literaturën më të re lidhur me temat që ata ligjërojnë.

Të gjitha publikimet e punimeve, poashtu librat dhe monografitë përdoren nga stafi akademik si një bazë e mirë e literaturës për të përfunduar procesin e ciklit të ligjëratave.

UKZ ka miratuar formularin standard të syllabuseve në kuadër të cilit parashihet edhe pjesa e hulumtimit nëpër lëndë. Hulumtimi vlerësohet minimalisht 20% të totalit të lëndës së ligjësuar. E rëndësishme është që futja e këtyre hulumtimeve shkon nëpër një proces monitorimi nga ana e KF, ku profesorët bëjnë kërkesë dhe sqarojnë kërkesën e tyre për futje në syllabuse të hulumtimit të tyre dhe Këshilli në çdo vit miraton syllabuset e lëndëve, duke përfshirë edhe pjesën nga hulumtimi.

7.9. Stafi akademik dhe hulumtues publikon nën emrin e institucionit në Kosovë, ku ata janë të lidhur si staf me kohë të plotë

Përputhshmëria e UKZ-së

Me qëllim të avancimit akademik të stafit dhe promovimit ndërkombëtar të kërkimeve të zhvilluar nga mësimdhënësit e tij, UKZ jep grante për pjesëmarrjen në konferenca të rëndësishme shkencore ndërkombëtare, simpoziume, kongrese, drejtime panelesh apo mbajtje ligjërata.

Stafi i rregullt akademik brenda UKZ obligohet që të publikojë punime në emër të UKZ. Përpos kësaj sipas kontratës stafi akademik nxitet që ta promovoj UKZ në të gjitha llogaritë e tij në rrjetet sociale siç mund të jenë: “facebook”, “twitter”, “academia.edu”, “instagram”, “linkedin” dhe në rrjetet tjera sociale duke e prezantuar/identifikuar si punëdhënësin primar të tij.

7.10. Janë krijuar politika për pronësinë e pronës intelektuale dhe procedura të qarta të përcaktuara për komercializimin e ideve të zhvilluara nga stafi dhe studentët

Përputhshmëria e UKZ-së

Pronësia intelektuale garantohej përmes procedurave dhe akteve të brendshme të nxjerra nga UKZ si: Rregullorja e KB dhe Rregullorja për veprimtarinë kërkimore shkencore, duke siguruar respektim të të drejtës së autorit përmes [Kodit të Etikës](#) neni 18 pika 1,2,3. Ky Kod po ashtu ka për qëllim që të vendosë rregulla standarde në fushën e kërkimeve shkencore, në atë mënyrë që të sigurohet kredibilitet në punë kërkimore të stafit akademik si dhe të respektohen standardet e kërkimit shkencor, përfshirë edhe citimin e burimeve të shfrytëzuara në kërkimin shkencor, shmangien e plagjiaturës etj.

Në cdo punim diplome të mbrojtur në UKZ studenti-kandidat e vendos në fillim të punimit deklaratën e origjinalitetit të punimit.

Përvec KdE, edhe në Rregulloren për Keshillin Botues janë disa seksione që trajtojnë pronësinë intelektuale.

Po ashtu, në Fakultetin Juridik është futur lënda që trajton pronësinë intelektuale si lëndë obligative.

Në Planin Strategjik të UKZ është paraparë që deri në fund të vitit 2022 të hartohet dhe miratohet Rregullorja për pronësinë intelektuale e cila përmban dispozita të cilat garantojnë mbrojtjen e të drejtave intelektuale të stafit akademik në kuadër të UKZ nga cdo cenim i mundshëm që mund të bëhet nga kushdo.

Poashtu pronësia intelektuale është futur në kuadër të programit të Fakultetit Juridik si lëndë obligative për studentët.

Edhe Rregullorja për Projekte në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, në nenin 12 të saj thekson se “Pronësia intelektuale e projekteve të punuara nga studentët dhe mësindhësit në projekte dhe gjatë zhvillimit të projekteve gjatë procesit të studimeve është pronë e UKZ-së”.

Ky [Udhëzues](#) përcakton pozicionin e Universitetit në lidhje me pronësinë intelektuale (IP) të zhvilluar nga stafi, studentët dhe disa të tjerë, së bashku me procedurat e vendosura për komercializimin e IP në pronësi të Universitetit. Ai përfshin të gjitha aktivitetet e lidhura me Universitetin, përfshirë kërkimin dhe inovacionin dhe edukimin e studentëve. Ky Udhëzim ka përfshirë në mënyrë specifike në të gjitha kontratat e punësimit të punonjësve dhe çdo marrëdhënie juridike midis Universitetit dhe studentëve të tij. Ekzistojnë përkufizime të shumta për IP. Në thelb, IP mund të konsiderohet si 'njohuri dhe zbatimi i saj krijues'. Në terma praktikë, i gjithë materiali i gjeneruar nga stafi duhet të konsiderohet se ka potencialisht IP. Shembujt e IP përfshijnë:

- Patentat; E drejta e autorit; Të drejtat e performancës; Të drejtat e dizajnit dhe Markat tregtare.

7.11. Ekzistojnë politika të qarta, procedura dhe njësi strukturore relevante për të siguruar ruajtjen e parimeve etike në hulumtim

Përputhshmëria e UKZ-së

Në UKZ ka politika të qarta për ruajtjen e etikës në hulumtim. Studentët i mësojnë edhe përmes kurseve të ndryshme, si Metodatat e kërkimit shkencor. [Kodi i Etikës](#) i trajton këto politika Rregulloja e Etikës, si dhe rregullorja për hartimin dhe mbrojtjen e temave të diplomave i trajton dhe Rregullorja për KB i trajtojnë këto çështje.

Sa u përket procedurave, edhe ato janë të qartësuar: do punim diplome që mbrohet në UKZ duhet të ketë të nënshkruar një deklaratë të origjinalitetit, ndërsa temat e masterit qëndrojnë në diskutim publik për 15 ditë në ueb faqen e UKZ.

SMU (Sistemi i Menaxhimit të Informatave) të Universitetit e ka një aplikacion anti-plagjiarizëm dhe aty testohen të gjitha punimet e diplomave për origjinalitet dhe shkallën e citimit.

UKZ ka formuar [Keshillin e etikës](#), i cili ka për detyrë të shqyrtojë rastet kur ndokush nuk e ka rrespektuar KdE, ka bërë shkelje etj. dhe ai merr masa disiplinore ndaj atyre personave.

Sipas [Rregullores për avansime](#) Komisioni Recensues e hulumton në detaje punën kërkimore shkencore të kandidatit edhe në aspektin e origjinalitetit. Ndërsa [Komisioni i Studimeve](#) e këshillon Senatin sidomos në këtë aspekt: për secilin rast vec e vec, për secilin kandidat për praninë në punë apo për avancim, Komisioni i Studimeve i hapë para Senatit scilin punim shkencor të kandidatit duke tregtuar revistën ku është botuar, ku është revista e indeksuar dhe a është revista ndonjë botues i dyshimtë.

Edhe [Rregullore për masat dhe procedurat disiplinore](#) për stafin akademik dhe studentë i rregullon disa aspekte të politikave për ruajtjen e etikës në hulumtim.

Shmangiet nga konflikti i interesit - terheqja e anetareve në të gjitha rastet kur ka konflikt i interesit sipas ligjit mbi konfliktin e interesit.

Programi antiplagjiature përmes projektit Erasmus+ ResearchCult. Projekti ResearchCult, në kuadër të paketës punuese nr. 4, parasheh edhe blerjen e softëerit antiplagjiarizëm, i cili është në p[roces të nënshkrimit të kontratës, ku studiuesit dhe studentët të cilët bëjnë hulumtim mund të kontrollojnë punën e tyre kërkimore dhe të shmangin përfshirje e paqëllimshme të plagjiaturës. Ai gjithashtu do të shërbejë personelit akademik për të mbështetur dhe drejtuar punën kërkimore të studentëve.

SWOT për Hulumtimin

Pikat e forta	Dobësitë
➤ Rezultate të hulumtimeve shkencore të stafit të UKZ-së si në pjesëmarrje në Konferenca kombëtare/vendore apo ndërkombëtare; ➤ Bashkëpunimi në hulumtimin e problemeve të arsimit të lartë në Kosovë me ekspertët dhe studiuesit e universiteteve të tjera. ➤ Stafi akademik i UKZ ka një përgatitje profesionale dhe shkencore të lartë; ➤ Profesionalizmi i stafit akademik dhe përvoja e tyre e më hershme në institucione akademike në Kosovë dhe jashtë saj; ➤ Cilësia dhe disiplina në nivel të lartë e profesorëve dhe asistentëve në ligjërata dhe ushtrime. ➤ Një numër i profesorëve janë hartues të teksteve universitare, ku tekstet e tyre janë obligative jo vetëm në universitetin “Kadri Zeka” por edhe në universitete tjera në Kosovë, në Shqipëri dhe Maqedoni. ➤ Përkrahja për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe vizitave studimore;	➤ Mungesa e qasjes së mjaftueshme në databaza shkencore ndërkombëtare; ➤ Buxheti jo i mjaftueshëm për zhvillimin e projekteve shkencore dhe hulumtuese nga ana e UKZ; ➤ Mungesa e organizimit të konferencave të mjaftueshme profesionale dhe shkencore në UKZ; ➤ Personel i pamjaftueshëm administrativ i përkushtuar sektorit të kërkimit ➤ Zotësi joadekuate e personelit në gjuhën angleze

➤ Përkrahja në hulumtim shkencor; ➤ Përkrahja për punë hulumtuese me studentë; ➤ Përkrahja për shkrimin e projekteve hulumtuese; ➤ Përkrahja për botimin e teksteve universitare dhe monografive; ➤ Buxheti nga projektet Erasmus+ për hulumtim dhe mobilitet; ➤ Organizimi i konferencave të përbashkëta shkencore ndërkombëtare dhe vendore si dhe vizitave studimore; ➤ Angazhimi i profesorëve të huaj në proceset hulumtuese dhe mësimore në UKZ nga Programi Fulbright ➤ Angazhimi Institucional për Ndërkombëtarizimin e sektorit të kërkimit shkencor ➤ Zbatimi i Projektit Erasmus + “ResearchCult” ➤ Përvojë në organizimin e ngjarjeve shkencore ndërkombëtare ➤ Rregullat dhe rregulloret ekzistuese për kërkime dhe mbështetje financiare nga IAL dhe MASHT ➤ Pjesëmarrje aktive në konsorciume ndërkombëtare, projekte dhe grante ➤ Investime kapitale në infrastrukturën kërkimore	
➤ Mundësitë ➤ Shfrytëzimi i rezultateve të institucioneve/instituteve, vendore dhe ndërkombëtare në procesin mësimor të programit të studimit. ➤ Organizimi i ligjëratave dhe punëtorive nga ekspertët e fushës nga universitete dhe institucionet evropiane në kuadër të aktiviteteve mësimore të UKZ-së ➤ Hulumtimi i problemeve të ndryshme në bashkëpunim me ekspertët dhe studiuesit e universiteteve të tjera; ➤ Pjesëmarrja në Konferenca të ndryshme, ndikon në rritjen e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë, respektivisht në UKZ; ➤ Mbështetje nga Ministria e Arsimit ➤ Mbledhja e fondeve të financimit të granteve kombëtare dhe të huaja; ➤ Erasmus + / Heras dhe projektet e donatorëve të tjerë; ➤ Bashkëpunimi ndërmjet stafit akademik të Kosovës dhe personave të tjerë; ➤ Programet e përbashkëta midis IAL-ve kombëtare; ➤ Financat e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare aktuale nga MASHT, p.sh. KOSTT dhe HERAS ➤ Shfrytëzimi i përvojës ndërkombëtare të personelit akademik; ➤ Shfrytëzimi i inovacioneve në pajisjet digjitale; ➤ Politika e hyrjes së hapur në infrastrukturën kërkimore; ➤ Platforma e menaxhimit të projektit ResearchCult;	➤ Rreziqet ➤ Mungesa e politikave të qarta në mbështetje të studimeve dhe kërkimeve shkencore, në nivelin e MAS.; ➤ Prioriteti i MAS në kërkimin e fushave të aplikuara; ➤ Mungesa e buxhetit për aktivitete kërkimore, artistike dhe kulturore nga MASH; ➤ Politikë jo konsistente e qeverisë për cilësinë e botimit ➤ Infrastruktura hapësinore e pamjaftueshme për personelin akademik, administrativ dhe procedurat e komplikuar që vijnë nga qeveria për t'i zgjidhur ato. ➤ Njohuri dhe mosbesim i mjaftueshëm i eksponentëve të ekonomisë së tregut në lidhje me aftësinë e universitetit për të zgjidhur problemet përmes kërkimit shkencor dhe të aplikuar

Standard 8. Stafit, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional

8.1. Një grup i plotë politikash dhe rregullash përfshihet në një doracak punësimi ose në doracak, i cili është i qasshëm për të gjithë personelin mësimor dhe administrativ. Ai përfshin të drejtat dhe përgjegjësitë, proceset e rekrutimit, mbikëqyrjen, vlerësimin e performancës, promovimin, proceset mbështetëse dhe zhvillimin profesional

Përputhshmëria e UKZ-së

Politikat për proceset e punësimit dhe zhvillimit profesional për personelin mësimor dhe administrativ, UKZ në Gjilan, i bazon në: Ligjin për Arsimin e lartë, Ligjin e punës, Ligjin për shërbyesit Civil, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr.01/-625, Dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (Rregulloren Nr.02/1531, Dt.13.10.2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për personelin administrativ.

Këto dokumente janë të qasshme për gjithë personelin akademik dhe administrativ si dhe audiencës përmes publikimit në ueb faqen e UKZ-së, në formë të një doracaku, i cili ju shpërndahet stafit të UKZ-së dhe është i publikuar në ueb të UKZ-së. Doracakun e ka miratuar KD. Doracakun përfshinë të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit akademik dhe administrativ, procesin e rekrutimit, vlerësimin e performancës së tyre si dhe zhvillimin profesional të tyre. Doracakun është i hartuar që të jetë i kuptueshëm për secilin të punësuar në UKZ.

8.2. Proceset e rekrutimit sigurojnë që stafi të ketë fushat specifike të ekspertizës, kualifikimit dhe përvojës për pozicionet që ata zënë. Proceset e rekrutimit sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve

Përputhshmëria e UKZ-së

Procesi i rekrutimit të stafit bëhet duke u bazuar në nevojat e Universitetit. Ky proces bëhet duke u bazuar në Statutin e përkohshëm të UKZ, ndërsa procedurat e vlerësimit dhe kushtet e veçanta specifikohen në [Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Nr. 01/625](#). Në konkursin e publikuar për rekrutim caktohen kushtet dhe kriteret për praninë në punë. Kështu, në bazë të Rregulloreve të lartëcekura, në nenet 5,6,7,8,9 janë caktuar në detaje kualifikimi që duhet të ketë kandidati për punë duke filluar nga fusha e studimit, publikimet, përvoja në mësimdhënie dhe aftësia në mësimdhënie. Komisioni recensues i cili do të vlerësojë kandidatët është në përbërje prej tre anëtarëve, ku të paktën dy anëtarë duhet të jenë nga fusha e ngushtë e studimeve për pozitën për të cilën është hapur konkursi. Anëtarët e komisionit duhet të jenë në thirrje më të lartë se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjedhet kandidati.

Komisioni recensues sipas afateve të parapara në Statutin e Përkohshëm të UKZ, Rregullores së sipërpërmendur dhe Udhëzimit administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 14, dhe raportet e vlerësimit nga studentët në lëndët përkatëse (të bëra nga Zyra për Cilësi- në rastet e riemërim dhe avancim ndërsa për stafin e ri vlerësimi i performancës mund të bëhet përmes intervistës), bën vlerësimin e kandidatëve dhe bën propozimin e kandidatit më të mirë. Në propozim komisioni recensuar duhet të arsyetojë propozimin e tij dhe e procedon për votin në KF përkatës. Në anën tjetër kandidatët e pakënaqur me referatin vlerësues kanë të drejtë të ankesës. Ankesa i drejtohet KF, ku në këtë rast Këshilli formon komision prej tre anëtarësh për zgjidhjen e ankesave.

I gjithë procesi i rekrutimit të stafit bazohet në parimin e barabarësisë së kandidatëve të cilës UKZ i kushton vëmendje të veçantë. Parimi i barabarësisë së kandidatëve është i shfaqur në garantimin e barabarësisë gjinore e cila shprehimisht është e shprehur në Statut: *Universiteti*

siguron dhe mbështetë barazinë gjinore ([Statuti i Përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit, MASHT, 2013, neni 7.](#)).

Për rekrutimin e personelit administrativ ndiqen të gjitha rregullat e ligjit për zyrtarët publik, i cili kërkon përgaditje profesionale për secilën pozitë dhe garanton procedura të qarta të rekrutimit të stafit civil, si dhe garanton barazi për të gjithë kandidatët.

8.3. Kandidatëve për punësim ju sigurohen përshkrime të plota për pozitën dhe kushtet e punësimit

Përputhshmëria e UKZ-së

Punësimi i kandidatëve bëhet në përputhëri me Statutin e Përkohshëm të UKZ (nenet 41, 153, 155, 156, 157, 158, 159, 160), dhe në Rregullore, në të cilat përcaktohen kriteret dhe kushtet për punësim për çdo pozitë. Në bazë të kësaj rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për fitimin e titullin dhe pranim në punë për Profesor të Rregullt, Profesor i Asocuar, Profesor Asistent, Asistent, Lektor dhe Korepetitor.

Rekrutimi i stafit administrativ bëhet konform Ligjit të Punës dhe Ligjit për Zyrtarët Publik, ndërsa përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi bëhet sipas Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës të UKZ-së. Sa i përket procedurës së hapjes së konkursit dhe vlerësimit e zgjedhjes së kandidatit kjo rregullore është në pajtueshmëri edhe me Udhëzuesin administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik (Udhëzuesin administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 14). Ndërsa sa i përket stafit joakademik përgjegjësitë dhe kualifikimet e veçanta për çdo post përcaktohen me përshkrimin e punës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në fund të procesit përzgjedhës secili punëtor ka të përshkruar në kontratë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës në varësi nga pozita të cilën e ka, kontratë, e cila bëhet në përputhshmëri me Ligjin e punës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit. Përpos procedurës një detyrë të rëndësishme në rekrutimin dhe promovimin e stafit të ri e kanë Prorektori për Çështje Akadematike dhe Dekanët e Fakulteteve në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim të cilësisë në lidhje me performancën e mësimdhënësve e cila vjen nga vlerësimi i studentëve. Ky vlerësim bëhet në përputhje me UV (UV, Ref. nr.01/198 Dt. 04/03 /2019, pika 6, nënpika, a,b,c,d,e,f,d,) dhe ka për qëllim përmirësimin e aktivitetit mësim dhe atij profesional. Pra, rekrutimi dhe promovimi i stafit akademik bëhet edhe duke e pasur parasysh performancën e stafit.

8.4. Stafit të ri të mësimdhënies i jepet një orientim efektiv për të siguruar njohje me institucionin dhe shërbimet e tij, programet dhe strategjitë e zhvillimit të studentëve, si dhe prioritetet institucionale për zhvillim

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka hartuar [Doracakun për stafin akademik](#), me të cilin stafi i ri orientohet që të njihet me institucionin dhe shërbimet e tij, me programet dhe strategjitë e zhvillimit, me misionin e UKZ-së, me hapsirën e UKZ-së, me personelin, etj..

Dekani i njësive akademike dhe stafi tjetër akademik i fakultetit, javën e parë e prezanton profesorin e ri para studentëve

Stafi i ri udhëzohet t'i lexojë dokumentet themelore dhe aktet normative të UKZ dhe të ketë një njohuri për të drejtat dhe detyrimet.

Nga praktika e deritashme, stafi i ri akademik është orientuar në mënyrë nga Menaxhmenti i njësive akademike dhe i është ofruar njohuri për institucionin dhe shërbimet e tij, por që të njëjtat nuk janë të përfshira në një Udhëzim për orientim të stafit të ri akademik në UKZ, i cili do t'ju lehtësonte orientimin e stafit të ri akademik.

8.5. Niveli i ofrimit të stafit mësimdhënës (raporti i studentëve për anëtar të stafit me orar të plotë) është adekuat për programet e ofruara. Ngarkesat mësimore janë të barabarta në të gjithë institucionin, duke marrë parasysh natyrën e kërkesave të mësimdhënies në fusha të ndryshme të studimit

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka shënuar një ndryshim pozitiv të raportit studentë profesorë në tri vitet e fundit. Kjo ka ndodhur për shkak të rekrutimit të stafit të ri akademik si dhe për shkak të avansimeve të asistentëve të doktoruar në thirrjen Profesor Asistentë. Në vitin akademik 2020/21 UKZ ka të punësuar 45 staf akademik me orar të plotë në pozitat e personelit akademik dhe 2343 studentë aktivë. Raporti i studentëve për anëtar të stafit me orar të plotë edhe nuk është i kënaqshëm (1/52), por kur t'i shtohet këtij numri të stafit akademik edhe stafi i angazhuar, e që janë 57, atëherë raporti i përgjithshëm student-mësimdhënës është i favorshëm, i afërt me mesataren e BE: 1/22. Profesori në UKZ është i ngarkuar me 6 orë mësimore në javë., me mundësi që edhe 6 orë të tjera ti merr në formë të angazhimit shtesë.

Në vitin 2020 UKZ ka hapur konkurs për pranimin në punë edhe të 13 profesorëve të rinj për tri njësi akademike, e që nënkupton se ky raport profesorë-studentë do të ndryshoj pozitivisht në vazhdimësi, deri sa të arrihen raportet që janë të përafërta me universitetet në BE.

Sipas rregullave të AKA, për 60 ECTS Universiteti duhet të ketë një profesor me kontratë të plotë. UKZ e plotëson këtë kusht tërësisht me përpikëri për të gjitha programet studimore.

Profesorët e UKZ-së nuk lejohen që gjatë orarit të punës në UKZ-së të punojnë në ndonjë institucion publik ose privat tjetër.

Tabela 28 Raporti personel akademik i rregullt (FT)/ student për njësi dhe institucion në përgjithësi (UKZ), si dhe raporti personel i rregullt dhe i angazhuar për njësi dhe institucion në përgjithësi (UKZ)

FAKULTETI	Programi i Studimit	Gjinia		Gjithsej Studentë	Staf akad. i rregullt	Staf akad. i angazhuar	Raporti St. Akad.- Student
		Femra	Meshkuj				
Fakulteti i Edukimit				744	11	17	
	Fillor	405	44	449			
	Parashkollor	291	4	295			
Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	383	191	574	10	18	
Fakulteti Ekonomik				574	15	4	
	Banka,Financa, dhe Kontabilitet	151	158	309			
	Menaxhment	77	46	123			
	Menaxhim dhe Ndërmarrësi	41	44	85			
	Menaxhment dhe Informatike	19	14	33			

	Marketing	18	6	24			
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat Kompjuterike	69	152	221	9	7	
Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematika Arsimore	32	19	51	8	4	
F. Ekonom. F. Jurid. FSHK	E-Qeverisja (master)	66	56	122		1	
UKZ Gjilan UHZ Pejw UUH Prizr.	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (master)	27	30	57		6	
Gjithsejtë		1579	764	2343	45	57	1:52 1:22,9

8.6. I gjithë personeli i punësuar në institucion (akademik, shkencor, administrativ) ka kualifikimet përkatëse në mënyrë që ata të jenë në gjendje të menaxhojnë në mënyrë efektive aktivitetet edukative, shkencore, kërkimore, krijuese dhe proceset administrative

Përputhshmëria e UKZ-së

Në UKZ punon stafi akademik me kualifikime përkatëse për mësimdhënie dhe hulumtime shkencore. Asnjë mësimdhënës që nuk ka gradën shkencore [Dr. Sc. Nuk mund të mbajë ligjërata. Stafi akademik obligohet që të bëjë punë akademike, kërkimore dhe shkencore gjatë çdo viti, në mënyrë që të ripërtirij kontratën e punës dhe që të avansohet në tituj akademik.

Poashtu edhe stafi administrative është i kualifikuar për punët dhe përgjegjësitë që ata mbartin mbi vete në bazë të konkursit të punës. Në çdo vit kalendarik atyre ju bëhet vlerësimi nga menaxherët si dhe nga studentët, kështu që ata detyrohen të performojnë sa më suksesshëm për të ruajtur vendin e punës.

UKZ organizon trajnime periodike si për stafin akademik ashtu edhe për stafin administrative, me qëllim që ti mundësojë stafit të rrisë performancën në punën e tyre.

Kualifikimi i stafit akademik dhe administrative si dhe trajnimi i tyre është paraparë edhe në PS të UKS, si objektivi i veçantë.

UKZ posedon rregulloret dhe procedurat sipas Statutit, ku i gjithë stafi akademik dhe administrativ pranohen sipas konkurseve, ndërsa në konkurse kërkohen kualifikimet e duhura për pozitat e shpallura, me të cilat përcaktohen qarte kriteret për pranimit të stafit si dhe procedurat të cilat ndiqen.

Gjithashtu UKZ është partnere në shumë projekte vendore dhe ndërkombëtare, në kuadër të të cilave delegon stafin nëpër sesione, vizita studimore dhe trajnime të ndryshme që organizohen.

8.7. Kriteret dhe proceset për vlerësimin e performancës janë specifikuar qartë dhe u janë bërë të njohura paraprakisht të gjithë stafit

Përputhshmëria e UKZ-së

Kriteret dhe proceset e vlerësimit të performancës janë të parapara në MVP. Manuali përcakton mënyrën dhe mekanizmat e vlerësimit të gjitha stafit akademik dhe administrativ. Manuali

është i strukturuar në disa pjesë, si baza ligjore, qëllimet, parimet e vlerësimit, vlerësuesit, të vlerësuarit, periudha e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e vlerësimit.

Rregullorja për avancime e UKZ-së parasheh që stafi duhet të jetë në trend të zhvillimeve të kohës dhe ndërkombëtare, me qëllim që të arrijë ti përmbushë kushtet për avansim. Kërkesat që dalin nga rregullorja për avancime janë kërkesa direkte për stafin që duhet ti plotësojë për tu avansuar. Këto kërkesa ndikojnë direkt në intensifikimin e punës kërkimore shkencore të stafit, e që ndikon edhe në rritjen e performancës së tyre por direkt edhe në cilësi të mësimdhënies.

Të gjitha këto kriteret të matjes së performancës janë të njohura paraprakisht nga i gjithë stafi akademik dhe administrativ.

Duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e cilësisë brenda programeve të UKZ-së, veçanërisht në realizimin e një performance akademike sa më adekuate, njësia akademike përkatëse motivon dhe mbështetë aplikimin edhe të instrumenteve të ndryshme dhe me theks të veçantë të: anketave, pyetësorëve dhe aktiviteteve të tjera të vazhdueshme të studentëve përmes të cilave ata bëhen pjesë e sigurimit dhe përmbushjes së cilësisë brenda njësisë akademike, të UKZ-së. Në këtë drejtim, KMCV në bashkëpunim me *Dekanin, Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, Koordinatorët për Cilësi dhe studentët* hartojnë pyetësorët, të cilët në mënyrë periodike do të evoluojnë dhe të cilët do të kontribuojnë edhe në paraqitjen e vlerësimit të studentëve në mënyrë anonime, rreth jetës akademike në tërësi brenda UKZ-së.

8.8. Vlerësimi i stafit akademik bëhet së paku përmes vetëvlerësimit, vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe eprorëve dhe ndodh në baza formale të paktën një herë në vit. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike

Përputhshmëria e UKZ-së

Subjekte të sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit në UKZ janë i gjithë stafi akademik. Për të arritur cilësinë në mësimdhënie stafi akademik vlerësohet vazhdimisht. Përcjelljen e vazhdueshme dhe sistematik si dhe grumbullimin e të dhënave rreth cilësisë kompetente është Zyra për Zhvillim të Cilësisë dhe KMCV.

UKZ nëpërmjet vlerësimeve të shumfishta e bënë vlerësimin e cilësisë. Për këtë arsye UKZ ka hartuar edhe pyetësorët për të gjitha vlerësimet, ku vlerësohen stafi akademik, administrativ, shërbimet si dhe kushtet mësimore-infrastruktura:

1. Pyetësori për vlerësimin nga Studentët për mësimdhënësit;
2. Pyetësori për vlerësimin nga ana e Dekanit për mësimdhënësin;
3. Pyetësori për vlerësimin e shërbimeve administrative nga ana e studentëve;
4. Pyetësori për Alumni, të cilët vlerësojnë programet e UKZ-së, por gjithashtu UKZ mat edhe arritjet e tyre profesionale pas diplomimit;
5. Pyetësori për vetëvlerësimin;
6. Pyetësori për mësimin online, si pasojë e Pandemisë Covid 19;
7. Pyetësori për bizneset, të cilët i vlerësojnë studentët e UKZ.

Secili mësimdhënës i vlerësuar merr rezultatin e vlerësimit nga ZZhAC në mënyrë elektronike. Studentët marrin informatë për vlerësimin nga raportet gojore të Dekanit. Dekanët dhe prodekanët marrin gjithë rezultatin për fakultetin e tyre, ndërsa Rektori dhe Prorektorët marrin rezultatet për Universitetin. 10% e rezultateve mete mira të vlerësimit (vendosur nga Dekani) vihen në dispozicion të publikut të gjerë përmes faqes së internetit të Universitetit. 10% e rezultateve më të mira përcaktohen si 10% i lëndëve të secilit fakultet me rezultate mesatare më të mira gjatë vlerësimit të përgjithshëm (d.m.th. pyetje numër 9 e pyetësorit). Ndërkaq përdorimi adekuat e rezultateve të vlerësimit qon në përmirësimin e cilësisë.

8.9. Nëse performanca e stafit konsiderohet më pak se e kënaqshme, kërkohen kërkesa të qarta për përmirësim. Institucioni po monitoron nga afër përmirësimet në aktivitetin e stafit, veçanërisht në segmentet e nënvizuara gjatë vlerësimeve

Përputhshmëria e UKZ-së

Përmirësimi i performancës së stafit akademik është e rregulluar me Rregulloren për Sigurim të cilësisë dhe vlerësim, MVP, si dhe UV dhe përdorimin e rezultateve të tyre në UKZ, të cilat bazohen në TP.

Nëse performanca e mësimdhënësit rezulton më e ulët se mesatarja dy herë në dy vjet, Prorektori për Çështje Akademike i fton ata në një intervistë vlerësimi dhe propozohen masa përmirësuese, respektivisht trajnime plotësuese për përmirësimin e mësimdhënies. Nëse mësimdhënësi nuk e përmbush këtë marrëveshje ose performanca e tij nuk përmirësohet, Prorektori për Çështje Akademike iniciu takimin e tij/saj me Rektorin. Masat e mundshme pas takimit janë :

- Vërejtje me shkrim nga Dekani i njësisë akademike përkatëse,
- Në rast të mospërfilljes së vërejtjes, paraqitja e masës pranë Komisionit të Etikës,
- Varësisht nga lloji i vërejtjes, do të iniciohet për ndalesa të mëdijve nga paga,
- Masat e tjera konform rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik dhe KdE

8.10. Institucioni ka plan të qartë për të gjithë zhvillimin profesional të stafit, një qasje të strukturuar në identifikimin e nevojave të tilla dhe cakton burimet e duhura për zbatimin e tij

Përputhshmëria e UKZ-së

Duke u bazuar në Planin Strategjik, UKZ-ja synon që stafi akademik dhe jo-akademik të zhvillohen vazhdimisht në aspektin profesional dhe teknik duke u ofruar mbështetje logjistike dhe financiare për trajnimin e tyre. Mobiliteti i Stafit akademik dhe administrativ konsiderohet shumë i rëndësishëm për të shkëmbyer dhe për të fituar përvoja të reja, shkathhtësi menaxheriale, aftësi hulumtuese dhe njohuri për tu përgjigjur sfidave dhe nevojave të Universitetit. Zhvillimi i stafit bëhet edhe nëpërmjet projekteve vendore dhe ndërkombëtare, ku UKZ ka arritur suksese sidomos në programin Erasmus+ dhe HERAS.

Edhe [Marrëveshja me UP dhe Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie](#) mundëson zhvillimin e stafit akademik të UKZ, duke marrë pjesë në trajnime në të gjitha fushat respektive, duke ofruar një qasje të re dhe numër të konsiderueshëm të programeve të trajnimit. Kjo bëhet me qëllim që stafi i UKZ-së të jetë vazhdimisht në rrjedhat më bashkëkohore të procesit të mësimdhënies.

UKZ mundëson trajnime për stafin akademik në metodologji të mësimdhënies (QPM), pastaj në vlerësim sumativ dhe formativ nëpërmjet projektit me GIZ, trajnime për përfshirjen e teknologjisë në mësimdhënie, trajnime për stafin administrativ nëpërmjet IKAP etj.

8.11. Të gjithë stafit u jepen mundësi të përshtatshme dhe të drejta për zhvillimin personal dhe të karrierës, me ndihmë të veçantë për ata që përballen me vështirësi

Përputhshmëria e UKZ-së

Përmes Rregullores për mbështetje të mobilitetit dhe aktiviteteve të tjera të stafit akademik janë përcaktuar kushtet, kriteret, forma dhe mënyrat e mbështetjes dhe lejes për mobilitet dhe aktiviteteve tjera: pjesëmarrja aktive në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të nivelit ndërkombëtar si dhe qëndrimet hulumtuese të stafi akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ.

Pjesëmarrësve në këto aktivitete shkencore, pas përmbushjes së procedurave do ti mbulohen shpenzimet për kuotizim dhe udhëtim.

Gjithashtu Rregullorja për Veprimtari kërkimore shkencore e UKZ-së parasheh përkrahjen financiare për stafin e UKZ-së, duke favorizuar të gjithë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë përjashtimi. Aty ku ka vështirësi më të theksuara, UKZ ka lidhur Marrëveshje me QPM, e cila mundëson zhvillimin e stafit akademik të UKZ. Mobilitetet në kuadër të projekteve Erasmus+, trajnimet nëpërmjet HERAS, trajnimet nëpërmjet GIZ, përkrahja financiare për hulumtime shkencore dhe publikime dhe avansimet në thirrje për stafin akademik.

Analiza SWOT

Tabela 29 Analiza SWOT

A. Pikat e forta (Fuqitë)	B. Pikat e dobëta (Dobësitë)
Stafi akademik i kualifikuar me grada shkencore brenda dhe jashtë vendit; Profili adekuat i stafit akademik sipas fushave të programeve studimore e dhe përvoja e tyre; Performanca e lartë e stafit akademik në procesin e mësimdhënies; Shkathhtësia e stafit akademik në përdorimin efikas të teknologjisë së informacionit në procesin e mësimdhënies, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm; Komunikimi i vazhdueshëm dhe i rregullt ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimnxënjes;	Procedurat e zgjatura administrative në zgjedhjen e stafit të ri akademik; Mungesa e thirrjeve akademike profesor i rregullt; Numër i kufizuar i mësimdhënësve që aplikojnë në projekte dhe zhvillojnë mobilitete; Vështirësitë në harmonizimin e programeve aktuale të studimit me ekonominë e tregut Kosovar.
C. Mundësitë (Shanset)	D. Rreziqet
Politikat proaktive e menaxhmentit të lartë, për plotësimin e nevojave të universitetit me staf të ri akademik sipas profileve të programeve studimore; Marrëveshjet e reja të Bashkëpunimit ndërkombëtar në zhvillimin e aktiviteteve të shkëmbimit të stafi akademik; Pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare; Mbështetja financiare nga UKZ për publikime, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe mobilitete; Rritja e nevojës për arsimim të gjeneratës së re, si rezultat i konkurrencës së lartë të tregut.	Kufizimeve buxhetore në rritjen e numrit personelit akademik; Zotërim jo i kënaqshëm i gjuhëve të huaja nga stafi akademik duke mos krijuar mundësi reale për hapjen e programeve ndërkombëtare të studimit në gjuhën angleze; Vështirësitë ndjekjes së trendëve të teknologjisë bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe adoptimit të si rezultat i ndryshimeve të shpejta inovative.

Standard 9. Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse

9.1. Kërkesat e pranimit janë të specifikuara qartë dhe të përshtatshme për institucionin dhe programet e tij; kërkesat e pranimit aplikohen vazhdimisht dhe në mënyrë të drejtë

Përputhshmëria e UKZ-së

Numri i studentëve të rinjë për pranim në secilin program studimor të UKZ përcaktohet nga AKA me rastin e vendimit për akreditim të programit. Në kuadër të këtij numëri, MASH e Kosovës përcakton edhe kuotat e rezervuara për studentët nga komunitetet minoritare të Kosovës. Në vitin e parë të studimeve mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer shkollat e mesme të Larta (shkollimi 12 vjeçar), kanë dhënë provimin e maturës dhe

kalojnë testin provues të organizuar nga njësitë akademike të UKZ-së. Për të gjithë kandidatët e interesuar, secila njësi akademike e UKZ, formon Komisionet për pranimin e studentëve dhe Komisionet për shqyrtimin e ankesave të cilat veprojnë në bazë të [Regullores për pranimin e studentëve](#). Komisionet për pranimin e studentëve organizojnë provimin pranues, përgatisin testet e provimit dhe aspektet tjera të nevojshme për një selektim korrekt dhe të drejtë, duke evidentuar tërë ecurinë në Procesverbalin e provimit pranues. Pas publikimit të rezultateve preliminare të listës së kandidatëve të pranuar, kandidatët që nuk janë pranuar kanë të drejtë ankesë. Të gjitha ankesat e paraqitura shqyrtohen nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave, i cili i përgjigjet Dekanit të njësisë akademike për secalin rast me një vendim të arsyeshëm. Pas vendimit të komisionit për shqyrtimin e ankesave, Komisioni për pranimin e studentëve të rinjë shpall rezultatet finale UKZ ka krijuar edhe Komisionin Qëndror, i cili shqyrton të gjitha ankesat në shkallë të dytë. Kandidatët nga vendet jashtë Kosovës, para konkurrimit bëjnë nostrifikimin e shkollimit të tyre.

9.2. Informacion i plotë rreth institucionit, duke përfshirë programin dhe kurset, kërkesat e programit, shërbimet, mundësitë e bursave pagesat për shkollim dhe taksat administrative dhe informacione të tjera relevante, bëhen të disponueshme për publikun para aplikimit për praninë

Përputhshmëria e UKZ-së

Universiteti organizon [Ditët Informuese](#) për [secilin program](#) studimor [veç e veç](#) për [çdo vit](#) të ri [akademik](#), [Doracaku i Studentit](#) është udhëzues i UKZ-së për studentët e saporegjistruar në UKZ. Ai është i botuar në uebfaqe të UKZ-së dhe poashtu kudo në objektin e UKZ-së dhe jashtë saj gjendet si broshurë që i ofrohet studentëve dhe atyre potencial pa pagesë. Doracaku i studentit përmban të gjitha të dhënat e përgjithshme dhe të veçanta që duhet ti ketë parasysh dhe duhet ti dijë një student i UKZ-së, duke përfshirë:

1. Informata të përgjithshme për UKZ-në dhe për stafin akademik e administrative të UKZ-së;
2. Programet studimore që ofrohen dhe akreditimi i tyre ndër vite;
3. Pjesë nga KdE dhe rregulloret disiplinore, të cilat duhet ti dijë studentit;
4. Pagesat që duhet të kryejnë studentët;
5. Zhvillimi i procesit mësimor dhe i aktiviteteve të tjera akademike;
6. Informata të tjera të nevojshme për studentët dhe jetën studentore;

Informacioni i plotë për UKZ-në ipet me anë të [web faqes](#). Në web faqen e UKZ-së janë të paraqitura të gjitha informacionet e nevojshme studimore për lëndët mësimore, ngarkesat për lëndë dhe program studimor, të shprehura në ECTS.

Po ashtu në web faqen e UKZ-së shpallet [konkursi për pranimin e studentëve të rinjë](#), në të cilën përmban afatin kohor të konkurimit, kushtet e pranimit dhe kushtet e tjera.

Menaxhimi i të dhënave të studentëve gjatë regjistrimit, notimit, paraqitjes së provimeve, pagesave të taksave administrative deri në diplomimin e tyre, kryhen në formën elektronike përmes sistemit të menaxhimit universitar (SMU) gjithmonë duke e ruajtur privatësinë e informacionit.

Administrata e UKZ në Gjilan është në shërbim të studentëve dhe të përpunojë dhe arkivojë me kujdes secilin dokument i cili gjenerohet nga Institucioni apo është pjesë e dokumentacionit të dosjes së studentit në kopje elektronike dhe kopje fizike. Kështu, (shih SMU-në në web faqe të UKZ-së. Administrata përveç që është përgjegjëse për dokumentacionin e stafit, mësimdhënësve dhe të punonjësve tjerë të Institucionit; kujdeset edhe për: Dokumentacionin e kandidatëve që paraqiten për regjistrim në UKZ, Dokumentacionin e studentëve të UKZ; Mbarëvajtjen e provimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për provime të studentëve;

Mbarëvajtjen dhe informimin me orarin e ligjëratave; Bibliotekën e Universitetit dhe pasurimin e saj; Mirëmbajtjen e shërbimeve të internetit; Punët e tjera që kanë të bëjnë me jetën studentore.

Pjesë e posaçme e punës së stafit akademik është orari i konsultimeve me studentë. Çdo mësimdhënës është i obliguar të shpall orarin e konsultimeve me studentë, së paku një herë në javë.

Bazuar në misionin e UKZ-së, preokupim kryesor i UKZ-së është përgatitja e studentëve për karrierë të suksesshme. Pjesë e procesit mësimor në të gjitha fakultetet është mësimi praktik, për këtë arsye, UKZ ka lidhë marrëveshje me institucionet përkatëse për [zhvillimin e mësimi praktik](#). Kështu, studentët e Fakultetit të Edukimit dhe të Shkencave Aplikative, respektivisht studentët e Matematikës Arsimore, do të realizojnë mësimin praktik në institucionet shkollore; Në këtë mënyrë, do të krijojmë të gjitha parakushtet që studentët tanë të kenë karrierë të suksesshme pas përfundimit të studimeve në UKZ.

9.3. Është organizuar një program gjithëpërfshirës orientimi për fillimin e studentëve për të siguruar një kuptim të plotë të gamës së shërbimeve dhe lehtësive në dispozicion të tyre, politikat dhe procedurat në institucion dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre

Përputhshmëria e UKZ-së

Çdo fillim vit të ri akademik organizohet [pranimi solemn për studentët e rinjë](#). Së pari pritja e studentëve të rinjë bëhet nga menaxhmenti i UKZ i cili i njofton studentët me vizionin dhe misionin e universitetit, të arriturat, politikat zhvillimore të universitetit dhe çështje tjera me rëndësi për studentët dhe universitetin. Administrata bënë shpërndarjen e [Doracakut të studentëve](#), i cili është një udhëzues i UKZ-së për studentët e saporegjistruar në UKZ.

Pritja e studentëve të rinjë organizohet në secilën njësi akademike. Dekani prezenton stafin akademik, programin studimor, përgjegjësitë dhe të drejtat e studentëve, shërbimet e studentëve, lehtësitë dhe rregullat e tjera të njësisë akademike.

Të gjithë studentët e pranuar pajisen me ID – kartela dhe e-maila zyrtar për shërbimet elektronike në universitet, të cilat mundësojnë regjistrimin elektronik në sistemin SMU. Në këtë mënyrë, studentëve u mundësohen lehtësira në procesin mësimor: ligjërata, ushtrime, paraqitja e provimeve, evidentimi i vijueshmërisë përdorimi i bibliotekës, laboratoreve, e të ngjashme.

9.4. Një sërë bursa dhe mbështetje financiare janë në dispozicion të studentëve, në mënyrë që të stimulojnë dhe shpërblejnë punën, si dhe të mbështesin studentët me prejardhje të pafavorshme. Këto dy kategori dhe kriteret e tyre funksionojnë ndaras; këto bursa dhe mbështetje financiare mund të akumulohen

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka disa forma të përkrahjes financiare të studentëve:

1. Institucioni ka një fond vjetor të caktuar për [bursat universitare të studentëve](#). Senati i përcakton kriteret e konkursit për bursa studentore ndërsa KD përcakton fondin e bursës.
2. Institucioni posedon fondin për lirim nga pagesa e studentëve me kushte të vështira ekonomike;
3. Institucioni vendos çdo vit akademik lirim nga pagesa për familjet që kanë më shumë se një student në UKZ;
4. Institucioni gjithashtu vendos për lirim nga pagesa për studentët me aftësi të kufizuara;
5. Për studentët e UKZ sigurohen edhe bursa nga MASH e Kosovës.

6. Studentët e UKZ përfitojnë bursa edhe nga komunat nga të cilat vijnë.
7. Bursat nga operatorët ekonomikë dhe bizneset.
8. Bursa jepen edhe nga Rotary Club e Komunës së Gjilanit

9.5. Ekzistojnë procese efektive për të grumbulluar dhe analizuar të dhëna të besueshme që i referohen profilit të popullatës studentore, progresit të studentëve, suksesit dhe shkallës së braktisjes, kënaqshmërisë së studentëve me programet e tyre, burimeve të mësimi dhe mbështetjes së studentëve në dispozicion, itineraret e karrierës së të diplomuarve. Të dhënat statistikore përdoren për qëllime të sigurimit të cilësisë, si dhe në mbështetjen e vendimmarrjes

Përputhshmëria e UKZ-së

SMU prodhon statistika për popullatën e studentëve dhe cdo dekan i merr parasysh ato për sigurimin e cilësisë më të mirë.

Dy zyrtarë, drejtori i ZZhAC dhe Udhëheqësi i Zyrës për IT janë të ngarkuar me mbikqyrjen dhe zhvillimin e shërbimeve të studentëve.

KF njoftohet me të dhënat e popullatës së studentëve dhe kur është nevoja ai merr vendime për të përmirësuar situatën.


Për shembull: në Fakultetin Ekonomik ka pasur një rënie të kalueshmërisë në semestrin veror të vitit 2020. KF ka debatuar për rënien e kalueshmërisë dhe shkaktarët e pasojat e saja. Është konstatuar se ligjëratat onlajn, sa do kanë treguar prezencë të plotë të studentëve dhe të orëve të mbajtura, në provimet kaluese rezultati ka dalë më i ulët se viteve të tjera (mosmbajtja e kolokuiumeve etj.). kështu KF ka marrë vendime që edhe gjatë procesit të mësimi onlajn kolokviumet të mbahen gjithësesi.

ZZhAC në vazhdimësi mbledh dhe përpunon të dhëna, të cilat i raporton në Këshill të Fakultetit dhe në Senat dhe këto dy organe vendim-marrëse akademike marrin vendimet e duhura.


Edhe zyrat e tjera janë të kycura në procesin e përcjelljes së popullatës së studentëve. Kështu, për shembull, Zyra e IT ka raportuar në vitin 2020 se mbi 1000 studentë janë jo aktiv të përhershëm në UKZ. Fjala është për një numër të studentëve të regjistruar që nga viti 2013, të cilët kanë kaluar kohën e lejuar ligjore për studime universitare dhe nuk kanë diplomuar. Senati ka diskutuar dhe ka marrë vendimin për rishikimin e statusit të studentit për ata persona

Në vazhdim po japim disa nga të dhënat statistikore:


Pasqyra grafike e studentëve të aktiv në sistem sipas gjinisë.




Pasqyra grafike e studentëve të jo aktiv në sistem sipas gjinisë.



Pasqyra grafike e studentëve të diplomuar në sistem sipas gjinisë.



Pasqyra grafike e studentëve të pa diplomuar në sistem sipas gjinisë.



9.6. Doracaku i studentit është i disponueshëm gjerësisht brenda institucionit, duke mbuluar të gjitha informacionet e kërkuara për të gjitha fazat e ciklit të jetës së studentit -pranimi, përparimi, njohja dhe certifikimi - përfshirë të gjitha rregulloret, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, veprimet që duhen ndërmarrë për shkelje të disiplinës, përgjegjësitë e nënpunësve dhe komisioneve përkatëse, si dhe ndëshkimet që mund të vendosen

Përputhshmëria e UKZ-së

Doracaku i Studentit është një broshurë ku përfshihen të dhënat kryesore për studentin, si: misioni dhe vizioni i UKZ, menaxhmenti i fakulteteve dhe i universitetit, sa fakultete dhe sa programe studimore kanë at, kur janë akredituar, sa studentë kanë ato programe, kush janë profesorët që lgjërojnë, cilat janë të drejtat, përgjegjësitë e studentit, njoftohen me pjesë të KdE, njoftohen me buxhetin e UKZ, me politikat e bursave studentore, me taksën studentore etj. Doracaku rri në uebfaqen e Universitetit gjithë kohën. Poashtu, Doracaku është i shtypur në letër dhe vendoset nëpër kënde të caktuara të Universitetit, ku kanë qasje të gjithë studentët. Doracaku shpërndahet edhe dy herë gjatë procesit të pranimit të studentëve për studentët potencialë të UKZ-së.

9.7. Procedura e apelimit të studentëve përcaktohet në rregullore, publikohet dhe bëhet e njohur gjerësisht brenda institucionit. Rregulloret bëjnë të qartë arsyet në të cilat mund të bazohen apelimet akademike, kriteret për vendimet dhe mjetet juridike në dispozicion. Procedurat e ankesave garantojnë vlerësime të paanshme nga persona apo komitete të pavarura nga palët e përfshira

Përputhshmëria e UKZ-së

Sipas Nenit 12 të Rregullores për studime bachelor, të drejtat e studentëve trajtohen që nga procesi i pranimit të tyre në UKZ, duke mbështetur të drejtën e anëkeses në njësinë akademike.

Gjithashtu bazuar në Nenin 107 të Statutit të Universiteti të UKZ, në bazë të Nenit 48 të Rregullores për Studimet Bachelor dhe Nenit 17 të Rregullores për Studimet Master, studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim te Dekani i njësisë akademike kundër notës që ai / ajo ka marrë.

Ankesa duhet të paraqitet brenda dy ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve. Pas marrjes së ankesës së paraqitur në kohë, Dekani i njësisë akademike formon Komisionin Shqyrtues brenda një dite pune pasi ankesa është marrë dhe emëron tre anëtarë, por pa mësimdhënësin, nota e të cilit po apelohej, për të siguruar paanshmërinë. Kemi raste të tilla pothuajse në çdo njësi akademike çdo vit, kështu që ne kemi zhvilluar një formë modeli që përdoret për krijimin e një komiteti të tillë për çdo kurs gjatë vitit. Ne mund të konfirmojmë paanësinë e këtij procesi në UKZ, me faktin se kemi pasur vlerësim pozitiv të Komisionit Shqyrtues në krahasim me notën e dhënë nga profesori i lëndës.

Rastet e tilla trajtohen konform statutit dhe rregulloreve përkatëse. Në bazë të raportit të komisionit, ne mund të konfirmojmë paanësinë e këtij procesi në UKZ.

Tabela 30 Raport nga SMU për notimin e studentit me komision

Numri i ID kartelës së studentit: **157024**

Drejtimi: **Arsimi Fillor**

Semestri kur është dëgjuar lënda: **Semestri i shtatë (VII)-Bachelor**

Studenti: **Qitirina Zeqiri**

Kodi i lëndës: **14B50S07021**

Lënda: **Mësimdhënia e njohurive gjeometrike (F)**

Nota përfundimtare: **6**

Data e vendosje së notës: **27/11/2020**

Data e shtypjes së fletëparaqitjes
05/01/2021

Komisioni provues

1. 
2. 
3. 

Nënshkrimi i profesorit

Kodi i Etikës dhe Rregullorja për Masat dhe procedurën disiplinore rregullojnë procedurën e përcaktimit të shkeljeve disiplinore të studentëve në UKZ, dmth. Vendosjen dhe përcaktimin e situatës faktike dhe shkelësin e supozuar, afatet për marrjen e masave, mbrojtjen e studentëve dhe ekzekutimin e disiplinës- masat.

Masat e mëposhtme mund të vendosen ndaj studentëve për shkelje disiplinore:

- Vërejtje me shkrim,
- Vërejtja e fundit me shkrim,
- Përgjashtimi nga studimet deri në gjashtë muaj,
- Përgjashtimi nga studimet për një vit.
- Përgjashtimi nga studimet për dy vite
- Përgjashtim përgjithmonë nga fakulteti

Sipas nenit 127 të Statutit të Përkohshëm të UKZ, studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e procesit mësimor ose infrastrukturën universitare. Paraqitësi i ankesës duhet të paraqet fakte, argumente dhe prova të beueshme duke përmbledhur shkruarimisht aryet për ankesë. Seanca për shqyrtimin e ankesave duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur po jo më vonë se 30 ditë, kur ankesa i drejtohet komisionit të ankesave.

Komisioni duhet të vendosë brenda 60 ditëve prej ditës kur rasti i është paraqitur komisionit. Studentët e ndëshkuar për sjellje në kundërshtim me KdE në UKZ, kanë të drejtë të intervistohen nga komisioni disiplinor në nivel të UKZ, nga Komisioni i themeluar nga Senati. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në procedura gjyqësore.

9.8. Politikat dhe procedurat e duhura janë në vend për t'u marrë me sjelljet e pahijshme akademike, duke përfshirë plagjiaturën dhe forma të tjera të mashtrimit

Përputhshmëria e UKZ-së

Në rast të sjelljes së joakademike, bazuar në Statutin e të UKZ, studentët që shkelin rregullat, siç përcaktohet në Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe procedurat për studentët në UKZ, përgjashtohen nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht me vendim të Këshillit të NJA. Studentët e akuzuar për sjellje joakademike kanë të drejtë të intervistohen nga komisioni disiplinor, i cili konsulton KF. Studentët e përgjashtuar kanë të drejtë të apelojnë tek komisioni i ankesave në nivel të UKZ, nga Komisioni i themeluar nga Senati. Kjo mundësi bazohet në nenin 133, paragrafi 1 të Statutit të UKZ.

Ndëshkimi i plagjiaturës bëhet duke iu referuar KdE, përkatësisht nenit 17, sipas të cilit plagjiaturë nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimit të një ideje, rezultatit, pune me shkrim ose ndonjë forme tjetër plotësisht ose pjesërisht, pa treguar burimin e përdorur. Të gjitha raportimet drejtuar KE (i zgjedhur nga Senati i Universitetit), Komsionit disiplinor, apo komisionit ad-hoc (i caktuar nga Rektori i UKZ), shqyrton dhe merr vendimet përkatëse conform Statutit të UKZ dhe rregulloreve të UKZ.

Një sistem anti-plagjiaturë funksionon nga janari 2021 brenda platformës [SMU](#) e cila mundëson zbulimin e plagjiaturës. UKZ gjithashtu ka fituar një Softwver të plagjiaturës (Plagiarismcheck) nëpërmjet projektit Erasmus+ CBHE, “ResearchCult), i cili është në proces të blerjes nga Koordinator i projektit – Kolegji IBCM dhe do të funksionalizohet diku nga Shkurti 2021.

9.9. Gama e shërbimeve të ofruara dhe burimet e dedikuara për studentët reflektojnë të gjitha kërkesat e popullatës studentore. Janë hartuar plane formale për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve të studentëve; zbatimi dhe efektiviteti i këtyre planeve duhet të monitorohet në baza të rregullta

Përputhshmëria e UKZ-së

Studentëve u ofrohet një ambient i rehatshëm për studime dhe hapësira tjera ndihmëse. Në bashkëpunim të ngushtë dhe në shërbim të studentëve, përveq shërbimeve on-line përmes uebfaqes së UKZ dhe [SMU](#), administrata në nivelin e fakultetit dhe në nivel qendror, lehtëson dhe plotëson kërkesat dhe nevojat e studentëve për të gjitha shërbimeve e nevojshme gjatë tërë procesit mësimor të tyre. Administrata ka orar të plotë pune në shërbim të studentëve çdo ditë, duke ofruar informacione të nevojshëm për ligjëratat, ushtrimet, ndryshimet e mundshme, editimet e ndryshme, informacione për ECTS, krijimin në kohë dhe cilësor të dosjeve të studentëve.

Në UKZ, biblioteka është e vendosur në katin e tretë, dhe shërben jo vetëm për huazimin e librave, por edhe si një sallë studimi. UKZ ka listën e mëposhtme të librave, punimeve shkencore, etj., në formë fizike në [Bibliotekën e Universitetit](#), si dhe në [bibliotekën digjitale të UKZ e-biblioteka](#). Studentët e UKZ gjithashtu kanë qasje në [Bibliotekën e Universitetit Frankophone](#). UKZ ka një marrëveshje me [Bibliotekën Kombëtare të Kosovës](#) që u siguron studentëve tanë qasje në rreth 800,000 tituj librash dhe gjithashtu ka lidhur [Marrëveshje me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës](#) për të ofruar mundësi për të pasur qasje në bibliotekat digjitale në internet.

Fakultetet janë të pajisura me laboratorë dhe infrastrukturë moderne, si dhe pajisje moderne për zbatimin e pjesës praktike të studimit. Shfrytëzimi i konviktit të studentëve dhe mensës bëhet në [Konviktin e nxënësve dhe të Studentëve](#).

Në anën tjetër, aktivitetet sportive si voleybolli dhe aktivitetet përkatëse rekreative për studentët, zhvillohen në sallën e sportit në kampusin e shkollave të mesme të Gjilanit. (shih Aneksi- [Marrëveshja me Drejtorinë e Arsimit të KK Gjilan](#).

[Marreveshja per ambulantë në UKZ](#), e cila ju siguron qasje në kujdesin e parë shëndetësor të gjithë studentëve si dhe personelit tjetër të UKZ.

9.10. Efektshmëria dhe rëndësia e shërbimeve studentore monitorohet rregullisht përmes proceseve që përfshijnë sondazhet e kënaqësisë. Shërbimet ndryshohen në përgjigje të vlerësimit dhe reagimeve

Përputhshmëria e UKZ-së

Menaxhmenti i UKZ-së gjithmonë u është përgjigjur kërkesave të studentëve, përfshirë ato që vijnë nga vlerësimet të bëra nga ZZHAC dhe Parlamentit Studentor. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Universitetit SMU, secili student përfiton nga ligjëratat, literatura, planprogramet, njoftimet, etj., të postuara në platformat e-learning dhe SMU, nga profesorët, kështu që studentët kanë qasje në këto të dhëna.

Në vitin akademik 2019/20 [vlerësimi i shërbimeve të administratës](#) që ofrojnë për studentët u bë në internet, përmes plotësimit të pyetësorëve të hartuar për të matur kënaqësinë e studentëve me shërbimet e administratës.

Shumica e studentëve u përgjigjën: shumë të mirë, të mirë dhe të kënaqur me shërbimet e ofruara nga administrata. Përgjigje pozitive u dhanë gjithashtu në lidhje punën e zyrave të shërbimit të studentëve në fakultete në lidhje me njoftime të ndryshme, përpunimin e kërkesave, ndihmën e dhënë me përdorimin e SMU, etj; ata gjithashtu vlerësuan si të kënaqshme përfaqësimin e tyre nga PS, si dhe higjienën në institucion. Studentët kanë kërkuar përmirësime në aspekte të veçanta, të tilla si pasurimi i bibliotekës me libra të rinj, qasja digitale në shërbimet e bibliotekës, përmirësimi i komunikimit horizontal në të gjitha nivelet. Studentët, kan kërkuar që të kenë më shumë vizita në institucione, kompani, organizata ose mbrëmje argëtuese të organizuara nga fakultete dhe të kenë më shumë lehtësira në lidhje me infrastrukturën për mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe aktiviteteve të tjera me interes për studentët, të tilla si ekspozita, panairët e prezantimit, folësit e ftuar, etj. Efikasiteti dhe rëndësia e shërbimeve të studentëve monitorohen rregullisht nga menaxhmenti dhe në përputhje me vlerësimin e studentëve dhe reagimet mbi shërbimet administrative, bëhen ndryshimet e duhura.

Rezultatet e krijuara nga vlerësimi shërbejnë si rekomandime dhe janë një pjesë integrale e planifikimit për vitin e ardhshëm akademik me qëllim të përmirësimit të cilësisë.

9.11. [Këshillimi akademik, planifikimi i karrierës dhe këshilla për punësim, si dhe shërbimet e këshillimit personal ose psikologjik ofrohen me qasje të lehtë për studentët nga çdo pjesë e institucionit](#)

Përputhshmëria e UKZ-së

Me vendim të Rektorit është caktuar Zyrtari i lartë i UKZ-së për punën me Alumni dhe Zhvillim të Karrierës, e cila përfaqëson një projekt shumë të rëndësishëm për studentët dhe vetë Universitetin. Një zyrtar i tillë do të jetë një person i rëndësishëm për pregaditjen e informacionit dhe ndërmjetësimin për studentët.

Ky zyrtar ndihmon studentët e UKZ në zhvillimin e njohurive dhe aftësive që do t'i ndihmojnë ata në punësim, duke u ofruar studentëve mundësinë për të fituar përvojë pune gjatë studimit, duke siguruar informacion mbi tregun e punës, duke siguruar qasje në informacion për studime, trajnime, seminare, leksione dhe aktivitete të tjera.

Përndryshe, zyrtari gjithashtu do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive, njohurive dhe aftësive që janë thelbësore për procesin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve, të sigurojë shërbime të dixhitalizuara për arsimim, këshillim, zhvillim dhe udhëzim në karrierë, etj.

Zyra Alumni siguron komunikim dhe lidhjeje midis Universitetit, studentëve dhe Alumni-ve për të promovuar zhvillimin nw karrierw. Programet e Alumni shërbejnë si një urë lidhëse midis studentëve dhe Alumni, duke i mbajtur ata të informuar dhe të interesuar për zhvillimin e vazhdueshëm të Universitetit dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe inkurajimin e studentëve për punë dhe studim.

[Zyra Alumni](#) e ka bërë publik edhe linkun e [Komunës së Gjilanit](#) e cila ofron një platformë me informacione themelore për bizneset dhe mundësitë e punësimeve.

9.12. Mundësitë sigurohen nëpërmjet lehtësimeve të përshtatshme dhe aranzhimeve organizative për aktivitetet jashtëshkollore për studentët. Janë organizuar aranzhime për të organizuar dhe nxitur pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet jashtëshkollore

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ vazhdimisht mbështet studentët e tij në jetën e tyre kulturore, me programe specifike siç janë ekskursione në vend dhe jashtë tij, aktivitete të ndryshme artistike, aktivitete sportive, etj. Për çdo vit akademik, PS mbështetet financiarisht për aktivitete jashtëuniversitare, dhe çdo vit KD i UKZ cakton fonde për aktivitete të tilla.

Në vitet e fundit PS organizoi një sërë aktivitete, duke përfshirë:

[Panairi i Shkencës dhe Kulturës](#), [Panairi i studimeve](#), [panairi i punës](#), [partneriteti me biznese](#).

- [Konkurse njohurish](#), [Konkursi](#) për [kreativitet figurative](#), [aktiviteti për nder të ditës së çlirimit të Kosovës](#), [Aktivitete humanitare](#) dedikuar [fëmijëve me nevoja të veçanta](#) (ekspozita e vizatime per femijet me nevoje), [ekpozitë për fëmijët e kopshteve të fëmijëve të Gjilanit](#), duke organizuar edhe [ditën e fëmijëve](#), [Gara të ndryshme sportive si në futboll, shah, pingpong](#), Vizita studimore në Kuvendin e Kosovës, Vizita studimore në Ministrinë e Drejtësisë, Vizita studimore në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Apelit, Vizita studimore në Odën e Avokatëve të Kosovës, Vizita studimore në Misionin për Rend dhe Ligj në Kosovë – EULEX.

ANALIZA SWOT

Tabela 31 ANALIZA SWOT

Pikat e forta	Dobësitë
1. Përdorimi i SMU-së në UKZ 2. Përdorimi i platëformës E-learning 3. Bibloteka me literaturë të mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze 4. Hapsira të mjaftueshme për lexim dhe studim në bibliotekë 5. Rregullore të mjaftueshme që rregullojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve në UKZ 6. Përkrahja financiare e menaxhmentit të UKZ-së në organizimet e aktiviteteve jashtë universitare të studentëve 7. Motivimi i studentëve me anë të bursave dhe lehtësitië finaciare.	1. Përdorimi i kufizuar i literaturës në gjuhë të huaja nga ana e studentëve 2. Vështirësitë në lëvizjen e lirë të studentëve dhe stafit akademik jashtë vendit (vizita studimore, vazhdimi i studimeve post diplomike, pjesëmarrja në konferenca shkencore etj.)
Mundësitë	Sfidat
1. Avancimi i bashkëpunimit në mes të studenteve dhe stafit akademik në zhvillimin shkencor profesionale dhe në marrjen e iniciativave të reja 2. Organizimi i punëtorive të profesionale në mbështetjen e procesit mësimor të UKZ-së	1. Kosto e lartë e mirëmbajtjes softwverike dhe sigurimit të softëveve të licencuar për nevoja të studentëve 2. Kufizimet buxhetore për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe shkencore të studentëve

3. Trajnime dhe mundesi të tjera të avansimit së kapaciteteve të studentëve	3. Gjendja e ulët ekonomike e studentëve në sigurimin e paisjeve për ndjekjen e mësimit online në kohën e pandemisë Covid 19
4. Krijimi i klubeve të studentëve dhe organizimi i garave në fusha të ndryshme;	
5. Projektet e ndryshme ndërkombëtare dhe të mobilitetit;	

Standard 10. Burimet mësimore dhe Hapsirat

10.1. Burimet financiare adekuate sigurohen për blerjet, katalogimin, pajisjet, dhe për shërbimet si dhe zhvillimin e sistemit

Përputhshmëria e UKZ-së

Për zhvillimin e punës në UKZ, buxheti miratohet njëherë në vit dhe rishikohet në Qershor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga i cili ndahen burime financiare për blerjen e pajisjeve dhe pagesën e shërbimeve për mësimdhënie.

Buxheti i tërësishëm i plasifikuar për vitin 2021 është 2,547,642.99 euro i shpërndarë në kategori ekonomike; mallra dhe shërbime 400,000 euro, Shpenzimet komunale 50,000 euro, Subvencione dhe transfere 100,000 euro, kurse shpenzimet kapitale janë në vlerë prej 700,000 euro të cilat kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturën.

Në UKZ në Gjilan zhvillohet veprimtaria mësimore dhe kërkimore në një hapësirë të mjaftueshme dhe me kushte të mira studimi për studentët dhe stafin.

Universiteti ka një sipërfaqe e cila i plotëson nevojat e programeve studimore. Kampusi ekzistues përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të ndërlidhura midis tyre dhe të përshtatshme për aktivitete mësimore. Gjendet në një pozitë të përshtatshme, brenda qytetit, me një mundësi të përshtatshme për qasje nga studentët dhe stafi. Objekti kryesor ka një hapësirë prej 6500 m² për zyrat e stafit akademik dhe administrativ, sallat e mësimit, laboratorët, kabinetet, bibliotekën dhe infrastrukturën tjetër të paraqitur në tabelën 1 dhe 2, ndërsa komplet Kampusi i UKZ-së në total ka një hapësirë prej 2ha ose 20000 m². UKZ, bashkë me Komunën e Gjilanit dhe me Qeverinë e Kosovës është duke planifikuar zgjerimin e kampusit aktual edhe me një objekt të madh apo ndërtimin edhe të një kampusi të ri në tjetër pozicion (7,3 ha).

Tabela 32 Zyrat e KD, menaxhmentit, dekanëve, stafit akademik, stafit administrativ, parlamentit studentor dhe depo

Zyret	Nr. i zyreve	Hyrja A	Hyrja B
Zyra e Këshillit Drejtues	1	Kati I	
Zyret e Menaxhmentit	5	Kati I - Rektorat	
Zyret e Dekanëve	5	Kati I, II	Kati P, I, II
Zyret e stafit Akademik	19	Kati I, II, III	Kati P, I, II
Zyret e stafit Administrativ	19	Kati P, I, II	Kati P, I,
Zyrja e Parlamentit Studentor	1		Kati II
Depo	3	Kati nëntoksor, P	

Tabela 33 Sallat e mësimit, kabinetet e informatikës dhe laboratorët

Hyrja A		Hyrja B	
Salla nr.	Nr. i ulëseve	Salla nr.	Nr. i ulëseve

A01	60-80	Amfiteatër i vogël (B01)	50-70
A02	60-80	B02	80-90
A12	58-65	B03	25-35
Klasa e dedikuar për parashkollor (A14)	50-70	Salla e Informatikës / Laborator i rrjeteve kompjuterike(B10)	30
A21	40-45	B11	100-110
A22	58-65	Salla e Informatikës (B12)	30
A23	40-45	B21	100-120
A25	46-50	B22	40-50
A33	46-50	B23	40-50
Laboratori i Shkencave Natyrore (A13)	24	Salla e Informatikës / Laborator i rrjeteve kompjuterike(B24)	30
Salla e Arteve (A26)	40-50	Salla e Informatikës B31	30
Kabineti i Muzikës (A24)	40-50	Total	555- 645
Salla e Konferencave (A/34)	60-70		
Salla e Leximit	250-300		
Salla mësimi	15-20		
Salla mësimi	20-30		
Total	907-1,090		

Pas akreditimit institucional të vitit 2017 është bërë riorganizimi dhe zgjerimi i hapësirës. Hyrja A dhe hyrja B janë të përshtatshme dhe mundësojnë lëvizje dhe frekuentim të pa penguar të palëve. Pjesa A dhe pjesa B e kanë një lidhje të përshtatshme fizike dhe mundëson kalimin e pa penguar të palëve.

Objekti i posedon salla mësimi, një laborator të shkencave të natyrës të pajisur përshtatshëm për të mbështetur nevojat e programeve të edukimit, një kabinet të muzikës të pajisur me vegla dhe instrumente të nevojshme, një sallë të arteve figurative, një klasë të veçantë të financuar nga projekti [SHPRESE-CARITAS](#) për edukimin parashkollor, katër laboratorë të informatikës, dy laboratorë profesional për ushtrime nga fusha e rrjetave kompjuterike (donacion, njëri nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit si dhe tjetri nga ProCreditBank) të cilat janë të inkuorporuar në sallat e Informatikës B10 dhe B24.

Në ndërkohë është bërë promovimi i [Labororit të informatikës](#) i cili është Donacion i ERASMUS+ dhe është hapur ekspozita e aktiviteteve të FSHK-së në projektet ndërkombëtare REBUS, Green Tech WB etj..

Krahas burimeve të sipërsëhënuara, universiteti realizon pjesë të programeve edhe jashtë kampusit, siç është mësimi praktik për studentët e Fakultetit të Edukimit që realizohet në shkollat e regjionit të Gjilanit, të Kamenicës, të Vitisë, të Kacanikut, të Lipjanit, të Shtimjes dhe të Novobredes. Kjo mbështetet nga [marrëveshjet e nënshkruara](#) nga ana e Universitetit me Drejtoritë Komunale të Arsimit Universiteti që nga themelimi ka një bashkëpunim me DKA-të e regjionit të Anamoravës. Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DKA Gjilan, Ferizaj, Kaçanik etj.

Studentët e Fakultetit të Edukimit i realizojnë 22 javë praktikë duke përdorur infrastrukturën në institucionet publike parashkollore dhe fillore.

Në Universitet funksionojnë pesë dekanate, të cilat posedojnë hapësirat e nevojshme për funksionim e tyre. Në kuadër të dekanateve gjenden edhe zyrat e personelit të rregullt akademik. Numri total i zyrave është 24.

Aktualisht, administrata e universitetit funksionon brenda hapësirës së universitetit dhe ofron shërbime të nevojshme për studentët, profesorët dhe palët tjera. Administrata i përdorë 23 zyra për funksionimin e tyre.

UKZ blenë libra dhe mjete të tjera edukative njëherë në vit, apo edhe sipas nevojës.

Biblioteka pasurohet nga burime të ndryshme, si burime të brendshme nga universiteti, pastaj nga burime të jashtme si: GIZ-i, ASHAK, MASHT-i, dhurata nga profesorët e universitetit si dhe nga autorë të jashtëm.

Gjithashtu, Universiteti ka nxjerrë rregullore sipas së cilës, çdo autor obligohet t'i dorëzoj 10 ekzemplarë në bibliotekën e Universitetit. Kjo lehtëson studentët në raste kur kemi të bëjmë me të drejtat e autorit dhe ato libra nuk mund të fotokopjohen, atëherë studentët shfrytëzojnë këtë mundësi t'i lexojnë përmes bibliotekës së universitetit ([Rregullore për punën e Këshillit Botues](#)).

Një numër i projekteve ERASMUS ndajnë mjete buxhetore për libra. KB e bënë vlerësimin e bibliotekës dhe nevojave të saj dhe të lexuesve një herë në vit.

10.2. Librat, revistat dhe materialet e tjera janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze (ose gjuhë të tjera) siç kërkohet për programet dhe hulumtimet e organizuara nga institucioni *Përputhshmëria e UKZ-së*

Universiteti ka në dispozicion bibliotekën, e cila në fondin e saj ka literature në gjuhën shqipe, angleze, serbokroate dhe një fond më të kufizuar të literaturës në gjuhën turke dhe greke.

Fondi i përgjithshëm i librave është 52,000 ekzemplarë.

Biblioteka posedon një [fond të revistave](#). Literatura ekzistuese në bibliotekë lehtëson dhe ndihmon programet ekzistuese dhe ato në riakreditim dhe akreditim.

Përveç bibliotekës së universitetit, studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturën e cila gjendet në [bibliotekën e qytetit “ Fan S. Noli” në Gjilan](#)

UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi me [Bibliotekën Kombëtare të Kosovës](#), në bazë të së cilës UKZ ka qasje në kopjet fizike të librave të cilat gjinden në Bibliotekën Kombëtare. Po ashtu Biblioteka Kombëtare do të furnizoj bibliotekën e UKZ-së me tituj sipas mundësive.

Me qëllim të begatimit të titujve të librave në bibliotekën e UKZ-së është lidhur marrëveshje me [Rrjetin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës](#). Për këtë çështje janë shkëmbyer përvoja për qasje sa më të lehtë në bibliotekat tjera elektronike jashtë vendit.

UKZ është pjesë e projektit Erasmus+ “ResearchCult” me anë të cilit do të krijohet qasja në një bibliotekë ndërkombëtare;

UKZ gjithashtu ndanë për cdo vit edhe fonde për blerjen e librave;

UKZ furnizohet me libra edhe nëpërmjet projekteve Erasmus+, si me SMAHPC, ENEMLOS, etj.

10.3. Qasja e besueshme dhe efiçente në bazat e të dhënave në internet, hulumtimet dhe materialet e revistës relevante për programet e institucionit janë të disponueshme për përdoruesit

Përputhshmëria e UKZ-së

Përdoruesit, studentë dhe stafi akademik, në çdo kohë, mund t'i qasen burimeve dhe bazave të të dhënave sa i përket hulumtimeve dhe revistave relevante për programet studimore të cilat janë pa pagesë si dhe atyre në kuadër të antarësisë së [Universitetit në rrjete ndërkombëtare](#).

Sa i takon qasjes në databaza elektronike me pagesë jemi në proces të shikimit të mundësive si institucion në mënyrë që të ofrohet qasja për staf akademik dhe studentë. Deri në vitin 2019 MASH ia ka paguar UKZ qasjen në databazat EBSCO dhe tash jemi duke hulumtuar mundësitë e riqasjes.

10.4. Janë ofruar lehtësi adekuate për të strehuar burimet e të mësuarit në një mënyrë që i bën ato të arritshme. Pajisja kompjuterik edhe softueri i përditësuar ofrohen për të mbështetur qasjen elektronike në burime dhe material referimi

Përputhshmëria e UKZ-së

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) me qëllim të lehtësimit dhe thjeshtësimit të procedurave, UKZ në Gjilan, për nevojat e tij, i jep në përdorim çelësat për licencim të softuerëve të Microsoft-it si në vijim: Microsoft Ëindoës 10 Education, Microsoft Office Professional 2019, Microsoft Project Professional 2019, Microsoft Visio Professional 2019, Core Ifrastructure Svr Std Edt, SQL Server Standard Edition 2019, Microsoft Visual StudioProfessional 2019.

Universiteti ofron edhe softuer të ndryshëm sipas kërkesave të njësive akademike, gjithashtu rekomandon edhe softuer të tjerë të cilët janë Open Source për student.

UKZ është pjesë e [Projektit KODE/NREN](#), të financuar nga Banka Botërore për promovimi i zhvillimit ekonomik dhe rritja e punësimit përmes përfshirjes së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në veçanti mundësimin të qasjes në resurse të teknologjisë dhe dijes për studentë dhe profesorë të të gjitha universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë.

Universiteti ka [Sistemin e Menaxhimit Universitar](#) (SMU), i cili përdoret për menaxhimin e të dhënave Universitare, në veçanti të të dhënave të studentëve, duke përfshirë nga konkurrimi për pranim e deri te diplomimi i studentëve. Sistemi është ëeb-based në të cilin qasje kanë studentët, profesorët dhe stafi administrativ. Sistemi administrohet nga zyra e TI-së në Universitet. Shumica e aktivitetit të studentëve zhvillohet përmes sistemit.

Nxënësit aplikojnë përmes sistemit, ku pasi të regjistrohen, ju krijohet qasja në sistem si student, i regjistrojnë lëndët e plan programit të tyre, i paraqesin provimet dhe shërbime të ngjashme. Studentët mund të gjenerojnë pagesat përmes sistemit.

Profesorët regjistrohen në SMU nga ku mund t'i notojnë studentët, mund të publikojnë njoftime për studentët, etj.

Stafi menaxhues mund të përcjell statistikën e ndryshme, kryesisht të studentëve të regjistruar, diplomuar, aktiv, jo aktiv, etj.

Stafi administrativ përmes sistemit kryejnë veprime në lidhje me studentët, si lëshimi i vërtetimeve, transkriptove të notave, diplomave, raporte statistikore, etj.

Administrimi i SMU-së bëhet nga zyra e TI-së dhe përfshinë regjistrimin e studentëve dhe të gjithë përdoruesve tjerë, të plan programeve dhe lëndëve, hapjen e afateve të paraqitjes së provimeve, të bursave, shtypjen e ID-kartelave, çregjistrimin e studenteve, etj.

Statistikat që gjenerohen nga sistemi janë: Statistika semestrale, historiat e përdorimit të sistemit nga përdoruesit, statistika të notës mesatare, statistika të pagesave, statistika të regjistrimit të studentëve në bazë të viteve akademike, në bazë të vendbanimit, kombësisë, në bazë të fakulteteve e drejtimeve. Statistika të studentëve të çregjistruar, të diplomuar etj.

Në kuadër të kësaj platforme ekzistojnë disa module si: Aplikimi online, Aplikimi për diplomë, Aplikimi për transfer, Pagesat, Moduli për cilësi, Id kartelave, Statistikave, etj.

UKZ përdor platformën [E-learning](#) (Moodle), përmes së cilës mësimdhënësit vendosin materialet e nevojshme për ligjërata, ushtrime, dorëzimi i detyrave dhe projekteve hulumtuese me orar të caktuar, gjithashtu mund të dërgohen edhe njoftime të caktuara përmes mesazheve tek studentët. Kjo platformë nga ana e studentëve lejon qasjen për shfrytëzimin e të gjithave informatave të lartcekura por jo me mundësi ndryshimi.

Universiteti është duke e zhvilluar dhe është në fazën testuese të platformës [ukz-platforma.net](#). Kjo platformë përmban pjesën menaxhuese të raporteve ditore, javore, mujore për stafin akademik, gjithashtu, ka edhe lehtësira në krijimin e orareve të njësive akademike duke përfshirë grupet e studentëve për lëndë të caktuara, menaxhimin e mësimin, i cili përfshinë menaxhimin e orëve të mbajtura online dhe fizikisht, raportimin në kohë reale të orëve të mbajtura, ndërlikohja e platformës me google.meet për mbajtje të orëve online, menaxhimin e të dhënave të stafit akademik si CV-të, menaxhimin e arkivës digjitale, menaxhimin e sistemit të pagave, etj.

Procesi i digjitalizimit të Bibliotekës është në vazhdim. Marrëveshja me Bibliotekën Kombëtare precizon edhe procesin e digjitalizimit, i cili do të bëhet sipas sistemit të Bibliotekës Kombëtare.

Universiteti ofron lehtësi në pajisje të shumta elektronike siç janë: kompjuterë, laptop, projektorë, zërimin në salla.

10.5. Biblioteka dhe pajisjet dhe shërbimet e lidhura janë të disponueshme për orë të zgjatura përtej kohës normale të mësimin për të siguruar akses kur kërkohet nga përdoruesit ***Përputhshmëria e UKZ-së***

Orari i bibliotekës është nga 8:00 deri në 16:00, çdo ditë pune. Pas renovimit dhe digjitalizimit të plotë biblioteka do të funksionoj nga ora 8:00 deri në orën 20:00 dhe ditën e shtunë. Qasje në bibliotekë kanë gjithë studentet dhe stafi akademik.

Në proces është renovimi i sallës së bibliotekës, e cila do të ofrojë ambient të përshtatshëm për lexim dhe studim, si dhe për të siguruar akses nga përdoruesit, qofshin ata studentë apo mësimdhënës, duke përmbushur kërkesat dhe nevojat e tyre. Me renovim biblioteka është zgjeruar me 300 m². Hapësirat janë bërë moderne, më të përshtatshme për lexim dhe punë të gjatë, me hapësirë për pushim në korridor. Janë siguruar gjysmë-kthina për nevojat e vecanta të përdoruesve të bibliotekës.

Bibliotekistja e UKZ ka ndjekur kursin dy vjeçar për digjitalizimin Bibliotekës.

Në planin operativ për administratën është paraparë pranimi në punë edhe i drejtorit të bibliotekës.

10.6. Sisteme të besueshme përdoren për regjistrimin e huave dhe kthimeve, me ndjekje efikase për materialin e vonuar. Sisteme efektive të sigurisë përdoren për të parandaluar humbjen e materialeve

Përputhshmëria e UKZ-së

Në bibliotekën e UKZ librat janë të katalogizuar dhe ka një sistem të punës funksional për huazimin e librave, kthimin e tyre me kohë dhe ndjekjen efikase për materialin e vonuar. Librat huazohen me ID kartelën e studentit tek Zyrtarja e bibliotekës.

Për të siguruar humbjen e materialeve, në universitet është i implementuar sistemi i sigurisë së kamerave. Ky lloj i sistemit bën ruajtjen e video incizimeve në kohë të caktuar (deri 15 ditë).

Mbas digjitalizimit të plotë të bibliotekës, edhe kërkimi e huazimi i librave do të digjitalizohet.

10.7. Institucioni siguron një ambient të përshtatshëm, të pastër, atraktiv dhe të mirëmbajtur mirë të të dy ndërtesave dhe bazave. Pajisjet plotësojnë plotësisht kërkesat e legjislacionit të Kosovës për shëndetin dhe sigurinë

Përputhshmëria e UKZ-së

Objekti i UKZ i përmbush kushtet për studime universitare. UKZ është në negociata me qeverinë e Kosovës për ngritjen e kampusit të ri. Komuna e Gjilanit ka ndarë trollin për kampus. Qeveria ka marrë vendim për realizimin e kampusit. UKZ ka marrëveshje me [Komunën për shfrytëzimin e Sallës së Sporteve](#) ngjitur me UKZ dhe për Sallën e Madhe sportive

Universiteti ka hapësira gjelbëruese, të cilat janë të rrethuara me rrethoja me standarde adekuate dhe të përcjella me siguri të lartë. Në këto hapësira për pushim dhe rekreacion përfshihen edhe pjesët të cilat janë të rregulluara me infrastrukturë të përshtatshme për pushime të studenteve dhe stafit.

Hapësira është e pajisur me ndriçim dhe kamerat e sigurisë, të cilat afrojnë një standard të sigurisë për 24 orë. Gjithashtu, në këtë pjesë hapësinore është edhe pjesa për parking të makinave të stafit, e cila me hyrje-daljet e saj garanton funksionalitet të mirë.

Objekti i universitetit posedon edhe pjesën e shkalleve të sigurisë për dalje emergjente. Po ashtu, në pikat e caktuara brenda objektit janë të vendosura edhe pajisjet emergjente për veprime kundra zjarrit.

UKZ i kushton vëmendje të veçantë edhe kujdesit shëndetësor të studentëve dhe stafit. Për këtë qëllim UKZ ka bërë marrëveshje me Drejtorinë Komunes për Shëndetësi Gjilanit dhe UKZ ka bërë ndarjen e një hapësire të përshtatshme ku do të kujdestarojnë në një kohë të caktuar një mjek çdo ditë pune.

Universiteti ka kontrate me kompani pastrimi për mirëmbajtje të objektit për të ofruar kushte të mira sanitare dhe ambientale (Kontrata Nr 05/1823 dt. 17.11.2020). Gjithashtu, Universiteti ka kontratë me kompani për sigurimin e pandërprerë të objektit dhe kampusit nëpërmjet personalit fizik, 24 ore në ditë. (Kontrata Nr 05/299 dt. 30.03.2018).

Gjatë pandemisë Covid 19 është siguruar dezinfektimi ditor i të gjitha hapësirave ku mbahen ushtrime në klasa, laboratore apo provime e kolokviume.

10.8. Proceset e sigurimit të cilësisë të përdorura përfshijnë si reagimet nga përdoruesit kryesorë në lidhje me përshtatshmërinë dhe cilësinë e objekteve, dhe mekanizmat për shqyrtimin dhe reagimin ndaj pikëpamjeve të tyre

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka një objekt, i cili përbëhet nga salla mjaft cilësore, me mjete teknologjike më të reja, si Smart Board, Projektor, pajisje tjera teknologjike si zërim të mjaftueshëm, pastaj shpërndarja e Lap Topëve për profesorë, etj.

Studentët e UKZ janë kryesisht afër universitetit (shumica janë në largësi më pak se 40 km). Për studentët jashtë rajonit të Gjilanit, UKZ ka marrëveshje me [Komonën për shfrytëzimin e Konviktit](#) për banim të studentëve. Studentët mund të ushqehen në konvikt tek menza e konviktit. Konvikti është afër Universitetit përafërsisht 70 metra.

Në pyetësorët të cilët ju parashtrohen studentëve lidhur me vlerësimin e tyre të përgjithshëm, në vazhdimësi zëjnë vend edhe pyetjet të cilat kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe përshtatshmërinë e saj krahas nevojave të tyre.

10.9. Për studentët dhe personelin me aftësi të kufizuara fizike ose për nevoja të tjera të veçanta (siç janë dëmtimet vizuale ose të dëgjimit) ofrohen kushte të përshtatshme për të dy ambientet dhe burimet e mësimi

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ofron kushte të pjesshme për personat me nevoja të veçanta (psh. hyrja, banjo, përcjellja etj.).

Në procesin e pranimi të studentëve të rinj UKZ krijon lehtësira në pranimin e studentëve me nevoja të veçanta. Po ashtu edhe gjatë procesit të mësimi e sidomos gjatë provimeve studentëve të tillë u ofrohet ndihma e kolegëve ose e zyrtarëve të UKZ.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile është i një rëndsie të veçantë, dhe për këtë arsye UKZ në raste të caktuara shfrytëzon burimet e OJQ-vë që mirren më çështje të tilla me qëllim të përmbushjes së kushteve më të mira për këta studentë;

10.10. Inventaret e plota mbahen nga pajisje të zotëruara ose të siguruar nga institucioni përfshirë pajisjet e caktuara për stafin individual. Shfrytëzimi i hapësirës monitorohet dhe kur objektet e përshtatshme rialokohen në përgjigje të kërkesave në ndryshim

Përputhshmëria e UKZ-së

Inventari i UKZ është i inventarizuar dhe shpërndahen e mirëmbahen sipas nevojave. Zyrtarja e pasurisë dhe Zyrtarja e Depos kujdesen për inventarin. Në menaxhimin e inventarit përdoret aplikacioni *E-pasuria*. Ka vendim për zhvlerësimin e pajisjeve elektronike.

Sistemi për [regjistrimin e pasurisë \(E-pasuria\)](#) është sistem i implemtuar në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, që përdoret për regjistrim dhe menaxhim të aseteve qeveritare.

UKZ gjithashtu ka krijuar edhe listën e inventarit nga Secili projekt Erasmus+ CBHE, në të cilat vendoset edhe logo e programit Erasmus+.

10.11. Pajisjet kompjuterike adekuate janë të disponueshme dhe të qasshme për mësimdhënie, staf dhe studentë në të gjithë institucionin. Përshtatshmëria e sigurimit të pajisjeve kompjuterike vlerësohet rregullisht përmes anketimeve ose mjeteve të tjera

Përputhshmëria e UKZ-së

Një numër i madh i pajisjeve elektronike janë vënë në disponim të mësimdhënësve, studentëve dhe stafit administrativ. Mësimdhënësit furnizohen me lloptopë, medime lëvizëse për ruajtjen e të dhënave (USB). Zyrat e profesorëve furnizohen me kompjuter desktop dhe printerë. Çdo njësi akademike posedon fotokopjues dhe material shpenzues të nevojshëm, si letër dhe ngjyrë për fotokopjues. Sallat e mësimi janë të pajisura me projektorë.

UKZ ka përfituar edhe pajisje më bashkëkohore (lap topë smart board, projektor me motor, TV, Sistemi digjital për Konferenca Ndërkombëtare Live me mikrofonë dhe kamera dhe TV, Kompjuterë All in one, etj).

(Laboratori për punë praktike në rrjetat kompjuterike në Sallën e Informatikës B24, e cila është përfituar nga QK)

Tabela 34 Numri total i kompjuterëve (desktopë dhe laptopë) funksionalë që disponon universiteti

	Përdoren nga stafi akademik	Përdoren nga stafi administrativ	Përdoren nga studentët	Total kompjuterë
Numri i përgjithshëm i kompjuterëve	97	48	125	218

Tabela 35 Numri total i pajisjeve të tjera teknologjike funksionale që disponon universiteti

Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Projektor	45
Smart Board	4
Smart TV	0
Makinë fotokopjuese	14
Printer	70
Kompjuterë në laboratorë të Informatikës	110
Kompjuterë për stafin akademik	70
Kompjuterë për administratë	38
Laptop	52
Printer për ID-kartela	1
Lexues Optik	1
Ëi-Fi (Modem)	15
Server	2
Pajisje Laboratorike	15
Grafoskop	13
Kamera të sigurisë	38
Aparat Profesional Fotografik	4
Router	6
Switch të menaxhueshëm	10
Switch të thjeshtë	15
UPS	50
Scanner	4

Përveç pajisjeve të listuara më lartë, Universiteti ka përfituar grante nga projektet e ndryshme si: Euforia, ReBus, E viva, Quadric, SMAHPC, ENEMLOS, ResearchCult, GreenTechWB, QATEK, etj, përmes të cilave grante ka pasuruar fondin e pajisjeve të ndryshme që i lehtëson aktivitetet akademike.

Tabela 36 Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme

Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Laptop	9
Desktop Lenovo ALL IN ONE	13
Video Projektor	10
Mobile Projektor	4
Aparat Proffesional	1
Printer Multifunksional	3
Kamera Ultra HD	2
Kompjuter Desktop	15
Laptop	15
Video Conference Sound System – Online learning equipment	1

10.12. Mbështetja teknike është në dispozicion për stafin dhe studentët që përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Janë ofruar programe trajnimi për të siguruar përdorimin efektiv të pajisjeve informatike dhe softuerit përkatës për vlerësim, mësimdhënie dhe administrim

Përputhshmëria e UKZ-së

Kohë pas kohe profesorët e FSHK dhe Zyra e IT organizojnë kurse trajnimi për mjeteve elektronike. Në vitin 2018 stafi akademik është trajnuar për përdorim të Moodle. Në vitin 2019 janë trajnuar stafi akademik dhe administrativ për përdorim të aplikacionit SPSS për ta futur në mbledhjen e të dhënave dhe të analizave për cilësinë në UKZ, projekt i financuar nga GIZ-i gjerman.

Një shembull më tipik është përshtatja e shpejtë e profesorëve dhe e studentëve me kalimin nga sistemi klasik i mësimin në sistemin virtual, me rastin e karantinimit për Covid 19. Vetëm për një javë ditë i tërë procesi është stabilizuar dhe mësimi ka vazhduar normalisht në sistemet SMU dhe google.meet

Me qëllim të përvetësimit sa ma të lehtë të mësimin online, janë mbajtur trajnime për studentët dhe stafin akademik nga ana e profesorëve të cilët kishin njohuri të mjaftueshme për përdorim të platformës Moddle, google meet.

Me kontratën e re të UKZ për SMU, e cila hyn në fuqi nga 1 janari 2021, aplikacioni është pasuruar edhe më shumë.

Edhe zyrtarët administrativë trajnohen për përdorim të aplikacioneve softuerike për punë e tyre ditore, si psh. Zyrtarja e Bibliotekës, Zyrtarja e Deposë etj.

ANALIZA SWOT PËR BURIMET E MËSIMIT DHE OBJEKTET:

Tabela 37 ANALIZA SWOT PËR BURIMET E MËSIMIT DHE OBJEKTET

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
- Planet financiare e mundësojnë qëndrueshmërinë e funksionimit të UKZ me programet ekzistuese dhe ka potencial financiar për programe të reja - Hapësira fizike dhe struktura e objektit mundëson operimin në një sipërfaqe e cila i plotëson nevojat e programeve të ofruara - Përdorimi i resurseve elektronike, SMU, E- Learning, ukz platforma.	- Mundësitë jo të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive të studenteve - Objekti i universitetit i vendosur në pjesën e ngarkuar urbane dhe cilësia e ajrit me raste është jo e favorshme -

- Sallat janë të pajisura me mjete konkretizimi, si: tabela, projektorë , smart board, furnizim me internet - Kabinete dhe laborator për mbështetjen e mësimi praktik në fusha përkatëse - Fond i konsiderueshëm i literaturës në bibliotekën e universitetit për programet e ofruara dhe furnizimi periodik me tituj të rinj.	
C. Mundësitë	Rreziqet
- Kampusi i ri i UKZ-se - Përfitimi i granteve për rregullimin elaboratorëve kërkimore nga industria dhe agjencitë qeveritare. - Proejktet IPA dhe projektet e tjera Erasmus+ dhe Horizon 2020	- Ndryshimet e shpejta teknologjike dhe shkencore - Ndarja e buxhetit vjetor për blerjen e pajisjeve teknologjike varet nga buxheti qendror

Standard 11. Bashkëpunimi Institucional

11.1. Ofruesi ka hartuar dhe miratuar një bashkëpunim institucional dhe/ose strategji/politikë të ndërkombëtarizimit që udhëzon vendimet institucionale dhe shpërndarjen e burimeve në këtë fushë

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ ka hartuar PSt 2017-2022, e rishikuar në vitin 2020. Rishikimi është mbështetur me ekspertë nga Programi Heras+. Strategjia trajton bashkëpunimin ndërkombëtar si ndër prioritetet e UKZ-së. Strategjia institucionale është përshkruar në standardin 1.

UKZ-ja ka hartuar edhe [Strategjinë për ndërkombëtarizim dhe projekte 2020-2025](#), si dokument më konkret i orientimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Strategjia për ndërkombëtarizim dhe projekte është miratuar nga UKZ-ja dhe është produkt i Projektit Erasmus+ “QUADIC” ku UKZ është koordinator. Strategjia është hartuar në bashkëpunim me 17 universitete partnere, ku 4 nga ta janë universitete nga shtetet e Unionit Evropian, si Universiteti i Ljubljanes (Slloveni), Universiteti Cote D’Azur (Francë), Universiteti i Shkencave Teknike në Sofie (Bullgari) dhe Universiteti i Perugias (Itali). Hartimi i strategjisë është rezultat i një pune gjashtë mujore në konsorcium, duke marrë ekspertizën më të mirë nga partnerët ndërkombëtarë.

Strategjia përfshinë këto komponente:

1. Hyrjen
2. Analizën e situatës
3. Vizionin dhe Misionin
4. Fushat e strategjisë
5. Edukimi dhe ambienti ndërkombëtar – (SWOT analiza, Objektivat)
6. Hulumtimi, Konferencat dhe Publikimet – (SWOT Analiza, Objektivat)
7. Mobiliteti dhe Rrjetëzimi – (SWOT Analiza, Objektivat)
8. Zhvillimi i projekteve dhe Menaxhimi – (SWOT Analiza, Objektivat)
9. Plani i implementimit dhe buxheti i detajuar

Gjithashtu, është hartuar [Rregullorja për ndërkombëtarizim](#), e miratuar nga Senati i UKZ-së në vitin 2020. Hartimin e kësaj rregulloreje e ka mbështetur programi HERAS përmes projektit për Rritjen e kapaciteteve për ndërkombëtarizim të IAL-ve në Kosovë. Për realizimin e kësaj rregulloreje janë zhvilluar tri punëtori, njëra në Universitetin e Salzburgut (Austri) dhe dy të

tjera në Prishtinë (Kosovë). Me këtë Rregullore përcaktohet korniza normative për ndërkombëtarizim të UKZ-së. Pjesa e parë përcakton aktorët e brendshëm në procesin e ndërkombëtarizimit; detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Ndërsa, pjesa e dytë rregullon procedurën që duhet ndjekur për mobilitet të stafit dhe studentëve.

Për hartimin e dokumenteve për BN janë konsultuar të gjitha palët e interesit.

UKZ në vitin 2018 ka themeluar Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar në kuadër të së cilës tani punojnë dy zyrtar. ZBN-ja është në koordinim të plotë me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

ZBN ka hartuar edhe [Planin e veprimit](#) për secilin vit kalendarik. Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ka caktuar objektivat e përgjithshme të punës së zyrës, duke i ndarë sipas prioriteteve, të cilat duhet të arrihen përmes aktiviteteve të planifikuara bazuar në dokumentet strategjike, rregulloren për ndërkombëtarizim dhe plan të veprimit.

[11.2 Institucioni ka krijuar dhe caktuar portfolion për bashkëpunimin institucional dhe/ose ndërkombëtarizimin tek një anëtar i menaxhmentit të lartë që është drejtpërdrejt i mandatuar dhe i përgjegjshëm për nismat dhe rezultatet në këtë fushë](#)

Përputhshmëria e UKZ-së

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar është udhëheqës i të gjitha proceseve që lidhen me bashkëpunim dhe projekte. Ai është gjeneratori kryesor i kësaj fushë e paraparë edhe me [Statutin e UKZ-së](#) – nenet 34-38. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe implementimin e bashkëpunimit institucional si dhe të projekteve vendore e ndërkombëtare ku UKZ është partner.

Prorektori për BN është koordinatori i projektit QUADIC, menaxhon punën e konzorciumit të përbërë nga 18 partnerë, ku UKZ është udhëheqëse. Ai koordinon punën e marrëveshjeve afatshkurtëra dhe afatgjata në kuadër të shkëmbimit të stafit dhe studentëve në ICM Erasmus +. Është në mbështetje të iniciativave dhe projekteve të vogla nga dhe për studentët, në programe të ndryshme siç janë HERAS, US Embassy grants, GIZ, Caritas, MEST, OSBE, USAID, USAlumni, etj.

Me nismën e Prorektorit është krijuar edhe ekipin për mbarëvajtjen e projekteve, ku nëpër të gjitha NJA është emëruar nga një koordinator nga stafi akademik për BN. Gjithashtu është kërkuar mbështetje nga stafi administrativ, duke zgjeruar përfshirjen e personelit në procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Prorektori në bashkëpunim me zyrtarët për BN, përcakton proceset që zhvillohen dhe rezultatet që priten në fushën e BN.

Ai është përgjegjës për arritjen e rezultateve në:

- Fushën e partneritetit ndërkombëtar, duke përfshirë marrëveshjet vendore e ndërkombëtare, projekte vendore e ndërkombëtare, mobilitetet dhe veçanarisht ICM, mirëmbajtjen e kontakteve ndërkombëtare të Universitetit, implementimin e marrëveshjeve, administrimin e rezultate konkrete me partnerët, anëtarësimin në Shoqatat e Arsimit të Lartë;
- Rritjen e aplikimeve në projekte vendore e ndërkombëtare, duke bërë Identifikimin e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, përcjelljen në baza të rregullta të thirrjeve vendore dhe ndërkombëtare për projekte, ngritjen e kapaciteteve të stafit akademik, administrativ dhe studentëve për të hartuar projekte vendore dhe ndërkombëtare, përkrahjen e të gjitha iniciativave për konsorciume për aplikime të përbashkëta, përkrahjen për aplikim të projekteve me bashkë-financim, zhvillimin aplikimi dhe menaxhimi i projekteve;

- Implementimin e programeve studimore me partneritet ndërkombëtar, duke përfshirë identifikimi i programeve më të mira për nevojat e tregut, miratimin e programeve, zhvillimin e kurrikulave, promovimin e programeve jashtë vendit, krijimin e programeve të reja në Gjuhën Angleze;
- Hulumtim, Konferenca dhe Publikime, përfshirë miratimin e më shumë kërkesave relevante të numrit të synuar për pjesëmarrje të stafit në konferenca, identifikimin e shoqatave në fusha të veçanta të bashkëpunimit, aplikimin për një numër të synuar të anëtarësive në shoqatat e universiteteve ndërkombëtare, miratimin e më shumë kërkesave relevante të numrit të synuar për pjesëmarrje të stafit në konferenca, përgatitjen e një shkëmbimi të strukturuar të studentëve dhe stafit, duke u bazuar në marrëveshjet bilaterale, miratimin e më shumë projekteve të përbashkëta vendore, rajonale dhe ndërkombëtare të përbashkëta dhe ndërdisiplinare, mbështetjen financiare;
- Mobiliteti dhe Rrjetëzimi përfshirë, shkëmbimin e studentëve, shkëmbimin e personelit akademik, ngritjen e ekipit të shërbimit për studentët ndërkombëtar, lidhjen e marrëveshjeve për mobilitet;
- Rritja e numrit të aplikimeve për bursa, duke përfshirë inkurajimin e studentëve për të aplikuar, inkurajimin e stafit akademik për të aplikuar për bursa, funksionalizimin e Qendrës për gjuhë të huaja, funksionalizimin e Qendrës për karrierë, shfrytëzimin e plotë të bursave të ofruara nga partnerët ndërkombëtar;

11.3 Institucioni ka marrëveshje të ndryshme dhe memorandume mirëkuptimi me partnerët dhe organizatat relevante ndërkombëtare. Përgjegjësitë e partnerëve janë të përcaktuara qartë në marrëveshjet formale

Përputhshmëria e UKZ-së

Bashkëpunimi ndërinstitucional është pjesë e prioriteteve të UKZ-së. Marrëveshjet bilaterale mundësojnë bashkëpunimit formal ndërmjet institucioneve. UKZ ka lidhur marrëveshje me partnerw lokal, rajonal, evropian dhe tw tjera, me universitete, organizata ndërkombëtare, institucione publike dhe jopublike, biznese, OJQ dhe të tjera.

Në këto marrëveshje janë të cekura qartë dhe në mënyrë të detajuar përgjegjësitë dhe detyrat nga ana e palëve si dhe implikimet buxhetore që do të kenë në të ardhmen.

Fusha kryesore e këtyre marrëveshjeve është ngritja e kapaciteteve nga praktikat më të mira, shkëmbimi i stafit dhe studentëve, organizimi i konferencave, simpoziumeve, seminareve të përbashkëta, aplikimi i përbashkët nëpër projekteve ndërkombëtare etj.

Tabela 38 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit

Nr.	Emri i institucionit	Vendi
1	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Nigdes	Turqi
2	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Trakyas	Turqi
3	Marrëveshje Bashkëpunimi me Great Lakes Colleges, GLCA	USA
4	Marrëveshje Bashkëpunimi me Des Moines Area Community College (DMACC), Iowa	USA
5	Marrëveshje Bashkëpunimi me Drake University, Iowa	USA
6	Marrëveshje Bashkëpunimi me University of Iowa,	USA
7	Marrëveshje Bashkëpunimi me University of Northern Iowa	USA

8	Marrëveshje Bashkëpunimi me James Madison University	USA
9	Marrëveshje Bashkëpunimi me Univeristetin e Rijekës	Kroaci
10	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Tetovës	Maqedoni e Veriut
11	Marrëveshje Bashkëpunimi mes UKZ, MASHT DHE UP	Kosovë
12	Marrëveshje bashkëpunimi mes UKZ dhe UP (inventari)	Kosovë
13	Marrëveshje Bashkëpunimit me Budapest Business School	Hungari
14	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Kastamonus	Turqi
15	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Rexhep Taip Erdogan	Turqi
16	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Ukshin Hoti”	Kosovë
17	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Haxhi Zeka”	Kosovë
18	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Pejës dhe te Prizrenit mbi programin Master	Kosovë
19	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Sarajevës	BeH
20	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Aleksandër Xhuvani”,	Shqipëri
21	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Alma Mater Europeae”,	Slovenia
22	Marrëveshje Bashkëpunimi me International Business College	Kosovë
23	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Shkencave të Aplikuara dhe Teknologjisë/ HEPIA,	Zvicër
24	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Ruses “Angel Kanchev”	Bulgaria
25	Marrëveshje Bashkëpunimi me Heimerer College	Kosovë
26	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”	Kosovë
27	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë	Shqipëri
28	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Edukimit të Mësuesëve	Zvicër
29	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Tekirdag “Namik Kemal”	Turqi
30	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Gjirokastrës “Eqrem Çabej”,	Shqipëri
31	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Korçës “Fan. S. Noli”,	Shqipëri
32	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Mariborit	Slovenia
33	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universita Politecnica Delle Marche, Ancona,	Itali
34	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Recep Tayyp Erdogan”,	Turqi
35	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Evropës Juglindore,	Maqedoni Veriore
36	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Durrësit	Shqipëri
37	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Podgoricës	Mali i Zi
38	Marrëveshje Bashkëpunimi me New Bulgarian University	Bulgaria

UKZ është anëtarësuar në disa institucione dhe organizata ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, shkencën, hulumtimin, kërkimin, inovacionin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të IAL-ve.

Tabela 39 [Lista e anëtarësimit të UKZ-së në institucione dhe organizata](#)

Nr.	Emri i institucionit	Anwtarwsimit
1	Anëtare Themeluese e BUA- Balkan Universities Association	2015
2	Anëtare e EUF- European Universities Foundation	2018
3	Anëtare e ATEE- Association of Teacher Education in Europe	2014
4	Anëtare e ENAI- European Network for Academic Integrity	2018

5	Anëtare e ELFA- European Law Faculties Association	2019
6	Anëtare e SDSN- Sustainable Development Solutions Network	2019
7	Anëtare e Forumit të Rektorëve të Evropës Jug-Lindore	2019
8	Anëtare e Konferencës së Rektorëve të Republikës së Kosovës	2017
9	Anëtare e Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Shqiptare	2018
10	Anëtare e Federatës së sporteve universitare	2019

UKZ-ja ka gjithashtu edhe disa marrëveshje të bashkëpunimit me institucioneve, biznese organizatat joqeveritare përmes të cilave synohet që të palët e jashtme të jenë pjesë e zhvillimit të universitetit dhe në të njëjtën kohë, UKZ-ja të përfitojnë nga ky bashkëpunim, si në aspektin e zhvillimit të programeve, procesin e akreditimit, realizimit të praktikave për studentë, ofrimin e ambienteve, mundësive dhe kapaciteteve të tyre në realizimin e hulumtimeve, kërkimeve të natyrave të ndryshme.

Tabela 40 [Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione, biznese, OJQ dhe të tjera](#)

Nr.	Emri i institucionit
1	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Drini Market
2	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Adea Group
3	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Fluidi
4	Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit në Gjilan, Kamenicë, Viti, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit
5	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Interex
6	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Albimi
7	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kombinatin e Duhanit
8	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Kosova Commerce
9	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Besa Center
10	Marrëveshje Bashkëpunimi me SHPK Dita GSH
11	Marrëveshje Bashkëpunimi me IPKO Telecommunications
12	Marrëveshje Bashkëpunimi me WUS Kosova
13	Marrëveshje Bashkëpunimi me Bislmi Group Foundaton
14	Marrëveshje Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës
15	Marrëveshje Bashkëpunimi I OVL e UÇK-Së
16	GOSVEZ
17	UKZ dhe KEDS
18	Marrëveshje bashkëpunimi mes ISLD (për konferenca dhe organizime të përbashkëta)
19	Mevlana Exchange Protokol
20	Memorandum Bashkëpunimi me GIZ
21	Përtëritje e Marrëveshjes me KEDS
22	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kuvendin Komunal të Gjilanit
23	Marrëveshje Bashkëpunimi me KUSA, Kosovo United States Alumni
24	Marrëveshje Bashkëpunimi me Institutin IKAF
25	Marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës
26	Marrëveshje me Komunën e Gjilanit
27	Marrëveshje me Swiss Caritas
28	Marrëveshje me Asociacionin e Verërave të Kosovës “Enologjia”

29	Marrëveshje me Këshillin Kombëtar Shqiptar
30	Marrëveshje me Bislmi Foundation
31	Marrëveshje me EUS Kosova
32	Marrëveshje me GIZZ CDBE
33	Marrëveshje me OJQ “PEMA”, Kosovë Marrëveshje me S.T.A.- Country Master Distributor of ETS
34	Marrëveshje me KUSA- Kosovo United States Alumni
35	Marrëveshje me Franco-Albanian Amity Association
36	Marrëveshje me Komunën e Kaçanikut
37	Marrëveshje me Komunën e Hani I Elezit
38	Marrëveshje me Odën e Avokatëve të Kosovës
39	Marrëveshje me Komunën e Kamenicës
40	Marrëveshje me KEDS
41	Marrëveshje me Agjencinë për Ndihma Juridike Falas
42	Marrëveshje me Shoqatën Kulturore “Dom Mikel Tarabulluzi”
43	Marrëveshje me RDA-Regional Development Agency- East, Gjilan
44	Marrëveshje me Komunën e Vitisë
45	Marrëveshje me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës
46	Marrëveshje me Mevlana Exchange Program
47	Marrëveshje me OJQ “Cactus”,
48	Marrëveshje me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike
49	Marrëveshje me Cultural Heritage Institute of Albanians në Shkup
50	Marrëveshje me Biblotekën Kombëtare të Kosovës dhe me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës
51	Marrëveshje me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan
52	Marrëveshje me HYMERI KLEEMANN sh.a.

Universiteti ka gjithashtu bashkëpunim me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe regional në kuadër të projekteve Erasmus+, me të cilët ka krijuar ura bashkëpunimi në kuadër të projekteve, duke hapur rrugën edhe bashkëpunimeve të tjera institucionale, por edhe të aplikimeve për projekte të reja si vazhdimësi, si dhe në organizime të përbashkëta akademike.

Tabela 41 Lista e partneriteteve me Universitete dhe institucione të tjera në kuadër të projekteve Erasmus+

Nr	Institucioni	Vendi	Projekti E+
1	Universite Cote D’Azur	France	QUADIC
2	Technical University of Sofia	Bulgaria	QUADIC
3	University of Medicine Tiranë	Albania	QUADIC
4	University of Ljubljana	Slovenia	QUADIC
5	European University of Tirana	Albania	QUADIC
6	International University for Business and Technology	Kosovo	QUADIC
7	Universita Per Stranieri Di Perugia	Italy	QUADIC
8	University of Prishtina “Hasan Prishtina”	Kosova	QUADIC
9	University of “Haxhi Zeka”, Peja	Kosovo	QUADIC
10	Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”	Kosovo	QUADIC
11	Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”	Kosovo	QUADIC
12	International Business College Mitrovica	Kosovo	QUADIC

13	University Fan S Noli i Korçë	Albania	QUADIC
14	University of Durres “Aleksander Moisiu”	Albania	QUADIC
15	Heimerer College	Kosovo	QUADIC
16	UBT College	Kosovo	QUADIC
17	University of Prozeren “Ukshin Hoti”	Kosov	QUADIC
19	Universiteti i Podgoricës	Montenegro	ENEMLOS
20	Universiteti i Prishtinës	Kosova	ENEMLOS
21	Universiteti i Pejës	Kosova	ENEMLOS
22	Gjykata Supreme,	Montenegro	ENEMLOS
23	Oda e Avokatëve	Montenegro	ENEMLOS
24	Zyra e Prokurorit të Shtetit,	Montenegro	ENEMLOS
25	Oda e Noterëve	Montenegro	ENEMLOS
26	Oda e gjyqtareve	Montenegro	ENEMLOS
27	Qendra e Ndërmjetësimit	Montenegro	ENEMLOS
28	Gjykata Themelore	Kosova	ENEMLOS
29	Oda e Avokateve te Kosovës	Kosova	ENEMLOS
30	Universiteti Regent, Londër	United Kongdom	ENEMLOS
31	Fondacioni i Klinikave Ligjore të Polonisë	Poland	ENEMLOS
32	Universiteti i Zagrebit	Croatia	ENEMLOS
33	International Business College Mitrovica	Kosova	ResearchCult
34	Ministry of Education, Science and Technology	Kosova	ResearchCult
35	University of Prishtina “Hasan Prishtina”	Kosova	ResearchCult
36	University of “Haxhi Zeka”, Peja	Kosova	ResearchCult
37	University of Applied Science, Ferizaj	Kosova	ResearchCult
38	University of Prizren “Ukshin Hoti”	Kosova	ResearchCult
39	University of Mitrovica “Isa Boletini”	Kosova	ResearchCult
40	University of Gjakova “Fehmi Agani”	Kosova	ResearchCult
41	Institute for Research, Education and Social Development – IREDS	Kosova	ResearchCult
42	Sapienza University of Rome,	Italy	ResearchCult
43	University of Zagreb,	Croatia	ResearchCult
44	University of National and World Economy,	Bulgaria	ResearchCult
45	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	Kosova	QATEK
46	University of Ljubljana	Slovenia	QATEK
47	University of Tallin	Estonia	QATEK
48	University LUMSA in Rome	Italy	QATEK
49	Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”	Kosova	QATEK
50	Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”	Kosova	QATEK
51	Heimerer College	Kosova	SMAHPC
52	MEST	Kosova	SMAHPC
53	Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”	Kosova	SMAHPC
54	Metropolia University	Finland	SMAHPC
55	JAMK University	Finland	SMAHPC
56	MCBU University	Turkey	SMAHPC
57	NGO Autizmi	Kosova	SMAHPC
58	ISHLP Institute	Kosova	SMAHPC
59	European University of Tirana	Albania	e-VIVA
60	die Berater	Austria	e-VIVA
61	Blended learning institutions’ cooperative	Germany	e-VIVA
62	University of Duisburg-Essen	Germany	e-VIVA

63	NOVA Information Management School	Portugal	e-VIVA
64	Ss. Cyril and Methodius University in Skopje	North Macedonia	e-VIVA
65	Mother Teresa University	North Macedonia	e-VIVA
66	University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"	Albania	e-VIVA
67	University of Sarajevo	BeH	e-VIVA
68	University Sarajevo School of Science and Technology	BeH	e-VIVA
69	University of Donja Gorica	Montenegro	e-VIVA
70	University of Montenegro	Montenegro	e-VIVA
71	Universum College	Kosova	e-VIVA
72	University of Novi Sad	Serbia	e-VIVA
73	University of Niš	Serbia	e-VIVA
74	Staffordshire University	UK	EUFORIA
75	University Of Gjakova "Fehmi Agani"	Kosova	EUFORIA
76	Universiteti "Haxhi Zeka" Në Pejë	Kosova	EUFORIA
77	Bpral Riinvest Sh.A. (Riinvest	Kosova	EUFORIA
78	Universiteti I Prishtines (Up)	Kosova	EUFORIA
79	Hochschule Fur Angeëandte Eïssenschaften Munchen (Muas)	Germany	EUFORIA
80	University Of Zagreb	Croatia	EUFORIA
81	Universita Politecnica Delle Marche (Univpm)	Italy	EUFORIA
82	The Nottingham Trent University (Ntu)	UK	EUFORIA
83	Economic Chamber Of Kosova	Kosova	EUFORIA
84	Ngo Gratë Në Biznes (Gnb)	Kosova	EUFORIA
85	Hotel Dukagjini (Hd)	Kosova	EUFORIA
86	Ujë Rugove Sh.P.K. (Rugove)	Kosova	EUFORIA
87	N.P.T. "Trepfarm" (Trepfarm)	Kosova	EUFORIA
88	Neëco Jugoterm International L.L.C.(Enrad)	Kosova	EUFORIA
89	Universidade de Vigo	Spain	Green Tech
90	Universidade do Porto	Portugal	Green Tech
91	Universität Paderborn	Germany	Green Tech
92	University of Ljubljana	Slovenia	Green Tech
93	University of Economics In Katoëice	Poland	Green Tech
94	University of Split	Croatia	Green Tech
95	University of Chemical Technology and Metallurgy	Bulgaria	Green Tech
96	Universidad de León	Spain	Green Tech
97	University Fan S Noli i Korçë	Albania	Green Tech
98	Agricultural University of Tirana	Albani	Green Tech
99	University of Vlora "Ismail Qemali"	Albania	Green Tech
100	University of Sarajevo	BeH	Green Tech
101	Dzemaal Bijedic University of Mostar	BeH	Green Tech
102	University of Zenica	BeH	Green Tech
103	University of Mitrovica "Isa Boletini"	Kosova	Green Tech
104	University of Donja Gorica	Montenegro	Green Tech
105	University of Montenegro	Montenegro	Green Tech
106	University of Nis	Serbia	Green Tech
107	University of Kragujevac	Serbia	Green Tech

Falë bashkëpunimit të mirë si partner në Projektin Erasmus+ e-VIVA, UKZ bashkë me Universitetin Nova Lisboan në Portugali ka fituar projektin për shkëmbim të stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus + ICM.

Si rezultat i bashkëpunimit në kuadër të Projektit SMAHPC, UKZ ka fituar edhe dy projekte tjera ICM me Universitetin “Celal Bayar” të Manisas në Turqi. Njëri në vitin 2019 dhe tjetri në vitin 2020.

Tabela 42 Lista e marrëveshjeve ICM me Universitetet ndërkombëtare

Nr	Koordinatori	Numri i stafit	Buxheti	Kohëzgjatja
1	Manisa Celal Bayar University, Manisa-Turkey	14	Konfirmuar	2019-2022
2	Manisa Celal Bayar University, Manisa-Turkey	14	Konfirmuar	2020-2023
3	Nova Lisboa, Lisbonë, Portugali	16	Konfirmuar	2020-2023
4	Universiteti “Angel Kancev”, Ruse, Bullgari		Në pritje të konfirmimit	2020-2023
5	Universiteti i Mariborit, Maribor - Slloveni		Në pritje të konfirmimit	2020-2023

UKZ e sheh bashkëpunimin ndërkombëtar si shumë të rëndësishëm dhe për këtë arsye ZMJ në emër të Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në vazhdimësi mbanë [korrespondencë për lidhje të partneritetit me institucione të tjera të arsimit të lartë](#) dhe ka hyrë në diskutim për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe ICM

Tabela 43 Lista e partnerëve që UKZ ka vendosur kontakte për bashkëpunim

Nr.	Emri i institucionit	Vendi
1.	Aalto University -	Finland
2.	Åbo Akademi University	Finland
3.	Alma Mater Europaea -	Slovenia
4.	Arcada University of Applied Sciences,	Finland
5.	Budapest Metropolitan University -	Hungary
6.	Budapest University of Technology and Economics -	Hungary
7.	Centria University of Applied Sciences -	Finland
8.	Corvinus University of Budapest-	Hungary
9.	Diaconia University of Applied Sciences -	Finland
10.	Environmental Protection College -	Slovenia
11.	Eötvös Loránd University -	Hungary
12.	Eszterhazy Karoly University -	Hungary
13.	Euro-Mediterranean University (EMUNI) -	Slovenia
14.	Faculty of Applied Social Studies in Nova Gorica -	Slovenia
15.	Faculty of Design - Trzin -	Slovenia
16.	Faculty of Media Ljubljana -	Slovenia
17.	Faculty of Organisation Studies in Novo Mesto -	Slovenia
18.	Haaga-Helia University of Applied Sciences -	Finland
19.	HAMK – Häme University of Applied Sciences -	Finland
20.	Hanken School of Economics -	Finland
21.	Higher Education Center Novo Mesto -	Slovenia
22.	Jyväskylä University of Applied Sciences -	Finland
23.	Kajaani University of Applied Sciences -	Finland
24.	Kodolányi János University -	Hungary
25.	LAB University of Applied Sciences -	Finland

26.	Lappeenranta university of technology -LUT -	Finland
27.	Laurea University of Applied Sciences -	Finland
28.	Metropolia University of Applied Sciences -	Finland
29.	Milton Friedman University -	Hungary
30.	Neumann János University -	Hungary
31.	Nova Gorica University -	Slovenia
32.	Novia University of Applied Sciences -	Finland
33.	Oulu University of Applied Sciences -	Finland
34.	Saimaa University of Applied Sciences -	Finland
35.	Satakunta University of Applied Sciences -	Finland
36.	Savonia University of Applied Sciences -	Finland
37.	Seinäjäki University of Applied Sciences -	Finland
38.	Semmelweis University -	Hungary
39.	South-East Finland Mikkeli University of Applied Sciences	Finland
40.	Szent István University-	Hungary
41.	University of Dunaújváros-	Hungary
42.	University of Ljubljana -	Slovenia
44.	University of Miskolc-	Hungary
45.	University of Óbuda -	Hungary
46.	University of Pannon -	Hungary
47.	University of Pécs -	Hungary
48.	University of Primorska -	Slovenia
49.	University of Sopron -	Hungary
50.	University of Szeged -	Hungary
51.	UP Faculty of Management Koper -	Slovenia
52.	Agricultural University of Tirana, -	Albania
53.	Goce Delcev University of Stip, -	North Macedonia
54.	Maria Curie-Skłodowska University,	Poland
55.	Ostim Technical University -	Turkey
56.	Pegaso Telematic University, -	Italy
58.	Ruhr-University of Bochum,	Germany
59.	Sapienza University of Rome -	Italy
60.	St. Clement of Ohrid University of Bitola, Ohrid	North Macedonia
62.	University of G. d Annunzio Chieti – Pescara,	Italy
63.	University of “Constantin Brancusi” of Targu – Jiu”,	Romania
64.	University of “Džemal Bijedić”, -	Bosnia&Herzegovina
65.	University of “Kütahia Dumlupinar”, -	Turkey
66.	University of Bihać,-	Bosnia&Herzegovina
67.	University of Lucerne,	Switzerland
68.	University of Malta,- Msida	Malta
69.	University of Northern Iowa, -	United States
70.	University of Opolski -	Poland
71.	University of Pula, -	Croatia
73.	University of Sarajevo,	Bosnia&Herzegovina
74.	University of Tuzla,	Bosnia&Herzegovina
75.	University of Zagreb,	Croatia
76.	University of Zenica,	Bosnia&Herzegovina
77.	University Powiślańska Szkoła Wyższa,	Poland
78.	Agrarian University – Plovdiv,	Bulgaria
79.	American University in Bulgaria	Bulgaria
80.	Burgas Free University	Bulgaria

81.	College of Tourism Blagoevgrad	Bulgaria
82.	D. A. Academy of Economics – Svishtov	Bulgaria
83.	European Higher School of Economics and Management	Bulgaria
84.	European Polytechnical University	Bulgaria
85.	International Business School , Botevgrad	Bulgaria
86.	Medical University – Pleven	Bulgaria
87.	Medical University of Plovdiv	Bulgaria
88.	Medical University-Varna	Bulgaria
89.	National Sports Academy Vasil Levski	Bulgaria
91.	Plovdiv University Paisii Hilendarski	Bulgaria
92.	Shumen University Bishop Konstantin of Preslav	Bulgaria
93.	Sofia University	Bulgaria
94.	South-West University Neofit Rilski	Bulgaria
95.	St. Cyril and St. Methodius- University of Veliko Tarnovo	Bulgaria
96.	Technical University – Varna	Bulgaria
97.	Technical University of Gabrovo	Bulgaria
98.	Technical University of Sofia	Bulgaria
99.	Trakia University	Bulgaria
100.	University of Agribusiness and Rural Development	Bulgaria
101.	University of Architecture, Civil Engineering and Geodesy	Bulgaria
102.	University of Chemical Technology and Metallurgy	Bulgaria
103.	University of Economics – Varna	Bulgaria
104.	University of Finance, Business and Entrepreneurship	Bulgaria
105.	University of Food Technologies – Plovdiv	Bulgaria
106.	University of Forestry, Sofia	Bulgaria
107.	University of Library Studies and Information Technologies	Bulgaria
108.	University of Security and Economics	Bulgaria
109.	University of Transport Todor Kableshkov – Sofia	Bulgaria
110.	University prof. dr. Asen Zlatarov	Bulgaria
111.	Varna Free University	Bulgaria
112.	Varna University of Management	Bulgaria

11.4. Institucioni merr pjesë, ose si një udhëheqës ose si një partner, në projekte ndërkombëtare *Përputhshmëria e UKZ-së*

UKZ, që nga themelimi në vitin 2013 ka qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare. Deri më sot, UKZ ka qenë dhe është pjesë e 25 projekteve lokale dhe ndërkombëtare. Momentalisht UKZ është aktive në 9 projekte Erasmus+ për ngritje të kapaciteteve (Erasmus+ CBHE), ku një prej tyre edhe si udhëheqës/koordinator.

Tabela 44 Lista e vizitave studimore. (UKZ)

Nr	Projekti	Koodinatori
1	Projekti QUADIC – Koordinator	Universiteti “Kadri Zeka”
2	Projekti QATEK	Universiteti i Prishtinës
3	Projekti ResearchCult	IBCM
4	Projekti ENEMLOS	Universiteti i Podgoricës
5	Projekti SMAHPC	Kolegji Heimerer
6	Projekti eVIVA	UET

7	Projekti REBUS	Universiteti i Sarajevës
8	Projekti EUFORIA	Staffordshire University
9	Projekti GreenTech	Universiteti i Vigos
10	Projekti SIAHDPC	Heimerer College
11	Projekti STEAMedu	Universiteti i Mostarit
12	Projekti STAND	IBCM
13	Programi Fullbright	Ambasada Amerikane
14	Projekti LECU	Qeveria zvicerane
15	Projekti SHPRESE	Caritas Zvicran
16	Projekti KODE	Banka Botërore
17	Projekti OPTIMA	US Grants
18	Projektet me GIZ (3 projekte)	GIZ
19	Projekti “UP TO YOUTH	USAID
20	Projektet e studentëve në fushën e digjitalizimit	UKZ
21	Projektet me HERAS (3 projekte)	WUS Austria
22	Projekti me HERAS +	WUS Austria
23	ICM Erasmus +	MCBU 2019
24	ICM Erasmus +	MCBU 2020
25	ICM Erasmus +	Nova Lisboa 2020
26	Projekti me US Alumni	US Alumni Association/Ambasada Amerikane

Erasmus+ CBHE Projects

11.4.1 Projekti QUADIC si Koordinator

UKZ është Koordinator i një projekti në Erasmus +, me 18 partnerë vendor dhe ndërkombëtar, me buxhet prej 991,831.00 €. Projekti ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve për ndërkombëtarizim dhe shkrimin e menaxhimit të projekteve dhe do të zgjasë deri në vitin 2023. Projekti QUADIC ka të bëjë me ndërkombëtarizimin dhe ngritjen e kapaciteteve në shkrim dhe menaxhim të projekteve dhe përfshinë gjithsej 10 paketa punuese. Në kuadër të këtij projekti parashihet të krijohen zyrat për bashkëpunim ndërkombëtar dhe projekte nëpër ato universitete që ende nuk i kanë krijuar dhe të forcohen zyrat ekzistuese të universiteteve partnere që tashmë i kanë këto zyra. Gjithashtu, është krijuar edhe dokumenti kryesor, pra Strategjia për Ndërkombëtarizim, me të cilin do të caktohen prioritetet dhe mënyra e funksionimit të universiteteve kundrejt ndërkombëtarizimit dhe globalizimit. Poashtu në kuadër të projektit është edhe në proces krijimi i platformës digjitale për menaxhimin e marrëveshjeve dhe projekteve ndërkombëtare nga ana e partnerëve të konzorciumit dhe e cila do të mund të zgjerohet në të ardhmen me përfshirjen edhe të universiteteve dhe organizatave tjera që dëshirojnë të antarësohen. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të përmirësojë cilësinë në IAL-të në Kosovë dhe në Shqipëri; ndërtimi i kapaciteteve institucionale për marrëdhëniet ndërkombëtare; krijimi ose bërja e zyrave përkatëse plotësisht funksionale (përfshirë kapacitetin për menaxhimin e ciklit të projektit) në anëtarët e konsorciumit.

11.4.2 Projekti QATEK

Projekti QATEK, i cili ka për qëllim futjen e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në IALnë Kosovë për të zbatuar praktika të brendshme të sigurimit të cilësisë që çojnë drejt ngritjes së cilësisë së të diplomuarve që janë të aftë të çojnë përpara reformën e shkollës. Qëllimet specifike të këtij projekti janë: Zhvillimi i mekanizmave dhe proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë brenda institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, të cilat i përgjigjen treguesve specifik të cilësisë; Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e mekanizmave të

brendshëm të sigurimit të cilësisë në arsimimin e mësuesve nëpër fakultetet e Edukimit, duke përfshirë miratimin e politikës së personelit të FE dhe politikën e hartimit të lëndëve; Zhvillimi i kapaciteteve të stafit akademik në ofrimin e cilësisë së mësimdhënies si një nga treguesit në mekanizmin e brendshëm të cilësisë; Zbatimi i një procesi të plotë të sigurimit të cilësisë për të gjitha fushat përkatëse të edukimit të mësuesve (zbatimi i lëndës, rëndësia e programit, programi hulumtues, bashkëpunimi ndërkombëtar, shërbimet e studentëve, praktikat administrative dhe të menaxhimit, etj.).

11.4.3 Projekti ResearchCult

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ResearchCult është të mbështesë rritjen e kulturës së kërkimit në IALnë Kosovë, duke mbështetur zhvillimin e politikave dhe praktikave të mira, si dhe krijimin dhe instalimin e rregulloreve, strukturave dhe mekanizmave të rinj në institucionet përfituese të projektit në Kosovë. Projekti synon objektivat specifike: Vlerësimi i gjendjes aktuale të kapaciteteve kërkimore në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë; Rritja e stimulimit dhe mbështetjes së kërkimit duke themeluar zyra / qendra universitare dhe planet e tyre strategjike për të mbështetur aktivitete të vazhdueshme kërkimore midis institucioneve të tyre; Përmirësimi i strategjisë universitare për publikimin e punës kërkimore shkencore përmes zhvillimit dhe aprovimit të standardeve të njohura ndërkombëtare për revistat shkencore, si dhe krijimin e revistave shkencore ndër-institucionale në prioritetet kryesore të kërkimit në Kosovë; Promovimi i punës kërkimore përmes konferencës shkencore të përbashkët vjetore; Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve të kërkimit duke zhvilluar rregulloret për etikën dhe integritetin kërkimor, si dhe krijimin e komiteteve të etikës kërkimore në institucionet e arsimit të lartë; Lehtësimi i qasjes së rregullt në publikimin e hulumtimit dhe krijimin e një platforme / baze të dhënash në internet për qasje të hapur për akumulimin e njohurive kërkimore; Rritja e mundësive për publikimin e hulumtimeve përmes ngritjes së kapaciteteve tek kërkuesit e rinj në e artikujve për hulumtime sipas kriterëve dhe kërkesave për botimin e punës kërkimore.

11.4.4 Projekti ENEMLOS

Projekti synon zhvillimin profesional të studentëve të Fakultetit Juridik në UKZ dhe universitetet e tjera në Kosovë. Ky projekt do të jetë me një rëndësi të madhe në Kosovë, sepse ka mungesë të praktikës në studimet e Fakultetit Juridik. Studentët përfundojnë fakultetin e tyre të drejtësisë, dhe akoma ka mundësi që të mos kenë praktikë deri në fund të fakultetit të tyre. Për këtë arsye ne kemi përfshirë në kurrikulat tona lëndët klinika juridike, por problemi kryesor është se akoma edhe profesorët nuk dinë të praktikojnë lëndën. Deri vonë, klinikat juridike po ligjëroheshin si mësim në teori, por asgjë në praktikë. Nga viti 2016, ne kemi filluar t'i dërgojmë studentët tanë nëpër gjykata, prokurori, noteri, avokatë, përmbaues. Projekti do të synojë kryesisht studentët, në mënyrë që të rritet niveli i tyre i praktikës, i cili më pas do t'i ndihmojë ata në procesin e punësimit duke zhvilluar aktivitet profesional gjatë studimeve në klinikën ligjore. Klinika juridike mundëson zhvillimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta me qytetarë të ndryshëm, biznese apo klientë, gjë që i bën studentët të ndiejnë momentet më interesante që ata presin pas përfundimit të studimeve. Kjo ndikon në avancimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre praktike juridike. UKZ përveç që do të krojojë klinikat juridike në kuadër të Fakultetit Juridik, ajo gjithashtu do të përfitojë pajisje dhe libra nga titujt më të ri të fushës së drejtësisë në vlerë të përgjithshme prej 45,000.00 €.

11.4.5 Projekti SMAHPC

Projekti SMAHPC është projekt në partneritet me gjashtë partnerë kosovar dhe tre partner evropian, i cili ka për qëllim krijimin e Qendrave Multidisciplinare për studentë që ofrojnë shërbime, të cilat janë duke u implementuar me sukses. Koordinator i këtij projekti është Kolegji Heimerer. UKZ ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në implementimin e të gjitha

detyrave dhe përgjegjësi si partner. UKZ ka organizuar Kick Off meeting (takimin e parë të partnerëve) në Gjilan, ku kanë marrë pjesë më shumë se 50 pjesëmarrës nga i gjithë konzorciumi. Gjithashtu, kontribut të madh UKZ ka dhënë edhe në krijimin e Platformës Digjitale, e cila do të përdoret nga tre universitetet partnere nga Kosova. Staf akademik dhe administrativ ka marrë pjesë në të gjitha vizitat studimore dhe trajnimet që janë mbajtur tek partnerët. Poashtu janë krijuar edhe Teachers Handbook dhe Key Concepts për Qendrën Multidisciplinare. UKZ gjithashtu do të përfitojë pajisje teknologjike në vlerë prej 13,000.00 €.

11.4.6 Projekti eVIVA

Projekti e-VIVA është projekt në partneritet me Universitetin Evropian të Tiranës dhe me nga dy partnerë nga secili shtet i Ballkanit Perëndimor dhe partnerë nga Evropa, i cili ka të bëjë me validimin e kompetencave të studentëve në shërbime. Nga ky projekti do të përfitojnë direkt 30 studentë nga UKZ, të cilët do të trajnohen dhe do të licensohen me lincensa të njohura ndërkombëtarisht. Në kuadër të këtij projekti, UKZ ka organizuar fokus grupe me bizneset që ofrojnë shërbime, për të parë nga afër gjendjen dhe trendët e të punësuarve të rinjë dhe sa janë kompetent në shërbimet që ofrojnë. Gjithashtu, është bërë edhe një analizë e gjerë e kësaj çështje për mbarë territorin e Kosovës (desk research). Në kuadër të këtij projekti janë realizuar disa vizita studimore si në Lisbonë, Vienë, Essen, për partnerët me qëllim të aftësimit të stafit, të cilët do të ligjërojnë studentët sipas syllabuseve dhe lëndëve të përditësuara me analiza paraprake sipas zhvillimeve të fundit. UKZ ka përfutur edhe pajisje teknologjike për të lehtësuar implementimin e projektit në vlerë afërsisht 17,000.00 €.

11.4.7 Projekti REBUS

Projekti është i financuar nga programi për zhvillimin e kapaciteteve në arsimin e lartë, Erasmus +, nga Komisioni Evropian. Projekti REBUS (Ready for Business) ka si qëllim: Studentët tanë, të cilët do të jenë në gjendje të shkëmbejnë ide të ndryshme me studentët e universiteteve të tjera të cilat janë pjesëmarrës në këtë projekt. Ide të ndryshme inovative për realizimin e projekteve të tyre; Ide praktike dhe inovative, ku ndërlidhja me fushën e teknologjisë informative do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e ideve ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë; Përkrahja e studenteve dhe profesorëve nga projekti REBUS: Përkrahja me platformën Mahara, e cila ndihmon të ndërlidhë profesorët dhe studentët tanë me universitet tjera; Përkrahja e profesorëve dhe e studentëve që të trajnohen në Graz të Austrisë për një periudhë të caktuar. Pastaj këto njohuri studentët dhe profesorët pjesëmarrës ti shpërndajnë në universitetin tonë. Studentët e UKZ në Gjilan përfitues të programit për zhvillimin e shkathtësive ndërmarrëse nga projekti REBUS (REady for BUSiness), të financuar nga Erasmus + të Komisionit Evropian, nga 15 shtator deri më 1 tetor të vitit 2018 kanë qëndruar në Universitetin e Shkencave Aplikative Joanneum në Graz të Austrisë, ku pos tjerash në aktivitete të shumta, ata po kanë qenë pjesë e trajnimit për zhvillim të moduleve inovative, moduleve trajnuese nga ndërmarrësia dhe validimi i kompetencave, përmes të cilave, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi t'i shohin kërkesat dhe nevojat e tregut të punës.

11.4.8 Projekti EUFORIA

Projekti EUFORIA është projekti i parë i fituar si partner në programin Erasmus +. Qëllimi i këtij projekti ishte ndërlidhja e universiteteve me bizneset në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar vizita studimore dhe trajnime të ndryshme për të parë nga afër se si funksionon kjo lidhje mes universiteteve dhe bizneseve neper vendet evropiane, universitetet e të cilave janë partnere. UKZ ka qenë përfitues i madh në këtë projekt, sepse falë tij janë nënshkruar më shumë se 20 marrëveshje bashkëpunimi me biznese të ndryshme në Gjilan, për punë praktike për studentët e Fakultetit Ekonomik. UKZ ka krijuar edhe zyrën e vendosjes

(placement office) e cila mban kontaktet mes studentëve, UKZ dhe bizneseve. UKZ ka përfituar edhe pajisje teknologjike për të pajisur këtë zyrë në vlerë diku afër 20,000.00 €.

11.4.9 Projekti GreenTech

UKZ ka qenë pjesë e një projekti në Erasmus Mundus në partneritet me Universitetin e Vigos në Spanjë dhe me 24 partnerë tjerë evropian. Studentët dhe stafi i UKZ kanë përfituar bursa të plota për të studiuar në universitet partnere evropiane në këtë projekt. Janë realizuar gjithsejtë 9 mobilitete, në 3 thirrje të hapura për 3 vite sa ka zgjat projekti. 7 studentë nga fakultete të ndryshme të UKZ kanë përfituar bursa të plota studimi dhe qëndrimi në universitete si Universiteti i Paderborn në Gjermani, Universiteti i Splitit Kroaci, Universiteti i Ljublanës në Slloveni, Universiteti i Katvicës në Poloni. Studentët tanë janë treguar të suksesshëm dhe janë kthyer me nota shumë të larta për të vazhdat studimet e mbetura në UKZ. Gjithashtu, edhe stafi akademik në UKZ ka përfituar nga ky projekt. Një asistent ka përfituar bursë të plotë studimi për studime doktorale në Universitetin e Splitit në Kroaci, ndërsa një profesor ka përfituar trajnim dyjavor në universitetin e Vigos në Spanjë. Një profesor nga Universiteti i Leonit ka qëndruar gjithashtu në UKZ si pjesë e shkëmbimit të stafit.

11.4.10 Projekti SIAHDPC

Projekti SIAHDPC pritet t'u mundësojë IAL-ve të Kosovës që të kontribuojnë në mënyrë më efektive në fushën e shëndetit, duke përmirësuar cilësinë dhe rëndësinë e mësimdhënies të nevojshme për të trajtuar mospërputhjet e aftësive në të ardhmen. Poashtu si një impakt direkt do të jetë edhe zhvillimi i aftësive drejt një sistemi të arsimit të lartë më gjithëpërfshirës dhe më të lidhur. Ky projekt do të krijojë edhe lidhje të reja dhe më të forta bashkëpunimi midis "trekëndëshit" të arsimit, kërkimit dhe industrisë për nivele më të larta të efektivitetit dhe mekanizmave të financimit. Projekti do të mundësojë zhvillimin e njohurive në teknologji dhe njohuri të reja për kërkimin dhe zhvillimin. Poashtu do të krijohen qasje të adaptuara pedagogjike e të favorshme për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijimtarisë. Një numër i madh i trajnimeve do të mundësojnë stafit dhe studentëve më të mirë që të trajnohen për përfshirjen e përdoruesve, inovacionin dhe sipërmarrjen, praktikën e informuar nga dëshmitë dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor, së bashku me industrinë, klientët dhe aktorë të tjerë relevantë.

11.4.11 Projekti STEAMedu

Projekti STEAMedu do të hulumtojë se si të forcojmë edukimin STEAM, duke siguruar një udhërrëfyes për të adresuar zhvillimin e një eko-sistemi arsimor STEAM në zhvillim, duke përfshirë edhe krijimin e një programi studimor Master (MSc), shërbimet e bashkëpunimit me palët e interesit dhe në procedurat e vlerësimit vazhdueshëm. Konsorciumi do të miratojë një qasje hibride, duke lidhur me këtë kërkimin, aktivitetet dhe palët e interesit, të cilët janë të gatshëm të kontribuojnë drejt dy vendeve specifike dhe objektivat e BE-së për vitin 2020. Kursi MSc do të hartohet ashtu që do t'u mundësojë studentëve të saj të jenë në gjendje të frymëzojnë më shumë të rinj për t'u specializuar në STEAM gjatë edukimit të tyre në mënyrë që të ndërmarrin karriera shkencore dhe teknike. Pastaj për të adresuar boshllëqet gjinore dhe stereotipet në programet STEAM dhe të mbështesë përgatitjen e profesorit për këtë lëvizje të reformës arsimore. Kursi MSc do të hartohet në mënyrë që t'u sigurojë studentëve një të ardhme të avancuar dhe kuptim gjithëpërfshirës të debateve kryesore bashkëkohore në lidhje me STEAM, arsimin, përfshirë politikën, kurrikulën, pedagogjinë dhe çështjet e vlerësimit krahas shqetësimeve globale në lidhje me barazinë, drejtësinë sociale, rritjen ekonomike, ndryshimin e klimës dhe qëndrueshmërinë. Do të sigurojë një fokus ndërkombëtar dhe kombëtar, duke parë të dy sistemet formale arsimore dhe kontekstin më të gjerë të arsimit. Do të ketë një theks të fortë në kritikën e literaturave kërkimore dhe dokumenteve të politikave dhe zhvillimin e njohurive nga ana e metodologjive të kërkimit. Programi do të inkurajojë bashkëpunimin,

ndërtimin e rrjeteve profesionale dhe bërjen e pyetjeve kërkimore përkatëse për kontekstet dhe sfidat tona.

11.4.12 Projekti STAND

Projekti STAND synon të rrisë autonominë e universitetit në Kosovë. Ai kërkon të zhvillojë dhe azhurnojë si menaxhimin dhe qeverisjen e universiteteve të Kosovës, ashtu edhe kapacitetet e autoriteteve kombëtare për të modernizuar sistemet e tyre të arsimit të lartë duke mbështetur zhvillimin e modeleve adekuate të autonomisë, zbatimin dhe monitorimin e politikave të reformës në autonominë e universitetit. Me mbështetjen e vendeve nga BE-ja dhe partnerëve të tjerë të qarkut të programit, projekti synon të nxisë tranzicionin e sistemeve të arsimit të lartë të Kosovës drejt qeverisjes autonome dhe sistemit të qëndrueshëm financiar.

Si pjesë e projektit, partnerët me përvojë të vendit të programit dhe Evropës do të mbështesin partnerët e IAL-ve në Kosovë në Kartelën e Vlerësimit të Autonomisë së Universitetit duke përdorur metodologjinë e kartelës dhe zhvillimin e një modeli adekuat të autonomisë universitare në Kosovë. STAND gjithashtu do të formojë një grup konsultues (Rrjeti i Ekspertëve) me përfaqësues nga IAL në Kosovë pjesë e konsorciumit që do të këshillojë partnerët dhe do të sigurojë informata kthyesë mbi materialin udhëzues për autonominë e universitetit dhe do të mbështesë shpërndarjen e rezultateve në universitetet e tjera të Kosovës.

11.4.13. Projekti i bashkëpunimit me Universitetin e Zug-ut në Zvicër

UKZ dhe Univeristeti i Zugur zhvillojnë një projekt të përbashkët, nga viti 2017, për mobilitetin e studentëve dhe të stafit akademik. Cdo vit, një grup prej rreth 20 studentëve të Zvicres vijnë në një vizitë studimore në UKZ, dhe rreth 20 studentë të Fakultetit të Edukimit shkojnë në Universitetin e Zugut për vizitë studimore. Vizitat studimore zgjasin, sipas rasteve 7-10 ditë.

Poashtu, sipas interesit, edhe stafi akademik i këtyre dy universiteteve organizojnë visita studimore të ndërsjella.

11.4.14 Programi Fulbright

Ambasada amerikane ka financuar dy profesor të cilët kanë qëndruar në UKZ për një semestër, gjegjësisht një vit akademik. Një profesor ka ligjëruar në programin e përbashkët Master “Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike”, në kuadër të Fakulteteve Juridike të tri universiteteve partnere nga Kosova dhe një Asistent ka mbajtur ushtrimet në lëndën Gjuhë Angleze në Fakultetin e Edukimit. Të dy profesorët janë financuar nga Programi Fullbright i Ambasadës Amerikane.

11.4.15 Projekti LECU

UKZ ka qenë pjesë e projektit “Mësimi i kulturave nëpër univeristete”, ku koordinator ka qenë Universiteti i Zurich-ut në Zvicër. Stafi akademik nga FEd ka qenë pjesë e këtij projekti dhe ka marrë pjesë në të gjitha punëtoritë e organizuara: në Zurich, Shkodër; Mitrovicë, Tetovë dhe punëtorja e fundit do të organizohet në UKZ-Gjilan. Projekti është në vazhdim e sipër.

11.4.16 Projekti SHPRESE

UKZ është pjesë e projektit “Vendosja e Standardeve Para-shkollorë të Cilësisë së Lartë duke Përforcuar Arsimin, Shkencën dhe Ekonominë” (SHPRESE), përkrahur nga Caritasi zviceran. Qëllimi kryesor i këtij projekti është aftësimi i profesorëve dhe asistentëve nëpër fakultetet e Edukimit në Kosovë me metodat pedagogjike më të reja për aftësimin e studentëve të cilët do të jenë edukatorët e ardhshëm për moshat 1-5 vjeç. Stafi akademik ka qenë pjesë aktive e

trajnimeve të mbajtura nga Caritas, të cilët edhe kanë financuar krijimin e një salle me inventar dhe lodra, në mënyrë që profesorët të improvizojnë në punë praktike ligjëratat e tyre rreth edukimit për fëmijë, ku studentët nga ligjërata do të dalin në punë praktike.

11.4.17 Projekti KODE

UKZ është pjesë e Projektit KODE/NREN, të financuar nga Banka Botërore për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e punësimit përmes përfshirjes së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në veçanti mundësimin të qasjes në resurse të teknologjisë dhe dijes për studentë dhe profesorë të të gjitha universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë. Qëllimi i këtij Projekti është ngritja dhe zhvillimi i komunitetit të hulumtuesëve dhe zhvillimi i edukimit në Kosovë, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe mundësitë që ofron “Rrjeti Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës”, i cili pretendon që të arrij këtë zhvillim duke i siguruar këtij komuniteti qasje në resurse të ndryshme digjitale, si: qasje në infrastrukturë moderne të teknologjisë së informacionit, shërbime të ndryshme digjitale, qasje në literaturë, si dhe të ofrojë bashkëpunim në mes të institucioneve arsimore brenda dhe jashtë kufirit të Kosovës. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është duke e zbatuar Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), të financuar nga Banka Botërore dhe bashkë me Rrjetin për Hulumtim dhe Edukim të Kosovës (Kosovo Research and Education Network -KREN), kanë për mision mbështetjen dhe lehtësimin e kërkesave të komunitetit shkencor, edukativ dhe hulumtues, duke synuar një transformim digjital dhe nxitje në inovacion. Rrjeti kombëtar për hulumtim dhe edukim është duke ndihmuar universitetet në zhvillimin e inovacionit, hulumtimit dhe edukimit në Kosovë. Nëpërmjet këtij projekti do bëhet gjithashtu lidhja me rrjetin ndërkombëtar GEANT.

11.4.18 Projekti OPTIMA

Nga Programi i Ambasadës Amerikane për mbështetje të Universiteteve, UKZ është pjesë e Projektit OPTIMA, i cili ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të performances së mësuesve akademikë për sistemin Universitar të arsimit të lartë publik në Kosovë. Poashtu në kuadër të projektit, parashihet që të plotësohen nevojat specifike të universiteteve si dhe të adresohen shqetësimet e stafit akademik dhe të administratës në secilin universitet. Në project planifikohet që modeli të përfshijë edhe standardet dhe udhëzimet e duhura për cilësinë akademike dhe mësimdhënies siç përcaktohet nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe AKA. Objektivat kryesore të programit janë: Marrja e njohurive nëpërmjet rishikimit dhe vlerësimit të shtatë universiteteve publike mbi statutin e tyre në adresimin e standardeve të AKA-së për vlerësimin e punës së stafit akademik. Objektivi tjetër është arritja e koncenzusit për qëllimet e përgjithshme dhe qasjen e unifikuar për zhvillimin e një procesi të evaluimit të stafit akademik si dhe të hartohet një plan gjithëpërfshirës, që do të përdor një proces shumëhapësh për t’u zbatuar në çdo universitet sa i përket standardeve të akreditimit të AKA-së.

11.4.19 Projektet me GIZ

GIZ gjerman ka qene gjithmonë në mbështetje të iniciativave nga stafi i UKZ-së. Falë bashkëpunimit të mirë kemi arritur të organizojmë tre konferenca lidhur me pilot projektin “Klasa 1 deri 5- Një apo më shumë mësues”. Idenë për këtë projekt e ka dhënë stafi UKZ-së, i cili ka organizuar tri tryeza debatuese, ku ka ftuar personat përgjegjës si mësues, prindër, psikolog, përfaqësues të institucioneve. Janë diskutuar shumë aspekte se a do të mund të implementohet dhe a është i mirë për fëmijët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore. Ky projekt ka filluar të implementohet fillimisht si pilot në një shkollë fillore në Gjilan, dhe pas dy viteve, është zgjeruar edhe në disa shkolla tjera në Gjilan dhe në disa qytete të tjera në Kosovë. Pas

një viti të implementimit, është mbajtur konferenca, ku janë prezantuar të gjeturat nga hulumtimi në shkollën ku ka filluar të implementohet.

Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ, gjithashtu është mundësuar që të zhvillohen edhe disa trajnime me studentë dhe profesorë të Fakultetit të Edukimit. Janë mbajtur dy trajnime për studentë të Fakultetit të Edukimit “Vlerësimi Sumativ dhe Hartimi i Testit 1-9”. Poashtu studentët dhe profesorët e UKZ-së janë trajnuar për programin e hulumtimit dhe nxjerrjen e të dhënave “SPSS”.

Dhe në përfundim të projektit GIZ ka financuar edhe të gjitha programet e veta të trajnimit për Institutin e UKZ-së, duke i dhënë të gjitha programet e trajnimit Institutit të Fakultetit të Edukimit, me qëllim që Instituti të fillojë trajnimet e mësuesve në module të ndryshme, duke filluar edhe certifikimin e tyre dhe poentimin gjithashtu.

11.4.120. Projekti Up to Youth

Ky projekt financohet nga USAID dhe është i shtrirë në 9-të komuna të Republikës së Kosovës, ku do të angazhon rreth 40 të rinj. Projekti “Up Up Youth” i financuar nga USAID funksionon me të rinjtë e Kosovës nga mosha 16-24 vjeç të cilët janë të prekshëm nga përjashtimi social, duke i mobilizuar dhe fuqizuar ata për një ndikim pozitiv në shoqëri. Projekti synon rininë e marginalizuar, veçanërisht ata të nënvlerësuar nga iniciativat kapitale, me stres dhe traumë të pa adresuar, ose të prekshme nga zhvillimi i sjelljeve të rrezikshme. Programi punon për ndërtimin e aseteve dhe agjencive rinore, duke mundësuar të rinjtë të kontribuojnë dhe luajnë role udhëheqëse në komunitetet e tyre, duke ndërtuar dhe mbështetur rrjete dhe një mjedis që ofron mundësi për zhvillim pozitiv të të rinjve.

Qëllimi i projektit është të ndikojë pozitivisht te të rinjtë, të cilët nën moshën 24 vjeç përbëjnë 42% të popullsisë së Kosovës, nga ta 52% janë të pa punë dhe 30% i takojnë ekonomisë joformale. Duke u mbushur me ambicie dhe dëshirë për t’u integruar plotësisht në ekonominë globale, ndërsa janë të irrituar nga mundësitë që kanë në dispozicion, rinia do të luajë një rol kryesor në përcaktimin e të ardhmes politike dhe ekonomike të Kosovës, dhe zëri juaj të dëgjohet.

11.4.21 Projektet e studentëve në Fakultetin e Shkencave Politike/fushën e digjitalizimit
Në kuadër të fakulteteve organizohen edhe punë hulumtuese e shkencore edhe nga ana e profesorëve dhe studentëve.

UKZ dhe Komuna e Gjilanit kanë arritur bashkëpunim për digjitalizimin e shërbimeve të Stacionit të Autobusëve dhe shkollave të mesme në Gjilan. Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë prezantuar punën e tyre në përpilimin elektronik të orarit mësimor, ueb faqes së shkollave, digjitalizimin të punës dhe shërbimeve në stacionin e autobusëve si dhe aplikacionin për menaxhimin e pagesave dhe shërbimeve hoteliere me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për publikun me këtë rast shkollat dhe ndërmarrjet, e në të ardhmen edhe institucionet tjera publike dhe rrjetin e bizneseve në përgjithësi.

Vetëm në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në lëndën e Projektit hulumtues, e cila është lëndë mësimore obligative në semestrin e tretë janë bërë këto projekte:

- Komunikimet ndërmjet kompjuterit, pllakës elektronike Arduino Uno, Serial Monitor dhe VT 100, me programim në C++
- Ndërtimi i sistemit për kyçjen e çkyçjen e LED diodave të displeit 7 segmentësh duke programuar mikrokontrolerin ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++

- Ndërtimi i sitemit në prezentimin e shkronjave A, B, C, E dhe F në kohë të caktuar në displein 7 segmentësh në kohë të caktuar dhe programimi i mikrokontrolerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemin digjital përmes të cilit kryhet prezentimi numerik nga 99 gjer në 0 duke përcjellur punën e semaforit në udhëkryq dhe programimi i mikrokontrolerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit përmes të cilit 6 LED dioda me ngjyra të ndryshme ndriçojnë në kohë të caktuar dhe për një kohë tjetër nuk ndriçojnë, duke programuar mikrokontrolerin në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për prenotime të hapësirave hotelierike
- Ndërtimi i sistemit digjital përmes të cilit lexohen kodet e RFID kartelave përmes USB Reader dhe evidenton hyrjet e daljet e studentëve në salla mësimi në UKZ, duke programuar në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për: reklamimin Shitjen dhe distribuimin e barnave popullor të një farmacie popullore
- Ndërtimi i aplikacionit për caktimin e numrit të ulëseve të fituara në Asamblenë Komunale në zgjedhjet lokale në Luginë të Preshevës sipas sistemit të Dontit!
- Ndërtimi i sistemit digjital kopshti i “mençur” përmes pllakës elektronike Arduino Uno me mikrokontrolor ATMEGA 328P dhe programimi i tij në gjuhën programuese C++
- Zhvillimi evolutiv i PC në raport me zhvillimet në Sisteme të shpërndara kompjuterike
- Disa protokolle më të rëndësishëm në shtresën e aplikacionit dhe simulimi i tyre përmes Packet Tracer
- Baza të dhënash dhe Siste të shpërndara, Data Lake
- Krijim i disa qareve dixhitale të kombinuara përmes elementeve logjike AND (7409), OR(7432) dhe NOT
- Aplikimi i Google suite për punë ekipore në dokument tekstual, tabelar, prezantues dhe ueb
- Mikrokontroleri Arduinouno, përshkrim hardverik, softveri dhe programimi me C++ i disa projekteve praktike
- Roli i ruterit në WAN, zhvillimi evolutiv i tyre, konfigurimi dhe një simulim përmes Packet Tracer
- Uebaplikacioni "Vullnetarët e Shkencave Kompjuterike"
- Uebaplikacioni "Gjeje një zhvillues për projekt"
- Uebaplikacioni "Biçikleta për huazim"
- Uebaplikacioni "Turizmi në Kosovë"
- Ndikimi i Vizualizimit dhe Procesimit të Imazheve në Mjekësi.
- Roli i Memories në Grafiken e Kompjuterëve

11.4.22. Projektet me HERAS

UKZ ka qenë pjesë e 2 projekteve në HERAS dhe 2 projekteve në HERAS+:

Në mbështetje nga WUS Austria, programi HERAS në Kosovë, UKZ, gjegjësisht stafi dhe studentët kanë qenë përfutues të dy projekteve, të cilat janë financuar plotësisht nga ky program. Projekti i parë ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve në ndërkombëtarizim dhe në shkrim të projekteve në universitetet e reja publike në Kosovë. Koordinator i këtij projekti ka qenë Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Salzburg të Austrisë, ndërsa është udhëhequr nga UKZ. Në kuadër të këtij projekti, është realizuar vizita studimore në po këtë universitet më përfaqësues nga menaxhmenti i secilit universitet partner në Kosovë. Gjithashtu janë mbajtur edhe trajnime të ndryshme me stafin akademik dhe administrativ të secilit universitet. Projekti

IKAP	Monitorimi i programeve të financuara nga BE	2 days: 26.11.2020 27.11.2020
IKAP	Komunikimi i MSA-se	2 days: 20.10.2020

		21.10.2020
Akademia Diplomatike e Kosovës	Protokolli dhe mirësjellja	3 days: 02.12.2020 04.12.2020
EUFG	Mega Project	1 day 04.12.2020
EUTOPIA	The Researchers workshop	1 day 02.12.2020

UKZ u jep hapësirë të madhe studentëve dhe angazhimit të tyre në projekte. Për këtë arsye, UKZ në vazhdimësi shpallë thirrje për angazhim të studentëve në projekte, të cilët përveç ngritjes së kapaciteteve të tyre përfitojnë edhe financiarisht, duke u paguar për punën e bërë nga projekti.

Tabela 49 Studentët e angazhuar në projekte. (UKZ)

Emri	Mbiemri	Fakulteti/Drejtimi				
Arian	Leka	Juridik		Andi	Brestovci	Juridik
Drilona	Maloku	Juridik		Faton	Sherifi	e-governance (Master degree)
Aulona	Dushica	Juridik		Endrit	Ahmeti	Juridik
Meridian	Asllani	Shkenca Kompjuterike		Aurita	Sherifi	Juridik
Bletë	Emini	Shkenca Kompjuterike		Korab	Sylejmani	Ekonomik (Banka dhe Financa)
Erza	Gashi	Shkenca Kompjuterike		Atdhe	Miftari	Juridik
Valza	Tasholli	F. i Edukimit		Enesa	Syla	F. i Edukimit

11.7. Angazhimi në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kontributet për komunitetin përfshihen në kriteret e promovimit dhe në rishikimin e performancës së stafit

Përputhshmëria e UKZ-së

Strategjia e UKZ-së si pikë të veçantë ka edhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe si rrjedhojë mundëson që pjesëmarrja në bashkëpunime dhe projekte ndërkombëtare, si dhe kontributi i për komunitetin përfshihet në matjen e performancës.

Statuti i UKZ-së parasheh edhe vlerësimin e aktivitetit të personelit akademik në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kontributin për komunitetin. Neni 170 i Statutit të UKZ-së parasheh vlerësimin e përvojës afatgjate në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme, si kriter për promovim në gradën më të lartë akademike. Gjithashtu, rregullorja Për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimet e personelit akademik në UKZ, neni 5 ka kriter përvojën afatgjate në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme për promovim në gradën profesor doktor.

[Rregullorja për veprimtarinë kërkimore- shkencore](#) në UKZ, në nenin 2 thekson se stafi akademik vlerësohet për aktivitetin e tij të jashtëm në veprimtarinë kërkimore shkencore. Vlerësimi do të jetë bazë për avancimet akademike në Universitet. Puna e stafit akademik kalon nëpër një proces të matjes së performancës, ku edhe mundësohet avansimi sipas [Rregullores për Zgjedhje, Rizgjedhje dhe Avansime në UKZ](#) si dhe avansimi i stafit administrativ sipas [Rregullores për vlerësimin në punë për nëpunësit civil dhe publik nr.21/2020](#).

Neni 37 i rregullores për procedurat e cilësisë, gjithashtu vendos kriteret e qarta të vlerësimit të cilësisë së bashkëpunimit të jashtëm, kombëtar, ndërkombëtar, dhe marrdhëniet me publikun. Përmes këtyre mekanizmave UKZ-ja merrë në konsideratë aktivitetin për komunitetin, aktivitetet dhe pjesëmarrjen në bashkëpunim ndërkombëtar.

[11.8. Janë krijuar mekanizma për të mbështetur bashkëpunimin me institucionet, rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ndihma është dhënë për stafin mësimdhënës për të zhvilluar marrëveshje bashkëpunuese me komunitetin ndërkombëtar](#)

Përputhshmëria e UKZ-së

Strategjia e UKZ-së për ndërkombëtarizim krijon hapësirë për stafin që të marrin pjesë në projekte ndërkombëtare, të ngrisin kapacitetet e tyre për shkrim të projekt propozimeve, të hulumtojnë dhe të organizojnë së bashku me partnerë ngjarje dhe forume të ndryshme akademike, konferenca ndërkombëtare, etj. Qëllimi është që të rritet numri i bashkëpunimeve ndërkombëtre të UKZ-së, rritja e numrit të projekteve vdnëore dhe ndërkombëtare, rritja e anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë, rritja e mobilitetit të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve, rritja e kurseve dhe programeve në gjuhën angleze, rritja e të hyrave financiare dhe pajisjeve për UKZ, etj.

Universiteti ka një sër mekanizmash që stimulojnë pjesëmarrjen e stafit nëpër aktivitete ndërkombëtare, duke përfshirë projektet ndërkombëtare, pjesëmarrjen në hulumtime, në konferenca, simpoziume dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre.

UKZ-ja ka përcaktuar qartë në rregulloren për veprimtarinë kërkimore - shkencore në UKZ, përkrahjen financiare, përmes së cilës inkurajohet stafi që të bëhet pjesë e ngjarjeve ndërkombëtare. Prej tyre mund të krijohen kontakte të rëndësishme që në të ardhmen mund të prodhojnë bashkëpunime institucionale.

[Rregullorja për veprimtarinë kërkimore shkencore në UKZ](#), sipas nenit 5, 6 dhe 8 përcakton mënyrat, bartësit, financimin dhe organizimin e zhvillimit të bashkëpunimit me institucionet, rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare të arsimit të lartë. Kjo rregullore është bazë e mirë për intensifikimin e zhvillimit të gjithmbarshëm të stafit dhe institucionit në aktivitete dhe pjesëmarrje ndërkombëtare.

Neni 9 dhe 10 i rregullores për veprimtarinë kërkimore shkencore në UKZ, spjegon procedurat për realizimin e financimit të pjesëmarrjes në ngjarje ndërkombëtare dhe publikim të punimeve shkencore.

Me Rregulloren për ndërkombëtarizim, projekte dhe mobilitet, neni 5, 6 dhe 9 të pjesës së dytë mbi procedurat e për mobilitet është paraparë rëndësia e mobilitetit, qëllimet, synimet dhe procesin për rritje të pjesëmarrjes dhe dukshmërisë në ngjarje ndërkombëtare.

Kontributi i vecantë i stafit akademik në rritjen e dukshmërisë dhe pjesëmarrjes në ngjarje ndërkombëtare vlerësohet me mirënjohje nga Universitetet për çdo vit akademik.

Universiteti për këtë qëllim është bërë edhe pjesë e shumë rrjeteve ndërkombëtare, me qëllim të ofrimit të mundësive të shumta për stafin e vetë që të përfshihet në organizime ndërkombëtare

Bazuar në mekanizmat ligjor në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, UKZ i ka dhënë liri të plotë njësisë akademike që të iniciojnë marrëveshje, të aplikojnë për projekte lokale dhe ndërkombëtare, të iniciojnë antarësimet nëpër organizata ndërkombëtare etj.

Me vendim të Rektorit janë emëruar stafi nëpër fakultete si koordinator për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të projekteve, e ku detyra kryesore e tyre ka qenë që ta bëjnë stafin

më aktiv në ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve. ZMJ mbështet punën e koodinatorëve nëpër fakultete.

Deri më tani janë emëruar 5 koordinatorë për secilën njësi akademike, të cilët do të kujdesen për zhvillimin e ndërkombëtarizimit dhe projekteve.

Mekanizmat që UKZ ka ndërtuar garantojnë një përfshirje intensive në ngjarjet ndërkombëtare, përfshirë aktivitetet shkencore, hulumtuese, kërkimore, projekteve ndërkombëtare, mobilitet dhe dukshmërisë.

11.9. I gjithë stafi inkurajohet të marrë pjesë në forume ku diskutohen çështje të rëndësishme të komunitetit dhe konsiderohen plane për zhvillimin e komunitetit

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ dhe ZBN në bashkëpunim me partnerët e saj, si organizatat lokale, organizatat ndërkombëtare në Kosovë, organizojnë punëtori, ditë informuese dhe vazhdimisht inkurajojnë stafin të marrë pjesë nëpër forume, punëtori, konferenca, etj.

Rregullorja për veprimtarinë kërkimore shkencore në UKZ, sipas nenit 4, 5, 6 dhe 8 përcakton aktivitetet për realizimin e hulumtimeve, duke përfshirë forumet, puntoritë, seminarët si dhe bartësit, mënyrën e financimit dhe organizimin e zhvillimit të aktiviteteve në bashkëpunim me institucione të caktuara në interes të komunitetit.

UKZ ka organizuar, bashkorganizuar dhe ka marrë pjesë në disa forume si më poshtë:

1. Trajnimi i mesimdheneve për Luginën e Preshëvës

Si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit mes UKZ dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar , profesor të Fakultetit të Edukimit kanë qëndruar në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Komunën e Bujanocit me qëllim të [trajnitimit të mesimdhënëseve të mësimiit klasor dhe mësimiit lëndor](#) të shkollave shqipe të komunës së Bujanocit dhe Preshevës.

2. Pilot projekti me GIZ per shkolla

GIZ gjerman ka qene gjithmonë në mbështetje të iniciativave nga stafi i UKZ-së. Falë bashkëpunimit të mirë kemi arritur të [organizojmë tre konferenca lidhur me pilot projektin “Klasa 1 deri 5- Një apo më shumë mësues”](#). Idenë për këtë projekt e ka dhënë stafi UKZ-së, i cili ka organizuar [tri tryeza debatuese](#), ku ka ftuar persnat përgjegjës si mësues, prindër, psikolog, përfaqësues të institucioneve. Janë diskutuar shumë se a do të mund të implementohet dhe a është i mirë për fëmijët dhe mesimdhënësit e shkollave fillore. [Ky projekt](#) ka filluar të implementohet fillimisht si pilot [në një shkollë fillore në Gjilan](#), dhe pas dy viteve, është zgjeruar [edhe ne disa shkolla tjera](#). Pas një viti të implementimit, është mbajtur [konferenca](#), ku janë prezantuar të gjeturat nga hulumtimi në shkollën ku ka filluar të implementohet.

3. Punëtorja e USAID me raste reale

UKZ dhe Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë, respektivisht FJu, me mbështetjen e Aktiviteti i USAID-it Drejtësia Vlen dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, kanë organizuar diskutimin në lidhje me [“Klinikat Juridike me raste reale”](#). Në këtë drejtim Klinikat Juridike me raste reale luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjithë dhe kjo ditë është e rëndësishme dhe e veçantë pasi që shënon pikënisjen e një projekti madhor për të zgjeruar projektin sikurse në klinikën juridike me raste të vërteta edhe me klinika të tjera.

FJu i UKZ në bashkëpunim me USAID programi Drejtësia Vlen, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, organizuan një Tryezë të Rrumbullakët për publikimin e raportit: [Hartëzimi i Nevojave të Komunitetit për Drejtësi 2019](#), në kuadër të Javës së të Drejtave të Njeriut.

4. Projektet e FSHK për stacionin e autobusëve dhe Shkollat e mesme

Studentët e UKZ në bashkëpunim me mentorët e tyre, [zhvilluan digjitalizimin e shërbimeve në ndërmarrjen publike “Stacioni i Autobusëve” dhe digjitalizim të shkollave të mesme, përmes ueb fageve](#), në mënyrë që dy nivelet e institucioneve, në këtë rast Komuna dhe Universiteti të jenë përfituese. Aktiviteti u ofron qytetarëve informacione të mjaftueshme, ndërsa studentëve njohuri praktike se si të punohet praktikisht në profesionin e tyre.

5. Konferenca për MSA dhe implementimin e MSA

Qendra Kosovare për Diplomaci ka organizuar konferencën me temë “Roli i MSA-së dhe liberalizimit të vizave në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve”, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve qeveritare, akademike, përfaqësues të OJQ-ve, të sigurisë, të rinjë studentë dhe të pranishëm të tjerë. [Konferenca trajtoi përfitimin e shtetit të Kosovës me MSA-në dhe liberalizimin e vizave si procesi i domosdoshëm](#). Me diskutimet e tyre kontribuan edhe përfaqësuesit e UKZ-së, duke paraqitur pikëpamjet dhe rrugën që duhet ndjekur në realizimin e aspiratave euro-atlantike.

6. Fokus grupi me biznese që kryejnë shërbime në kuadër të Eviva

[UKZ nëpërmjet projekti Erasmus+ eVIVA ka krijuar lidhje me biznese që ofrojnë shërbime në komunitet](#), me qëllim që krijojë fokus grupin, i cili do të ndihmojë zhvillimin e ideve për të promovuar biznesin që ofron shërbime në Kosovë dhe në të njëjtën kohë të ngritë nivelin e kompetencave në ofrimin e shërbimeve. UKZ është pjesë partner në Projektin ERASMUS+, e-VIVA, projekt ky i cili na ndihmon të bëjmë validimin e kompetencave në shërbim të studentëve, të cilët në të ardhmen do të jenë kompetent për fushën që kanë diplomuar dhe do të jenë të certifikuar me certifikatë të njohur ndërkombëtarisht. Universiteti gjithashtu ka caktuar koordinatorin për bashkëpunim me biznese, i cili si detyrë kryesore ka bashkëpunimin me bizneset dhe mirëmbajtjen e këtij bashkëpunimi në intervale të rregullta. Ai gjithashtu merret edhe me krijimin e mundësive për punë praktike dhe punë të përhershme për studentët dhe alumnit e UKZ-së.

Poashtu gjatë hartimit të secilit program studimor duhet të bëhet konsultimi i të gjithë mekanizmave këshidhënës, palëve të interesit dhe alumnive të UKZ-së. Ata japin kontribut të çmuar dhe konsiderohen si një vlerë e shtuar në hartimin sa më kualitativ të programeve studimore.

7. Organizimi i forumeve dhe punëtorive në bashkëpunim me OSBE

UKZ së bashku me OSBE-në kanë organizuar ngjarje dhe aktivitete të ndryshme. [Është realizuar punëtorja mbi të drejtat pronësore](#), bazuar në përvojën e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Qëllimi i trajnimit është të rrisë njohuritë e studentëve për tema e të drejtave pronësore të tilla si: shpronësimi, tatimi në pronën e paluajtshme, uzurpimi ilegal i pronës, banimi social, planifikimi hapësinor dhe menaxhimi i tokës komunale.

[UKZ dhe OSBE në bashkëpunim me forumin e grave gjyqtare dhe prokurore kanë organizuar diskutimin “Gra të suksesshme në drejtësi dhe qeverisje”](#). Në punëtori kanë marrë pjesë stafi akademik, studentë dhe pjesmarrës të tjerë për demokratizimin dhe transparencën e institucioneve.

[UKZ dhe OSBE kanë organizuar serinë e ligjëratave për qeverisjen e mirë](#). Përmes ligjëratave do të trajtohen çështje kritike të qeverisjes dhe do t'iu siguroj pjesëmarrësve – studentëve, ekspertëve, përfaqësuesve të OJQ-ve dhe medie – mundësi që të propozojnë veprime që mund të shprien në politika më të mira. Në të cilën kanë marrë pjesë figura të rëndësishme të fushës. UKZ dhe OSBE kanë organizuar së bashku edhe tryezën debatusë/“16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore”.

[11.10. Marrëdhëniet krijohen me industrinë lokale dhe punëdhënësit për të ndihmuar shpërndarjen e programeve \(këto mund të përfshijnë angazhimin e studentëve për programet e studimit të punës, mundësitë e punësimit me kohë të pjesshme dhe identifikimin e çështjeve për analizë në aktivitetet e projektit të studentëve\)](#)

Përputhshmëria e UKZ-së

Nënshkrimi i marrëveshje të bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera për punë praktike të studentëve, varësisht nga fusha e studimit ka ndikuar në krijimin e raporteve ndërmjet UKZ-së dhe bashkëpunorëve.

UKZ synon të bashkojë forcat me institucionet që ndajnë të njëjtat qëllime dhe të ofrojnë ndihmë profesionale, por gjithashtu të investojnë në ide të reja që do të zhblokojnë potencialin e inovacionit në sektorë të ndryshme në Kosovë. Prandaj, në fazën aktuale synojmë të arrijmë objektiva duke bërë sigurimin e ekspertizës akademike dhe profesionale, përdorimin e pajisjeve më të reja teknologjike, krijimin e kanaleve të reja të komunikimit me qendrat e inovacionit në Kosovë dhe rajon, ndërtimin e urave ndërmjet investitorëve të mundshëm dhe sipërmarrësve.

UKZ ka krijuar BKI, përmes të cilit realizohen më lehtë bashkëpunimet, krijohet kontakte dhe zhvillohen proceset ndërmjet UKZ dhe bashkëpunorëve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi futen praktikat profesionale të studentëve, punësimi i pjesëshëm i studentëve, fokus grupet për zhvillimin e strategjisë dhe programeve të institucionit, punëtoritë e përbashkëta për zhvillimin e hulumtimeve, analizave të ndryshme profesionale. Krijimi i BKI të UKZ është produkt i rezultateve të projektit Erasmus+ EUFORIA.

UKZ gjithashtu ka caktuar nga FEK, [koordinatorin për biznese](#) i cili ka për detyrë mirëmbajtjen e kontakteve të vazhdueshme në mes të institucionit dhe partnerëve, partnerëve potencial dhe palëve të tjera të interesit. i gjithashtu merret me krijimin e mundësive të reja për punë praktike, punë të pjesëshme dhe të përhershme për studentët dhe alumnit e UKZ-së.

UKZ ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e bashkëpunimit me biznese, qoftë si ndërmarrje institucionale apo edhe përmes projekteve nacionale dhe ndërkombëtare, të cilat janë të cekura më poshtë.

1. Joint Venture Group në kuadër të projektit Erasmus+ SMAHPC

Nga projekti SMAHPC, në partneritet me Kolegjin Heimerer mbi krijimin e Qendrave Multidisciplonare, është krijuar edhe Joint Venture Group. Këtë grup, UKZ e ka krijuar dhe ka caktuar edhe stafin akademik i cili do të jetë përgjegjës për punët e këtij grupi. Grupi ka për detyrë zhvillimin e ideve, proceseve që kanë të bëjnë me rritjen e ofrimit të shërbimeve multidiciplinare brenda hapsirave universitare.

2. UKZ ka realizuar fokus grupin me biznese që ofrojnë shërbime në kuadër të projektit Erasmus+ eVIVA

Në kuadër të projektit E-viva, në UKZ është mbajtur fokus grupi me disa përfaqësues të bizneseve në Gjilan. Në këtë takim është biseduar në përgjithësi për arsimimin në lidhje me kompetencat që ndërliken me shërbimet, e në veçanti për marketingun, mbështetjen e palëve të treta, ofrimin e programeve të studimit që ndikojnë në rritjen e kompetencave në shërbimet, metodologjinë dhe validimin e tyre.

3. Qendra Multidisciplinare SMAHPC për ofrim të shërbimeve qytetarëve

Projekti SMAHPC ka për qëllim krijimin e Qendrave Multidisciplinare për studentë që ofrojnë shërbime. UKZ ka angazhaur edhe studentët që të jenë pjesë e këtij projekti, ata kanë dhënë kontribut për dizajnimin e qendrës multidisciplinare dhe mënyrën se si duhet të funksionoj kjo qendër. Studentët janë pjesë kryesore e qendrës ku do të ofrohen shërbimet nga ta dhe duhet të jenë të informuar saktësisht rreth krijimit, shërbimeve dhe menaxhimit që nga fillimi i implementimit e deri tek fillimi i punës së kësaj qendre.

4. Krijimi i Klinikave Ligjore për ofrim të shërbimeve juridike e përkrahur nga USAID dhe nga projekti Erasmus+ ENEMLOS

Bashkëpunimi që ka UKZ me partnerët e tij akademik u mundëson studentëve të orientojnë njohuritë e tyre në tregun aktual, ata ndërtojnë njohuritë e tyre bazuar në kërkesat e tregut. Punëdhënësit do të jenë në gjendje të identifikojnë punonjësit e tyre të ardhshëm. Studentët që marrin pjesë në klinikën ligjore kanë mundësi më të lartë për t'u angazhuar në punë gjatë studimeve dhe pas përfundimit të tyre. Profesorët, asistentët dhe bashkëpunëtorët tjerë do të kenë mundësinë për të rritur dhe zhvilluar njohuritë e tyre profesionale për praktikën që do të zhvillojnë me studentë dhe aktorë të tjerë në klinikën ligjore.

Grupet e marginalizuara janë ato që do të përfitojnë këshilla pro bono nga zbatimi i projektit. Me ofrimin e kësaj ndihme, këto grupe rrisin vetëdijen e realizimit të interesave të tyre kundër proceseve të ndryshme që mund të kenë. Mbështetja e këtij projekti për përfshirjen e studentëve dhe profesorëve në një klinikë arsimore juridike është një mundësi e favorshme që ndihmon në rritjen e efikasitetit në punë. Ndikon në zhvillimin e studentëve dhe profesorëve, kontribuon në avancimin e aftësive të tyre profesionale.

UKZ ka lidhur marrëveshje për praktika të studentëve si dhe ka fituar projekte, të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Marrëveshjet me Drejtoritë Komunale të Arsimit për Komunën e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës, Ferizajit, Kacanikut, Hani i Elezit
- Projekti me USA Alumni për praktikën e studentëve
- Projekti në UKZ për praktikë të studentëve e përkrahur nga Bordi i UKZ-së
- Praktika në Postën e Kosovës
- Praktika në Agjencionin e Privatizimit të Kosovës
- Praktika në Gjykatën Themelore në Gjilan
- Praktika në zyret e Avokatisë
- Praktika në zyret e noterëve

11.11. Punëdhënësit vendas dhe profesionistët janë të ftuar të bashkohen në komitetet përkatëse këshillimore ose njësitë e tjera strukturore duke marrë parasysh programet e studimit dhe aktivitetet e tjera institucionale

Përputhshmëria e UKZ-së

Gjatë zhvillimit të të gjitha proceseve të rëndësishme në UKZ, institucioni fton për të marrë pjesë palët e interesit.

Në hartimin e strategjisë zhvillimore të UKZ, rishikimin e saj janë ftuar të gjitha palët e interesit, duke përfshirë institucionet publike, bizneset, përfaqësuesit e OJQ, mediat, programet e ndryshme që veprojnë në Kosovë dhe partnerët tjerë. Dokumentet e rëndësishme të UKZ-së vëhen në diskutim publik, ku të gjitha palët mund të japin kontributin e tyre në përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të tyre.

Punëdhënësit lokal dhe profesionistët janë të përfshirë në trupat punuese që zhvillojnë programe studimore nëpër NJA.

UKZ gjithashtu nëpër këto trupa përfshinë edhe studentët alumni, të cilët nga këndvështrimi i tyre japin rekomandime për institucionin.

Në të gjitha organizimet e saj, sic janë përvjetorët, ceremonitë e diplomimit, dita e universitetit dhe evente të tjera, ftonë përfaqësuesit e institucioneve publike, punëdhënësit, përfaqësuesit e bizneseve, OJQ-të, mediat dhe faktorët tjerë të rëndësishëm për institucionin.

Një nga objektivat më të rëndësishme për [Bordin Këshillëdhënës Industrial](#) (BKI) është të kontribuojë në suksesin strategjik të UKZ dhe të programeve studimore të fakulteteve të tij. BKI fokusohet në aspektet e marrëdhënies së mësimi akademik dhe tregut të punës, pra në ndërlidhjen sa më të mirë të programeve studimore me biznesin dhe industrinë. BKI do të trajtojë çështje siç është, përcaktimi i hapave që kërkohen për të përmirësuar dhe zgjeruar marrëdhëniet aktuale të programeve studimore të UKZ me biznesin dhe industrinë, ajo do të ndihmojë UKZ që të ndërtojë një imazh më të mirë, do të ndihmojë në ndërlidhjen e perspektivës industriale në programet universitare, të ofrojë kontribut në përmirësimin e kursit dhe kurrikulës në drejtim të perspektivës industriale dhe njëherësh do të ndihmojë që programet studimore të UKZ, të tërheqin grante kërkimore, projekte të dizajnuara nga studentët, organizimin e praktikës së studentëve etj. Gjatë përpilimit të programeve të reja por edhe në ristrukturimin e programeve ekzistuese, UKZ fton BKI për të marrë opinion dhe për të par nga afër trendet e zhvillimit të fushave për të cilat është bërë aplikimi për programe. Ata janë anëtar të komisioneve hartuese dhe bwhet një studim i fizibilitetit për secilin program, madje dekanëve të fakulteteve ju kërkohet që të zhvillojnë programe bashkëpunimi konkret me anëtarët e BKI në realizimin e synimeve të përbashkëta.

UKZ nëpërmjet projekti Erasmus+ eVIVA ka krijuar fokus grupin, i cili do të ndihmojë zhvillimin e ideve për të promovuar biznesin që ofron shërbime në Kosovë dhe në të njëjtën kohë të ngritë nivelin e kompetencave në ofrimin e shërbimeve.

Koordinatori për bashkëpunim me biznese nga kontakti i vazhdueshëm me biznese, transmeton idetë e tyre rreth programeve të reja studimore apo edhe rreth përmirësimit të programeve ekzistuese.

11.12. Kontakti i rregullt mbahet me alumnin, duke i mbajtur ata të informuar rreth zhvillimeve institucionale, duke ftuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete dhe duke inkurajuar mbështetjen e tyre për zhvillimet e reja

Përputhshmëria e UKZ-së

UKZ mban kontakt të rregullt me ish studentët ose alumnit, duke ju ndihmuar dhe ofruar mundësi të ndryshme në avansimin e tyre. Ata gjithashtu ftohen në hartimin e programeve të reja studimore si dhe në rishikimin dhe riakreditimin e programeve studimore në UKZ.

Për këtë arsye UKZ ka krijuar edhe [regjistrin e Alumnive](#) dhe një sërë dokumentesh të tjera.

Zyrtarja e Alumnive informon alumnit për çdo mundësi për studime jashtë shtetit në programe Master apo doktoaturë. Ajo informon për çdo mundësi apo konkurs për punë që publikohet në

Republikën e Kosovës. Ajo informon për cdo mundësi apo konkurs për punë praktike nga cilido institucion apo biznes në Kosovë.

UKZ mbanë ë informuar dhe fton në të gjitha ngjarjet me interes lumnit, sic janë përvjetori i Universitetit, pastaj dita e diplomimit, ku në këto ceremoni një alumni nga secili fakultet paraqet sukseset e saj/tij pas diplomimit, duke dhënë shembull edhe për te tjerët. UKZ nëpërmjet koordinatorit për biznese mundohet të krijojë mundësi të reja për punë për alumnit e UKZ-së.

Tabela 50 ANALIZA SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Angazhimi Institucional për Ndërkombëtarizimin – Prioritizimi i ndërkombëtarizimit Zbatimi i projekteve Erasmus + e në veçanti projektit QUADIC Infrastruktura ekzistuese (zyrat ekzistuese IR dhe PM) Staf ekzistues me kapacitete të mira në ndërkombëtarizim dhe projekte Bashkëpunimi aktual ndërkombëtar dhe projektet e përbashkëta Anëtarësimet në rrjetet ndërkombëtare Numër i madh i studentëve të angazhuar në ndërkombëtarizim, mobilitete, projekte Përvojë në organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare Strategji, dhe rregullore për ndërkombëtarizim, projekte dhe lëvizshmëri Pjesëmarrje aktive në konsorciume, projekte dhe grante ndërkombëtare Interes i shtuar nga menaxhmenti, stafi akademik dhe studentët e Universitetit për lëvizjen ndërkombëtare (dalëse dhe hyrëse). Lidhja e stafit me stafin e universiteteve në Evropë dhe me gjerë Bashkëpunimi aktual ndërkombëtar dhe projekte të përbashkëta Përdorimi i përvojës nga rrjetet ekzistuese p.sh. BUA, ENAI, EUF, ELFA, etj.	Mungesa e kurseve të ofruara në gjuhën angleze Mungesa e programeve në gjuhë të huaj; Zotësi joadekuate e personelit në gjuhën angleze Alokimi i pamjaftueshëm i buxhetit për ndërkombëtarizimin dhe zhvillim të projekteve Mungesa e trajnimit të vazhdueshëm për stafin në ndërkombëtarizim dhe projekte Mungesa e platformave / programeve të menaxhimit të projekteve dhe mobiliteteve Mungesa e përvojës në zhvillimin dhe menaxhimin e projektit
MUNDËSITË	RREZIQET
Mbledhja e fondeve të financimit të granteve kombëtare dhe të huaja Projektet Erasmus + / Heras dhe donatorë të tjerë Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë Programet e përbashkëta midis IAL-ve kombëtare Programet e studimit në gjuhë të huaj Përdorimi i mësimi në distancë dhe miratimi i teknologjive më të fundit të informacionit dhe komunikimit Shfrytëzimi i inovacioneve në pajisjet dixhitale. Platforma e menaxhimit të projektit ResearchCult Platforma e menaxhimit të projektit QUADIC Programet e përbashkëta studimi për bachelior, master and PhD me partnerë Evropian/ndërkombëtarë të Arsimit të Lartë Projektet Horizon 2020	Ulja e numrit të studentëve të rinj Politikë qeveritare jo konsistente Konkurrencë e fortë e universiteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar Jo gatishmëria e stafit për tu përfshirë në projekte ndërkombëtare për shkak të gjuhës dhe përvojës Kërcënimet pandemike Mungesa e buxhetit për aktivitete kërkimore, artistike dhe kulturore. Çështja e liberalizimit të vizave Zvogëlimi i donatorëve çdo ditë e më shumë Rritje e numrit të IAL-ve që aplikojnë për projekte

Tabela 51 Rekomandimet e Ekspertëve nga procesi i akreditimit 2017

Rekomandimet e Ekipit të Ekspertëve në RVV 2017	Plani implementues i rekomandimeve nga Universiteti	Komentet relevante
<i>Rekomandim i rëndësishëm afatshkurtër: Të themelohet Bordi Këshilldhënës Lokal.</i>	Është hartuar <i>Rregullore për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshilldhënës të UKZ-së, Nr. 01/268-1</i> , dt.23.02.2017. Është themeluar BKI më 30.05.2018.	Është përmbushur
<i>Rekomandim i rëndësishëm afatmesëm: Të realizohen aktivitete të përbashkëta me palët e interesuara lokale, të cilat koordinohen nga Bordi Këshilldhënës Lokal.</i>	Janë mbajtur takime me BKI. Janë mbajtur takime konsultative me hisedarë, si: me drejtoritë e arsimit në komunat e Kosovës Lindore, me Gjykatat, me përfaqësues të bizneseve Takimet konsultative me Alumnin. Hulumtimi i Alumnit.	Është përmbushur
<i>Rekomandim afatmesëm: Të përmirësohet plani i zhvillimit të strategjisë, i cili u prezantua gjatë vizitës në terren; dhe të zhvillohen tregues për matjen e progresit, në nivelin e lartë dhe gjithashtu në nivelin e projektit. Menaxhmenti për cilësi mund të jetë përgjegjës për të monitoruar gjendjen dhe për të raportuar progresin tek rektorati dhe Këshilli Drejtues i Universitetit.</i>	KD ka miratuar Rregulloren për mbikëqyrjen e zbatimit të PSt. KD ka formuar Grupin që mbikëqyr zbatimin e PSt dhe progresin e shënuar. Grupi për mbikëqyrje raporton periodikisht për rezultatet e arritura dhe dobësitë. Merren vendime për përmirësimin e dobësive. Raportet e Grupit Mbikëqyrës publikohen në veb faqen e Universitetit.	Është përmbushur
<i>Rekomandim më pak i rëndësishëm: Të diskutohet dhe nëse është e nevojshme të miratohet misioni.</i>	KD ka marrë vendim për rishikimin e Strategjisë zhvillimore të UKZ si dhe të misionit. GP e ka rishikuar misionin dhe ka bërë disa përmirësime të nevojshme.	Është përmbushur
<i>Të krijohet një plan i detajuar i ndërkombëtarizimit duke përfshirë: përparësitë, burimet organizative dhe financiare.;</i>	Është miratuar Strategjia për Ndërkombëtarizim dhe Projekte 2020-2025 Është miratuar Rregullorja për Ndërkombëtarizim Është hartuar PV Është krijuar zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar	Është përmbushur
<i>Të arrihen marrëveshje me universitete të huaja.</i>	UKZ ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me universitete, Organizata, OJQ dhe Institucione vendore dhe ndërkombëtare. Sot UKZ numëron 90 MoU.	Është përmbushur
<i>Të krijohet zyra për marrëdhënie ndërkombëtare për koordinimin e aktiviteteve të ndërkombëtarizimit</i>	Në vitin 2018, UKZ ka krijuar Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Sot kjo zyrë ka dy zyrtarë dhe funksionon normalisht dhe në bashkëpunim të plhtë me prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar angazhohen në mbarëvajtjen dhe implemtimin e projekteve ndërkombëtare, monitoron procesin e shkëmbimeve të stafit dhe studentëve, përcjell mbarëvajtjen e MoU.	Është përmbushur
<i>Të zhvillohet një plan i ri kërkimor, i cili mund të përkrah veçanërisht: projektet ndërdisiplinore ndërmjet fakultetesh; projektet kërkimore të aplikuara me industrinë dhe qeverinë; thirrjet për grante të</i>	Është hartuar Strategjia për Hulumtime Shkencore Studentët e FSHK kanë zhvilluar projekte me bizneset (stacioni i autobusëve dhe komunat); Projektet hulumtuese të studentëve me HERAS	Është përmbushur

<i>brendshme (ndërdisciplinore) kërkimore; projektet transdisiplinare të studentëve;</i>		
<i>Të përfshihen studentët dhe palët e tjera të interesit (alumni, punëdhënësit, personeli akademik) në hartimin dhe përshtatjen e programeve;</i>	UKZ në të gjitha fazat e hartimit të programeve studimore angazhon në grupet punuese studentë, alumni, profesorë dhe asistentë, si dhe hisedarë të jashtëm nga të gjitha fushat	Është përmbushur
<i>Të zhvillohen metodat e mësimdhënies duke marrë parasysh dhe duke përdorur metoda të ndryshme, kur është e përshtatshme, të zhvillohen mënyra të ndryshme të të mësuarit;</i>	Stafi akademik është orientuar tek mësimdhënia interaktive me studnetin në qendër, me punën e pavarur të studentëve, zhviollimi i mendimit kritik; Janë organizuar trajnime për metodologji të mësimdhënies Janë organizuar trjname për format e vlerësimeve;	Është përmbushur
<i>T'u jepet studentëve pyetëtori i vlerësimit pas çdo semestri për lëndët që kanë ndjekur, t'u prezantohen rezultatet dhe të sigurohen që ka masa vijuese si rezultat i matjes së kënaqësisë së studentëve;</i>	ZZHAC ka pregaditur pyetësorët për studentë, duke vlerësuar profesorët për lëndët që ata kanë ligjëruar ZZHAC harton raportin përfundimtar, i cili bëhet publik ne ueb të UKZ KMCV është krijuar si organ që mbikëqyr, mbështet dhe harton politikat e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë	Është përmbushur
<i>Të sigurohet një koordinim më i mirë midis stafit gjatë hartimit të planprogrameve, në mënyrë që të shmangen shkeljet ose, nëse ka, të sigurohet komunikim i mjaftueshëm për këto shkelje për studentët;</i>	Këshillat e Fakulteteve krijojnë grupet punuese për secilin program studimor; Në këto grupe punuese marrin pjesë stafi akademik dhe studentët; Diskutimi dhe bashkëpunimi ndodh në kuadër të KF dhe aty votohet përfundimisht; Diskutimi dhe votimi përfundimtar ndodh edhe në Senat; Komunikimi i shëndoshë mundësohet dhe ndihmohet edhe nga ZZHAC	Është përmbushur
<i>Të sigurohet pjesëmarrja e studentëve në të gjitha komisionet e Senatit të UKZ-së, jo vetëm në Komisionin për studime dhe të sigurohet përfaqësimi i studentëve nga të gjitha fakultetet, nëse është e mundur.</i>	Studentët me Statut janë të përfaqësuar në të gjitha organet menaxheriale të UKZ Ata marrin pjesë në të gjitha Komisionet e përhershme të UKZ-së; Marrin pjesë në grupe punuese për të gjitha politikat strategjike për UKZ	Është përmbushur
<i>Të zhvillohen mundësi për punë praktike për studentët dhe të mundësohet një procedurë për matjen e cilësisë së praktikave, me përfshirjen e mësuesve mentorë;</i>	KD ka miratuar Rregulloren për praktikën e studentëve në UKZ KD ka ndarë një buxhet për pagesë të studentëve për praktikë; UKZ ka lidhë marrëveshje bashkëpunimi që ju mundësojnë studentëve punë praktike nëpër biznese dhe institucione publike ZZHAC ka krijuar edhe pyetësorët për vlerësimin e punës praktike për studentë Praktika e studentëve është futur si lëndë obligative për studentë në FSHK, Juridik, Master QLSHD	Është përmbushur

<i>Të rritet përqendrimi në aktivitetet e orientimit për karrierë;</i>	Është caktuar një zyrtar për karrierë Është bërë regjistri i alumneve Organizohen takime me alumni; Organizohen panairë të punës për alumni; Informohen për konkurse të punës Alumni ftohet të marrë pjesë në hartimin e të gjitha dokumenteve strategjike të UKZ	Është përmbushur
<i>Të hartohet një plan i qartë dhe shumë konkret për zhvillimin e kërkimit shkencor me tregues dhe afate të qarta;</i>	Është hartuar Strategjia për Hulumtim me objektivat e veta Secili staf akademik duhet të publikojë minimumi një punim shkencor mbrenda vitit	Është përmbushur
<i>Të investohet një pjesë e buxhetit në kërkime shkencore;</i>	UKZ ndanë një buxhet prej 10,000.00 € UKZ nga projektet Erasmus+ ka fituar për hulumtim një buxhet prej 133,440.00 €	Është përmbushur
<i>Të përkrahet stafi në zhvillimin e aftësive të tyre kërkimore;</i>	Është hartuar Rregullorja për mobilitet dhe mbështetje financiare Është hartuar Rregullorja për veprimtari shkencore në UKZ Është hartuar Rregullorja për KB Rritja e aplikimeve për projekte ndërkombëtare (Erasmus+) dhe kombëtare	Është përmbushur
<i>Të përcaktohet qartë dhe të vihet në praktikë një aneks mësimor - kërkimor për kategoritë individuale të stafit;</i>	Punimet individuale të stafit akademik janë të listuara në listën e punimeve dhe ato përdoren nga SA për procesin mësimor pasi të miratohen nga KF Njëjtë vlenë edhe për monografitë	Është përmbushur
<i>Të përkrahet lidhja midis mësimdhënies dhe hulumtimit të studentëve;</i>	Praktika dhe hulumtimi studentor është bërë pjesë e të gjitha programeve studimore; Realizohet si: Praktika Profesionale, Projekti Hulumtues, Seminarët, Praktika Pedagogjike etj.	Është përmbushur
<i>Procedurat e sigurimit të cilësisë të lidhen me zhvillimin e kërkimit;</i>	Zhvillimi i hulumtimit tek stafi është i përfshirë tek Treguesit e performancës Procedurat e Sigurimit të Cilësisë bëhen në bazë të Treguesve të Performancës	Është përmbushur
<i>Të vazhdohet një politikë punësimi me fokus në kategori specifike të personelit;</i>	UKZ ka krijuar një politikë të ngritjes së kapacitetit me SA në përputhje me Planin Strategjik 2017-2020	Është përmbushur
<i>Të krijohen strategji të zhvillimit të stafit me një fokus specifik në kategoritë individuale të stafit;</i>	UKZ ka lidhë marrëveshje me QPM e UP UKZ është në proces të krijimit të QPM (Plani Strategjik 4.1 dhe 4.7) Stafi i UKZ është pjesë aktive e projekteve Erasmus+	Është përmbushur
<i>Të identifikohen individët për studime PhD dhe t'u sigurohet atyre një mbështetje e mjaftueshme;</i>	UKZ ka targetuar asistentë të rinjë, të cilët janë mbështetur për studimet PhD dhe të cilët janë angazhuar në mësimdhënie.	Është përmbushur/ Në proces
<i>Procedurat e sigurimit të cilësisë të lidhen me zhvillimin e stafit;</i>	UKZ ka rishikuar Planin Strategjik UKZ ka miratuar Rregulloren për Cilësi dhe Vlerësim Ka miratuar Treguesit e Performancës UKZ ka miratuar MVP	Është përmbushur
<i>A mund të sqaroni arsyen (et) e statutit të anëtarit të vëzhguesit për studentët në Këshillin Drejtues?</i>	Kjo është e rregulluar kështu me Statutin e UKZ. Statuti i UKZ miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Kjo nuk varet nga UKZ

<i>A mund ta shpjegoni në detaje Planin e Zhvillimit, në lidhje me parashikimet e Buxhetit?</i>	UKZ ka një buxhet vjetor të ndarë nga Qeveria e Kosovës dhe ky shpenzohet për paga dhe mëditje, ndërsa një pjesë e konsiderueshme ndahet për plotësimin e objektivave strategjike të UKZ (shih annexin për buxhet) Një pjesë e madhe e fondeve vijnë edhe nga Projektet Erasmus+	Është përmbushur
<i>Në procesin e përzgjedhjes së stafit, Komisioni Recensues duhet të përbëhet nga një minimum anëtarësh (1/3) nga universitete të tjera ose institucione të jashtme (të huaja ose jo).</i>	Në të gjitha Komisionet Recensuese, minimumi një nga anëtarët është nga ndonjë universitet tjetër nga Kosova ose jashtë Kosovës;	Është përmbushur
<i>Një "renditje" e përparësive do të ndihmonte UKZ-në të zhvillohet në fusha të ndryshme.</i>	UKZ ka rishikuar Planin Strategjik dhe ka amandamentuar objektivat dhe prioritetet për zhvillimin e tij	Është përmbushur
<i>Të sigurohet një parashikim realist i buxhetit të UKZ-së dhe të ndërlidhet parashikimi buxhetor me planin strategjik të zhvillimit të UKZ-së.</i>	Buxheti ndahet nga Qeveria e Kosovës; Zhvillimi i projekteve bëhet në bazë të prioritetëve (shih standardin 2.2); Projektet Erasmus+ përdoren për ngritje të stafit.	Është përmbushur
<i>Të rritet numri i librave në dispozicion në bibliotekë dhe të sigurohet një bibliografi minimale për çdo lëndë dhe të vazhdoen përpjekjet për dixhitalizimin e burimeve të disponueshme në bibliotekë;</i>	Libraria është rritur dhe rinovuar Numri i teksteve është rritur vazhdimisht UKZ ndanë mjete buxhetore për blerjen e teksteve çdo vit; UKZ ka blerë libra edhe nga projektet Erasmus+ UKZ ka miratuar Rregulloren për KB UKZ ka krijuar Këshillin Botues	Është përmbushur
<i>Duhet të themelohet Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe të pajiset me fuqi punëtore të mjaftueshme menjëherë;</i>	Është themeluar ZZhAC Është zgjedhur drejtori; Janë emëruar edhe 5 koordinator për cilësi Është krijuar KMCV	Është përmbushur
<i>Të përcaktohen objektiva të duhura dhe të qarta për standardet e cilësisë, duke përfshirë kriteret dhe treguesit e duhur për vlerësimin e arritjes së objektivave.</i>	Është rishikuar PSt i cili përcakton qartë objektivat strategjike për sigurim të cilësisë, Është rishikuar Rregullorja për sigurim të cilësisë dhe vlerësimit, Janë përcaktuar qartë Fushat e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit	Është përmbushur
<i>Të sqarohen përgjegjësitë dhe detyrat e komisioneve dhe këshillave të ndryshëm dhe palëve të tjera të përfshirë në aktivitetet e Sigurimit të Cilësisë.</i>	ZZhAC KMCV Koordinatorët për Cilësi nga çdo njësi akademike. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve janë të përcaktuara me rregullativën e Universitetit Organet bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë dhe përmisimit të cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë brenda Universitetit. Përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit dhe KMCV janë sqaruar në Rregulloren për sistemin e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë	Është përmbushur
<i>Të qartësohet lidhja, bashkëveprimi dhe ndarja e punës midis të gjithë</i>	Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të cilësisë si në vijim:	Është përmbushur

<i>komisioneve dhe agjentëve të rëndësishëm për aktivitetet e Sigurimit të Cilësisë.</i>	Implementon Planin e Veprimit për Cilësisë të aprovuar nga Senati. Mbledh informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë mekanizmat brenda universitetit Në bashkëpunim me KMCV dhe Koordinatorët për Cilësi organizon procesin e vlerësimit të brendshëm sipas MVP, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual. Shpërndan pyetësorët, mbledh , përpunon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e vlerësuar sipas planit Ofron mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së Universitetit. I ofron mbështetje njësive akademike përmes Koordinatorëve për Cilësi Koordinon punën në mbështetje të Njësive Akademike për procesin e Ri/Akreditimit Institucional dhe të programeve studimore bazuar në Udhëzuesit dhe standardet e AKA-së. Mirëmban dhe i shqyrton dokumentacionin e procesit të ri /akreditimit, përgatitë raporte dhe analiza përkatëse Në përmbushje të detyrave , zyra bashkëpunon me të gjitha organet përgjegjëse për sigurimin dhe përmisimin e cilësisë në UKZ KMCV është organ i cili bashkëpunon me organet e tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit I cili planifikon , harton, miraton, monitoron,analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor,dhe të gjitha vlerësimet që mbulohen nga Universiteti. Koordinatori për cilësi është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë; në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike Koordinatori këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike	
<i>Të shtjellohen objektivat për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kriteret përkatëse.</i>	Është hartuar Rregullorja për Sigurim dhe Vlerësimin. Rregullorja për sigurim të cilësisë dhe vlerësimit ka përcaktuar objektivat për ngritje të cilësisë në mësimdhënie . Manuali për vlerësimin e stafit akademik; Udhëzuesi për vlerësimin e stafit akademik nga ana e studentëve	Është përmbushur
<i>Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies të lidhen me kushtet e zhvillimit të stafit akademik.</i>	Rezultatet e vlerësimeve e ndikojnë zhvillimin e stafit akademik si në zgjedhje, rizgjedhje apo emërimë në pozita menaxheriale duke pas për bazë rezultatet e të gjitha vlerësimeve të parapara me Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performances së Stafit Akademik.	Është përmbushur

<i>Të trajnohen të gjithë agjentët relevantë të Sigurimit të Cilësisë për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre të plotë në proceset dhe aktivitetet e Sigurimit të Cilësisë.</i>	Duke qenë pjesë e disa projekteve ndërkombëtare (Erasmus+) dhe vendore si Qatek dhe Optima, UKZ , me një përfshirje të gjerë nga stafi akademik dhe administrativ është duke krijuar në vazhdimësi mekanizma për ngritje të cilësisë .	Është përmbushur, por edhe në proces
---	--	--------------------------------------